KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO FINANCIARE NË ISH KOMUNAT E QARKUT FIER, QENDËR, TOPOJË, CAKRAN, FRAKULL, LEVAN, DËRMËNAS DHE LIBOFSH

Programi i auditimit: Nr. 276/2, datë 13.03.2017 dhe shtesës nr. 276/4, datë 04.05.2017
Periudha e Auditimit: Nga data 01.01.2013 deri me datë 30.07.2015
Afati i Auditimit: Nga data 15.03.2017 deri me datë 12.05.2017

-QERSHOR 2017-

Përmbajtja:	**Faqe**
Lista e shkurtimeve të përdorura	**3**
I. Hyrje	**4**
II. Qëllimi i Auditimit	**4**
III. Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes së audituar	**4-5**
IV. Kriteret e Vlerësimit	**5-7**
V. Standardet e Auditimit të aplikuara në auditim	**7**
VI. Përmbledhje procedurës audituese të kryer	**7-8**
VII. Gjetjet e auditimit	**8-25**
VIII. Opinion për auditimin e përputhshmërisë	**25-26**
IX. Rezultatet e auditimit me sqarimet për përgjigjet e subjektit	**26-230**
IX/1. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimet e mëparshëm	26-31
IX/2. Auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Komunave	31-40
IX/3. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (pagat dhe shpërblime etj.)	40-60
IX/4. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Nxjerrja e llogarisë vjetore (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive të pasurisë publike. Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i vlerave materiale.....	60-75
IX/5. Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime e shërbime.....	75-152
IX/5.1. Zbatimi i kontratave të punimeve.....	152-158
IX/6. Auditim mbi realizimin e të ardhurave nga taksa t e tarifat vendore...	158-191
IX/7. Auditimi në fushën e Planifikim e Zhvillim Territorit.....	191-208
IX/8. Auditimi mbi administrimin e aseteve, procedurën e dhënies me qira të aseteve.....	208-219
IX/9. Auditimi për zbatimin e procedurave për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara në ish Komuna.....	219-228
IX/10. Auditim i Inspektorati Vendor Mbrojtjes Territorit.....	228-230
X. Rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.....	**230-236**
ANEKSE me numër nga 1-13.....	**236-247**

Lista e shkurtimeve të përdorura në material

KLSH	-	Kontrolli i Lartë i Shtetit
INTOSAI	-	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme
ISSAI	-	Institucionet Supreme të Auditimit.
VKM	-	Vendim i Këshillit të Ministrave
KM	-	Këshilli i Ministrave
IMTV	-	Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendor
ZVRPP	-	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
KVO	-	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
DPZHT	-	Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit
KRRT	-	Këshilli i Rregullim Territorit
VKK	-	Vendimi i Këshillit të Komunës
EKB	-	Enti Kombëtar i Banesave
PPV	-	Plani Përgjithshëm Vendor
AKPT	-	Agjencia Kombëtare e Planifikim Territorit.
OE	-	Operator Ekonomik.
AK	-	Autoriteti i Konkurrencës.
APP	-	Agjencia e Prokurimit Publik.
LPP	-	Ligji i Prokurimit Publik.
NJHDT	-	Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit.
DT	-	Dokumente Tenderi
SNA	-	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	-	Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve
IDI	-	Iniciativa e Zhvillimit të INTOSAI-t

Ky Raport Përfundimtar i Auditimi u përgatit bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, në afatet e duhura kohore dhe që garantoi një proces ballafaqimi.

I. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vijim KLSH*) auditoi ish Komunat e Qarkut Fier si, ***Qendër, Topojë, Cakran, Frakull, Levan, Dërmënas dhe Libofshë***, në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 276/2, datë 13.03.2017 ndryshuar me nr. 276/4, datë 04.05.2017, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me rregullshmërinë e procedurave të ndjekura në përputhje me kërkesat e aktet ligjore e nënligjorenë zbatimin e detyrave të lëna në auditimin e mëparshëm, për hartimin dhe realizimin e buxhetit, për miratimin e strukturave organike e zbatimin e tyre si dhe ndërtimi marrëdhënieve të punës në institucion, për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, për prokurimet me fonde publike, për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, për shqyrtimin dhe miratimin e planeve zhvillimore, për dhënien e lejeve të zhvillimit, të shesheve e lejeve të ndërtimit, për administrimin e aseteve, për dhënien me qira të objekteve pronë publike dhe tokave me qira dhe për funksionimin e IMTV.

II. <u>Qëllimi i Auditimit (fokusi)</u>:

Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare, vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, integritetin dhe përputhshmërinë e vendimeve administrative, si dhe funksionimin e IMTV.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 276/2, datë 13.03.2017 ndryshuar me nr. 276/4, datë 04.05.2017, për periudhën nga data 01/01/2013 deri me datë 30/07/2017.

III. <u>Identifikimi dhe Përshkrimi i çështjes që është audituar</u>.

Në veprimtarinë tonë audituese jemi fokusuar dhe mbështetur në:

Verifikimin e aktiviteteve të kryera për realizimin e produkteve të çdo programi të klasifikuara sipas funksioneve të njësive vendore, kontributin e produkteve në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të çdo programi.

Sistemet e menaxhimit dhe transaksionet nëse janë në përputhje me aktet ligjore, aktet normative dhe rregulloret në fuqi;

Përputhshmëria ligjore e prokurimet me vlera të vogla dhe me vlera të mëdha (procedurën e tenderimit);

Përputhshmëria ligjore lidhur me administrimin dhe kontabilizimin e aktiveve, hartimin dhe zbatimin e buxhetit;

Përputhshmëria ligjore e planifikimit dhe arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore;

Përputhshmëria ligjore në administrimin dhe menaxhimin e aseteve të kaluara në pronësitë njësive vendore;

Përputhshmëria ligjore në administrimin dhe dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi ose jo të njësive vendore.;

Për këtë jemi mbështetur në hartimit e pyetësorëve të ndryshëm, si dhe kryer testime mbi transaksionet financiare, jemi mbështetur në kombinimin e intervistave, rishikimeve analitike,

rishikimin e dokumenteve për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e veprimeve në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të veprimtarisë së subjektit të audituar.
Gjendja aktuale e çështjes së shqyrtuar është në fazën, kur grupi i auditimit është paraqitur Projektraport Auditimi dhe nga subjekti audituar janë paraqitur shpjegimet dhe kundërshtitë në lidhje me problematikat e konstatuara me shkresën nr. 2085/132, datë 13.06.2017 (prot KLSH nr. 276/12, datë 16.06.2017).
Për këtë grupi i auditimit analizojë me kujdes paanshmëri dhe profesionalizim kundërshtitë e subjektit si ato të paraqitura në formë shkresore dhe ato të cilat u ballafaquan në takimin përmbyllës të zhvilluar në ambientet e KLSH me datë 19.06.2017 ora 10.^{oo}, duke i trajtuar në bazë të argumenteve ligjorë të paraqitur, ku për rastet të cilat nuk kanë gjetur shpjegim, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

IV. Kriteret e vlerësimit.

Kriteret janë piketa (standarde ISSAI 4100) që përdoren për të vlerësuar ose matur njësinë që auditohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të arsyeshme. Kuadri rregullator (autoritet) është burimi i kritereve. Kriteret burojnë nga ligjet, politikat, rregullat, rregulloret dhe instrumente të tjerë dhe duhen për të vlerësuar shkallën e përputhshmërisë ose të mos përputhshmërisë.
Auditimi është kryer, mbi bazën e testimeve, komunikimin e vazhdueshëm me stafin dhe specialistët e subjektit objekt Auditimi, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë dhe të qartë për zbatimin e përputhshmërisë se në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.
Auditimi është kryer me zgjedhje, ku për kryerjen e tij grupi i auditimit është mbështetur në dokumentacionin ligjor të paraqitur nga subjekti i audituar, evidencat e ndryshme në format të printuar dhe elektronik, në të dhënat elektronike të prokurimeve *(marrë dhe nga sistemi www.app.gov.al)*, si dhe në ballafaqimin e problemeve nëpërmjet kontakteve verbale e shkresore me subjektin e audituar.
Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:
-llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;
-procedurat e mekanizmave të Auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;
-nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;
-anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimit, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;
-ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe;
-shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve;
-vlerësimin me objektivitet, profesionalizim dhe paanshmëri i observacioneve të paraqitura nga subjekti audituar.
Ish Komunat aktivitetin e tyre e kanë mbështetur në ligje bazë e të veçanta dhe akte nënligjore në zbatim të tyre për secilën fushë të aktivitetit të saj si:

Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015"Për vetëqeverisjen vendore";.
-Në fushën e buxhetit dhe administrimin financiar:
Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
Ligji nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013";

Ligji nr. 185/2013, datë 2.12.2013 "Për buxhetin e vitit 2014";
Ligji nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015";
-Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare.
Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, .i ndryshuar ligjin nr. 9477,datë 9.2.2006;
-Në fushën e prokurimeve publike:
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik".*
-Në fushën e marrëdhënieve të punës dhe shpërblimeve:
Ligji nr. 152/2013, datë 01.10.2013 "Për Nëpunësit Civil", i ndryshuar;
Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatim mbi të ardhurat", i ndryshuar;.
-Në fushën e administrimit taksave dhe tarifave vendore:
Ligjin nr. 9632,dt. 30.10.2006*"Për sistemin e taksave vendore".*
Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar";
Ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
-Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit territorit:
Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar me ligjin nr. 10258, datë 25.03.2010, me ligjin nr. 22/2013 dhe ligjin nr. 110/2013, datë 01.04.2013;
Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin e punimeve në ndërtim", i ndryshuar, me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007
Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013;
Ligji nr. 10433 datë 16.06.2011" Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
-Për administrimin e pronës publike:
Ligji nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme";
Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar";
-Për Tokat, Pyjet dhe Kullotat:
Ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara";
Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural";
Ligji nr.8752, datë 26.03.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës";
Ligji nr. 57/2012 "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të Ish-Ndërmarrjeve Bujqësore";
Ligji nr.9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar;
Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor";
Ligji nr. 8337, datë 30.4.1998 "Për kalimin në pronësi të tokave bujqësore, pyjore, livadhe dhe kullota";
VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara";
VKM nr. 121,datë 17.02.2011 "Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga Drejtoritë e administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarqe dhe Zyrat e menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Komuna dhe Bashki";
VKM nr. 1064,datë 22.12.2010,"Për disa ndryshime në VKM nr. 391,datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave";
Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore;
Udhëzimi i KM nr.2 datë 13.06.2013 "Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)";
-Të tjera:
Ligji nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në zbatim;
Ligj nr. 9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë";

Ligji nr. 8480,datë 27.05.1999"Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve ";
Ligji nr. 8485,datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të RSH" (i ndryshuar).
Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", pjesa V, kreu I, Akti administrativ, nenet 98-102.

V. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e auditimit

Auditimi në ish Komunat Qendër, Topojë, Cakran, Libofshë, Levan, Frakull dhe Dermenas është kryer në bazë të Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të miratuar në Korrik të vitit 2015, i cili bazohet në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 3, pika 5, dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe konkretisht:

ISSAI 100– (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

Standardet Auditimit të cilat bazohen ose janë në konsistencë me (**ISSAI 400**) Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë niveli 3 **(ISSAI 100 - 999**) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

ISSAI 4000 – 4100"Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë";

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC; Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituese; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë".

VI. Përmbledhje e procedurës audituese të kryer.

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi ish Komunat Qendër, Topojë, Cakran, Libofshë, Levan, Frakull dhe Dërmenas, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme auditimit të përputhshmërisë se në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi, e cila konsiston në:

Miratimin dhe realizimin e buxhetit; mbajtjen e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen, shqyrtimi dhe dhënien e opinionit për pasqyrat pasqyrave financiare (bilanci) dhe saktësia e tyre në evidentimin dhe pasqyrimin e shpenzimeve dhe të ardhurave nga taksat e tarifat vendore; gjendjen, evidentimin, ndjekjen, sistemimin dhe arkëtimin e debi-kredive; administrimin e marrëdhënieve të punës; prokurimet në investime, blerje mallrash e shërbimesh dhe zbatimin e kontratave; procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, të lejeve të zhvillimit dhe përdorimit; administrimin e aseteve dhe dhënia me qira e tyre.

Për realizimin e funksioneve të saj të sanksionuara me ligjin organik të Pushtetit Vendor në shërbim të komunitetit ka përllogaritur kostot aktiviteteve për realizimin e produkteve të programeve sipas funksioneve dhe ka kryer buxhetin e tyre. Pra ka planifikuar dhe përdorur fonde për kryerjen e një sërë shërbimesh *(përmisim të rrjeteve rrugore, mirëmbajtje kanale vaditëse dhe kulluese, mirëmbajtjeje të ambienteve shkollore dhe parashkollore, etj.)* dhe investimesh në dobi të komunitetit si, në drejtim të asfaltimit të rrugëve, mbrojtjes nga përmbytjet, rikonstruksionit të shkollave, përmirësimit të rrjetit të ujësjellës kanalizimit, etj.

Objektivi i auditimit, është të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 1320), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, sigurimi i një evidence Auditimi të mjaftueshme, përkatëse dhe të besueshme *(ISSAI*

*1500,ISA 300),*duke saktësuar përputhshmërinë e tyre dhe të akteve administrative me ligjet dhe rregullat në fuqi me qëllim që Auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Përgjegjësia jonë, është të shprehim një konkluzion të pavarur (*për llogaritë e subjektit*), bazuar në auditimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe udhëzuesit për auditimin e përputhshmërisë.

Auditim përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca të mjaftueshme dhe përkatëse për të mbështetur opinionin tonë(*ISSAI 1500,ISA 300*). Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Për realizimin e Auditimi të përputhshmërisë, audituesit ka kryer teste kontrolli, veçanërisht gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore mbi çështjet e përzgjedhura për auditim, si dhe janë kryer procedura analitike që përfshijnë marrjen e informacionit nga burime të ndryshme për të përcaktuar pritshmërinë, duke krahasuar gjendjen aktuale me atë të pritshme, duke hetuar arsyet për çdo mospërputhje që është shfaqur dhe vlerësimi i rezultateve. Krahas këtyre procedurave janë kryer kontrolle aritmetike të shumave të dokumenteve financiare, janë kryer analiza të qëndrueshmërisë së shpenzimeve krahasuar me buxhetin e viteve të mëparshëm; analiza të vendimeve dhe të procedurave të kryera sipas fushave të auditimit për të verifikuar përputhshmërinë me ligjet dhe rregullat; inspektime të faturave, regjistrime dhe dokumente; objekte fizike p.sh. shkolla, rrugë, ura etj. Në bazë të kritereve të vlerësimit gjykimit profesional audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të ish Komunat Qendër, Topojë, Cakran, Libofshë, Levan, Frakull dhe Dërmenas.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë audituar ish-Komuna Portës dhe Mbrostar deri në fund të periudhës datë 31.07.2015.

VII. Gjetjet nga Auditimi

Periudha e auditimit u shtri në afatin kohorë nga 01.01.2013 deri me datë 31.07.2015, ku në përfundim të procesit të auditimit, gjetjet e konstatuara në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

Çështja 1 - Mbi zbatimin e detyrave nga auditimi i mëparshëm.

Niveli i prioritetit: *i mesëm*

Gjetja 1. Në Bashkinë Fier nga 9 masa organizative me vlerë 19,064,943 lekë, janë zbatuar 4 masa me vlerë 3,772,193 lekë, në proces zbatimi 2 masa me vlerë 3,753,807 lekë dhe nuk janë zbatuar 3 masa me vlerë 11,538,943 lekë. Ndërsa nga **8** masa shpërblim dëmi me vlerë **3,118,167 lekë**, janë në proces zbatimi **2** masa me vlerë **928,983** lekë dhe nuk janë zbatuar **6** masa me vlerë **2,177,816 lekë,** *respektivisht***:**

Në ish-Komunën Portëz, nga **6** masa organizative me vlerë 7,526,000 lekë, janë zbatuar **4**masa, në proces zbatimi **1** masa me vlerë 3,753,807 lekë, *pasi vlera prej 3,772,193 lekë është arkëtuar* dhe nuk është zbatuar **1** masa.

Në ish-Komunën Mbrostar, nga **3** masa organizative me vlerë 11,538,943 lekë, është në proces zbatimi 1 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa për vlerën 11,538,943 lekë.
Nga **8** masa shpërblim dëmi me vlerë **3,118,167 lekë**, janë në proces zbatimi **2** masa me vlerë **928,983** lekë, pasi vlera prej 11,368 lekë është arkëtuar dhe nuk janë zbatuar **6**masa me vlerë **2,177,816 lekë**.

Çështja 2 - Mbi hartimin dhe realizimin e buxhetit të Bashkisë.
Niveli i prioritetit: *i ulët*

Gjetja 1. Nga të dhëna mbi buxhetin e ish- Komunave të Qarkut Fier për vitet 2013 - 6/mujori I –rë. 2015, u konstatua se:
Të ardhurat nga detyrimet e viteve të mëparshme nuk janë programuar si të ardhura të vitit ushtrimorë, veprime në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ku specifikohet se: "Buxheti vendor duhet i balancuar", Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". Edhe detyrimet ndaj të tretëve e veçanërisht shpenzimet utilitare si për ujë, energji, postare e telekomit nuk janë programuar si detyrime .
Gjatë zbatimit të buxheteve nuk janë kryer analiza për treguesit e buxhetit, por janë mjaftuar vetëm në mbyllje të periudhave ushtrimore, veprim ky në papajtueshmëri me nenin 47, të ligjit 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Nga verifikimi i treguesve të mbyllur me shkrirjen e komunave për 6/mujorin e parë të vitit 2015, janë realizuar të ardhura (përfshirë dhe fondet e buxhetit të shtetit) 240,600 mijë lekë dhe janë përdorur gjatë 6/mujorit vlera 191,058 mijë lekë ose 79.4%, dhe janë trashëguar në Bashkinë Fier 49,542 mijë lekë.

Çështja 3 -Mbi funksionimin dhe respektimin e strukturës organike.
Niveli i prioritetit: *i mesëm.*

Në auditimin e dokumentacioni mbi strukturën organizative dhe klasifikimi sipas pozicionin dhe nivelit arsimore, në ish Komunat e Qarkut Fier si: Komunat Cakran, Dërmënas, Frakull, Levan, Topojë, Libofshë dhe Qendër (sot Njësi Administrative të Bashkisë Fier), u konstatuan veprime jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në kryerjen e pagesave, me efekt financiar negativ me **dëm në buxhet për vlerën 10,160,217 lekë**, *konkretisht*:

Gjetja 1. Në ish Komunat e Qarkut Fier sot Njësi Administrative e Bashkisë Fier, janë kryer pagesa të këshilltarëve të ish komunave, pa qenë prezent në mbledhjet e zhvilluara, duke plotësuar formalisht listprezencat në adrese të sektorit/zyrave së financës për kryerjen e pagesave, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2, i ndryshuar, **me efekt negativ me dëm në buxhet në vlerën 9,980,063 lekë,** nga e cila: *ish Komuna Cakran në vlerën 1,632,686 lekë, ish Komuna Dërmënas në vlerën 1,909,317 lekë, ish Komuna Frakull në vlerën 1,316,700 lekë, ish Komuna Levan në vlerën 1,530,360 lekë, ish Komuna Topojë në vlerën 1,282,500 lekë, ish Komuna Libofshë në vlerën 1,444,500 lekë dh ish Komuna Qendër në vlerën 864,400 lekë.*

Gjetja 2. Në auditimin e veprimeve me bankë, konstatohet se sipas urdhrit te titullarit nr. 151,datë 31.12.2014 është dhënë një rroge shpërblim page neto për 6 punonjës për rezultate te mira ne arkëtimin e te ardhurave nga taksat lokale, ne kundërshtim me VKM nr. 929 datë

17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit te veçante", i ndryshuar me VKM nr. 493, datë 6.7.2011, **me dëm në buxhet për vlerën 180,154 lekë,** për punonjësit: *Q. C. në vlerën 35,281 lekë, D. Ll. në vlerën 35,281 lekë, S. S. në vlerën 26,640 lekë, I. B. në vlerën 29,672 lekë, S. S. në vlerën 26,640 lekë dhe G. M. në vlerën 26,640 lekë.*

Gjetja 3. Në auditimin e kryer konstatohet se për vitin 2013 për 44 punonjës me kontrate, paga bazë mbi të cilën janë paguar është nën nivelin e pagës minimale të prej 21,000 – 22,000 lekë/muaj, duke u paguar me pagë bazë 12,000 lekë/muaj nga artikulli 602.Për këto punonjës nuk janë aplikuar dhe ndalur detyrimet për sigurimet shoqërore në masën 11.2% për punëmarrësin dhe 16.7% për punëdhënësin**, duke mos xhiruar në buxhet vlerën prej 930,193 lekë,** veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8487, datë 13.05.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave te punës", i ndryshuar me ligjin nr. 9065, datë 08.05.2003 neni 5 germa (a); ligjin nr. 10405 datë 24.03.2011; VKM nr. 566, datë 14.07.2010, ndryshuar me VKM nr. 527, datë 20.7.2011 dhe VKM nr. 445, datë 11.7.2012 "Për përcaktimin e pagës minimale ne shkalle vendi"; ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, si dhe me ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësorë ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 9136 datë 18.08.2003 "Për mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqërore e shëndetësorë ne R.SH".

Çështja 4 - Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Niveli i prioritetit: *i mesëm*.

Në auditimin e dokumentacionit të mbajtjes së kontabilitetit dhe shpenzimeve bankare në ish Komunat Cakran, Levan, Libofshë, Topojë, Qendër, Dërmënas dhe Frakull, u konstatuan veprime jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, nga e cila **me dëm në buxhet për vlerën 1,200,656 lekë**, *konkretisht*:

Gjetja 1. Në ish Komunën Cakran, llogaria nr. 231 "*Shpenzime në proces*" është paraqitur pa gjendje edhe pse në mbyllje të periudhave ushtrimore janë pasqyruar detyrime të pa shlyera ndaj sipërmarrëseve për ndërtim objektesh brenda garancive (llogaria nr. 466). Në mbyllje të periudhave ushtrimore në raste të veçanta nuk është rakorduar me Drejtorinë Arsimore Rajonale Fier për furnizimet me inventarë në adresë të shkollave që administrohen nga Njësia Administrative Cakran. Nuk është vepruar me konformitet me llogarinë nr. 45 "*marrëdhënie me institucionet brenda e jashtë sistemit*". Për mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore nuk është plotësuar libri përmbledhës i llogarive. Në llogarinë nr. 202 "Studime e kërkime" prej vitesh pasqyrohet teprica në vlerë 4,304,858 lekë, që ju përket 15 projekteve, por nuk është e saktësuar sa nga projektet janë zbatuar dhe duhej të ishin përfshirë në vlerën e objekteve të marra në dorëzim".

Gjetja 2. Në ish Komunën Cakran**,** është likuiduar vlera e plotë e projektit të rrugës "*Gorishtë- Autostradë* " në vlerë 169,000 lekë në favor të subjektit "Novatech", pa filluar ndërtimi i objektit, ku duhej të ishte likuiduar 60 % e vlerës. Është likuiduar më tepër 40% e vlerës e barabartë **me vlerën 67,600 lekë (dëm ekonomik),** pasi objekti nuk ka filluar. Pagesa është kryer në masën 100%, në kundërshtim me VKM nr. 444,datë 05.09.94 "Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve", i ndryshuar, si dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e bilanceve në sistemin buxhetor, pasi nuk është zbatuar ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",

ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", neni 5. Nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14,datë, 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre".

Gjetje 3. Në ish Komunën Frakull, në mbajtjen e kontabilitetit u konstatuan mangësi në azhurnimin e artikujve kontabël të mbylljeve të llogarive në mbyllje të periudhave ushtrimore. Gjithashtu nuk është azhurnuar dhe ditari i veprimeve të ndryshme për korrigjimin e gabimeve dhe mbylljen e llogarive në fund të vitit ushtrimorë. Nga sektori i financës nuk është vepruar me llogarinë nr. 45 "Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit". Për furnizimet e bëra nga DAR Fier në adresë të shkollave që ka administruar Komuna Frakull, nuk janë kryqëzuar veprimet dhe kjo llogari nuk ka funksionuar, pasi nuk është vepruar me konfirmitetet përkatëse, veprim në kundërshtim me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj". Nuk janë kontabilizuar faturat e energjisë elektrike, të Albtelekomit, të postës, të ujit etj. Llogaria nr. 468 "*Debitorë në persona*", prej vitesh është paraqitur pa gjendje, duke mos përfshirë në kontabilitet të ardhurat e pa arkëtuara nga biznesi i vogël.
Në fletë hyrjen nr. 7,datë 29.04.2015, janë bërë hyrje 4 programe me çmim 2000 lekë/copa në vlerë **8,000 lekë,** të cilat nuk janë paraqitur në inventarë. Edhe kontabilizimin e hyrjeve të inventarëve që i përkasin llogarisë nr. 218 *"Inventarë ekonomik"* janë përfshirë në llogarinë nr. 32 "Objekte Inventari". Sistemimet e këtyre llogarive në fund të viteve ushtrimore janë sistemuar pa artikuj kontabël.

Gjetje 4. Në ish Komunën Libofshë**,** ka mangësi në rakordimet me Drejtorinë Arsimore Rajonale Fier për furnizimet që ju janë bëre shkollave. Nuk është vepruar me konformitet me llogarinë nr. 45 "*Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit*", veprime në papajtueshmëri me dispozitat ligjore që rregullojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e bilanceve në sistemin buxhetor, pasi nuk është zbatuar ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligji nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", neni 5, si dhe UMF nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr. 14, datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar.
Nga verifikimi i inventarëve rezulton se: Ish – drejtoresha e shkollës mesme Libofshë zj. A. Gj. nuk i ka përfshirë në inventarin e shkollës 4(katër) laptop dhe 4(katër) projektor **në vlerën 393,393 lekë.**
Në këto kushte shprehim opinionin se: *Pasqyrat financiare që shoqërojnë bilancin nuk kanë saktësi e konkretisht: "Pasqyra mbi "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të AQT"*.

Gjetje 5. Në ish Komunën Qendër, përgjithësisht plotësimi i pasqyrave financiare është mbështetur mbi të dhënat e nxjerra nga azhurnimi i kontabilitetit dhe pozicionet financiare në aktiv dhe në pasiv të bilanceve të viteve 2013,2014 e 2015, janë të njëjta me pasqyrat shoqëruese të bilancit. Në llogarinë nr. 202 "Studime dhe kërkime me vlerë 4,091,040 lekë e trashëguar prej vitit 2013 që ju përket projekteve për objekte ndërtimi, nuk është përfshirë në

vlerën e objekteve, veprim i pa sistemuar me kontabilitet. Llogaria nr. 468 "*Debitor në persona*", është paraqitur pa gjendje, çka tregon se nuk janë pasqyruar detyrimet për taksa e tarifa vendore të pa shlyera brenda viteve ushtrimore. Në pasiv të bilancit nuk janë pasqyruar të ardhura për tu arkëtuar nga taksat dhe tarifat vendore.

Gjetje 6. Në ish Komunën Dërmënas**,** u konstatuan mungesë e artikujve kontabël në mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, pasi nuk është plotësuar libri përmbledhës i llogarive (centralizatori apo libri i madh). Në llogarinë nr. 202, "*Studime e kërkime*" në vlerën 640,000 lekë është e pa analizuar dhe trashëgohet prej vitesh (nga viti 2012). Në bilance nuk janë pasqyruar shpenzime në proces për investimet e pa përfunduara. Gjithashtu janë kryer veprime ekstra kontabël (pa artikuj), fenomene këto të konstatuara dhe nga auditi i brendshëm i bashkisë, në kundërshtim me UMF nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar.

Gjetje 7. Në ish Komunën Dërmënas**,** u konstatuan nga Auditi i Brendshëm i Prefekturës Fier, në rekomandimin nr. 5, i është kërkuar Kryetarit të Komunës të dalë urdhër ekzekutiv në ngarkim të N. V. për vlerën **739,663 lekë** *(diferenca për 12 kompjuterë në vlerë 492,761 lekë, 16 karrige në vlerë 64,512 lekë,11 UPS në vlerë 59,043 lekë dhe 1(një) kompjuterë e 1(një) laptop me vlerë 123,347 lekë)*. Nga verifikimi i analizës së llogarisë nr. 468 "*Debitor të ndryshëm*", u konstatua se nuk është përfshirë në debitorë dhe nuk është shlyer detyrimi. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi ish – Kryetarin e Komunës z. V. F. në cilësinë e nëpunësit urdhërues, pasi nuk ka urdhëruar marrjen e masave për rakordimin me DAR Fier për furnizimet e kryera në adresë të shkollave që janë administruar nga Ish- Komuna Fier dhe nxjerrjen përgjegjësisë materiale.

Gjetje 8. Në ish Komunën Levan**,** ka mangësi në azhurnimin e artikujve kontabël në mbyllje të aktivitetit ushtrimorë sipas viteve përkatëse pasi, nuk është plotësuar libri përmbledhësi llogarive (*centralizatori apo libri i madh*), nuk është azhurnuar ditari i veprimeve të ndryshme për mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore. Në bilancet e viteve 2013 dhe 2014, Llogaria nr. 4341"*Operacione me shtetin kreditorë*" dhe llogaria nr. 475 "*Të ardhura për tu riregjistruar vitet pas ardhëse*" është paraqitur pa gjendje.
Në llogarinë nr. 202 "*Studime e kërkime*", nga viti 2012 është mbartur teprica prej 6,616,150 lekë) dhe në bilancin e fundit të 7/mujorit të vitit 2015, ka një tepricë në vlerën 8,017,750 lekë. Për objekteve e ndërtimit të përfunduara vlera e projekteve nuk është përfshirë në vlerën e objekteve.
Në aktivin e bilancit të vitit 2013, në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm"* është paraqitur me gjendje në vlerën 10,045,446 lekë, në bilancin e vitit 2014 është paraqitur me gjendje në vlerën 9,194,020 lekë. Rezulton se në pasiv të bilancit nuk ka kundër parti për debitorët dhe veprimet kontabël janë ekstra kontabël pa kuadraturë (aktiv-pasiv).
Në administrimin e aseteve dhe në asgjësimin e inventarëve u vrenjten mangësi në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", neni 5**,** si dhe UMF nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr. 14, datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar, pasi ka pasaktësi në hartimin e proces

verbaleve të asgjësimit dhe në komisione nuk kanë marrë pjesë specialist të fushës për nxjerrje jashtë përdorimit të kompjuterëve.

Gjetje 9. Në ish Komunën Topojë**,** në mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e pasqyrave financiare ka mangësi, pasi nuk janë plotësuar centralizatori dhe ditari i veprimeve të ndryshme, mungojnë disa pozicione financiare si llogaria debitorë në persona për taksa e tarifa vendore të pa shlyera brenda viteve ushtrimore. Llogaria nr. 4341 "*Operacione me shtetin kreditorë*" dhe llogaria nr. 475 "*Të ardhura për tu arkëtuar*" janë pa gjendje në bilancet e viteve 2014 e 2015. Llogaria nr. 202 "*Studime e kërkime*" në vlerën 2,614,400 lekë prej vitesh është pa analizë. Llogaria nr. 231 "*Shpenzime në proces*" është paraqitur pa gjendje edhe pse në mbyllje të periudhave ushtrimore janë pasqyruar detyrime të pa shlyera ndaj sipërmarrëseve për objekte brenda garancive (llogaria nr. 466), veprime në papajtueshmëri me dispozitat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligji nr. 10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", neni 5, si dhe UMF nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr. 14,datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre".

Çështja-5. Mbi prokurimin e fondeve publike.

Niveli i prioritetit: *i lartë*

Në ish Komunat Topojë, Frakull, Cakran, Dërmënas, Libofshë, Qendër dhe Levan, për periudhën 01.01.2013 deri më 30.07.2015 janë kryer gjithsej 37 procedura prokurimi, nga të cilat janë audituar 36 procedura me fond limit 109,151 mijë lekë ose 99.3%.
Në 37 procedura prokurimi, janë zhvilluar me procedurë të "*Hapur*" 4 tendera, me procedurë "*Kërkesë me propozim*" 31 tendera dhe 2 procedura me "*Kërkesë me propozim pa shpallje paraprak*e".
Nga 37 procedura prokurimi të zhvilluara <u>në 18 prej tyre ose 48.6 % ka marrë pjesë vetëm 1 operator ekonomik (OE).</u> Fondi limit i prokuruar është 109,901 mijë lekë nga i cili me zhvillimin e procedurës së prokurimit ka diferencë të vlerave fituese me fondin limit në shumën 7,851 mijë lekë ose 7.1%**.**

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit dhe likuidimit të kontratave u konstatuan shkeljet të akteve ligjore e nënligjore të ligjit të prokurimeve, të cilët kanë ndikuar në keqadministrimin e fondeve publike në shërbim të komunitetit dhe biznesit, si vijon:

- **Në 4 raste me vlerë 5,338,472 lekë,** është konstatuar dëm ekonomik nga s'kualifikimi i OE me ofertë ekonomike më të leverdishme dhe shpallja fitues e OE me ofertë ekonomike më të lartë, megjithëse ky i fundit ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas DST, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4;
- **Në 16 raste me vlerë 29,443,172 lekë,** është krijuar impakt negativ në buxhet nga shpallja fitues e OE me mangësi në dokumentet e paraqitura, për të cilën KVO duhet të kish anuluar procedurën, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1**;**

- **Në 3 raste me vlerë 476,104 lekë,** nuk janë llogaritur penalitete për mos përfundimin në afat të punimeve, vërtetuar me fatura dhe situacionet, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995, **"**Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, neni 13, "Momenti i furnizimit" i ndryshuar me nenin 99, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, faturat tatimore nr. 27, datë 27.10.2014;
- **Në 3 raste me vlerë 335,870 lekë,** fondi limit është planifikuar më tepër.
- **Në 4 raste,** kriteret kualifikues të vendosura nga NJP janë të paargumentuara me volumet e preventivit të punimeve, duke bërë që shumë subjekte të mesme të vetë përjashtohen si rezultat i këtyre kritereve të forta, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa c, ç dhe d, dhe Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c, neni 46 pikat (1) dhe (3), dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2 "Hartimi i Dokumenteve të tenderit".

Në mënyrë më të zgjeruar për çdo ish komunë po e paraqesim më poshtë:

Gjetje 1: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluara në ish Komunat e Qarkut Fier, u konstatuan se **17** procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2*"Parimet e përzgjedhjes"*, nenin 55*"Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", nenin 24*"Anulimi i një procedure prokurimi"* dhe pika 5 e nenit 53 *"Shqyrtimi i ofertave",* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, *pasi*:

Operatorët ekonomik të shpallur fitues kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST të miratuara nga Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprim këto **me impakt negativ në buxhet për vlerën 29,443,172 lekë**, duke favorizuar operatorët ekonomik në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit dhe shpallur fitues me kritere të paplota, *konkretisht*:

Në ish Komunën Libofshë për vlerën 4,632,965 lekë.

a-. Në tenderin me objekt *"Blerje karburant për nevojat e Komunës Libofshë në vitin 2013*", me fond limit në vlerën 1,958,033 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "B.-O." me vlerë kontrate prej 1,958,033 lekë (10% marzh ose 15 lekë/litri).

b-Në tenderin me objekt *"Blerje karburant për nevojat e Komunës Libofshë në vitin 2014*", me fond limit në vlerën 1,919,525 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "B.-O." me vlerë kontrate prej 1,919,525 lekë (9.9% marzh ose 15 lekë/litri).

c-Në tenderin me objekt *"Blerje karburant për nevojat e Komunës Libofshë në vitin 2015*", me fond limit në vlerën 755,407 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "B.-O." me vlerë kontrate prej 755,407 lekë (10% marzh ose 15 lekë/litri).

Në ish Komunën Dërmënas për vlerën 2,213,267 lekë.

a- Në tenderin me objekt *"Blerje karburant për nevojat e Komunës Dërmënas në vitin 2013*", me fond limit në vlerën 750,000 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "G. K. P." me vlerë kontrate prej 750,000 lekë.

b- Në tenderin me objekt *"Blerje karburant për nevojat e Komunës Dërmënas në vitin 2014*", me fond limit në vlerën 683,267 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE **"**G. K. P." me vlerë kontrate prej 683,267 lekë.

c- Në tenderin me objekt *"Grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane në fshatrat: Darëzez e Re, Poveleçë, Hoxharë, Baltëz, Hamil, Radostinë dhe Pojan*", me fond limit në vlerën 780,000 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "H. K." me vlerë kontrate prej 629,555 lekë.

<u>Në ish Komunën Qendër për vlerën 1,993,000 lekë.</u>

a- Në tenderin me objekt *"Blerje ushqime për Konviktin e Shkollës së Mesme "R. K., viti 2015*", me fond limit në vlerën 1,993,000 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "M. C.&E." me vlerë kontrate prej 1,990,100 lekë.

<u>Në ish Komunën Levan për vlerën 3,317,660 lekë</u>.

a- Në tenderin me objekt *"Ndriçimi rrugor Levan Fier*", me fond limit në vlerën 1,742,660 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "N." me vlerë kontrate prej 1,281,447 lekë.

b- Në tenderin me objekt *"Blerje karburant 2015 për nevojat e Komunës Levan*", me fond limit në vlerën 1,575,000 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "V. P." me vlerë kontrate prej 1,497,000 lekë(9.5% marzh ose 15.96 lekë/litri).

<u>Në ish Komunën Topojë për vlerën 6,983,292 lekë</u>.

a- Në tenderin me objekt *"Blerje karburant për nevojat e Komunës Topojë në vitin 2013*", me fond limit në vlerën 1,416,666 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "**A.-1**" me vlerë kontrate prej 1,350,000 lekë (7.22% marzh).

b- Në tenderin me objekt *"Rikonstruksion i Rrugës Topojë-ShenPjeter, Komuna Topojë, Seman, Fier*", me fond limit në vlerën 4,166,626 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "B. B" me vlerë kontrate prej 4,051,325 lekë pa TVSh.

c- Në tenderin me objekt *"Blerje karburant për nevojat e Komunës Topojë, viti 2014*", me fond limit në vlerën 1,400,000 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "**A.-1**" me vlerë kontrate prej 1,400,000 lekë (12.6% marzh).

<u>Në ish Komunën Frakull për vlerën 6,879,988 lekë</u>.

a- Në tenderin me objekt *"Thellim i Kanaleve Kullues në Komunën Frakull*", me fond limit në vlerën 4,162,989 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "I. G." me vlerë kontrate prej 4,128,225 lekë pa TVSh.

b-Në tenderin me objekt *"Rehabilitim i varrezave Frakull -Kafaraj*", me fond limit në vlerën 2,686,999 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "A." me vlerë kontrate prej 2,637,860 lekë pa TVSh.

<u>Në ish Komunën Cakran për vlerën 3,423,000 lekë</u>.

a- Në tenderin me objekt *"Rikonstruksion rrugës Qendër - Cakran (ndërtim kanalizimi KUZ)*", me fond limit në vlerën 833,000 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "N. 1943" me vlerë kontrate prej 666,540 lekë pa TVSh.

b- Në tenderin me objekt **"***Blerje karburant për nevojat e Komunës Cakran, viti 2014*", me fond limit në vlerën 2,590,000 lekë, në të cilën është shpallur fitues OE "R." me vlerë kontrate prej 2,590,000 lekë(10% marzh).

- **<u>Në ish Komunën Dërmënas</u>.**

<u>Gjetje 2:</u> Në tenderin me objekt *"Riveshje e dy rrugëve paralele Hidrovor-Bregdet dhe hapja e trashjeje për rrugë paralele me bregdet"* të zhvilluar në ish Komunën Dërmënas, KVO **nuk duhej të kualifikonte BOE "H. K. & S."** ShPK, pasi nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, por nisur nga fakti se OE "**B.-B**" me vlerë oferte 5,914,750 lekë, ka mangësi të cilat klasifikohen si gabime të vogla dhe që nuk ndikojnë në zbatimin e projektit dhe KVO duhet të vlerësonte ofertën ekonomike më të leverdishme ndërmjet dy operatorëve, duke evituar dëmin ekonomik në vlerën **3,085,240 lekë** (si diferencë ndërmjet dy operatorëve)**,** në kundërshtim me

ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4.Pra KVO ka vepruar me dy standarte pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e BOE "H. K. & S.**"**, me vlerë më të lartë dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit (DST) .

Gjetja 3: Në tenderin me objekt *"Rikonstruksion i rrugëve të brendshme "Driza", "Shpata", "Fasko" në fshatin Radostinë"* të zhvilluar në ish Komunën Dërmënas dhe KVO **nuk duhej të kualifikonte OE "H. K."** ShPK, pasi nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, por nisur nga fakti se OE "**S.**" me vlerë oferte 1,316,510 lekë, ka mangësi të cilat klasifikohen si gabime të vogla dhe që nuk ndikojnë në zbatimin e projektit, KVO duhet të vlerësonte ofertën ekonomike më të leverdishme ndërmjet dy operatorëve, duke evituar dëmin ekonomik në vlerën **207,532 lekë** (si diferencë ndërmjet dy operatorëve)**,** në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4.
Pra KVO ka vepruar me **dy standarte** pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE "H. K.", me vlerë më të lartë dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit (DST).

Gjetje 4:Në lidhje me fondin limit të përcaktuar nga NJP me vlerë 750,000 lekë dhe ofertën e fituese nga OE "**G. K. P." ShPK prej 180 lek/litri** pa TVSh, konstatohet se ky fond është llogaritu me shumë, bazuar në buletinin e APP të datës 23 Maj 2013 me çmimet referuar bursës REUTERS për "*gazoil (10 ppm ULSD)*" është në vlerën 162.11 lekë/litër pa TVSh dhe jo 180 lekë/litër.
Diferenca më shumë e çmimit të aplikuar në llogaritjen fondit limit dhe me ofertë e paraqitur nga subjekti është në vlerën 17.89 lekë/litri (180 – 162.11). Nisur nga sasia e karburantit të planifikuar për komunën në sasinë prej 5000 litra, diferencë e planifikuar më shumë në llogaritjen e fondit limit paraqitët në shumën **89,450 lekë.**

- **Në ish Komunën Qendër.**

Gjetja 5:Në tenderin me objekt *"Rikonstruksion i rrugës së varrezave në fshatin Grecalli"* të zhvilluar në ish Komunën Qendër, KVO **nuk duhej të kualifikonte BOE "S. & F."** ShPK, pasi nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, por nisur nga fakti se OE "S." me vlerë oferte 839,200 lekë, ka mangësi të cilat klasifikohen si gabime të vogla dhe që nuk ndikojnë në zbatimin e projektit dhe KVO duhet të vlerësonte ofertën ekonomike më të leverdishme ndërmjet dy operatorëve, duke evituar dëmin ekonomik në vlerën **147,420 lekë** (si diferencë ndërmjet dy operatorëve)**,** në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4.
Pra KVO ka vepruar me **dy standarte** pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE "H. K.", me vlerë më të lartë dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit (DST).

- **Në ish Komunën Levan.**

Gjetje 6: Në tenderin me objekt *"Riparim e mirëmbajtje të rrugëve të parcelave të fshatrat Bishan, Bashkim, Qarri"* të zhvilluar në ish Komunën Levan, KVO **nuk duhej të kualifikonte**

OE "F." ShPK, pasi nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, por nisur nga fakti se OE "N. 1943" me vlerë oferte 850,890 lekë. KVO duhet të vlerësonte ofertën ekonomike më të leverdishme ndërmjet dy operatorëve, duke evituar dëmin ekonomik në vlerën **19,676 lekë** (si diferencë ndërmjet dy operatorëve)**,** në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4.
Pra KVO ka vepruar me dy standarte pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE "H. K.", me vlerë më të lartë dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit (DST).

Gjetja 7: Nga auditimi rezulton se fondi limit i përcaktuar në preventivin me vlerë 2,093,452 lekë pa TVSh është rënduar padrejtësisht, pasi sipas këtij preventivi është futur një zë punimesh në **vlerën 170,000 lekë** (*riparim i pasarel dhe lyrje me bojë*), ku megjithëse njësia paraqitet zero, sasia është zero dhe vlera është 170,000 lekë (punim i pakryer).
Në këto kushte nga preventivusi z. Z. T. është rënduar padrejtësisht fondi limit për vlerën **170,000 lekë, vlerë e cila konsiderohet si dëm në buxhetin e komunës**, pasi kjo vlerë është hedhur për prokurim pavarësisht nga ofertat e paraqitura nga OE pjesëmarrës, veprime në kundërshtim me nenet 57 dhe 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Gjetja 8: Në auditimin e dokumentacionit mbi likuidimin e kontratës së punimeve në ish Komunën Levan, u konstatua se në 2 raste nuk janë llogaritur penalitete për mos përfundimin në afat të punimeve me dëm ekonomik në vlerën 345,551 lekë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995"Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, neni 13, "Momenti i furnizimit" i ndryshuar me nenin 99, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, konkretisht:
a-Në tenderin me objekti *"Ndriçimi rrugor Levan Fier",* punimet nuk kanë përfunduar sipas afateve të përcaktuara në kontratën nr. 588, datë 30.07.2014, pasi nga subjekti "N." situacionet përfundimtarë është paraqitur me **42 ditë vonesë** dhe nga zyra e financës nuk janë llogaritur penalitete për mos përmbushje të kontratës në vlerën **215,283 lekë,** ndaj subjekti "N.".
b-Në tenderin me objekti *"Riparim e mirëmbajtje të rrugëve të parcelave të fshatrat Bishan, Bashkim, Qarri",* punimet nuk kanë përfunduar sipas afateve të përcaktuara në kontratën nr. 589/4, datë 18.9.2014, pasi nga subjekti "F." situacionet përfundimtarë është paraqitur me **28 ditë vonesë** dhe nga zyra e financës nuk janë llogaritur penalitete për mos përmbushje të kontratës në vlerën **130,269 lekë,** ndaj subjekti "F.".

- **Në ish Komunën Cakran.**

Gjetje 10: Në tenderin me objekt *"Rikonstruksion i ujësjellës Rajonal Cakran"* të zhvilluar në ish Komunën Dërmënas, KVO **nuk duhej të kualifikonte OE "B. B"** ShPK, pasi nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, por nisur nga fakti se BOE "**N.& P. V.**" me vlerë oferte 6,742,927 lekë, ka mangësi të cilat klasifikohen si gabime të vogla dhe që nuk ndikojnë në zbatimin e projektit, KVO duhet të vlerësonte ofertën ekonomike më të leverdishme ndërmjet dy operatorëve, duke evituar dëmin ekonomik në vlerën **2,026,024 lekë** (si diferencë ndërmjet dy operatorëve)**,** në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4.

Pra KVO ka vepruar me **dy standarte** pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE "H. K.", me vlerë më të lartë dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit (DST).

Gjetja 11: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluara në ish Komunat e Qarkut Fier, u konstatuan se **4** procedura kriteret kualifikues të vendosura nga NJP janë të paargumentuara me volumet e preventivit të punimeve, duke bërë që shumë subjekte të mesme të vetë përjashtohen si rezultat i këtyre kritereve të forta, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa c, ç dhe d, dhe Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c, Neni 46pikat (1) dhe (3), dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar, Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2 "Hartimi i Dokumenteve të tenderit", konkretisht; ish Komuna Dërmënas në tenderin me objekt "*Riveshje e dy rrugëve paralele Hidrovor-Bregdet dhe hapja e trashjeje për rrugë paralele me bregdet",* ish Komunën Qendër në tenderin me objekt *"Rakip Kryeziu, viti 2015",* ish Komunën Frakull në tenderin me objekt *"Ndërtim i rrjetit KUZ për fshatin Kashitsht"* dhe ish Komunën Cakran në tenderin me objekti *"Rikonstruksion i ujësjellës Rajonal Cakran"*.

Çështja 5.1-Mbi zbatimin e kontratave të punëve publike.

Niveli i prioritetit: *i lartë*

Në Bashkinë Fier, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, u auditua 1 kontratë zbatimi punimesh e cila ishte përfunduar, ishte kolauduar dhe ishte marrë në dorëzim nga ish-Komunat, Fier. Ndërsa një prej kontratave u auditua për hartimin e fondit limit, pasi ishte objekt ende i papërfunduar.

Nga ky auditim rezultuan:

- Janë përfituar më tepër në vlerë, duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit **9,590,880 lekë pa TVSh,** nga të cilat:
  - Janë preventivuar më tepër fond limit në vlerën **8,096,380 lekë pa TVSh,** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore
  - Diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **500,000 lekë pa TVSh;**
  - Zëra punimesh qe nuk janë kryer sipas kërkesave të projektit por janë ndryshuar pa u shoqëruar me çmimin përkatës duke shkaktuar një dëm ekonomik në **vlerën 994,500 lekë pa TVSh.**

Gjetje 1. Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 4, paragrafi 4.

Gjetje 2. Në objektin *"Riveshje e Dy Rrugëve Paralele "Hidrovor - Bregdet" dhe Hapje Traseje për Rrugën Paralel me Bregun",* ish-Komuna Dermenas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerën **1,494,500 lekë pa TVSh duke shkaktuar dëm ekonomik,** *nga të cilat:* vlera **500,000 lekë pa TVSh** për punime të pakryera në fakt dhe vlera **994,500 lekë pa TVSh** si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës, veprime në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar,

Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me AK ish-Komuna Dermenas, dhe mbikëqyrësit të punimeve Ing. N. M., neni 4 dhe neni 6 pika 1, të Udhëzimit nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

Gjetje 3: Në objektin *"Rikonstruksioni i Rrugës Topojë – SheqMarinëz - Seman",* ish-Komuna Topojë Seman, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, fushën e prokurimit publik, duke i shkaktuar buxhetit të ish-Komunës Topojë Seman, **dëm ekonomik në vlerën 8,096,380 lekë pa TVSh.**

Çështja 6 -Mbi realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore.

Niveli i prioritetit: *i mesëm*

Gjetje 1: Për vitet 2013, 2014 dhe 6-mujori i parë 2015, është evidentuar borxh i pa vjelë për detyrimet për tatim taksat lokale, sipas ish Komunave si më poshtë:

Nga ish Komuna Qendër**,** borxhi i krijuar nga mos vjelja e tatim taksave lokale, është në shumën **11,743,974 lekë** nga të cilat;

-për 5,229,934 lekë debitorë nga 86 biznese të mëdha e të vogla,

-për 3,058,460 lekë debitorë për taksën mbi tokën bujqësore,

-për 700,580 lekë debitorë për taksën mbi ndërtesat familjare dhe

-për 2,262,000 lekë debitorë për tatim taksat familjare.

Nga ish Komuna Levan**,** borxhi i krijuar nga mos vjelja e tatim taksave lokale, është në shumën **75,859,017 lekë** nga të cilat:

-për 459,285 lekë debitorë nga 26 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël dhe

-për 75,461,715 lekë debitorë për taksën mbi tokën bujqësore.

Nga ish Komuna Topojë**,** borxhi i krijuar nga mos vjelja e tatim taksave lokale, është në shumën **22,264,201 lekë** nga të cilat:

-për 1,078,120 lekë debitorë nga 49 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël dhe

-për 21,186,081 lekë për taksën mbi tokën bujqësore.

Nga ish Komuna Frakull**,** borxhi i krijuar nga mos vjelja e tatim taksave lokale, është në shumën **30,472,920 lekë** nga të cilat:

-për 7,667.420 lekë debitorë nga 17 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël,

-për 1,292,500 lekë debitorë nga entet shtetërore,

-për 18,457,000 lekë debitorë për taksën mbi tokën bujqësore,

-për 2,054,000 lekë debitorë për taksën mbi ndërtesat familjare.

Nga ish Komuna Cakran**,** borxhi i krijuar nga mos vjelja e tatim taksave lokale, është në shumën **3,381,464 lekë** nga 227 subjekte debitorë.

Nga ish Komuna Dërmënas**,** borxhi i krijuar nga mos vjelja e tatim taksave lokale, është në shumën **877,570 lekë** nga 73 subjekte debitorë.

Nga ish Komuna Libofshë**,** borxhi i krijuar nga mos vjelja e tatim taksave lokale, është në shumën **30,462,623 lekë** nga të cilat:
-për 1,307,946 lekë debitorë nga 62 biznese të mëdha dhe të vogla,
-për 28,068,735 lekë debitorë për taksën mbi tokën bujqësore dhe
-për 1,085,942 lekë për taksën mbi ndërtesat familjare.
-Nga Zyra e Tatim Taksave, nuk janë nxjerrë njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 23 dhe Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03, datë 17.01.2014 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014", pika 52, nuk janë bërë njoftim detyrimi për detyrimet e bizneseve, nuk është bërë inventarizimi i bizneseve që ushtrojnë aktivitet në Njësitë e Qeverisjes Vendore.
-Për arkëtimin e detyrimeve nga bizneset e vogla debitorë, nuk u janë dërguar bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar nenet 90, 93.
-Nuk është llogaritur dhe arkëtuar penalitete ndaj bizneseve debitorë, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 114.
Gjetje 2: Në ish Komunat Qendër, Frakull, Cakran, Libofshë, Dërmënas dhe Topojë, nuk janë organizuar evidencat debitorë për detyrimet për taksën mbi tokën bujqësore, taksat mbi ndërtesat e banimit si dhe për tatim taksat familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.
Gjetje 3: Në ish Komunat Qendër, Frakull, Cakran, Libofshë, Dërmënas dhe Topojë, realizimi i programit të ardhurave nga tatim taksat lokale, është në nivele të ultë për vitet 2013-2015.
Gjetje 4: Në ish Komunën Portës, kanë ushtruar aktivitetin e tyre dy subjekte për qëllime "Shfrytëzim minerar, rërë bituminoze", përkatësisht subjekti "R." shpk sipas lejes së shfrytëzimit minerar Nr. 718, datë 20.08.2003, i cili më pas i ka shitur kapitalin subjektit "B. M." ShPK.
Nga subjekti "Rakipi" shpk, nuk janë paguar detyrimet për taksat lokale në shumën **573,310,624 lekë** dhe nga subjekti "B. M." ShPK, nuk janë paguar taksat lokale për shumën **353,684,706 lekë**, detyrime përsa kanë shfrytëzuar sipërfaqet pyjore, pa kontrata dhe nuk kanë paguar detyrimet sipas tarifave të llogaritura me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pika 6, të ardhura të munguara për buxhetin e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Çështja 7 -Auditim në Fushën Planifikim Zhvillim Territorit.
Niveli i prioritetit: *i lartë*

Gjetja 1. Nga ish Komunat Qendër, Dërmënas, Topojë, Libofshë, Levan, Frakull dhe Cakran, nuk janë miratuar Planet e Përgjithshme të Zhvillimit Vendor, si dhe nuk janë miratuar nga Këshillat e Njësive të Qeverisjes Vendore, nisma për miratimin e dokumenteve të Planit Vendor, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, nenet 12 dhe 13.
Gjetje 2: Nga ish Komuna Cakran, është miratuar dhënia e 1 leje ndërtimore me objekt: "***Magazinë 1 kat për fabrikë për prodhimin e vajit të ullirit***", fshati Gorishovë.

Leja zhvillimore ndërtimi, është miratuar me vendim të Kryetarit të Komunës nr. 76, datë 5.12.2014 dhe e konfirmuar nga "Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit" me shkresën nr. 1357/01, datë 10.11.2014, investitor "S." ShPK.
Është llogaritur dhe paguar më pak, detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë për **vlerën 39,927 lekë me dëm ekonomik**, në kundërshtim me kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar neni 46 dhe UKM nr. 2, datë 6.08.2014 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014".

Gjetje 3: Nga ish Komuna Qendër, janë miratuar dhënia e lejeve zhvillimore për 9 objekte banimi, nga të cilat 8 lejë ndërtimore përfshihen brena zonës të Planit të Përgjithshëm Ndërvendor të Bashkisë Fier, miratuar me vendim të KKT-së nr. 16, datë 10.05.2013 kurse 1 leje ndërtimore, është konfirmuar nga Agjencinë Kombëtare e Planifikimit të Territorit.
Në tre raste të lejeve ndërtimore të miratuara, nuk janë llogaritur saktë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë **për vlerën 211,767 lekë me dëm ekonomik,** në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, neni 46 dhe UKM nr. 2, datë 6.08.2014 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014".

Gjetje 4: Nga Komuna Qendër, në 4 raste, janë miratuar leje zhvillimore për objekte banimi, në të cilat nuk janë përcaktuar marrëdhëniet e truallit.
Në këto raste, lejet e ndërtimit të miratuara për investitorë privatë, janë dhënë mbi shesh, cili është në pronësi të njërit nga investitorët: T. H., sipas certifikatës së pronësisë noterizuar me nr. 3994 Rep.., datë 31.05.2010, ZK 3981, nr. pasurisë 269/64, lloji pasurisë "Arë" me sip. 2485 m^2. Investitorët e tjerë, nuk në pronësi sheshin e ndërtimit. Konkretisht janë miratuar lejet zhvillimore:
-"Banesë 3 kate", miratuar me vendim të Kryetarit të Komunës nr. 5, datë 1.09.2014, investitor T. H.,
-"Banesë 2 kate", miratuar me vendim të Kryetarit të Komunës nr. 467/1 prot., datë 27.09.2013, investitor E. H.,
-"Banesë 2 kate", miratuar me vendim të Kryetarit të Komunës nr. 467/1 prot., datë 27.09.2013, investitor Z. H.,
-"Banesë 2 kate", miratuar me vendim të Kryetarit të Komunës nr. 467/2 prot., datë 19.11.2014, investitor Q. H., veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar nenet 10 dhe 16.

Gjetje 5: Nga Komuna Libofshë, është miratuar 1 leje zhvillimore me objekt: *"Stallë për bagëti, gropa silazhi dhe hangar për mjete bujqësore"*, miratuar me vendim të Kryetarit të Komunës nr. 122, datë 25.06.2015, me investitor "T. A." ShPK.
Nuk janë llogaritur saktë dhe nuk janë arkëtuar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për vlerën **478,758 lekë me dëm ekonomik**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar neni 46 dhe UKM nr. 2, datë 6.08.2014 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014.

Gjetje 6: Nga Dërmënas, janë miratuar 2 leje zhvillimore për të cilat nuk janë llogaritur dhe paguar saktë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konkretisht:
-Leje zhvillimi me objekt: *"Dy qendra prindërore për rritje zogjsh",* miratuar me nr. 524 prot., datë 1.08.2014, me investitor "D." shpk **për vlerën 2,296,179 lekë**.
-Leje zhvillimore për objektin: "*Magazinë Bujqësore 1 kat Baltëz*", miratuar me nr. 411 prot., me afatin 02.06.2016, investitor A. Gj. për shumën **264,268 lekë,** në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar neni 46 dhe UKM nr. 4, datë 30.09.2015 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015"**.**

Çështja 8- Mbi administrimin e aseteve dhe dhënia me qira e tyre
Niveli i prioritetit: *mesëm*

Gjetje 1: Për ish Komunat; Qendër, Frakull, Cakran, Libofshë, Dërmënas dhe Topojë, me VKM, janë miratuar kalimi në përdorim ose në pronësi të pronave të pa tundshme si dhe pyje dhe kullota, konkretisht:
Për ish Komunën Qendër, me VKM nr. 676, datë 21.05.2008, janë transferuar në pronësi pyje dhe kullota dhe me VKM nr. 509, datë 6.07.2011, janë transferuar në përdorim dhe pronësi, prona të pa luajtshme publike.
Për ish Komunën Frakull, me VKM nr. 596, datë
14.05.2008, janë transferuar në pronësi pyje dhe kullota dhe me VKM nr. 770, datë 14.11.2007, janë transferuar në përdorim dhe pronësi, prona të pa luajtshme publike.
Për ish Komunën Cakran, me VKM nr. 679, datë 21.05.2008, janë transferuar në pronësi pyje dhe kullota dhe me VKM nr. 456, datë 22.06.2007, janë transferuar në përdorim dhe pronësi, prona të pa luajtshme publike.
Për ish Komunën Libofshë, me VKM nr. 558, datë 7,05,2008, janë transferuar në pronësi pyje dhe kullota dhe me VKM nr. 375, datë 18.05.2011, janë transferuar në përdorim dhe pronësi, prona të pa luajtshme publike.
Për ish Komunën Dërmënas, me VKM nr. 854, datë 4.12.2012, janë transferuar në pronësi prona të pa luajtshme publike.
Për ish Komunën Topojë, me VKM nr. 363, datë 1.04.2009, janë transferuar në pronësi prona të pa luajtshme publike dhe me VKM nr. 982, datë 2.07.2008, janë transferuar në pronësi dhe përdorim pyje dhe kullota.
Nga këto ish Komuna, janë përgatitur dokumentacioni i nevojshëm dhe janë regjistruar në pronësi të tyre, një pjesë e pronave të miratuara me VKM.
Për administrimin e pronave, *pyje dhe kullota***,** nga këto ish Komuna, nuk janë miratuar Planet e mbarështimit e të shfrytëzimit të pyllit komunal të miratuara nga Këshillat e Komunave, si dhe nuk janë programuar fondet përkatëse për investime në miradministrimin e pyjeve dhe kullotave, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar neni 4, 5, 26, VKM nr. 22, datë 9.01.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të administrimit të pyllit komunal" pikat 4/d, 5 dhe 11, VKM nr. 396, datë 21.06.2006 "Kriteret e transferimit dhe përdorimit të pyjeve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore", pikat 4, 5 si dhe ligjin nr. 49/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor" të ndryshuar, neni 14 pika 5 dhe neni 26.

Çështja 9. - Mbi dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara në ish Komuna.

Niveli i prioritetit*: i lartë*

Gjetje 1: Nga ish Komuna Libofshë, sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Komunës, në vitin 2013, janë lidhur 37 kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore të pa ndarë për sipërfaqen totale 308,429 m^2 , me afat 1 vjeçar dhe dy kontrata për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave me afat 3 vjeçar.
Nuk janë paguar detyrimet kontraktuare për 1 kontratë qiradhënie të tokës bujqësore për shumën 11,340 lekë dhe për 2 kontrata për pyje dhe kullota për shumën 144,000 lekë, **gjithsej 155,340 lekë me dëm ekonomik**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850 dhe kushteve të kontratës.

Gjetje 2: Nga ish Komuna Levan, në periudhën e viteve 2009-2011, janë lidhur gjithsej 37 kontrata qiradhënie të tokës bujqësore me afat 99 vjet.
Nga këto kontrata, nuk janë paguar detyrimet kontraktore për periudhën e viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016 për 9 kontrata **në shumën totale 1,514,736 lekë,** *nga të cilat 208,114 lekë sipas vlerës së kontratës dhe 1,306,622 lekë vlera e penalitetit të llogaritur përsa nuk janë paguar detyrimet kontraktuare në afat*. në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850 dhe kushteve të kontratës.

Gjetje 3: Nga ish Komuna Dërmënas, në periudhën e viteve 2009-2011, janë lidhur gjithsej 25 kontrata qiradhënie të tokës bujqësore me afat 99 vjet.
Nga këto kontrata, nuk janë paguar detyrimet kontraktore për periudhën e viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016 për 14 kontrata **për shumën 12,082,150 lekë,** *nga të cilat 902,200 lekë principali dhe 11,179,950 lekë është kamat vonesa (Penaliteti),* në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850 dhe kushteve të kontratës.

Gjetje 4: Nga ish Komuna Topojë, janë lidhur në vitin 2011 gjithsej 60 kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore me afat 30 vjet, nga këto 38 kontrata janë anuluar me urdhër të Titullarit të Komunës nr. 5, datë 11.04.2013, pasi qiramarrësit nuk kanë paguar detyrimet kontraktuare për vitet 2012 dhe 2013, duke ngelur debitorë 16 subjekte **për vlerën 2,277,250 lekë,** *nga të cilat vlera e kontratës (principali) 789,000 lekë dhe penaliteti 1,478,250 lekë me dëm ekonomik***.**
Për 22 kontrata e tjera që janë në fuqi, nuk kanë paguar detyrimet kontraktuare 14 subjekte për vlerën totale **4,994,200 lekë,** *nga të cilët detyrimi i kontratës (principali) 624,000 lekë dhe penaliteti (Kamat vonesa) 4,370,200 lekë, me dëm ekonomik,* në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850 dhe kushteve të kontratës.

Çështja 9. - Mbi dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara në ish Komuna.
Niveli i prioritetit: *i lartë*

Gjetje 1: Nga ish Komuna Libofshë, sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Komunës, në vitin 2013, janë lidhur 37 kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore të pa ndarë për sipërfaqen totale 308,429 m^2 , me afat 1 vjeçar dhe dy kontrata për dhënien me qira të pyjeve dhe kullotave me afat 3 vjeçar.
Nuk janë paguar detyrimet kontraktuare për 1 kontratë qiradhënie të tokës bujqësore për shumën 11,340 lekë dhe për 2 kontrata për pyje dhe kullota për shumën 144,000 lekë, ***gjithsej***

155,340 lekë me dëm ekonomik, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850 dhe kushteve të kontratës.

Gjetje 2: Nga ish Komuna Levan, në periudhën e viteve 2009-2011, janë lidhur gjithsej 37 kontrata qiradhënie të tokës bujqësore me afat 99 vjet.
Nga këto kontrata, nuk janë paguar detyrimet kontraktore për periudhën e viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016 për 9 kontrata **në shumën totale 1,514,736 lekë,** *nga të cilat 208,114 lekë sipas vlerës së kontratës dhe 1,306,622 lekë vlera e penalitetit të llogaritur përsa nuk janë paguar detyrimet kontraktuare në afat,* në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850 dhe kushteve të kontratës.

Gjetje 3: Nga ish Komuna Dërmënas, në periudhën e viteve 2009-2011, janë lidhur gjithsej 25 kontrata qiradhënie të tokës bujqësore me afat 99 vjet.
Nga këto kontrata, nuk janë paguar detyrimet kontraktore për periudhën e viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016 për 14 kontrata **për shumën 12,082,150 lekë,** *nga të cilat 902,200 lekë principali dhe 11,179,950 lekë është kamat vonesa (Penaliteti),* në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850 dhe kushteve të kontratës.

Gjetje 4: Nga ish Komuna Topojë, janë lidhur në vitin 2011 gjithsej 60 kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore me afat 30 vjet, nga këto 38 kontrata janë anuluar me urdhër të Titullarit të Komunës nr. 5, datë 11.04.2013, pasi qiramarrësit nuk kanë paguar detyrimet kontraktuare për vitet 2012 dhe 2013, duke ngelur debitorë 16 subjekte **për vlerën 2,277,250 lekë,** *nga të cilat vlera e kontratës (principali) 789,000 lekë dhe penaliteti 1,478,250 lekë me dëm ekonomik***.**
Për 22 kontrata e tjera që janë në fuqi, nuk kanë paguar detyrimet kontraktuare 14 subjekte për vlerën totale **4,994,200 lekë**, *nga të cilët detyrimi i kontratës (principali) 624,000 lekë dhe penaliteti (Kamat vonesa) 4,370,200 lekë, me dëm ekonomik,* në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850 dhe kushteve të kontratës*).*

Çështja 10 -Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV.

Niveli i prioritetit: *i ulët*

Gjetje 1: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të ish Komunave: Qendër, Dërmënas, Topojë, Libofshë, Levan dhe Frakull, nuk janë konstatuar raste të ndërtimeve pa leje nga subjektet private kurse nga IMTV-ja e ish Komunës Cakran, janë konstatuar 9 raste të ndërtimeve pa leje për të cilat janë mbajtur akte konstatime. Në këto akte konstatimi, nuk janë evidentuar marrëdhëniet e truallit lidhur me këto ndërtime.
Në këto konstatime; për 5 raste është njoftuar Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, kurse për 3 raste të tjera, është marrë vendim për prishje të objektit por vendimin nuk është ekzekutuar.
Për shkeljet e konstatuara, nuk është bërë kallëzim në Prokurori dhe nuk është dhënë masa "Gjobë" ndaj subjekteve për vlerën jo më pak se 500,000 lekë për secilin subjekt ose në vlerën **totale 4,500,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguar për Njësinë e Qeverisjes Vendore,** mosveprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar neni 5, germat (b, d, dh) dhe ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar pika 52/1, germa "e".

VIII. Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë

Procedurat e Prokurimeve*:* në **vlerën 5,338,472 lekë,** si rezultat i kryerjes së veprimeve jo në përputhje me aktet ligjore dhe rregulloret të procedurave të prokurimit publik në lidhje me vlerësimin e gabuar i ofertave, me mos llogaritjen e kamatëvonesave.
Në zbatimin e kontratave të punimeve: në **vlerën 1,494,500 lekë,** si rezultat i mos kryerjes së punimeve sipas projektit.
Në planifikimin e fondit limit: në **vlerën 8,355,830 lekë**, si rezultat i planifikimit të fondit limit mbi manualet e cimeve të ndërtimit.
Administrimin e shpenzimeve të pagave: në **vlerën 10,160,217 lekë,** nga kryerja e pagesave mbi shpërblimin e punonjësve për punë të mirë dhe shpërblimit pa të drejtë të këshilltarëve edhe në rastet e mospjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit të Komunës.
Administrimin e shpenzimeve operative: në **vlerën 1,200,656 lekë** në likuidimin e projekteve të pakryera, në mangësi në inventarët e pasjeve të marra nga DAR Fier.
Planifikimin zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit: në **vlerën 3,338,053 lekë** si rezultat aplikimit të gabuar të tarifës së taksës së ndikimit infrastrukturës.
Administrimin e aseteve dhe dhënien me qira të tyre: në **vlerën 21,023,676 lekë** si rezultat i hartimit të gabuar të kontratave për dhënien me qira të fondit pyjor dhe tokës bujqësore në lidhje me përcaktimin e tarifës së qirasë jo në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe mos pagesës së detyrimeve kontraktore të qiradhënies.
Mos zbatimin e kontratave të punimeve/shërbimeve: në **vlerën 345,552 lekë,** si rezultat i mos llogaritjes së kamatave për punimet e papërfunduar në afat sipas kontratave.

Konkluzion/Opinion: Nga Auditimi mbi përputhshmërinë i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin ish Komunat e Qarkut Fier (sot Njësi Administrative e Bashkisë Fier), rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret),në fushën e prokurimeve, në zbatimin e kontratave, dhënien me qira të pyjeve dhe tokave bujqësore, në shpenzimet operative, mbajtjen e kontabilitetit, dhe shpenzimet për paga, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë prekur **nga gabime materiale me dëm ekonomik në vlerë totale 51,403,776 lekë**(*pra mbi nivelin e parashikuar të materialitetit në mbështetje të* ***ISSAI 1320***[1]), por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinioni të kualifikuar*** (*opinioni i kundërt* **ISSAI 1705**[2]**)**.

IX. Rezultatet e auditimit sipas programit të auditimit me komentet dhe sqarimet për përgjigjet nga njësia e audituar paraqiten si më poshtë.

IX/1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimin e mëparshëm.

- **Ish-Komuna Mbrostar.**

[1]**ISSAI 1320** - Objektivi i audituesit është të përcaktojë dhe të rikonsiderojë ndërsa auditimi vazhdon, një nivel të duhur materialitetit, që t'i mundësojë audituesit kryerjen e auditimit.
[2]**ISSAI 1705** – Audituesi shpreh një opinion të kundërt, në rastet kur transaksionet nuk përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor në fuqi.

-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

Nga verifikimi, rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Fier rekomandimet mbi auditimin e kryer në ish-Komunën Mbrostar me objekt *"Kërkesë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, në auditimin e fundit në ish-Komunën Mbrostar"* me shkresën nr. 1113/131, datë 31.01.2017, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 7521/4, datë 06.02.2017.

Bashkia Fier për zbatim e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve nga data e depozitimit të shkresës në institucion me shkresën nr. 7521/6, datë 20.02.2017.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Fier është hartuar urdhri nr. 77, datë 14.02.2017 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë me shkresën nr. 1113/131, datë 31.01.2017 (Plan veprimi), ku ka ngarkuar personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve me afate dhe detyra konkrete.

-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në fazën e auditimit të zbatimit të rekomandimeve **nuk** është plotësuar afati 6 mujor për të kthyer përgjigje për vijimin e punës në zbatimin e masave të rekomanduar.

-Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezulton se:

Nga **3** masa organizative me vlerë 11,538,943 lekë, janë pranuar nga subjekti 3 masa, nga të pranuarat janë në proces zbatimi 1 masa dhe nuk është zbatuar 2 masa për vlerën 11,538,943 lekë.

Nga **8** masa shpërblim dëmi me vlerë **3,118,167 lekë**, janë pranuar nga subjekti 8 masa, nga të pranuarat janë në proces zbatimi **2** masa me vlerë **928,983** lekë, *pasi vlera prej 11,368 lekë është arkëtuar* dhe nuk është zbatuar **8**masa me vlerë **2,177,816 lekë,** sipas të dhëna të pasqyrës së mëposhtme.

- **Ne ish Komunën Portëz.**

-*Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

Nga verifikimi, rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Fier rekomandimet mbi auditimin e kryer në ish-Komunën Portëz me objekt *"Dërgim Raporti Përfundimtar dhe rekomandime"* me shkresën nr. 596/6, datë 30.09.2015, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 4254, datë 05.10.2015.

Bashkia Fier për zbatim e rekomandimeve të KLSH **nuk ka kthyer përgjigje** në afatin e 20 ditëve nga data e depozitimit të shkresës në institucion.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, nga subjekti Bashkia Fier është hartuar program masash nr. 4254/2, datë 12.11.2015 (Plan veprimi), ku ka ngarkuar personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve me afate dhe detyra konkrete.

-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga Bashkia Fier **nuk** është kthyer përgjigje brenda afatit 6 mujor nga data e marrjes së Njoftim Raport Auditimit, veprime në kundërshtim me pikën 2 e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

-Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezulton se:

Nga **6** masa organizative me vlerë 7,526,000 lekë, janë pranuar nga subjekti 6 masa, nga të pranuarat janë zbatuar **4**masa ose 66.6 %, në proces zbatimi **1** masa me vlerë 3,753,807 lekë ose 49.8 % e vlerës, *pasi vlera prej 3,772,193 lekë është arkëtuar* dhe nuk është zbatuar **1** masa ose 16.6 % e masave.

Nga 3 masa disiplinore, rezulton se janë zbatuar **3** masa ose 100 %, sipas pasqyrës së mëposhtme.

(Gjerësisht trajtuar në aneksin nr.1, bashkëlidhur Raport Auditimit)

Në përfundim vlerësojmë se nga Bashkia Fier me gjithë punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve mbi auditimet e kryera nga KLSH-ja në ish Komunat Mbrostar dhe Portëz, konstatohet se disa rekomandime nuk janë vlerësuar maksimalisht, duke mos ndjekur të gjithë procedurat ligjore në arkëtimin e detyrimeve për shpërblim dëmi.

Mos zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, si një organ i pavarur dhe që vlerëson në mënyrë të paanshme dhe profesionale aktivitetin ekonomik e financiare të këtij institucioni, kanë sjellë moszbatim të neneve 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2015, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

(Trajtuar gjerësisht në faqen 27-32, të Projektraport Auditimit)

IX/2. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

- **Në ish Komunën Cakran.**

-Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore, i kritereve në çeljen e buxhetit, detaj imin i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Në mijë lekë

Nr.	Nr.	Emërti	Viti 2013	Viti 2014	6/mujori 2015

	log	mi shpenzimit	Plani	Fakti	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	600	Paga	27,285	24,822	91	27,821	26,683	96	24,857	16,019	64.4
2	601	Sigurim	3,531	2,984	84.5	4,361	4,153	95.2	4,239	1,963	46.3
3	602	Oper.	22,441	13,406	59.7	25,965	17,380	67	19,031	8,936	47
4	604	Transf	1,889	0	0	400	0	0	1,075	1,075	100
5	606	Ndihma	425	60	14.2	1,570	605	38.5	5,135	4,580	89
6	230	Bl akt	150	0	0	480	0	0	500	372	74.4
7	231	Invest.	37,327	15,072	40.4	25,067	9,384	37.4	7,090	3352	47.3
		Totali	**93,048**	**56,344**	**60.5**	**85,664**	**58,205**	**68**	**61,927**	**36,297**	**58.6**
7	606	Pak	63,302	63,276	99	76,778	76,126	99	47,983	39,907	83
			156,350	**119,620**	**76.5**	**162,442**	**134,331**	**82.7**	**109,910**	**76,204**	**69.3**

Nga verifikimi i shpenzimeve të kryera nëpërmes degës së thesarit (urdhër shpenzimeve), është respektuar çelja e fondeve në nivel programi dhe artikulli dhe likuidimet janë kryer mbështetur në fondet e çelura. Teprica e llogarisë "Diponibilitete në thesar në fund të mbylljes të periudhave ushtrimore është e rakorduar me thesarin.

-Në se Kryetar i Komunës ka raportuar në Këshillin e Komunës për gjendjen ekonomiko-financiare, të paktën njëherë në 6 muaj, sipas nenit 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.
*-Auditim me zgjedhje të administrimit të ndihmave ekonomike, procedurat e shqyrtimit në Këshillat e Komunave, plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e tyre etj. të përcaktuara në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij***.**
Në ish- Komunën Cakran nuk është aplikuar ndihmë ekonomike, pasi familjarët nuk kanë përfituar ndihmë meqenëse kanë në pronësi tokë bujqësore. Janë aplikuar ndihma për raste emergjencash dhe fatkeqësi të ndryshme me dokumentacion të rregullt dhe me miratim në Këshillin Komunës.
Buxheti është miratuar në Këshillin e Komunës për çdo vit ushtrimorë mbështetur në burimin e të ardhurave të veta dhe grandeve nga buxheti i shtetit.
Për vitin 2013, buxheti është miratuar në Këshillin e Komunës me vendimin nr. 5, datë 25.03.2013.
Nga totali i shpenzimeve të programuara për vitin 2013, janë programuara nga të ardhurat 31,188 mijë lekë, ndërsa nga buxheti i shtetit janë programuar të ardhura 40,869 mijë lekë, trashëguar nga viti 2012 , në vlerën 3,346 mijë lekë . Gjithsejte janë programuar 75,403 mijë lekë. Programimi i buxhetit është mbështetur në kërkesat e ligjit nr.119/2012, datë 17.12.2012 *"Për miratimin e buxhetit të vitit 2013"*
Për vitin 2014 buxheti është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 9, datë 12.03.2014 dhe konfirmuar nga prefekti i Qarkut Fier.
Të ardhurat janë planifikuar në total 83,923 mijë lekë nga të cilat, transfertë e pakushtëzuar 41,277 mijë lekë , trashëguar nga viti 2013 në vlerën 12,070,mijë lekë dhe të ardhur të planifikuar nga taksat dhe tarifat vendore në 30,575 mijë lekë, garanci punimesh sipas të dhënave të pasqyruara në bilancin e vitit 2013 në vlerën 3,281 mijë lekë .
Programimi i buxhetit është mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 185/2013, datë 02.12.2013 *"Për miratimin e buxhetit të vitit 2014.*
Për vitin 2015, buxheti është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 29.01.2015 , në total të ardhura të planifikuara (Burimet e financimit të shpenzimeve) 48,289

mijë lekë nga të cilat, transfertë e pakushtëzuar 10,525 mijë lekë trashëguar nga viti 2014 në shumën 8,566 mijë lekë dhe të ardhura të programuara nga taksat dhe tarifat vendore 25,919 mijë lekë, garanci punimesh 3,310 mijë lekë.

Buxhetet janë përgatitur sipas ligjit Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Mbi Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit".

Detyrimet afat shkurtra sipas bilanceve në lekë.

Nr./llogarive	Emërtimi llogarive	Bilancet e viteve		
		2013	2014	2015
401	Furnitorë	98,065,707	169,208,954	-
42	Personeli	1,613,538	2,001,588	-
431	Detyrim tatim taksave	73,421	45,004	-
4341	Operacione me shtetin	16,069,635	24,987,481	19,920,528
435	Sigurime shoqërore	502,376	559,014	-
436	Sigurime shëndetësore	70,046	77,576	-
464	Detyrime për tu paguar për letra me vlerë .	-		-
466	Kr. Për mjete në ruajtje	1,500,407	953,227	965,035
467	Kr. të ndryshëm	-	-	9,805,891
	Totali detyrime	**117,895,130**	**197,832,844**	**30,679,484**

Llogaria e diponibilitete në thesar në vitin 2013, ka rezultuar me tepricë aktive për 13,570,634 lekë ,në vitin 2014 në vlerën 8,837,392 lekë , ndërsa në 6/mujorin e vitit 2015 në vlerën 4,762,117 lekë, rakorduar me Degën e Thesarit Fier.

Në momentin e shkrirjes së aktivitetit të Komunës Cakran datë 07.07.2015 sipas të dhënave të rakorduar me Degën e Thesarit Fier është bërë rakordimi për të ardhurat e trashëguar nga grandi dhe realizimi i të ardhurave nga programi vjetor (viti buxhetor 2015) që i përket 6/mujorit të dytë të vitit (transferuar në Bashkinë Fier).

Për vitin 2015 000/lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Programuar	Përdorur	Mbetur
1.	Trashëguar nga 2014, të ardhura dhe grandi	7,884	7,884	0
2.	Të ardhura të realizuara 2015	6,842	5,464	1,377
3.	Nga buxheti për 6/mujorin viti 2015	26,905	24,473	2,432
4.	Garanci Punimesh	953	-	953
Totali		**42,584**	**37,821**	**4,762**

Si mangësi u konstatua se në mbyllje të periudhave ushtrimore nuk janë saktësuar detyrimet ndaj të tretëve e veçanërisht detyrimet e vitit 2012 e të vitit 2013 për të i përfshirë në buxhetet e viteve pasardhëse. Edhe pse nuk janë realizuar treguesit programuar gjatë zbatimit të buxhetit, nuk është bërë rishikimi i buxhetit gjatë viteve buxhetore ,por vetëm në mbyllje të vitit, në kundërshtim me nenin 47 të ligjit të buxhetit, i ndryshuar.

- **Në ish Komunën Dërmënas.**

-Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejt dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Pasqyrat financiare janë plotësuar mbi të dhënat e nxjerra nga përmbledhësja e ditarëve të kontabilitetit, por si mangësi u konstatua se:

Nuk është mbajtur ditari i veprimeve të ndryshme për mbylljen e llogarive në mbyllje të periudhave ushtrimore (viti 2013 ,2014 e 6/ mujori i parë i vitit 2015). Gjithashtu nuk është hartuar libri përmbledhës i llogarive për pasqyrimin e xhirove debitorë e kreditore të llogarive sintetike dhe të llogarive analitike (lëvizjet e llogarive). Mosplotësimi i këtij dokumentacioni bie në kundërshtim me Udhëzimin i Ministrisë Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14,datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar. Për detyrimet ndaj të tretëve të rezultuar nga mbyllja e aktivitetit të Komunës nga Auditimi i brendshëm i bashkisë është ushtruar auditim për saktësimin e detyrimeve ndaj të tretëve mbështetur në faturat përkatëse dhe janë bërë sistemimet duke u mbështetur në faturat. Nga ana e bashkisë janë bërë sistemimet mbështetur në shkresën nr. 3083/2, datë 12.10.2015 .

*-Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit, sistemimi i diferencave, si dhe respektimi i dispozitave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina***.**

Për vitin 2013 dhe 2014 është kryer inventarizimi i pasurisë së komunës. Fillimisht janë ngritur komisionet inventarizimit sipas objekteve me urdhër të veçantë të kryetarit të Komunës.

Në kontabilitet nuk janë pasqyruar diferenca. Nga Auditimi i ushtruar nga Auditimi i Brendshëm i Prefekturës Fier është ushtruar auditim tematik financiar sipas programit nr.1134,datë 27.08.2014 për "Verifikimin e gjendjes kontabël dhe fizike të llogarisë nr.218, inventarë ekonomik për institucionet arsimore të rrethit Fier dhe Mallakastër në varësi të organeve të qeverisjes vendore "është kërkuar kryetarit të Komunës në Rekomandimin nr. 5, të dalë urdhri ekzekutiv në ngarkim të N. V. për vlerën **739,663 lekë**, për sa kanë rezultuar mangët 12 kompjuterë në vlerë 492,761 lekë, 16 karrige në vlerë **64,512 lekë**, 11 UPS në vlerë **59,043 lekë** dhe 1(një) kompjuterë e 1(një) laptop me vlerë **123,347 lekë**. Nga verifikimi i analizës së llogarisë nr.468 "debitor të ndryshëm", u konstatua se nuk është përfshirë në debitorë dhe nuk është shlyer detyrimi. **Ky veprim ngarkon me përgjegjësi ish – Kryetarin e Komunës z. V. F. në cilësinë e nëpunësit urdhërues, pasi nuk ka urdhëruar marrjen e masave për rakordimin me DAR Fier, për furnizimet e kryera në adresë të shkollave që janë administruar nga Ish-Komuna Fier dhe nxjerrjen përgjegjësisë materiale.**

-Zbatimi i normativave të harxhimit për pjesë këmbimi, të karburanteve të mjetet motorike apo Gjeneratorët që disponon Komuna, miratimi në Këshillin e Komunës për secilin tip, mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, pajisje me leje qarkullimi i tyre, pagesa e taksave dhe siguracione vjetore.

Për përdorimin e karburantit janë plotësuar fletë udhëtimet dhe është llogaritur karburanti mbi bazën e distancave të përshkruar nga shoferët. Përdorimi i karburantit është audituar dhe nga auditi i brendshëm i bashkisë deri më datën e shkrirjes së komunës.

-Administrimi, dokumentimi dhe marrja në dorëzim e ndihmave nga donatorët e ndryshëm.

Sipas të dhënave të kontabilitetit dhe të inventarëve fizik nga komuna nuk janë dokumentuar ndihma nga donatorë të huaj.

-Administrimi i letrave me vlerë, sipas përcaktimeve në VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë, i ndryshuar me VKM nr. 277,datë 6.4.2011 dhe VKM nr. 393, datë 18.6.2014.

Sipas të dhënave të kontabilitetit dhe të inventarëve fizik nga komuna nuk janë dokumentuar letra me vlerë.

-Auditim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

Nga ish- Komuna në Bashkinë Fier vetëm është dorëzuar bilanci i 6/mujorit të parë të vitit 2015, i shoqëruar me analizat përkatëse me të dhënat mbi debitorët dhe kreditorët dhe i shoqëruar me inventarin e llogarive për aktivet afat gjata dhe afat shkurtra. Në llogarinë nr. 202, " Studime e kërkime në vlerën 640,000 lekë është e pa analizuar dhe trashëgohet nga viti 2012.

Nuk është zbatuar pika2,e kreut V-të " Transferimi i arkivave dhe i dokumentacionit të njësive që shkrihen".

-Auditim mbi ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit kontabël në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe zbatimi i rregullores "Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore".

Dokumentacioni i kontabilitetit aktualisht administrohet në arkivin e Njësisë Administrative Dermenas , pasi në Bashkinë Fier nuk ka patuar ambiente për arkivim.

Përfundimisht u arrit në konkluzion se: Pasqyrat financiare përgjithësisht janë plotësuar mbështetur në të dhënat e kontabilitetit , por u konstatuan dhe mungesë e artikujve kontabël në mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, pasi nuk është plotësuar libri përmbledhës i llogarive (centralizatori apo libri i madh). Në llogarinë nr. 202 " Studime e kërkime në vlerën 640,000 lekë është e pa analizuar dhe trashëgohet prej vitesh (nga viti 2012). Në bilance nuk janë pasqyruar shpenzime në proces për investimet e pa përfunduara. Gjithashtu janë kryere dhe veprime ekstra kontabël (pa artikuj), fenomene këto të konstatuara dhe nga auditi i brendshëm e bashkisë. Këto veprime bien në kundërshtim me Udhëzimin i Ministrisë Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14,datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar.

Për sa mësipërm është mbajtur akt-verifikimet nr. 18, datë 11.05.2017, me personat z. H. M. me detyrë ish- Përgjegjës i Sektorit të Financës (nëpunës zbatues), që ka drejtuar Sektorin e Financës deri më datë 30.06.2015 dhe ka mbyllur bilancin e 6/ mujorit të vitit 2015.

- **Në ish Komunën Frakull.**

-Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimin i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Në mijë lekë

Nr.	Nr. llog	Emërtimi shpenzimit	Viti 2013			Viti 2014			6/ mujori I 2015		
			plan	fakt	%	plan	fakt	%	plan	fakt	%
1	600	Paga	16,172	13,989	86.5	18,018	16,935	94	16,091	7,266	45
2	601	Sigurime sh	4,671	1,928	41,28	5,666	2,654	47	3,801	1,215	32
3	602	Operative	12,447	8,245	66	12,985	8,980	69	4,950	3,996	80
4	604	**Trans.brend.**	200	**-**	**0**	**200**	**0**	**0**	**200**	**0**	**0**
	230	**projekte**	960	**-**	**0**	**1,260**	**0**	**0**	**1,260**	**0**	**0**
5	231	Investime	15,544	11,883	**76**	**18,510**	**11,617**	**63**	**10,503**	**10,502**	**99**
6		**Totali**	**49,994**	**36,045**		**56,639**	**40,186**		**36,805**	**22,979**	
7	606	Ndihma ekon	41,816	**41,816**	**99**	**42,637**	**39,776**	**93**	**28,944**	**18,258**	**63**

Shpenzimet dhe të ardhurat për vitin 2013 janë miratuar me vendimin e Këshillit të Komunës Frakull nr. 1,datë 14.01.2013 dhe të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier.
Për vitin 2014, buxheti është miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2014, ndërsa për vitin 2015 është miratuar me vendimin nr. 13, datë 21.01.2015.
Buxhetet janë miratuar mbështetur në treguesit e të ardhurave dhe të grandeve .
Nga verifikimi i shpenzimeve të kryera nëpërmes degës së thesarit (urdhër shpenzimeve), është respektuar çelja e fondeve në nivel programi dhe artikulli dhe likuidimet janë kryer mbështetur në fondet e çelura. Teprica e llogarisë "Diponibilitete në thesar në fund të mbylljes të periudhave ushtrimore është e rakorduar me thesarin. Në mbyllje të vitit ushtrimorë 2013, mjete likuide në thesar janë pasqyruar në bilanc 386,086 lekë, në vitin 2014, janë pasqyruar 6,485,969 lekë, ndërsa për vitin 2015 (6/mujori parë) ka një tepricë në vlerën 1,163,382 lekë. Të dhënat janë të njëjtat të dhënat e pasqyruara në pasqyrën " Formati nr. 5" Pasqyrë e lëvizjes në cash".
Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për çdo muaj dhe në mbyllje të periudhave ushtrimore është rakorduar me thesarin për shpenzimet e kryera sipas artikujve.
-Në se Kryetar i Komunës ka raportuar në Këshillin e Komunës për gjendjen ekonomiko-financiare, të paktën njëherë në 6 muaj, sipas nenit 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.
Në mbyllje të periudhave ushtrimore, është bërë miratimi i realizimit të treguesve të buxhetit të vitit ushtrimorë dhe programimi i treguesve të vitit pasardhës, por nuk janë përgatitur raporte për gjendjen e realizimit të të ardhurave dhe ndryshimet për 6/mujorin e dytë.
-Auditim me zgjedhje të administrimit të ndihmave ekonomike, procedurat e shqyrtimit në Këshillat e Komunave, plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e tyre etj. të përcaktuara në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij.
Buxheti është miratuar në Këshillin e Komunës për çdo vit ushtrimorë mbështetur në burimin e të ardhurave të veta dhe grandeve nga buxheti i shtetit. Për vitin 2013, buxheti është miratuar në Këshillin e Komunës me vendimin nr. 02 datë 25.01.2013.
Nga totali i shpenzimeve të programuara për vitin 2013, janë programuara nga të ardhurat 26,715 mijë lekë, ndërsa nga buxheti i shtetit janë programuar të ardhura 20,767 mijë lekë., trashëguar nga viti 2012, në vlerën 549 mijë lekë , garanci punimesh 1,166 mijë lekë.
Për vitin 2014 buxheti është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 10.02.2014
Të ardhurat janë planifikuar në total 25,359 mijë lekë nga të cilat, transfertë e pakushtëzuar 23,979 mijë lekë , trashëguar nga viti 2013 në vlerën 279 mijë lekë. Totali i të ardhurave 49,617 mijë lekë.

Për vitin 2015, buxheti është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 13 datë 20.01.2015 , në total të ardhura të planifikuara (Burimet e financimit të shpenzimeve) 33,944 mijë lekë nga të cilat, transfertë e pakushtëzuar 10,911 mijë lekë trashëguar nga viti 2014 në shumën 5,974 mijë lekë dhe të ardhura të programuara nga taksat dhe tarifat vendore 17,059 mijë lekë, garanci punimesh .

Detyrimet afat shkurtra sipas bilanceve në lekë.

Nr/llogarive	Emërtimi llogarive	Bilancet e viteve		
		2013	2014	2015
401	Furnitorë	1,697,751	0	-
42	Personeli	795,790	1,251,960	-
431	Detyrim tatim taksave	0	24,587	-
4341	Operacione me shtetin	0	0	-
435	Sigurime shoqërore	850,845	193,746	-
436	Sigurime shëndetësore	0	21,958	-
464	Detyrime për tu paguar për letra me vlerë .	0	0	-
466	Kr. Për mjete në ruajtje	88,843	512,232	1,120,913
467	Kr. të ndryshëm	15,119,670	2,258,313	17,977,639
Totali detyrime		**18,552,899**	**4,262,796**	**19,098,552**

Llogaria e diponibilitete në thesare në vitin 2013, ka rezultuar me tepricë aktive për 368,086 lekë, në vitin 2014 në vlerën 6,485,969 lekë, ndërsa në 6/mujorin e vitit 2015 në vlerën 1,163,382 lekë, rakorduar me Degën e Thesarit Fier.
Për çdo muaj dhe në mbyllje të periudhave ushtrimore janë kryer rakordimet me Degën e Thesarit Fier për të ardhurat dhe shpenzimet.
Në momentin e shkrirjes së aktivitetit të Komunës Frakull datë 07.07.2015, sipas të dhënave të rakorduar me Degën e Thesarit Fier është bërë rakordimi për të ardhurat e trashëguar nga grandi dhe realizimi i të ardhurave nga programi vjetor (viti buxhetor 2015) që i përket 6/mujorit të dytë të vitit (*transferuar në Bashkinë Fier*).

Për vitin 2015 000/lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Programuar	Përdorur	Diferenca
1	Trashëguar nga 2014, të ardhura dhe grandi	5,974	5,974	-
2	Të ardhura të realizuara 2015	11,091	11,091	-
3	Nga buxheti për 6/mujorin viti 2015	2,329	2,286	43
4	Garanci Punimesh	1,633	512	1,121
	Totali	**21,027**	**19,863**	**1164**

- **Në ish Komunën Levan.**

-Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimin i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt trequesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Buxheti i Komunës LEVAN në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2013			Viti 2014			6/mujor 2015		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	600 paga	24,450	20,294	83	24,086	20,056	83	20,156	11,430	56.7
2	601sigurme	3677	3368	91.5	3,667	3306	90	3,364	1,895	56.3
3	602, operat	29875	22,844	76.4	31,182	28,042	90	28,377	13,024	45.9
	606 Ndihma	-	-	-	1,229	430	35	3,115	2659	85.3
4	231 Innves.	12,177	4,477	36.7	8,737	6,956	80	4,020	2,647	65.8
5	230 Blerje	1,780	470	26.4	1,440	833	58	960	98	10.2
6	Totali	71,959	51451	71.5	70,341	59,623	85	59,992	31,753	53
7	PAK	75,182	75,106	99.8	80,685	77,160	95	41,490	32,387	78
Totali		147,141	126,559	86	151,026	136,783		101,482	64,140	63.2

Buxheti i vitit 2013 është miratuar me VKK nr. 17, datë 24.01.2013.
Për vitin 2014, buxheti është miratuar me VKK nr. 18, datë 27.01.2014
Për vitin 2015,buxheti është miratuar me VKK nr. 21,datë 16.01.2015.
Vendimet e Këshillit të Komunës janë konfirmuar nga Prefekti I Qarkut Fier.

Detyrimet afat shkurtra sipas bilanceve LEVAN në lekë.

Nr/llogarive	Emërtimi llogarive	Bilancet e viteve		
		2013	2014	2015
401	Furnitorë	4,300,748	0	-
42	Personeli	1,409,916	1,422,321	-
431	Detyrim tatim taksave	106,334	37,397	-
341	Operacione me shtetin	-	-	9,185,984
435	Sigurime shoqërore	415,465	399,870	-
436	Sigurime shëndetësore	58,052	55,493	-
466	Kr. Për mjete në ruajtje	294,836	419,167	499,351
467	Kr. të ndryshëm	2,176,594	1,903,862	409,372
	Totali detyrime	**8,761,945**	**4,238,110**	**10,094,707**

Janë programuar në buxhet detyrimet e viteve të mëparshme sipas faturave . Buxheti është hartuar i balancuar me të ardhurat dhe shpenzimet duke përfshirë dhe grandet e buxhetit të shtetit. Nga verifikimi i shpenzimeve të kryera nëpërmes degës së thesarit (urdhër shpenzimeve), është respektuar çelja e fondeve në nivel programi dhe artikulli dhe likuidimet janë kryer mbështetur në fondet e çelura. Teprica e llogarisë "Diponibilitete në thesar në fund të mbylljes të periudhave ushtrimore është e rakorduar me thesarin.

-*Në se Kryetar i Komunës ka raportuar në Këshillin e Komunës për gjendjen ekonomiko-financiare, të paktën njëherë në 6 muaj, sipas nenit 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*.

Nga kryetari I komunës është raportuar në këshillin e Komunës në mbyllje të periudhave ushtrimore dhe paralelisht janë paraqitur treguesit për vitin e ri ushtrimorë. Në treguesit e realizuar për shpenzimet e programuara nuk janë tejkaluar shpenzimet e planifikuara në fillim të periudhave ushtrimore.

-Auditim me zgjedhje të administrimit të ndihmave ekonomike, procedurat e shqyrtimit në Këshillat e Komunave, plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e tyre etj. të përcaktuara në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij.

Nuk është aplikuar ndihmë ekonomike e pjesshme, apo e plotë për arsye se nuk plotësohen kriteret pasi familjet janë të pajisur me tokë bujqësore. Janë aplikuar vetëm ndihma të veçanta për raste fatkeqësish me dokumentacion mbështetës dhe të miratuar rast pas rasti në Këshillin e Komunës Levan.

Për vitin 2015 ***000/lekë***

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Programuar	Përdorur	Diferenca
1	Trashëguar nga 2014, të ardhura dhe grandi	5100	5,100	-
2	Të ardhura të realizuara 2015	15,743	12,593	3,150
3	Nga buxheti për 6/mujorin viti 2015	11,319	11,058	261
4	Garanci Punimesh	918	419	499
	Totali	**33,080**	**29,170**	**3,910**

- **Në ish Komunën Libofshë.**

-Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimin i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Nr.	Emërtimi	Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	600 paga	24,070	20,088	83.4	22,468	20,872	92.8	21,774	12,598	57.8
2	601sigurme	4,092	3,380	82.6	4,011	3,563	88.8	3,703	2,103	56.8
3	602, operat	10,698	6,880	64.3	10,644	7,707	72.4	7,576	1,136	15
4	604,transferta	1,069	0	0	1,285	0	0	529	0	0
5	231 Innves.	25,537	22,625	88.6	23,271	22,822	98	12,115	11,479	94.7
6	230 Blerje ak.	0	0	0	200	0	0	0	0	0
7	**Totali**	**65,466**	**52,973**		**61,879**	**54,964**		**45,697**	**27,316**	
8	606, PAK	34,274	34,274		36,558	34,517		20,535	19,913	

Nga verifikimi i shpenzimeve të kryera nëpërmes degës së thesarit (urdhër shpenzimeve), është respektuar çelja e fondeve në nivel programi dhe artikulli dhe likuidimet janë kryer mbështetur në fondet e çelura. Teprica e llogarisë "Diponibilitete në thesare në fund të mbylljes të periudhave ushtrimore është e rakorduar me thesarin.

-Në se Kryetar i Komunës ka raportuar në Këshillin e Komunës për gjendjen ekonomiko-financiare, të paktën njëherë në 6 muaj, sipas nenit 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

Auditim me zgjedhje të administrimit të ndihmave ekonomike, procedurat e shqyrtimit në Këshillat e Komunave, plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e tyre etj. të përcaktuara në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij.

veta dhe grandeve nga buxheti i shtetit.

Buxheti është miratuar në Këshillin e Komunës për çdo vit ushtrimorë mbështetur në burimin e të ardhurave të veta dhe grandeve nga buxheti i shtetit.

Për vitin 2013, buxheti është miratuar në Këshillin e Komunës me vendimin nr. 02datë 25.01.2013

Nga totali i shpenzimeve të programuara për vitin 2013, janë programuara nga të ardhurat 26,300 mijë lekë, ndërsa nga buxheti i shtetit janë programuar të ardhura 20,972 mijë lekë, trashëguar nga viti 2012 , në vlerën 4,183 mijë lekë , garanci punimesh 1,166 mijë lekë.

Për vitin 2014 buxheti është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 10.02.2014 Të ardhurat janë planifikuar në total 55,028 mijë lekë nga të cilat transfertë e pakushtëzuar 23,132 mijë lekë, trashëguar nga viti 2013 në vlerën 3,053,mijë lekë dhe të ardhura të planifikuar nga taksat dhe tarifat vendore në 25,610 mijë lekë, garanci punimesh sipas llogarisë të pasqyruara në bilancin e vitit 2013 në vlerën 3,281 mijë lekë. Totali i të ardhurave 55,028 mijë lekë.

Për vitin 2015, buxheti është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 29.01.2015, në total të ardhura të planifikuara (Burimet e financimit të shpenzimeve) 48,289 mijë lekë nga të cilat, transfertë e pakushtëzuar 10,525 mijë lekë trashëguar nga viti 2014 në shumën 8,566 mijë lekë dhe të ardhura të programuara nga taksat dhe tarifat vendore 25,919 mijë lekë, garanci punimesh 3,310 mijë lekë.

Detyrimet afat shkurtra sipas bilanceve në lekë.

Nr./llogarive	Emërtimi llogarive	Bilancet e viteve		
		2013	2014	2015
401	Furnitorë	10,424,754	8,597,658	9,044,398
42	Personeli	4,247,692	1,576,341	-
431	Detyrim tatim taksave	78,472	27,510	-
4341	Operacione me shtetin	1,775,195	3,109,802	3,363,547
435	Sigurime shoqërore	296,612	301,626	-
436	Sigurime shëndetësore	198,928	202,292	-
464	Detyrime për tu paguar për letra me vlerë .	-	-	-
466	Kr. Për mjete në ruajtje	3,291,001	3,309,706	1,624,686
467	Kr. të ndryshëm	-	-	-
	Totali detyrime	**20,312,654**	**17,124,935**	**14,032,631**

Llogaria e diponibilitete në thesar në vitin 2013, ka rezultuar me tepricë aktive për 6,296,344 lekë ,në vitin 2014 në vlerën 11,845,336 lekë, ndërsa në 6/mujorin e vitit 2015 në vlerën 7,248,448 lekë, rakorduar me Degën e Thesarit Fier.

Për çdo muaj dhe në mbyllje të periudhave ushtrimore janë kryer rakordimet me Degën e Thesarit Fier për të ardhurat dhe shpenzimet.

Për vitin 2015, Buxheti është miratuar me vendimin nr. 1, datë 25.01.2015, të përbërë nga: Transfertë e pakushtëzuar 10,525 mijë lekë, trashëguar nga viti 2014,në vlerë totale 8,566 mijë lekë , nga të ardhurat 25,919 mijë lekë.

Në momentin e shkrirjes së aktivitetit të Komunës Libofshë datë 07.07.2015 sipas të dhënave të rakorduar me Degën e Thesarit Fier është bërë rakordimi për të ardhurat e trashëguar nga grandi dhe realizimi i të ardhurave nga programi vjetor (viti buxhetor 2015) që i përket 6/mujorit të dytë të vitit (transferuar në Bashkinë Fier).

Në komunën Libofshë është dhënë ndihmë ekomomike e pjesshme dhe e plotë , për vitin 2013, në shumën 278 mijë lekë , në vitin 2014 në vlerën 220 mijë lekë dhe në vitin 2015 në vlerën 184 mijë lekë. Për çdo muaj, ndihma ekonomike është miratuar në Këshillin e Komunës.

Burimet e financimit dhe përdorimi për 7/mujorin 2015 në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Realizuar	Përdorur	Diferenca
11	Trashëguar nga 2014, të ardhura dhe grandi	8,536	8,536	0
22	Të ardhura të realizuara 2015	13,480	12,220	1260

33	Nga buxheti për 6/mujorin viti 2015	10,525	6,162	4363
44	Garanci Punimesh	4,934	3,310	1,624
5	Totali	**37,475**	**30,228**	**7,247**

- **Në ish Komunën Qendër**.

-Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimin i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Buxheti është miratuar në Këshillin e Komunës për çdo vit ushtrimorë mbështetur në burimin e të ardhurave të veta dhe grandeve nga buxheti i shtetit.

Në mijë lekë

Nr.	Nr. llog	Emërtimi shpenzimit	Viti 2014			6/mujori 2015		
			plan	fakt	%	plan	fakt	%
1	600	Paga	28,504	23,666	83	30,822	14,960	48.5
2	601	Sigurime sh	4,547	3,953	87	4,916	2,499	50.8
3	602	Operative	22,219	14,942	67	19,582	8,973	45.8
4	604	**Trans.brend.**	875	**0**	**0**	200	**11**	**5.5**
	606		1,758	**1,410**	**80**	2,070	**2,070**	**100**
5	231	Investime	13,756	**10,113**	**73.5**	4,200	**2,180**	**52**
	230	Blerje AQT	500	**0**	**0**	0	**0**	**0**
6		**Totali**	**72,159**	**54,084**	**75**	61,790	**30,693**	**49.7**
7	606	Paaftësi +ndihma	47,391	45,956	**97**	**25,241**	17,977	**71.2**
			119,550	100,040	**83.6**	**87,031**	48,670	**56**

Për vitin 2013, në ish Komunën Qendër Fier është ushtruar auditim nga KLSH**.**

Për vitin 2014, buxheti është miratuar me VKK nr. 7 datë 30.01.2014 në shumën totale 63,425 lekë dhe të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier.

Për vitin 2015, Buxheti është miratuar me VKK nr.3,datë 23.01.2015 në shumën totale 56,819 mijë lekë.

Detyrimet afat shkurtra sipas bilanceve në/lekë. Komuna Qendër

Nr/llogarive	Emërtimi llogarive	Bilancet e viteve		
		2013	2014	2015
401	Furnitorë	10,000	-	-
42	Personeli	1,529,000	1,858,671	-
431	Detyrim tatim taksave	88,848	44,660	-
4341	Operacione me shtetin	-	-	-
435	Sigurime shoqërore	446,361	525,133	-
436	Sigurime shëndetësore	61,946	72,876	-
464	Detyrime për tu paguar për letra me vlerë .	-	-	-
466	Kr. Për mjete në ruajtje	461,253	936,250	1,044,514
467	Kr. të ndryshëm	-	-	-

Nr/llogarive	Emërtimi llogarive	Bilancet e viteve		
		2013	2014	2015
	Totali detyrime	**2,597,218**	**3,437,590**	**1,044,514**

Llogaria e diponibilitete në thesar në vitin 2013, ka rezultuar me tepricë aktive për 4,143,471 lekë ,në vitin 2014 në vlerën 14,310,047 lekë , ndërsa në 6/mujorin e vitit 2015 në vlerën 17,025,253 lekë, rakorduar me Degën e Thesarit Fier. Të dhënat e pasqyruara në bilancet përkatëse janë të njëjta me pasqyrën formatin nr. 4, Pasqyrë e lëvizjes në "Cash".
Për çdo muaj dhe në mbyllje të periudhave ushtrimore janë kryer rakordimet me Degën e Thesarit Fier për të ardhurat dhe shpenzimet.
Nga verifikimi i treguesve të programuar dhe të realizuar të buxheteve sipas viteve ushtrimore u konstatua se: Janë programuar burimet e financimit dhe shpërndarja e shpenzimeve sipas programeve dhe artikujve . Për çdo vit ushtrimorë janë programuar në buxhet detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve në përshtatje me udhëzimet e buxhetit.

Burimet e financimit dhe përdorimi për 7/mujorin 2015 në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Realizuar	Përdorur	Diferenca
2	Trashëguar nga 2014, të ardhura dhe grandi	4,596	4,596	-
3	Të ardhura të realizuara 2015	19,574	16,202	3,372
4	Nga buxheti për 6/mujorin viti 2015	13,079	9,840	3,239
	Grande konkurruese	21,394	7,195	14,199
5	Garanci Punimesh	2,172	122	2,050
	Totali	**60,815**	**37,955**	**22,860**

Ndihma ekonomike për çdo muaj është paraqitur në Këshillin e komunës dhe nga krahasimi i vendimeve të Këshillit të (me të zgjedhur) me listë pagesat e hartuar nga ekonomisti i ndihmës ekonomike u gjetën të njëjta. Nga Auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve u konstatua se: Janë zbatuar dispozitat ligjore në hartimin dhe zbatimin e buxhetit të komunës .
Për sa mësipërm është mbajtur akt-verifikimet nr. 25, datë 12.05.2017, me personat znj.L.Dh. me detyrë ish- Përgjegjëse e Sektorit të Financës (nëpunëse zbatuese), dhe ish- Kryetarin e Komunës z. H. M..

- **Në ish Komunën Topojë.**

Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimin i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.
-Në se Kryetar i Komunës ka raportuar në Këshillin e Komunës për gjendjen ekonomiko-financiare, të paktën njëherë në 6 muaj, sipas nenit 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".
Auditim me zgjedhje të administrimit të ndihmave ekonomike, procedurat e shqyrtimit në Këshillat e Komunave, plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e tyre etj. të përcaktuara në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar dhe aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij.

Buxheti është miratuar në Këshillin e Komunës për çdo vit ushtrimorë mbështetur në burimin e të ardhurave të veta dhe grandeve nga buxheti i shtetit.

Zbatimi i buxhetit në 000/lekë

Nr.	Nr. llog	Emërtimi i shpenzimit	Viti 2013			Viti 2014			6/ mujori I 2015		
			plan	fakt	%	plan	fakt	%	plan	fakt	%
1	600	Paga	19,238	14,567	75.7	19,663	12,229	62.2	13,400	6,120	45,7
2	601	Sigurime shoqërore	2,789	2,449	87.8	2,160	2,016	93	2,150	901	42
3	602	Operative	15,701	8,144	51.8	15,819	10,796	68	17,197	9,097	52.9
	604	Transferta familjare	350	-	0	165	-	-	160	-	0
	606	Ndihma (emergj)	240	115	48	300	95		300	810	270
4	231	Investime	29,981	29,981	100	17,894	6,203		11,490	2,703	23.5
		Totali	**68,299**	**55,466**	**81.2**	**58,056**	**31,339**		**44,697**	**26,025**	**58.2**
	604	Ndihma ekon	32,687	32,687	**100**	**34,558**	34,558	**100**	**17,186**	**17,486**	**100**

Për vitin 2013, buxheti është miratuar në Këshillin e Komunës me vendimin nr. 8 datë 29.01.2013

Detyrimet afat shkurtra sipas bilanceve në lekë. Komuna Qendër

Nr/llogarive	Emërtimi llogarive	Bilancet e viteve		
		2013	2014	2015
401	Furnitorë	12,532,323	16,209,567	18,433,344
42	Personeli	7,982,326	88,436	0
431	Detyrim tatim taksave	58,706	20,571	0
4341	Operacione me shtetin	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	303,812	250,797	0
436	Sigurime shëndetësore	42,167	34,806	0
464	Detyrime për tu paguar për letra me vlerë	0		0
466	Kr. Për mjete në ruajtje	2,055,745	2,145,556	2,280,729
467	Kr. të ndryshëm	1,498,200	1,282,500	1,067,100
	Totali detyrime	**24,473,279**	**20,832,233**	**21,790173**

Nga totali i shpenzimeve të programuara për vitin 2013, janë programuara nga të ardhurat 34,433 mijë lekë, ndërsa nga buxheti i shtetit janë programuar të ardhura 13,342 mijë lekë. Të ardhurat të trashëguara 1880 mijë lekë, gjithsej 49,655 mijë lekë.

Për vitin 2014, buxheti i Komunës është miratuar me vendimin nr. 6 datë 28.01.2014. Janë programuar të ardhura nga të ardhurat e veta 29,487 mijë lekë mijë lekë , ndërsa nga buxheti i shtetit janë programuar të ardhura 17,410 mijë lekë (grand). Janë trashëguar të ardhura nga viti 2013 në vlerën 9,104 mijë lekë. Ndryshimet në buxhet për vitin 2013 dhe 2014, rast pas rasti janë miratuar në këshillin e komunës. Buxheti është i detajuar në muaj e tremujor e vjetor. Plani i të ardhurave dhe taksave vendore për vitin 2014 është planifikuar në shumën 29,487 mijë lekë.

Sipas vendimit nr. 7, datë 28.02.2014, të Këshillit të Komunës Topojë , është bërë ndryshim në buxhetin e komunës duke pakësuar zërin, " Shtrime rrugësh të brendshme nëpër fshatra 900 mijë lekë, pakësim ", " Blerje makinë shërbimi në vlerën 400 mijë lekë" dhe është shtuar zëri " Ndërtim Kopshti në fshatin Grykë në vlerën 1,300 mijë lekë". Gjithashtu është bërë ndryshim në buxhet brenda zërit "Materiale shkollore 120 mijë lekë" duke e pakësuar dhe duke shtuar zërin "sponsorizonim e A. Gj. 70 mijë lekë" , për librin e botuar dhe "M. G. për 50 mijë lekë për librin e botuar". Vendimi i Këshillit të Komunës është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier sipas shkresës nr. 320/3,25.03.2014. Nga buxheti i Komunës nuk mund

të bëhen sponsorizime dhe një veprim bien në kundërshtim me ligjin e buxhetit dhe ngarkon me përgjegjësi ish- Kryetari i Komunës z. A. V. në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe ish-P/ Financës T. L. në cilësinë e nëpunëses zbatuese. **Vlera për 120,000 lekë përbën përdorim pa efektivitet të fondeve publike.**

Për vitin 2015, Buxheti është miratuar me vendimin nr. 1, datë 26.01.2015, në vlerë totale 42,552 mijë lekë nga të ardhurat e komunës 30,837 mijë lekë, të trashëguara nga 2014 në vlerë 3,794 mijë lekë, grand i vitit 2015 në vlerë 7,921 mijë lekë.

Burimet e financimit dhe përdorimi për 7/mujorin 2015 në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Realizuar	Përdorur	Diferenca
1	Trashëguar nga 2014, të ardhura dhe grandi	3,794	3,794	0
2	Të ardhura të realizuara 2015	6,394	5,996	398
3	Nga buxheti për 6/mujorin viti 2015	7,918	7918	0
4	Garanci Punimesh	4,426	2,146	2,280
	Totali	**22,532**	**19,854**	**2,678**

(Trajtuar gjerësisht në faqen 32-45, të Projektraport Auditimit)

IX/3. Dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës *(Pagat e shpërblimet)*

Nga Auditimi i dokumentacionit në ish Komunat Qendër, Libofshë, Topojë, Frakull, Levan, Cakran dhe Dërmënas, nuk u konstatuan probleme në pikat e mëposhtme të auditimit sipas programit, konkretisht:

-Auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit (kryesisht ato me arsim të lartë), për pagesën sipas klasave të kryer.

U auditua bazushmëria ligjore e klasave, kategorive, pagat sipas grupit, emërtimeve, shtesave për vjetërsi, pozicion, të pagave të vendosura nga Këshilli i Komunës, për efekt page mbi caktimin e kufijve të pagave të organeve të qeverisjes vendore, sipas VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore", i ndryshuar me VKM nr. 598, datë 27.04.2009; VKM nr. 693, datë 18.08.2010; VKM nr. 553, datë 11.08.2011 dhe VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", *rezulton se ato janë në përputhje aktet ligjore e nënligjore.*

-Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 01.01.2013 – 30.07.2015.

U audituan Listpagesat e periudhës (Prill – Maj 2013, Janar - Maj 2014 dhe Janar – Qershor 2015), ku konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara. Shumat bruto korrektuar me ndalesat rakordojnë me shumat neto dhe përmbledhëset përkatëse. Listë prezencat janë plotësuar çdo fund muaj ku shënohen ditë punët e administratës, të nënshkruara nga Kryetari i Komunës, mbi bazën e të cilave janë hartuar listë pagesat. Është hartuar përmbledhësja në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. Listpagesat janë të kuadruara me përmbledhjen e tyre dhe kopjen i kalon bankës për pagat e punonjësve në llogaritë përkatëse të tyre. Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit te sigurimeve shoqërore të punonjësve të Ish-Komuna Libofshë, janë në

përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003"Për mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ne RSH".

-Krahasimi me të zgjedhur i përmbledhëses të listë pagesave me shumat e urdhër shpenzimeve dhe pagesat e kryera, përllogaritjet, aplikimet dhe derdhja e detyrimeve, për tatimin mbi të ardhurat, kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore etj.

-Krahasimi me të zgjedhur i përmbledhëses të listë pagesave me shumat e urdhër shpenzimeve dhe pagesat e kryera, përllogaritjet, aplikimet dhe derdhja e detyrimeve, për tatimin mbi të ardhurat, kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore etj.

Nga Auditimi i përmbledhëses të listë pagesave duke i krahasuar me urdhër shpenzimet rezulton se në të gjitha rastet përmbledhëset e listë pagesave janë të barabarta me urdhër shpenzimet përkatëse. Në përmbledhësen e listë pagesave janë përcaktuar paga bazë, vjetërsia në punë, pozicioni, shuma bruto, ndalesa për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ndalesa për tatimin mbi të ardhurat dhe paga neto. Gjithashtu, në urdhër shpenzim janë përcaktuar sipas grupit, kapitullit, kodit programor, llogarive ekonomike, nën llogarive duke përcaktuar shumat përkatës, veprime në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Fondi i pagës është miratuar me VKK nr. 6 datë 28.01.2014 "Për miratimin e buxhetit te vitit 2014". U be verifikimi i punonjësve ne fakt sipas liste pagesës se muajit qershor 2014 dhe dolën se si ne sektorin e Administratës dhe ne sektorin e punonjësve mbështetës, paguhen punonjës brenda limitit te miratuar me VKK.

Ne sektorin e punonjësve mbështetës është shtuar 1 punonjës, shofer administrate me VKK nr. 11, datë 27.3.2014 "Për miratimin e pozicionit "Shofer i shërbimeve për administratën", me page mujore 30,000 lekë.

Nga Këshilli i Komunës janë miratuar nivelet e pagave sipas grupeve e klasave për punonjësit, përcaktimi i klasave dhe grupeve sipas vendeve te punës është bere për çdo rast konkret nga ekzekutivi me emërimet respektive te punonjësve. Pagat e vendosura për çdo punonjës, janë bere sipas klasave, kategorive dhe pagave individuale te përcaktuara ne lidhjet përkatëse te pagave , midis tyre ka 8 punonjës me arsim te larte te cilët janë paguar për pagën sipas vendimit te mësipërm dhe për diplomën e vjetërsinë sipas VKM përkatëse.

Pra pagesa e punonjësve është bere sipas rregullave ku si baze është VKM nr. 586 datë 17.07.2013 "Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësive vendore".

Për të gjithë punonjësit është llogaritur paga bruto dhe bere ndalesa për çdo punonjës për kontributin e sig. shoqërore -shëndetësore sipas ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për sig. shoqërore ne Republikën e Shqipërisë", tatim mbi te ardhurat personale , kjo sipas ligjit nr. 107/2013 "Për disa ndryshime ne ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 " Për tatimin mbi te ardhurat" te ndryshuar, pasi janë bere ndalesat ka dale paga neto për secilin prej tyre e cila është depozituar ne llogarinë e tyre bankare çdo muaj.

-Respektimi i dispozitave ligjore për kohëzgjatjen e kohës së punës, pagesa për orë jashtë orarit të punës etj.

Nga Auditimi i bërë dokumenteve të bankës dhe listpagesave, u konstatua se nuk ka punonjës që janë paguar për orët jashtë orarit.

-Hapja dhe azhornimi periodik i librit të pagave.

Nga sektori i financës ishin hapur librat e pagave, të cilat ishin të azhornuara dhe të plotësuara për çdo punonjës dhe kuadruar me përmbledhëset e listë pagesave dhe pagat mujore të përfituara. Në këto libra janë evidentuar pagat bazë, shtesat për funksionet, pagat mbi të cilat llogaritej tatimi mbi të ardhurat, paga mbi të cilën llogaritej kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe ndalesat respektive, deri në pagën neto.

-Auditimi mbi organizimin e dosjes së regjistrit të personelit

Dosjet personale të punonjësve pas ballafaqimit të problemeve me personat përgjegjës, u konstatua se ato janë të plotësuara në përputhje me kërkesat e nenit 95, të ligjit nr. 7961 dt. 12.07.1995 "Kodi i Punës ne R.SH", i ndryshuar dhe me VKM nr. 355, datë 07.07.2000 "Për organizimin e dosjes se regjistrit te personelit". Gjithashtu është mbajtur dhe regjistri i punonjësve.

- **Në ish Komunën Libofshë.**

-Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar.

Ish-Komuna Libofshë ka ushtruar funksionin e saj në zbatim të VKM për Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës dhe Pagës në Njësitë e Qeverisjes Vendore, konkretisht: ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore", ndryshuar; me VKM nr. 586, datë 17.07.2013, VKM nr. 589, datë 17.07.2013 për disa ndryshime në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrave dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet…….dhe administratën e prefektit", *konkretisht*:

Për vitin 2013, me VKK nr. 91, datë 13.12.2012 është miratuar struktura organizative e administratës të ish-Komunës Libofshë me 27 punonjës. Me vendim të KK nr. 92, datë 13.12.2012 është miratuar numri i punonjësve me kontratë në arsim dhe komunë prej 18 punonjësish, nga e cila: në arsim prej 9 punonjës dhe në komunë prej 9 punonjësish Me vendim nr. 93, datë 13.12.2012 të KK është miratuar numri i punonjësve të ujësjellës kanalizime, gjithsej 20 punonjësish Gjithsej numri i punonjësve të miratuar në ish-Komunën Libofshë është **65 punonjës**.

Për vitin 2014, struktura e organikes se punonjësve për Komunën Libofshe është miratuar me Vendim Këshillit Komunës (këtu e në vijim VKK), te ndara sipas sektorëve përkatës, administrate 25 punonjës sipas VKK nr. 48 datë 11.12.2014 "Për miratimin e strukturës se organikes" dhe pagesa e tyre është miratuar me VKK nr. 51 datë 11.12.2014 "Mbi miratimin e nivelit te pagave te administratës", për punonjësit mbështetës për shërbime te ndryshme te komunës, 18 punonjës me VKK nr. 5, datë 01.01.2014 "Për miratimin e strukturës organizative te punonjësve mbështetës te Komunës Libofshe" dhe pagesa e tyre është miratuar me VKK nr. 54 dt. 11.12.2014" Për miratimin e nivelit te pagave te sektorit mbështetës, për ujësjellësin 21 punonjës, miratuar me VKK nr. 53 datë 11.12.2013 "Për miratimin e strukturës e organikes" dhe pagesa e tyre është bere sipas VKK nr. 53 datë 11.12.2014 "Për miratimin e nivelit te pagave te sektorit se ujësjellësit", gjithsej nr. punonjësve është miratuar **64 punonjës**.

Për vitin 2015, struktura organike e punonjësve është miratuar me VKK, te ndara sipas sektorëve përkatës, administrate **25 punonjës**, sipas VKK nr. 47, datë 2.12.2014 "Për miratimin e strukturës organike", gjate vitit është shtuar një punonjës. Pagesa është bere sipas VKK nr. 50 datë 02.12.2014 sektori i punonjësve mbështetës me kontrate, **18 punonjës**, këto

me VKK nr. 48, datë 02.12. 2014 "Për miratimin e strukturës organizative te Komunës Libofshe", dhe pagesa është bere sipas VKK nr. 53 datë 2.12.2014 dhe për ujësjellësin, **21 punonjës** kjo sipas VKK nr. 49 datë 02.12.2014. Pagesa është bere sipas VKK nr. 52 datë 02.12.2014. U be verifikimi i nr. te punonjësve ne fakt dhe dolën ne rregull , pra brenda limitit te miratuar.

-Realizimi i fondit të pagave. Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma, fatkeqësi.

-Mbi përdorimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore në lekë.

Nr	Emërtimi	Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Fondi i pagës	24,070,200	20,088,380	83.4	22,468,000	20,872,519	92.8	21,774,000	12,597,735	57.8
2	F.sig. shoqer.	4,091,900	3,380,167	82.6	4,011,000	3,563,318	88.8	3,703,000	2,102,843	56.8
3	Fondi veçantë	1,069,000	0	0	1,285,000	0	0	529,000	0	0

Nga Auditimi i dokumentacionit mbi krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, të dhëna të cilat janë pasqyruar në tabelën mësipërm, konstatohet se fondi i veçantë nuk është përdorur nga komuna.

Për vitin 2013 fondi i pagave është planifikuar në vlerën 24,070 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 20,088 mijë lekë ose 8.4%, për vitin 2014 fondi i pagave është planifikuar 22,468 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 20,872 mijë lekë ose 92.8%, ndërsa për vitin 2015 (6/mujori parë/2015) janë planifikuar 21,774 mijë lekë dhe janë përdorur në vlerën 12,597 mijë lekë ose 57.8%. Nga të dhënat konstatohet se ky fond nuk është tejkaluar.

Auditimi mbi marrjen dhe dorëzimin e detyrës me akt verifikim.

Nga Auditimi, rezulton se të gjithë punonjësit e rimarrë në detyrë ose të larguar, dorëzimi dhe marrja e detyrës nuk është bërë me akt verifikim, sipas pikave 50 dhe 51, të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunëse civil, pezullimi dhe lirimi".

-Zbatimi i vendimeve të Gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona.

Nuk ka raste të pagesave të kryera me vendim gjykate për punonjës të larguar nga puna**.**

***Pagesa e Këshilltarëve*.**

Në ish-Komunën Libofshë, janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve të Këshillit të Komunës për çdo muaj mbi bazën e listprezencave të pjesëmarrjes së në mbledhjet e këshillave, të hartuara nga Kryetari i Këshillit dhe të dërguara pranë Sektorit të Financës për kryerjen e pagesave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve, mbajtur nga Sekretari i Këshillit për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë përkatës, nuk përkon me listprezencat e dorëzuara, të cilëve u është paguar shpërblimi padrejtësisht për këto muaj në shumën **1,444,500lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën1,444,500 lekë***(sipas pasqyrës Aneks 2, bashkëlidhur Raport Auditimit)***,**nga e cila: për vitin 2013 në vlerën 783,000 lekë dhe për vitin 2014 në vlerën 661,500 lekë.

Komente dhe sqarime. *Shpjegimet e paraqitura nga ish Kryetari dhe Sekretari i Këshillit të Komunës Libofshe me shkresën nr. 2085/88, datë 15.05.2017 (ardhur në KLSH me datë 23.05.2017), në lidhje me kryerjen e pagesave të kundërligjshme të ish këshilltarëve pa qenë*

prezent në mbledhjet, nuk argumenton problemin e trajtuar nga grupi i auditimit, kjo për faktin se:
Sipas ligjit këshilltari shpërblehet për punën që kryhen që në rastin konkret është pjesëmarrja në mbledhjet e këshillave. Të dhënat në lidhje me mungesat janë marrë nga protokolli i mbledhjeve ku në fillim të çdo mbledhje është pasqyruar prezenca dhe mungesa e këshilltarëve. ***Argumenti juaj nuk qëndron.***

- **Në ish Komunën Qendër.**

*-Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar***.**
Ish-Komuna Qendër ka ushtruar funksionin e saj në zbatim të VKM për Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës dhe Pagës në Njësitë e Qeverisjes Vendore, konkretisht: ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore", ndryshuar; me VKM nr. 586, datë 17.07.2013, VKM nr. 589, datë 17.07.2013 për disa ndryshime në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrave dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet…….dhe administratën e prefektit", *konkretisht*:
Për vitin 2013, me VKK nr. 03, datë 31.01.2013 të KK është miratuar struktura organizative e administratës të ish-Komunës Qendër me **72 punonjës,** *nga e cila* Kryetar, Zv/kryetar **2** punonjës, sek/këshill komune një person, Sek/Kryetari një person, Dega e financës **3** punonjës, dega e taksave **5** punonjës, dega e menaxhimit të mbrojtjes **4** punonjës, dega e PZHT prej **5** punonjës, dega e IMT prej **2** punonjës, Policia Komunës **2** punonjës, dega juridike **një** punonjës, dega e administratës **një** punonjës, gjendja civile **një** punonjës, dega e shërbimeve **6** punonjës, dega e shërbimeve **6** punonjës, sektori i shërbimeve **25** punonjës, konvikti i shkollës së mesme **12** punonjës. Me vendim nr. 4, datë 30.01.2013 të KK është miratuar paga e punonjësve të punonjësve të ish-Komunës Qendër.
Vendimet e mësipërme janë miratuar nga Prefekti Qarkut Fier me shkresën nr. 117/1, datë 08.02.2013, si në përputhje me ligjin.
Për vitin 2014, me VKK nr. 03, datë 30.01.2014 të KK është miratuar struktura organizative e administratës të ish-Komunës Qendër me **72 punonjës,** *nga e cila* Kryetar, Zv/kryetar **2** punonjës, sek/këshill komune një person, Sek/Kryetari një person, Dega e financës **3** punonjës, dega e taksave **5** punonjës, dega e menaxhimit të mbrojtjes **4** punonjës, dega e PZHT prej **5** punonjës, dega e IMT prej **2** punonjës, Policia Komunës **2** punonjës, dega juridike **një** punonjës, dega e administratës **një** punonjës, gjendja civile **një** punonjës, dega e shërbimeve **6** punonjës, dega e shërbimeve **6** punonjës, sektori i shërbimeve **25** punonjës, konvikti i shkollës së mesme **12** punonjës. Me vendim nr. 4, datë 30.01.2013 të KK është miratuar paga e punonjësve të punonjësve të ish-Komunës Qendër.
Vendimet e mësipërme janë miratuar nga Prefekti Qarkut Fier me shkresën nr. 166/1, datë 07.02.2014, si në përputhje me ligjin.
Për vitin 2015, me VKK nr. 02, datë 26.01.2015 të KK është miratuar struktura organizative e administratës të ish-Komunës Qendër me **72 punonjës,** *nga e cila* Kryetar, Zv/kryetar 2 punonjës, sek/këshill komune një person, sek/Kryetari një person, Dega e financës 3 punonjës, dega e taksave 5 punonjës, dega e menaxhimit të mbrojtjes tokës 4 punonjës, dega e PZHT 5 punonjës, dega e IMT prej 2 punonjës, Policia Komunës 2 punonjës, dega juridike një punonjës, dega e administratës një punonjës, gjendja civile një punonjës, dega e shërbimeve 6

punonjës, dega e shërbimeve 6 punonjës, sektori i shërbimeve 30 punonjës, konvikti i shkollës së mesme 12 punonjës.
Vendimi i mësipërme janë miratuar nga Prefekti Qarkut Fier me shkresën nr. 113/1, datë 03.02.2015, si në përputhje me ligjin.

-Auditimi mbi marrjen dhe dorëzimin e detyrës me akt verifikim.
Nga Auditimi, rezulton se të gjithë punonjësit e rimarrë në detyrë ose të larguar, dorëzimi dhe marrja e detyrës nuk është bërë me akt verifikim, sipas pika 50 dhe 51, të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunëse civil, pezullimi dhe lirimi"**.**
-Zbatimi i vendimeve të Gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona.
Nuk ka raste të pagesave të kryera me vendim gjykate për punonjës të larguar nga puna**.**
Për sa mësipërm është mbajtur akt-verifikimet nr. 4, datë 02.05.2017, me ish-Komunën Qendër (sot Njësia Administrative Qendër), me z. H. M. me funksion ish-Kryetar Komune dhe B. X. me funksion ish P/Zyrës Administratës dhe Arkiviste.

-Për Këshilltarët e ish Komunës Qendër.
Në ish-Komunën Qendër, janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve të Këshillit të Komunës për çdo muaj mbi bazën e listprezencave të pjesëmarrjes së në mbledhjet e këshillave, të hartuara nga Kryetari i Këshillit dhe të dërguara pranë Sektorit të Financës për kryerjen e pagesave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve, mbajtur nga Sekretari i Këshillit për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë përkatës, nuk përkon me listprezencat e dorëzuara, të cilëve u është paguar shpërblimi padrejtësisht për këto muaj në shumën **864,400 lekë** *(sipas pasqyrës Aneks 3, bashkëlidhur Projektraport)*, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën864,400 lekë**(nga e cila për vitin 2014 në vlerën 607,500 lekë dhe periudhën e gjashtëmujorit të parë 2015 në vlerën 256,500 lekë).

- **Në ish Komunën Topojë**.

*-Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar***.**
Ish-Komuna Topojë ka ushtruar funksionin në zbatim të VKM për Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës dhe Pagës në Njësitë e Qeverisjes Vendore, konkretisht: ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore", ndryshuar; me VKM nr. 586, datë 17.07.2013, VKM nr. 589, datë 17.07.2013 për disa ndryshime në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrave dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet…….dhe administratën e prefektit", *konkretisht*:
Për vitin 2013, me VKK nr. 6, datë 30.01.2013 të KK është miratuar struktura organizative e administratës me **20 punonjës.** Me vendim nr. 7, datë 29.01.2013 të KK është numrin e punonjësve me kontratë gjithsej prej **29 punonjësish** Gjithsej numri në Komunën Topojë paraqitet për **49 punonjës**. Vendimet e mësipërme janë konfirmuar nga Prefekti qarkut me shkresën nr. 106/1, datë 11.02.2013.

Për vitin 2014, struktura e organikes se punonjësve për Komunën Topojë është miratuar me VKK, te ndara sipas sektorëve përkatës, ne administrate **13** punonjës, sipas VKK nr. 33 datë 27.12.2013 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave". Për punonjësit mbështetës për shërbime te ndryshme te komunës, **15** punonjës këto me VKK nr. 34, datë 27.12.2013 "Për miratimin e strukturës organizative te punonjësve mbështetës". Gjithsej numri i punonjësve është miratuar **28 punonjës**.

Për vitin 2015, struktura organike e punonjësve është miratuar me VKK, te ndara sipas sektorëve përkatës, administrate prej **13 punonjës** dhe sektori i punonjësve mbështetës me kontrate prej 19 punonjës, miratuar me VKK nr. 3, datë 23.01. 2015 " Për miratimin e strukturës organizative". U be verifikimi i nr. te punonjësve ne fakt, sipas liste-pagesës se muajit Mars 2015 dhe doli se administrata kishte 13 punonjës dhe sektori mbështetës kishte 17 punonjës, me pak 2 punonjës, nuk është paguar punonjës pastrimi ne fshatin SheqMarinëz me pagën 22,000 lekë dhe elektricist me pagë 22,000 lekë, pra nr. i punonjësve dhe pagesa është bere brenda limitit te miratuar. Procedura e pagesës se punonjësve është njësoj si ajo e vitit 2014 dhe është bere, për administratën sipas VKK nr. 4, datë 16.01.2015 "Për miratimin e nivelit te pagave administratës", ndërsa për punonjësit mbështetës me VKK nr. 5, datë 23.01.2015 "Për miratimin e pagave te punonjësve mbështes", ku janë përcaktuar pagat për çdo punonjës sipas pozicionit dhe detyrës funksionale.

-Realizimi i fondit të pagave. Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma, fatkeqësi.

-Mbi përdorimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore në 000/lekë.

Emërtimi	Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Fondi i pagës (Llog 600)	19,588	10,401	53	20,263	18,888	93	13,337	6,199	46
Fondi i sigurimeve shoq	2,839	2,382	84	2,160	1,981	92	2,150	901	42
Fondi i veçantë	0	0	0	0	0	0	63	63	100

Nga Auditimi i dokumentacionit mbi krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, konstatohet se vetëm për vitin 2015 është përdorur në masën 63,000 lekë për dalje në pension të punonjësve sipas USH nr. 218, datë 25.06.2015 dhe urdhrit nr. 331, datë 15.06.2015.

Për vitin 2013 fondi i pagave është planifikuar në vlerën 19,588 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 10,401 mijë lekë ose 53%, për vitin 2014 fondi i pagave është planifikuar 20,263 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 18,888 mijë lekë ose 93%, ndërsa për vitin 2015 (6/mujori parë/2015) janë planifikuar 13,337 mijë lekë dhe janë përdorur në vlerën 6,199 mijë lekë ose 46%. Nga të dhënat konstatohet se ky fond nuk është tejkaluar.

-Auditimi mbi marrjen dhe dorëzimin e detyrës me akt verifikim.

Nga Auditimi, rezulton se të gjithë punonjësit e rimarrë në detyrë ose të larguar, dorëzimi dhe marrja e detyrës **nuk** është bërë me akt verifikim, sipas pika 50 dhe 51, të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunëse civil, pezullimi dhe lirimi.

-Zbatimi i vendimeve të Gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona.

Në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore të punonjësve të larguar nga puna, konstatohet se për këtë periudhë është vetëm një punonjës s që ka bërë ankimi në gjykatë, larguar në vitin 2011. Vlera e detyrimit sipas vendimit të gjykatës është prej 618,522 lekë bashkë me detyrimet përmbarimore, e cila është likuiduar totalisht deri me datë 01.07.2015 sipas marrëveshjes nr. 91, datë 19.02.2015**.**

-Për ish Këshilltarët e Komunës Topojë.

Në ish-Komunën Topojë, janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve të Këshillit të Komunës për çdo muaj mbi bazën e listprezencave të pjesëmarrjes së në mbledhjet e këshillave, të hartuara nga Kryetari i Këshillit dhe të dërguara pranë Sektorit të Financës për kryerjen e pagesave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve, mbajtur nga Sekretari i Këshillit për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë përkatës, nuk përkon me listprezencat e dorëzuara, të cilëve u është paguar shpërblimi padrejtësisht për këto muaj në shumën **1,275,750 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2 ku përcaktohet se: "*Këshilltari shpërblehet për punën që kryen*", i ndryshuar, ku përcaktohet se: *"Këshilltari kryen **funksionin** me shpërblim mujor të barabartë me 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të komunës përkatëse"*, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën1,275,750 lekë** *(sipas pasqyrës Aneks 4, bashkëlidhur Projektraport) (*nga e cila për vitin 2013 në vlerën 418,500 lekë, për vitin 2014 në vlerën 668,250 lekë dhe periudhën e gjashtëmujorit të parë 2015 në vlerën 189,000 lekë).

- **Në ish Komunën Levan.**

*-Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar***.**

Ish-Komuna Levan ka ushtruar funksionin e saj në zbatim të VKM për Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës dhe Pagës në Njësitë e Qeverisjes Vendore, konkretisht: ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore", ndryshuar; me VKM nr. 586, datë 17.07.2013, VKM nr. 589, datë 17.07.2013 për disa ndryshime në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrave dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet…….dhe administratën e prefektit", *konkretisht*:

Për vitin 2013, me VKK nr. 01, datë 24.01.2013 të KK është miratuar struktura organizative e administratës të ish-Komunës Levan me **26**punonjës**.** Me vendim nr. 2, datë 24.01.2013 të KK është niveli i pagave të administratës. Me vendim nr. 4, datë 24.01.2013 të KK është miratuar numri i punonjësve të punonjësve mbështetës, gjithsej **29**punonjës. Me vendimin nr. 5, datë 24.01.2013 të KK është miratuar niveli i pagave të punonjësve mbështetës, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Fier me shkresën nr. 101/1, datë 07.02.2013.

Për vitin 2014, struktura e organikes se punonjësve është miratuar me VKK nr. 2 datë 27.01.2014 "Për miratimin e strukturës se organikes", te ndara sipas sektorëve përkatës, administrate **25**punonjës dhe pagesa e tyre është miratuar me VKK nr. 3 datë 27.01.2014 "Mbi miratimin e nivelit te pagave te administratës", për punonjësit mbështetës për shërbime te ndryshme te komunës, **29**punonjës me VKK nr. 5, datë 27.01.2014 "Për miratimin e strukturës organizative te punonjësve mbështetës" dhe pagesa e tyre është miratuar me VKM nr. 6 datë 27.01.2014 " Për miratimin e nivelit te pagave te sektorit mbështetës". Gjithsej nr. punonjësve është miratuar **54 vete,** konfirmuar nga Prefekti Qarkut Fier me shkresën nr. 144/1, datë 04.02.2014.

Për vitin 2015, struktura organike e punonjësve është miratuar me VKK nr. 6, datë 16.01.2015, te ndara sipas sektorëve përkatës, administrate **24**punonjës, dhe sektori i punonjësve mbështetës me kontrate, **30**punonjës, këto me VKK nr. 9, datë 16.01.2015 "Për

miratimin e strukturës organizative", konfirmuar nga Prefekti Qarkut Fier me shkresën nr. 71/1, datë 28.01.2015.

-Realizimi i fondit të pagave. Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma, fatkeqësi.

-Mbi përdorimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore në lekë.

Nr	Emërtimi	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
		Plan	Plan	Plan
1	Fondi i pagës	23,298,498	23,088,726	19,052,618
2	F.sig. shoqërore.	3,500,000	3,500,000	3,180,000
	SHUMA	**26,798,498**	**26,588,726**	**22,232,618**

Efektet financiare për zbatimin e strukturës së pagesës do të përballohen 35% nga granti dhe 65% nga të ardhurat e realizuara gjatë vitit..

-Auditimi mbi marrjen dhe dorëzimin e detyrës me akt verifikim.

Nga Auditimi, rezulton se të gjithë punonjësit e rimarrë në detyrë ose të larguar, dorëzimi dhe marrja e detyrës **nuk** është bërë me procesverbal, sipas pika 50 dhe 51, të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunëse civil, pezullimi dhe lirimi**.**

-Zbatimi i vendimeve të Gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona.

Nuk ka raste të pagesave të kryera me vendim gjykate për punonjës të larguar nga puna**.**

-Për ish Këshilltarët e Komunës Levan.

Në ish-Komunën Levan, janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve të Këshillit të Komunës për çdo muaj mbi bazën e listprezencave të pjesëmarrjes së në mbledhjet e këshillave, të hartuara nga Kryetari i Këshillit dhe të dërguara pranë Sektorit të Financës për kryerjen e pagesave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve, mbajtur nga Sekretari i Këshillit për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë përkatës, nuk përkon me listprezencat e dorëzuara, të cilëve u është paguar shpërblimi padrejtësisht për këto muaj në shumën **1,312,740 lekë** *(sipas pasqyrës Aneks 5, bashkëlidhur Projektraport)*, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën1,312,740 *lekë***(nga e cila për vitin 2013 në vlerën 365,040 lekë, për vitin 2014 në vlerën 687,960 lekë dhe periudhën e gjashtëmujorit të parë 2015 në vlerën 259,740 lekë).

- **Në ish Komunën Frakull.**

*-Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar***.**

Ish-Komuna Frakull ka ushtruar funksionin e saj në zbatim të VKM për Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës dhe Pagës në Njësitë e Qeverisjes Vendore, konkretisht: ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore", ndryshuar; me VKM nr. 586, datë 17.07.2013, VKM nr. 589, datë 17.07.2013 për disa ndryshime në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrave dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet…….dhe administratën e prefektit", *konkretisht*:

Për vitin 2013, me VKK nr. 06, datë 24.02.2014 dhe miratim nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 13714, datë 13.03.2014 është miratuar struktura organike dhe niveli i pagave të ish-Komunës Frakull gjithsej **37 punonjës**.

Për vitin 2014, struktura organikes se punonjësve është miratuar për 41 punonjës, te ndara këto sipas sektorëve përkatës, administrate, punonjës me kontrate për shërbime te ndryshme te komunës, me VKK nr. 5 datë 17.01.2014 "Për miratimin e strukture organizative te Komunës Frakull".

U be verifikimi i punonjësve ne fakt sipas liste pagesës se muajit shkurt 2014 dhe dolën se ne sektorin e Administratës paguhen 24 punonjës ndërsa ne sektorin e punonjësve me kontrate paguhen 7 punonjës, pra janë brenda limitit te miratuar. Pagat e vendosura për çdo punonjës, janë bere sipas klasave, kategorive dhe pagave individuale te përcaktuara ne lidhjet përkatëse te pagave , konkretisht Administrata qe janë 24 punonjës dhe mbështetës me kontrate 7 punonjës. Pagesa e tyre është bere sipas VKK nr. 6, data 17.01.2014 "Për miratimin e pagave te administratës te Komunës Frakull", midis tyre ka dy punonjës me arsim te larte te cilët janë paguar për pagën sipas vendimit te mësipërm dhe për diplomën e vjetërsinë sipas VKM përkatëse. Pra pagesa e punonjësve është bere sipas rregullave ku si baze është VKM nr. 586 dt. 17.07.2013. Pasi është llogaritur paga bruto është bere ndalesa për çdo punonjës për kontributin e sig. Shoqërore -shëndetësore sipas ligjit nr. 7703 dt. 11.05.1993 "Për sig. shoqërore ne Republikën e Shqipërisë", tatim mbi te ardhurat personale , kjo sipas ligjit nr. 107/2013 "Për disa ndryshime ne ligjin nr. 8438, dt. 28.12.1998 " Për tatimin mbi te ardhurat" te ndryshuar, pasi janë bere ndalesat ka dale paga neto për secilin prej tyre e cila është depozituar ne llogarinë e tyre bankare çdo muaj. Pagat e punonjësve janë hedhur ne librin e pagave nga dega. e financës çdo muaj i cili është mbajtur sipas rregullave.

Për vitin 2015, struktura organike e punonjësve është miratuar me VKK, te ndara sipas sektorëve përkatës, administrate **25 punonjës**, sipas VKK nr. 47, datë 2.12.2014 "Për miratimin e strukturës organike", gjate vitit është shtuar një punonjës. Pagesa është bere sipas VKK nr. 50 datë 02.12.2014 sektori i punonjësve mbështetës me kontrate, **18 punonjës**, këto me VKK nr. 48, datë 02.12. 2014 "Për miratimin e strukturës organizative te Komunës Libofshe", dhe pagesa është bere sipas VKK nr. 53 datë 2.12.2014 dhe për ujësjellësin, **21 punonjës** kjo sipas VKK nr. 49 datë 02.12.2014. Pagesa është bere sipas VKK nr. 52 datë 02.12.2014. U be verifikimi i nr. te punonjësve ne fakt dhe dolën ne rregull , pra brenda limitit te miratuar.

Në format tabele numri i punonjësve për çdo vit paraqitet, si vijon:

Punonjësit sipas sektorëve:	**Viti 2013**	**Viti 2014**	**6-mujori i I/ Viti 2015**
Administrata	27	25	26
Shërbimet publike	18	18	19
Ujësjellësi	23	21	21
TOTALI	68	64	66

-Realizimi i fondit të pagave. Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma, fatkeqësi.

-Mbi përdorimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore në lekë.

Nr	**Emërtimi**	**Viti 2013**			**Viti 2014**			**Viti 2015**		
		Plan	**Fakt**	**%**	**Plan**	**Fakt**	**%**	**Plan**	**Fakt**	**%**
1	Fondi i pagës	24,070,200	20,088,380	83.4	22,468,000	20,872,519	92.8	21,774,000	12,597,735	57.8
2	F.sig. shoqer.	4,091,900	3,380,167	82.6	4,011,000	3,563,318	88.8	3,703,000	2,102,843	56.8
3	Fondi veçantë	1,069,000	0	0	1,285,000	0	0	529,000	0	0

Nga Auditimi i dokumentacionit mbi krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, të dhëna të cilat janë pasqyruar në tabelën mësipërm, konstatohet se fondi i veçantë nuk është përdorur nga komuna.
Për vitin 2013 fondi i pagave është planifikuar në vlerën 24,070 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 20,088 mijë lekë ose 8.4%, për vitin 2014 fondi i pagave është planifikuar 22,468 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 20,872 mijë lekë ose 92.8%, ndërsa për vitin 2015 (6/mujori parë/2015) janë planifikuar 21,774 mijë lekë dhe janë përdorur në vlerën 12,597 mijë lekë ose 57.8%. Nga të dhënat konstatohet se ky fond nuk është tejkaluar.
-Auditimi mbi marrjen dhe dorëzimin e detyrës me procesverbal.
Nga Auditimi, rezulton se të gjithë punonjësit e rimarrë në detyrë ose të larguar, dorëzimi dhe marrja e detyrës nuk është bërë me procesverbal, sipas pika 50 dhe 51, të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunëse civil, pezullimi dhe lirimi"**.**

-Për ish Këshilltarët e Komunës Frakull.
Në ish-Komunën Frakull, janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve të Këshillit të Komunës për çdo muaj mbi bazën e listprezencave të pjesëmarrjes së në mbledhjet e këshillave, të hartuara nga Kryetari i Këshillit dhe të dërguara pranë Sektorit të Financës për kryerjen e pagesave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve, mbajtur nga Sekretari i Këshillit për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë përkatës, nuk përkon me listprezencat e dorëzuara, të cilëve u është paguar shpërblimi padrejtësisht për këto muaj në shumën **935,000 lekë** *(sipas pasqyrës Aneks 6, bashkëlidhur Projektraport)*, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 935,000 lekë**(nga e cila për vitin 2014 në vlerën 935,550 lekë).

Komente dhe sqarime: *Në shpjegimet e paraqitura nga D. T. ish Sekretar i Këshillit të Komunës Frakull me shkresën nr. 2085/199, datë 25.06.2017 (prot KLSH nr. 276/9, datë 31.05.2017 në lidhje me pagesën e Këshilltarëve të ish-Komunës Frakull, merret në konsideratë fakti se detyrimet e konstatuara për periudhën e 6/mujorit/2015 nuk qëndrojnë, pasi nga ana e Zyrës së Financës së ish Komunës nuk janë kryer pagesat për Këshilltarët për këtë periudhë. Në këto kushte vlera e detyrimit për vitin 2015 (6 mujorin e parë) prej* ***381,150 lekë nuk qëndron****.*

- **Në ish Komunën Dërmënas.**

*-Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar***.**
Ish-Komuna Dërmenas ka ushtruar funksionin e saj në zbatim të VKM për Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës dhe Pagës në Njësitë e Qeverisjes Vendore, konkretisht: ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore", ndryshuar; me VKM nr. 586, datë 17.07.2013, VKM nr. 589, datë 17.07.2013 për disa ndryshime në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e

strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrave dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet…….dhe administratën e prefektit", *konkretisht*:

Për vitin 2013, me VKK nr. 34, datë 27.12.2012 të KK është miratuar struktura organizative e administratës të ish-Komunës Dermenas me **26 punonjës.** Me vendim nr. 35, datë 27.12.2012 të KK është niveli i pagave të punonjësve të ish Komunës Dermenas.

Për vitin 2014, struktura e organikës së Komunës Dërmenas është miratuar me VKK, si vijon: Administrata përbehet nga **28** punonjës, sipas VKK nr. 2 datë 17.01.2014, ndërsa pagesa e tyre është bërë me VKK nr. 3 datë 17.01.2014. Punonjës me kontratë janë miratuar **47** punonjës, sipas VKK nr. 4, datë 17.01.2014.

Për vitin 2015, struktura e organikës së Komunës është miratuar me VKK, si me poshtë: Administrata me **28** punonjës sipas VKK nr. 2 datë 16.01.2015, ndërsa niveli i pagës pagesa (klasa), sipas VKK nr. 3, datë 16.01.2015. Punonjës me kontratë janë 50 me pagë mujore 22,000 lekë, sipas VKK nr. 5 datë 16.01.2015.

-Realizimi i fondit të pagave. Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma, fatkeqësi.

-Mbi përdorimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore në 000/lekë.

Nr	Emërtimi	Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Fondi i pagës	14,810	14,211	95	16,652	16,636	99.9	15,528	8,093	52
2	F.sig. shoqërore.	2,897	2,422	83	2,563	2,487	97	2,943	1,254	42.6
	SHUMA	**17,707**	**16,633**		**19,215**	**19,123**		**18,471**	**9,347**	

Nga auditivi i dokumentacionit mbi krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, të dhëna të cilat janë pasqyruar në tabelën mësipërm, konstatohet se fondi i veçantë nuk është përdorur nga komuna.

Për vitin 2013 fondi i pagave është planifikuar në vlerën 14,810 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 14,211 mijë lekë ose 95%, për vitin 2014 fondi i pagave është planifikuar 16,652 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 16,636 mijë lekë ose 99.9%, ndërsa për vitin 2015 (6/mujori parë/2015) janë planifikuar 15,528 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 8,093 mijë lekë ose 52%. Nga të dhënat konstatohet se ky fond nuk është tejkaluar.

-Hapja dhe azhornimi periodik i regjistrit të pagave dhe organizimin e dosjes së regjistrit të personelit.

Nga Auditimi rezulton se është hapur regjistri themeltar i personelit, por që nuk është i plotësuar me te gjitha te dhënat e duhura dhe për te gjithë punonjësit, si kolona mbi largimin dhe motivi i largimit. Për çdo punonjës ka një dosje me te cilat ne vazhdimësi punohej për tu plotësuar me dokumentacionin e plote shkresor sipas kërkesave ligjore.

Nga Auditimi i dosjeve te vena ne dispozicion nga arshiva u konstatuan këto mangësi si:

Dokumentacioni themelor shkresor, konkretisht mungon fleta e inventarit, kërkesa për pune e shoqëruar me CV-ne përkatëse, vërtetimi nga organet e drejtësisë mbi gjendjen e tyre gjyqësore, mbi kualifikimet te ndryshme, nuk është përshkruar pozicioni i vendit te punës, paga baze për çdo punonjës, certifikate pune, vlerësime pune te dhënë nga Titullari i Institucionit për periudha 1-vjeçare etj. Gjithashtu mungojnë kontratat e punës ndërmjet punëdhënësit e punëmarrësit, veprime ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës ne RSh", neni 2, neni 36, neni 95 i tij, ndryshuar me ligjin nr. 8085 datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, ligjin nr. 10053, datë 29.12.2008 dhe me VKM nr. 355, datë 7.07.2000 "Për organizimin e dosjes se regjistrit te personelit" **dhe ngarkojnë me përgjegjësi Përgjegjësin/Administratës.**

-Auditimi mbi marrjen dhe dorëzimin e detyrës me akt verifikim.

Nga Auditimi, rezulton se të gjithë punonjësit e rimarrë në detyrë ose të larguar, dorëzimi dhe marrja e detyrës **nuk** është bërë me akt verifikim, sipas pika 50 dhe 51, të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunëse civil, pezullimi dhe lirimi"**.**

-Zbatimi i vendimeve të Gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona.

Nuk ka raste të pagesave të kryera me vendim gjykate për punonjës të larguar nga puna**.**

-Për ish Këshilltarët e Komunës Dërmënas.

Në ish-Komunën Dermenas, janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve të Këshillit të Komunës për çdo muaj mbi bazën e listprezencave të pjesëmarrjes së në mbledhjet e këshillave, të hartuara nga Kryetari i Këshillit dhe të dërguara pranë Sektorit të Financës për kryerjen e pagesave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve, mbajtur nga Sekretari i Këshillit për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë përkatës, nuk përkon me listprezencat e dorëzuara, të cilëve u është paguar shpërblimi padrejtësisht për këto muaj në shumën **1,744,844 lekë** *(sipas pasqyrës Aneks 7, bashkëlidhur Projektraport)*, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 1,744,844 lekë**(nga e cila për vitin 2013 në vlerën 657,892 lekë, për vitin 2014 në vlerën 993,898 lekë dhe periudhën e gjashtëmujorit të parë 2015 në vlerën 92,963 lekë).

Komente dhe sqarime: *Shpjegimet e paraqitura nga ish Kryetari dhe ish Sekretari të Këshillit të Komunës Dërmënas me shkresën nr. 2085/103, datë 22.08.2017 (ardhur në KLSH me datë 23.05.2017), nuk sqarojnë problemin e pagesës së këshilltarëve për rastet e mos prezencës në mbledhjet e Këshillave të Komunës,* ***pasi siç është theksuar edhe në ligj këshilltari shpërblehet për punën që kryhen (mbledhjet e këshillave).***

- **Në ish Komunën Cakran**

-Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturës organike të miratuar.

Ish-Komuna Cakran ka ushtruar funksionin e saj në zbatim të VKM për Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës dhe Pagës në Njësitë e Qeverisjes Vendore, konkretisht: ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të Organeve të Qeverisjes Vendore", ndryshuar; me VKM nr. 586, datë 17.07.2013, VKM nr. 589, datë 17.07.2013 për disa ndryshime në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrave dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet…….dhe administratën e prefektit", *konkretisht*:

Për vitin 2013, me VKK nr. 01, datë 25.03.2013 të KK është miratuar struktura organizative e administratës të ish-Komunës Cakran me **36 punonjës.** Me vendim nr. 2, datë 25.03.2013 të KK është numrin e punonjësve me kontratë gjithsej prej **14 punonjësish** Me vendim nr. 7, datë 25.03.2013 të KK është miratuar numri i punonjësve të me kontratë të ndërmarrjes së ujësjellësit, gjithsej **36 punonjës**. Me vendimin nr. 8, datë 25.03.2013 të KK është miratuar numri i punonjësve të zyrës së shërbimeve, gjithsej **6 punonjës**. Gjithsej numri në Komunën

Cakran paraqitet për **92 punonjës**. Vendimet e mësipërme janë konfirmuar nga Prefekti qarkut me shkresën nr. 284/1, datë 04.04.2013.

Për vitin 2014, me VKK nr. 01, datë 04.02.2014 të KK është miratuar struktura organizative e administratës të ish-Komunës Cakran me **34 punonjës.** Me vendim nr. 2, datë 25.03.2013 të KK është miratuar niveli i pagave të ish Komunës. Me vendim nr. 7, datë 25.03.2013 të KK është miratuar numri i punonjësve të me kontratë të ndërmarrjes së ujësjellësit, gjithsej **36 punonjës**. Me vendimin nr. 8, datë 25.03.2013 të KK është miratuar numri i punonjësve të zyrës së shërbimeve, gjithsej **6 punonjës**. Gjithsej numri në Komunën Cakran paraqitet për **92 punonjës**. Vendimet e mësipërme janë konfirmuar nga Prefekti qarkut me shkresën nr. 284/1, datë 04.04.2013.

Për vitin 2015, struktura organike e punonjësve është miratuar me VKK, te ndara sipas sektorëve përkatës, administrate **32 punonjës**, sipas VKK nr. 9, datë 27.02.2015 "Për miratimin e strukturës organike". Me vendim nr. 11, datë 27.02.2015 të KK është miratuar numri i punonjësve të zyrës së shërbimeve, gjithsej **8 punonjës**. Me vendim nr. 12, datë 27.02.2015 të KK është miratuar numri i punonjësve të ndërmarrjes së ujësjellësit, gjithsej **21 punonjës.** Me vendim nr. 13, datë 27.02.2015 të KK është miratuar numri i punonjësve mbështetës me kontratë për arsimin, gjithsej **14 punonjës.** Gjithsej numri i punonjësve paraqitet gjithsej prej **75 punonjës**. Vendimet e mësipërme janë konfirmuar nga Prefekti qarkut me shkresën nr. 303/1, datë 13.03.2015.

-Realizimi i fondit të pagave. Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma, fatkeqësi.

-Mbi përdorimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore në lekë.

Nr	Emërtimi	Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Fondi i pagës	27,245,440	24,825,820	91.1	36,824,690	35,683,260	96.9	24,857,170	16,020,400	64.4
2	F.sig. shoqërore.	3,532,700	2,984,600	84.5	4,361,000	4,153,550	95.2	4,794,000	2,252,200	46.9
	SHUMA	**30,778,140**	**27,810,420**	**0**	**41,185,690**	**39,836,810**	**0**	**29,651,170**	**18,272,600**	

Nga auditivi i dokumentacionit mbi krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, të dhëna të cilat janë pasqyruar në tabelën mësipërm, konstatohet se fondi i veçantë nuk është përdorur nga komuna për shpërblimin e punonjëse për punë të mirë në vlerën bruto 208,800 lekë dhe në dy raste për punonjës në rast fatkeqësie me vlerë bruto 60,000 lekë.

Për vitin 2013 fondi i pagave është planifikuar në vlerën 27,245 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 24,825 mijë lekë ose 91.1%, për vitin 2014 fondi i pagave është planifikuar 36,824 mijë lekë dhe është përdorur në vlerën 35,683 mijë lekë ose 96.9%, ndërsa për vitin 2015 (6/mujori parë/2015) janë planifikuar 24,857 mijë lekë dhe janë përdorur në vlerën 16,020 mijë lekë ose 64.4%. Nga të dhënat konstatohet se ky fond nuk është tejkaluar.

-Krahasimi me të zgjedhur i përmbledhëses të listë pagesave me shumat e urdhër shpenzimeve dhe pagesat e kryera, përllogaritjet, aplikimet dhe derdhja e detyrimeve, për tatimin mbi të ardhurat, kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore etj.

Nga Auditimi i përmbledhëses të listë pagesave duke i krahasuar me urdhër shpenzimet rezulton se në të gjitha rastet përmbledhëset e listë pagesave janë të barabarta me urdhër shpenzimet përkatëse. Në përmbledhësen e listë pagesave janë përcaktuar paga bazë, vjetërsia në punë, pozicioni, shuma bruto, ndalesa për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ndalesa për tatimin mbi të ardhurat dhe paga neto. Gjithashtu, në urdhër shpenzim janë përcaktuar sipas grupit, kapitullit, kodit programor, llogarive ekonomike, nën llogarive duke përcaktuar shumat përkatës, veprime në përputhje me ligjin nr. 9936, datë

26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Në auditimin e veprimeve me bankë, konstatohet se me urdhër shpenzimi nr. 55 datë 25.03.015, sipas urdhrit te titullarit nr. 151 datë 31.12.2014 është dhënë një rroge shpërblim page neto për 6 punonjës në vlerën 180,154 lekë, për rezultate te mira ne arkëtimin e te ardhurave nga taksat lokale. Pagesa e krye për 5 persona 180,154 lekë, është ne kundërshtim me VKM nr. 929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit te veçante", i ndryshuar me VKM nr. 493, datë 6.7.2011, konkretisht për punonjësit sipas pasqyrës:

Nr.	Emri Punonjësit	Paga bruto	Vl. ndalës	Paga neto
1.	Q. C	41,400	6,118.8	35,281
2.	D. L.	41,400	6,118.8	35,281
3.	S. S.	30,000	3,360	26,640
4.	I. B.	34,000	4,328	29,672
5.	S. S.	30,000	3,360	26,640
6.	G. M.	30,000	3,360	26,640
	Totali	**206,800**	**26,646**	**180,154**

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të VKM nr. 929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit te veçante", i ndryshuar me VKM nr. 493, datë 6.7.2011, me dëm ekonomik në buxhet për vlerën **180,154 lekë.**

Në auditimin e kryer konstatohet se për vitin 2013 për 44 punonjës me kontrate *(punonjës shërbimesh dhe ujësjellësit)* , paga bazë mbi të cilën janë paguar është nën nivelin e minimal të pagës prej 21,000 – 22,000 lekë/muaj, pasi janë paguar me pagë bazë 12,000 lekë/muaj **paguar kjo nga artikulli 602**, si dhe nuk janë aplikuar dhe ndalur detyrimet për sigurimet shoqërore në masën 11.2% për punëmarrësin dhe 16.7% për punëdhënësin**, duke mos xhiruar në buxhet vlerën prej 930,193 lekë** *(pasqyra Aneks 1, bashkëlidhur Raportin Përfundimtar të Auditimit)***,** veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8487, datë 13.05.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave te punës", i ndryshuar me ligjin nr. 9065, datë 08.05.2003 neni 5 germa (a); ligjin nr. 10405 datë 24.03.2011; VKM nr. 566, datë 14.07.2010, ndryshuar me VKM nr. 527, datë 20.7.2011 dhe VKM nr. 445, datë 11.7.2012 "Për përcaktimin e pagës minimale ne shkalle vendi"; ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, si dhe me ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësorë ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 9136 datë 18.08.2003 "Për mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqërore e shëndetësorë ne R.SH", **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi z. V. K. me funksion ish-Kryetar Komune dhe z. M. L. me funksion ish-P/Zyrës së Financës.**

Komente dhe sqarime: *Në shpjegimet e paraqitura nga ish Kryetari i Komunës z. V. K. dhe ish p/zyrës së financës z. A. Xh. me shkresën nr. 2085/95, datë 18.05.2017 në lidhje me problemin e mos pagesës së sigurimeve shoqërore për punonjësit me kontratë dhe paguar nën pagën minimale* ***nuk sqaron problemin e trajtuar nga grupi i auditimit të KLSH,*** *pasi veprimet janë në kundërshtim me dispozitat e mësipërme dhe se një VKK nuk mund të jetë në shkelje të ligjit. Merret ne konsideratë fakti se p/zyrës së financës ka qenë z. M. Ll. dhe jo A. Xh..* ***Argumenti juaj nuk qëndron.***

-Respektimi i dispozitave ligjore për kohëzgjatjen e kohës së punës, pagesa për orë jashtë orarit të punës etj.

Nga Auditimi i bërë dokumenteve të bankës dhe listpagesave, u konstatua se nuk ka punonjës që janë paguar për orët jashtë orarit.

-Hapja dhe azhornimi periodik i librit të pagave.

Nga sektori i financës ishin hapur librat e pagave, të cilat ishin të azhornuara dhe të plotësuara për çdo punonjës dhe kuadruar me përmbledhëset e listë pagesave dhe pagat mujore të përfituara. Në këto libra janë evidentuar pagat bazë, shtesat për funksionet, pagat mbi të cilat llogaritej tatimi mbi të ardhurat, paga mbi të cilën llogaritej kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe ndalesat respektive, deri në pagën neto.

-Auditimi mbi organizimin e dosjes së regjistrit të personelit

Ne dosjet personale te punonjësve mungon dokumentacioni themelor shkresor konkretisht kërkesa për punësim e shoqëruar me CV përkatëse, fotokopje e noterizuar e diplomës (për punonjësit me arsim te larte), ose te dëftesës se pjekurisë (për punonjësit me arsim te mesëm), certifikata te kualifikimeve te ndryshme, certifikata personale, referenca nëse kane punuar ne vende te tjera pune, vlerësime pune dhëne nga Titullari për periudha kohe te ndryshme (6 mujore apo një vjeçare), etj. Mungojnë kontratat e punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Regjistri i personelit është i pa plotësuar me te dhënat për te gjithë punonjësit, veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 95, të ligjit nr. 7961 dt. 12.07.1995 "Kodi i Punës ne R.SH", i ndryshuar dhe me VKM nr. 355, datë 07.07.2000 "Për organizimin e dosjes se regjistrit te personelit".

-Auditimi mbi marrjen dhe dorëzimin e detyrës me procesverbal.

Nga auditim, rezulton se të gjithë punonjësit e rimarrë në detyrë ose të larguar, dorëzimi dhe marrja e detyrës **nuk është bërë me procesverbal**, sipas pika 50 dhe 51, të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunëse civil, pezullimi dhe lirimi".

-Zbatimi i vendimeve të Gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona.

Nuk ka raste të pagesave të kryera me vendim gjykate për punonjës të larguar nga puna.

Për sa mësipërm është mbajtur procesverbal nr. 26, datë 10.05.2017, me z. V. K. me funksion ish-Kryetar Komune dhe z. A. Xh. me funksion ish-p/zyrës së financës dhe z. K. H. me funksion ish-p/zyrës së administratës, të cilët ngarkohen me përgjegjësi.

-Për ish Këshilltarët e Komunës Cakran.

Në ish-Komunën Cakran, janë kryer pagesa për shpërblimin e Këshilltarëve të Këshillit të Komunës për çdo muaj mbi bazën e listprezencave të pjesëmarrjes së në mbledhjet e këshillave, të hartuara nga Kryetari i Këshillit dhe të dërguara pranë Sektorit të Financës për kryerjen e pagesave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve, mbajtur nga Sekretari i Këshillit për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë përkatës, nuk përkon me listprezencat e dorëzuara, të cilëve u është paguar shpërblimi padrejtësisht për këto muaj në shumën **1,632,686 lekë** *(sipas pasqyrës Aneks 8, bashkëlidhur Raport Auditimit)*, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2 ku përcaktohet se: "*Këshilltari shpërblehet për punën që kryen*", i ndryshuar, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën1,632,686 lekë** (nga e cila për vitin 2013 në vlerën 814,320 lekë, për vitin 2014 në vlerën 561,600 lekë dhe periudhën e gjashtëmujorit të parë 2015 në vlerën 256,766 lekë).

Komente dhe sqarime. *Në argumentet e paraqitur nga ish punonjësit:*
-ish Komuna Libofshë me shkresën nr. 2085/29, datë 08.05.2017 nga ish punonjësja A. B.;
-ish Komuna Qendër me shkresën nr. 2085/30, datë 08.05.2017 nga ish punonjësja B. Xh.;
-ish Komuna Dërmënas me shkresën nr. 2085/28, datë 08.05.2017 nga ish punonjësit z. V. F. Kryetar dhe A. Ll.;
-ish Komuna Levan me shkresën nr. 2085/56, datë 10.05.2017 nga ish punonjësit Xh. M. Kryetar dhe S. K. protokoll arkiv, është sqaruar problemi i dosjeve personale të punonjësve, mbajtjes së regjistrit dhe dorëzimit të detyrës me procesverbal të cilat merren në konsideratë nga grupi auditimit.

Në lidhje me pretendimin që ngrihet nga ish Sekretari i Këshillit B. M. dhe Kryetari i Këshillit z. A. H. të Komunës Qendër dhe nga ish Sekretari i Këshillit A. M. dhe Kryetari i Këshillit z. M. S. të Komunës Topojë, ***nuk merret në konsideratë*** *shpjegimet e dhëna, pasi në referencë të ligjit të trajtuar në material (kapitulli IX/3), këshilltari paguar për prezencën në mbledhjet e këshillave të komunës.*

Në shpjegimet që jepen (në elektronik) nga ish Kryetari i Këshillit z. T. P. dhe ish Sekretari i Këshillit z. P. D. të Komunës Libofshë, sqarohet se ish këshilltari I. M. është zëvendësuar me këshilltarin K. G. por pa paraqitur dokumente justifikues. Ky argument ***nuk mund të merret në konsiderata*** *pasi sipas protokollit të mbledhjeve këshilltari I. M. rezulton i shkruar.*
Në lidhje me pretendimin se për 6/mujorin e parë 2015 nuk jeni paguar, merret në konsideratë dhe nuk gjen pasqyrim në material. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera ***nuk merret në konsideratë*** *shpjegimet e dhëna, pasi në referencë të ligjit të trajtuar në material (kapitulli IX/3), këshilltari paguar për prezencën në mbledhjet e këshillave të komunës.*

IX/4. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Nxjerrja e Pasqyrave financiare vjetore (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive të pasurisë publike. Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i vlerave materiale e monetare.

- **Në ish Komunën Qendër.**

-Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 " Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj". Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejt dhe në përputhje me aktet nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
Pasqyrat financiare janë plotësuar pjesërisht mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga ditarët e kontabilitetit. Si mangësi u konstatua se: nga ish- Sektori i Financës nuk është plotësuar ditari i veprimeve të ndryshme për mbylljen e llogarive në fund të çdo viti ushtrimorë. Gjithashtu nuk është plotësuar centralizatori apo libri i madh i llogarive.

Situacionet e investimeve nuk janë kontabilizuar. Bilanci i vitit 2013 nuk është shoqërua me rakordimi me Albtelekomin, Shërbimin Postar, CEZ-Shpërndarjen për detyrimet e prapambetura (*të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimore 2013*). E njëjta procedurë është ndjekur dhe për vitet 2014 e 6/mujorin e vitit 2015.

-Inventarizimi i pronës shtetërore , nxjerrja e rezultateve të inventarizimit ,sistemimi i diferencave ,si dhe respektimi i dispozitave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina .

Për vitin 2014 është inventarizuar pasuria e komunës. Nga Kryetari i Komunës ngritur komisioni i inventarizimit sipas urdhrit nr. 13.11.2014. Inventari fizik është kryer mbështetur në të dhënat e nxjerra nga kontabiliteti për aktivet afat gjata e aktivet afat shkurtra dhe materialet gjendje magazine dhe nga krahasimi nuk kanë rezultuar mungesa. Komisioni ka vlerësuar aktivet jashtë përdorimit dhe nga kryetari i komunës është ngritur komisioni i asgjësimit, sipas urdhrit nr.63,datë 13.11.2014.

Nga komisioni i asgjësimit janë ndjekur procedurat në përshtatje me UMF nr. 30. Është hartuar proces verbali datë 25.01.2015, duke bërë hyrje në magazinë si mbeturina për dru zjarri dhe për skrap të sasive të përdorshme. Janë bërë shkarkimet në kontabilitet në pasqyrën e bilancit "Ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara".

Bilanci i vitit 2014 dhe 6/ mujori i vitit 2015, është shoqëruar me analizën e llogarive të aktiveve të qëndrueshme afat gjata.

Pas përfundimit të inventarizimit, komisioni ka hartuar **një raport** lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuat kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me **karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara**, **shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës.**

-Zbatimi i normativave për harxhimin e pjesë të këmbimi, të karburanteve për mjetet motorike apo gjeneratorë që ka disponuar komuna , miratimi në këshillin e komunës për secilin tip, mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, pajisje me leje qarkullimi i tyre, pagesa e taksave dhe figuracioneve vjetore.

Harxhimi i karburanteve është shoqëruar me fletë udhëtime referuar normativave të miratuara të harxhimit të karburantit.

Makinat në përdorim të Komunës janë dorëzuar në bashki dhe janë marrë në dorëzim me komision të posaçëm që ka ngritur bashkia më datë 27.07.2015. Janë hartuar proces verbale të veçanta për dorëzimin e çdo makine , nga të cilat 2 makina për punë dhe 2(dy) vetura. Makinat kanë qenët të siguruara dhe të kolauduara.

Sipas të dhënave të bilancit nuk ka pasur ndihma nga donatorë të ndryshëm.

Administrimi i letrave me vlerë, sipas përcaktimeve të VKM1497,datë 19.11.2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë, i ndryshuar me VKM nr. 277,datë 06.04.2011 dhe VKM nr. 393, datë 18.06.2014.

Në bilancet viteve të audituar (viti 2013 ,2014 e 2015), në aktivin e bilancit nuk janë pasqyruar letra me vlerë në llogarinë nr. 532" Vlera të tjera" është me gjendje 0, si dhe nuk ka detyrime për tu paguar për letrat me vlerë në llogarinë nr.464"detyrime për tu paguar për letrat me vlerë' në bilancet 2013,2014 e 2015.

-Auditim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr.510, datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar ne njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial".

Dokumentacioni kontabël aktualisht administrohet në ish- Zyrën Financës të Komunës dhe nuk është inventarizuar. Në arkivat e njësive administrative nuk është arkivuar dokumentacioni me inventarë të rregullt, veprim në kundërshtim me pikat 2 dhe 4 të kreut V "Transferimi i arkivave dhe i dokumentacionit" të KM nr. 510 "Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve ,personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial ",është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3237, datë 16.07. 2015 të dy ministrive: Ministri për Çështjet Vendore dhe Ministri i Financave "Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial" dhe me ligjin mbi arkivat.

Në përfundim u arrit në konkluzion se: Përgjithësisht plotësimi i pasqyrave financiare është mbështetur mbi të dhënat e nxjerra nga azhurnimi i kontabilitetit dhe pozicionet financiare në aktiv dhe në pasiv të bilanceve të viteve 2013,2014 e 2015, janë të njëjta me pasqyrat shoqëruese të bilancit. Në llogarinë nr.202 "Studime dhe kërkime me vlerë 4,091,040 lekë e trashëguar prej vitit 2013 që ju përket projekteve për objekte ndërtimi nuk është përfshirë në vlerën e objekteve, veprim i pa sistemuar me kontabilitet. Llogaria nr. 468, "Debitor në persona", është paraqitur pa gjendje, çka tregon se nuk janë pasqyruar detyrimet për taksa e tarifa vendore të pa shlyera brenda viteve ushtrimore. Në pasiv të bilancit nuk janë pasqyruar të ardhura për tu arkëtuar nga taksat dhe tarifat vendore.

Të ardhurat dhe shpenzimet janë rakorduar me Situacionet e thesarit. Llogaria nr.520 " Diponibilitete në Thesari" është e kuadruar me shpenzimet e kontabilizuar " .

Për sa mësipërm është mbajtur akt verifikimi nr. 28, datë 12.05.2017, me znj.T. L. me detyrë ish - Përgjegjëse e Sektorit të Financës (nëpunës zbatues), ish- kryetarin e Komunës A.V. (Nëpunës urdhërues).

- **Në ish Komunën Libofshë.**

Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 " Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/ zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj". Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejt dhe në përputhje me aktet nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Pasqyrat financiare janë plotësuar pjesërisht mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga ditarët e kontabilitetit. Si mangësi u konstatua se: nga ish - Drejtoria e Financës nuk është plotësuar ditari i veprimeve të ndryshme për mbylljen e llogarive në fund të çdo viti ushtrimorë. Gjithashtu nuk është plotësuar centralizatori apo libri i madh i llogarive, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004" për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare "

Në aktivin e bilancit nuk janë pasqyruar në llogarinë nr. 231" Shpenzime në proces" për vitin 2013 që ju përkasin investimeve të kryera (fatura të pa likuiduara) në vlerën 9,736,217 lekë që përbëhet "Ndërtim Shkolla 9/vjeçare Ndernenas" në vlerë 8,441,072 lekë, "Punime për Ujësjellësin Agim " për 911,145 lekë, "Blerje pompë zhytëse" në vlerë 384,000 lekë, veprime në kundërshtim me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar. Këto veprime janë përfshirë si detyrime afat shkurtra të mbartura në bilancin e vitit 2014, pa artikuj kontabël.

Totali i aktiveve respektivisht sipas viteve: Në vitin 2013 në vlerën 300,319,065 lekë në vitin 2014 në vlerën 332,566,390 lekë dhe në 6/mujorin e vitit 2015 në vlerën 337,674,509 lekë.
Situacionet e investimeve nuk janë kontabilizuar. Faturat për shërbimet nuk janë kontabilizuar dhe për pasojë detyrimet në mbyllje të periudhave ushtrimore (fund viteve) nuk janë pasqyruar si detyrime ndaj të tretëve dhe nuk janë përllogaritur në buxhetet fillestare si shpenzime të pa likuiduara. Bilanci i vitit 2013 nuk është shoqëruar me rakordimi me Albtelekomin, Shërbimin Postar, Cez-Shpërndarjen për detyrimet e prapambetura (të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimorë 2013). E njëjta procedurë është ndjekur dhe për vitin 2014 dhe 6/mujorin e vitit 2015.
Inventarizimi i pronës shtetërore , nxjerrja e rezultateve të inventarizimit ,sistemimi i diferencave ,si dhe respektimi i dispozitave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina .
Për vitin 2013 , inventari është kryer mbështetur në urdhrin nr. 184, datë 21.11.2013, nuk kanë rezultuar diferenca. Për vitin 2013 janë nxjerrë jashtë përdorimit vlera **349,109 lekë** që i përkasin llogarisë nr. 327, "Objekte inventari" , miratuar me vendim të Këshillit Komunës nr. 4, datë 10.04.2014.
Është kryer inventari për vitin 2014, mbështetur në urdhrin për ngritjen e komisionit të inventarit fizik nr. 186, datë 2.11.2014
Për vitin 2014 nga inventari fizik nuk kanë rezultuar diferenca. Për vitin 2014 janë nxjerrë jashtë përdorimit vlera 206,277 lekë që i përkasin llogarisë 327, "Objekte inventari", miratuar me vendim të Këshillit të Komunës nr. 8, datë 06.03.2015.
Edhe pse inventarët janë nxjerrë në vitet pasardhëse, janë shkarkuar nga kontabiliteti ekstra kontabël dhe nuk janë paraqitur në bilance te viteve ushtrimore. Shkarkimi nga kontabiliteti para asgjësimit është në kundërshtim me ligjin e kontabilitetit dhe udhëzimin nr. 30, datë "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik "pika 51dhe 56 .
Bilanci i vitit 2013, 2014 dhe 6/ mujori i vitit 2015 është shoqëruar me analizën e llogarive të aktiveve të qëndrueshme afat gjata e afat shkurtër por nuk kanë saktësi të dhënat e kontabilitetit.
Në mbyllje të periudhave ushtrimore nuk është rakorduar me Zyrën Arsimore Fier dhe institucione të tjera për furnizimet e përfshira në inventarë të shkollave. Përfshirja në inventarë fizik të shkollave të aktiveve të qëndrueshme afat gjata dhe afat shkurtër pa i përfshirë në inventar kontabël, është në kundërshtim me udhëzimin nr. 30,datë 27.11.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik "pika 51 dhe 56 .
U konstatua se: Në ish – Komunën Libofshë janë administruar fletë dalje të DAR Fier, ku marrës të inventarëve në ngarkim janë ish drejtorë shkollash që nuk i kanë paraqitur në magazinën e komunës dhe nuk janë bërë hyrje në komunë dhe as nuk janë kontabilizuar (inventarët nuk ka saktësi).

Disa fletë dalje të DAR Fier

Nr.	Shkollat	Personi tërheqës	Flet dalje DAR		Inventar/lekë	Inventarë kryesore
			Nr.	Datë		
1	Sh/mesme	A. Gj.	113	16.02.2009	146,692	2 laptop,2 projektor
2	Sh/mesme	A. Gj.	118	26.01.2009	246,693	2 laptop,2 projektor
3	Sh/ mesme	A. Gj.	49	26.01.2012	146,700	9,dollape e 3 tavolina
4	**1+2+3, Totali që ka tërhequr A. Gj.**				**540,085**	
5	Sh/9 vjeçare	M. S.	954	19.11.2009	22,560	10 karrige
6	Sh/9 vjeçare	M. S.	117	16.02.2009	123,346	1 laptop ,1 projektor

Nr.	Shkollat	Personi tërheqës	Flet dalje DAR		Inventar/lekë	Inventarë kryesore
			Nr.	Datë		
7	Sh/9 vjeçare	M. S.	251	17.03.2009	2,298,072	Tavolina dhe karrige
8	Sh/ 9 vjeçare	M. S.	44	26.01.2012	345,060	Karr. tav,do.rafteetj
9	5+6+7+8 , Totali që ka tërhequr M. S.				**2,789,038**	
10	(4+9) Totali për të dy shkollat				**3,329,123**	

Nga verifikimi i inventarëve rezulton se: Ish – drejtoresha e shkollës mesme Libofshë nuk i ka përfshirë në inventarin e shkollës 4(katër) laptop dhe 4 (katër) projektor **në vlerën 393,393 lekë, vlerë të cilën duhet të ç'dëmtoje.**

Në këto kushte grupi i auditimit vlerëson se: Pasqyrat financiare që shoqërojnë bilancin nuk kanë saktësi e konkretisht: "Pasqyra mbi "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme" që i përkasin bilancit të 6/mujori parë të vitit 2015, për shtesat e vitit ushtrimorë jashtë sistemit në vlerën 2,055,736 lekë në rreshtin 14 kolona 3, nuk është mbështetur në të dhëna kontabël.

Sipas fletë daljes të DAR Fier me nr. 134,datë 22.04.2015 në vlerën 3,554,544 lekë, tërhequr nga R. T., nuk është bërë hyrje në Komunë dhe është rritur inventari ekstra kontabël në shumën 2,055,735 **lekë ose më pak në vlerën 1,498,809 lekë** *(duhet të shtohet në inventar)*

Në inventarin e llogarisë nr. 202, " Studime dhe kërkime" është i mbartur që ju përket viteve 2007-2011 ,vlera prej 5,179,000 lekë që ju përket 14 (katërmbëdhjetë) projekteve . Kjo vlerë duhej të ishte përfshirë në vlerat përkatëse të objekteve të ndërtuara.

Pas përfundimit të inventarizimit, komisioni nuk ka hartuar **një raport** lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuat kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me **karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara**, **shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës**, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues, veprim në papajtueshmëri me germën **c** pika 85 dhe 89, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ku përcaktohet: "Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues."

Për sa sipër mban përgjegjësi ish- Drejtore e Financës znj. G. L. dhe Ish- Kryetari i Komunës Libofshë N. D. .

-Zbatimi i normativave për harxhimin e pjesë të këmbimi, të karburanteve për mjetet motorike apo gjeneratorë që ka disponuar komuna , miratimi në këshillin e komunës për secilin tip, mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, pajisje me leje qarkullimi i tyre, pagesa e taksave dhe figuracioneve vjetore.

Në inventarin e makinave sipas të dhënave të inventarit në komunë janë në inventarë 2 (dy) makina , nga të cilat mjeti "Tip bens 200 D" dhe mjeti tip "STEYR , A680" për të cilat është përcaktuar normativa për çdo mjet dhe janë plotësuar fletë udhëtimet për të gjitha lëvizjet e përshkruara . Karburanti është bërë hyrje dhe dalje. Nga verifikimi i fletë daljeve të magazinës me zgjedhje u konstatua se: Fletë daljet janë shoqëruar me kërkesa, urdhër dorëzim , projekte në rastet kur karburanti është përdorur për punë.

Makinat që ka disponuar komuna janë dorëzuar me proces verbal në Bashkinë Fier. Proces verbali datë 24.07.2015 si dorëzues K. D. për mjetin "STEYR AG 80" dhe për mjetin tip bens 200D.

Administrimi, dokumentimi dhe marrja në dorëzim e ndihmave nga donatorët e ndryshëm.

Për periudhën e audituar, Komuna nuk ka marrë ndihma nga donatorë të ndryshëm.

*Administrimi i letrave me vlerë., sipas përcaktimeve të VKM 1497,datë 19.11.2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë" i ndryshuar me VKM nr. 277,datë 06.04.2011 dhe VKMnr.393, datë 18.06.2014***.**

Në bilancet e viteve të audituar (viti2013,2014 dhe 2015) në aktivin e bilancit nuk janë pasqyruar letra me vlerë në llogarinë nr.532" Vlera të tjera" është me gjendje 0 , si dhe nuk ka detyrime për tu paguar për letrat me vlerë në llogarinë nr.464"detyrime për tu paguar për letrat me vlerë' në bilancet 2013,2014 e 2015.

-Auditim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr.510, datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore ,të prekura nga riorganizimi administrativo territorial".

Dokumentacioni kontabël aktualisht administrohet në ish- Zyrën Financës të Komunës dhe nuk është inventarizuar. Në arkivat e njësive administrative nuk është arkivuar dokumentacioni me inventarë të rregullt, veprim në kundërshtim me pikat 2 dhe 4 të kreut V "Transferimi i arkivave dhe i dokumentacionit" të KM nr. 510 "Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve ,personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial ",është vepruar në kundërshtim me **Udhëzimin nr. 3237, datë 16.07. 2015** të dy ministrive: Ministri për Çështjet Vendore dhe Ministri i Financave "Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial" dhe me ligjin mbi arkivat.

-Auditim mbi ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit kontabël në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2013 "Për arkivat" si dhe zbatimi i rregullores për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore".

Dokumentacioni kontabël është ruajtur në ish zyrën e financës të ish- Komunës (Njësia Administrative Libofshë).

Nga Auditimi i dokumentacionit kontabël u konstatua se:

Mbi zbatimin e SKK të përmirësuara për vitin 2015, të shpallura me urdhër ë ministrit financave nr.64, datë 22.07.2014.

Për sa sipër nuk janë zbatuar SKK .

Opinion: Si rezultat i mangësive të konstatuara , grupi i auditimit në lidhje me informacionin kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare nuk siguron se është i besueshëm dhe paraqet mjaftueshëm gjendjen reale të aktiveve. Ka mangësi në rakordimet me Drejtorinë Arsimore Rajonale Fier për furnizimet që ju janë bëre shkollave. Nuk është vepruar me konformitet me llogarinë nr.45 " Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit", veprime këto që janë në papajtueshmëri me dispozitat ligjore që rregullojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e bilanceve në sistemin buxhetor, pasi nuk është zbatuar plotësisht, ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligji nr. 10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", neni 5. Nuk ka gjetur zbatim të plotë Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14, datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave

financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar.

- **Në ish Komunën Levan.**

-Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejt dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Si mangësi u konstatua se: Në mbajtjen e kontabilitetit nuk janë kryer disa veprime kontabël në mbyllje të periudhave ushtrimore, nuk janë kontabilizuar faturat për shërbimet si energji, shpenzime telefonike, postare etj. Nuk janë pasqyruar shpenzimet në proces për investime për objektet e pa marra në dorëzim dhe ato të pa likuiduara .

Në llogarinë nr. 202 "Studime e kërkime" prej vitesh (nga viti 2012 është mbartur teprica prej 6,616,150 lekë) dhe në bilancin e fundit të 7/mujorit të vitit 2015, ka një tepricë në vlerën 8,017,750 lekë. Për objekteve e ndërtimit të përfunduara vlera e projekteve nuk është përfshirë në vlerën e objekteve.

Nr./llogarive	Emërtimi llogarive	Bilancet e viteve		
		2013	2014	2015
401	Furnitorë	4,300,748	0	-
42	Personeli	1,409,916	1,422,321	-
431	Detyrim tatim taksave	106,334	37,397	-
4341	Operacione me shtetin	-	-	9,185,984
435	Sigurime shoqërore	415,465	399,870	-
436	Sigurime shëndetësore	58,052	55,493	-
466	Kr. Për mjete në ruajtje	294,836	419,167	499,351
467	Kr. të ndryshëm	2,176,594	1,903,862	409,372
	Totali detyrime	**8,761,945**	**4,238,110**	**10,094,707**

Në bilancet e viteve 2013 e 2014 , Llogaria nr. 4341"Operacione me shtetin kreditorë" dhe llogaria nr. 475 "Të ardhura për tu riregjistruar vitet pas ardhëse " është paraqitur pa gjendje .

Në aktivin e bilancit të vitit 2013, në llogarinë 468 "debitorë të ndryshëm" është paraqitur me gjendje në vlerën 10,045,446 lekë, në bilancin e vitit 2014 është paraqitur me gjendje në vlerën 9,194,020 lekë. Rezulton se në pasiv të bilancit nuk ka kundër parti për debitorët dhe veprimet kontabël janë ekstra kontabël pa kuadraturë (aktiv-pasiv).

-Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit, sistemimi i diferencave, si dhe respektimi i dispozitave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina.

Nga kryetari i komunës janë ngritur komisioni i inventarizimit dhe komisioni i asgjësimit të inventarëve jashtë përdorimit në përshtatje me kërkesat e udhëzimit nr. 30 të Ministrisë Financave .

Për vitin 2013 , inventari është kryer mbështetur në urdhrin nr. 25,datë 04.12.2013 , ku është përcaktuar komisioni dhe afati i kryerjes së inventarit fizik.

Për vitin 2013 nga inventari fizik nuk kanë rezultuar diferenca. Për vitin 2013 janë nxjerrë e asgjësuar inventarët jashtë përdorimit mbështetur në urdhrin e Kryetarit të Komunës nr. 9/1,datë 09.06.2014. Asgjësimi është bërë me vonesë dhe nuk janë grumbulluar në magazinë të veçantë , inventarët e vlerësuar jashtë përdorimit . Gjithashtu nuk janë sistemuar me artikull kontabël në llogari të veçantë si inventarë të dëmtuara llogaria nr. "Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara" veprime në kundërshtim me nr. 30 datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik" dhe Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14,datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre".
Për vitin 2014, inventarizimi i pasurisë është kryer nga komisioni i inventarit i ngritur sipas urdhrit të kryetarit të komunës nr. 34, datë 19.12.2014. Asgjësimi i inventarëve jashtë përdorimit është kryer nga komisioni i veçantë i ngritur me urdhër të veçantë nr. 12/1, datë 15.06.2015.
Për të dy vitet shkarkimi në kontabilitet është bërë në vitet, pas ardhëse, konkretisht inventarët jashtë përdorimit të konstatuara në vitin 2013, janë asgjësuar në vitin 2014 dhe të vitit 2014 janë asgjësuar në vitin 2015.
Në vitin 2014 , janë shkarkuar 17(shtatëmbëdhjetë) kompjuter në vlerë 1,374,325 lekë , 4 (katër) printer në vlerë 77,398 lekë , projektor 1(një) në vlerë 64,571 lekë. Fotokopje 1(një) në vlerë 280,000 lekë. Nuk janë zbatuar procedurat sipas kërkesave nr. 30 datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik", pasi nxjerrja jashtë përdorimit është bërë pa specialistë të fushës përkatëse.
-Zbatimi i normativave të harxhimit për pjesë këmbimi, të karburanteve të mjetet motorike apo Gjeneratorët që disponon Komuna, miratimi në Këshillin e Komunës për secilin tip, mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, pajisje me leje qarkullimi i tyre, pagesa e taksave dhe figuracioneve vjetore.
Harxhimi karburantit është bërë me shkarkim nga magazina sipas urdhër dorëzimeve , për të cilat është prerë fletë dalje në ngarkim të shoferëve të cilët e kanë marrë në dorëzim . Harxhimi karburantit në fund të çdo muaj është justifikuar me fletë udhëtimet e shoferëve dhe në raste të punimeve me kryera me orë pune sipas normativave të miratuara në buxhetin e çdo viti në Këshillin e Komunës . Pjesët e blera për makinat e komunës janë bërë me blerje me vlera të vogla. Makinat janë dorëzuar në Baskinë Fier , ku janë marrë në dorëzim me komision të veçantë të ngritur nga Kryetari i Bashkisë Fier. Dokumentimi i dorëzimit dhe marrjes në dorëzim është dokumentuar me proces verbal të mbajtur midis dy palëve .
Komisioni i ngritur nga Bashkia Fier ka në përbërje specialistë të fushës përkatëse.
-Administrimi, dokumentimi dhe marrja në dorëzim e ndihmave nga donatorët e ndryshëm.
Nuk ka pasur ndihma nga donator të ndryshëm.
-Administrimi i letrave me vlerë, sipas përcaktimeve në VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë, i ndryshuar me VKM nr. 277,datë 6.4.2011 dhe VKM nr. 393, datë 18.6.2014.
Përveç të certifikatave të gjendjes civile që janë administruar nga gjendja civile dhe janë likuiduar me fondin përkatës nëpërmes Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier nuk janë dokumentuar letra me vlerë .
-Auditim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e

të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

Bashkimi i aktivitetit të komunës është bërë mbi bazën bilanceve të dorëzuar me analiza për aktivet dhe pasivet deri më datë 30 Qershor 2015, të shoqëruar me analizat e llogarive**.**

-Auditim mbi ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit kontabël në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe zbatimi i rregullores "Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore".

Dokumentacioni kontabël aktualisht administrohet në ish- Zyrën Financës të Komunës dhe nuk është inventarizuar. Në arkivat e njësive administrative nuk është arkivuar dokumentacioni me inventarë të rregullt, veprim në kundërshtim me pikat 2 dhe 4 të kreut V "Transferimi i arkivave dhe i dokumentacionit" të KM nr. 510 "Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve ,personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial ",është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3237, datë 16.07. 2015 të dy ministrive: Ministri për Çështjet Vendore dhe Ministri i Financave "Për procedurat ,afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial" dhe me ligjin mbi arkivat.

Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se: Ka mangësi në azhurnimin e artikujve kontabël në mbyllje të aktivitetit ushtrimorë sipas viteve përkatëse pasi , nuk është plotësuar libri përmbledhës i llogarive (centralizatori apo libri I madh), nuk është azhurnuar ditari I veprimeve të ndryshme për mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore .Në administrimin e aseteve dhe në asgjësimin e inventarëve u vrenjten mangësi në hartimin e proces verbaleve të asgjësimit dhe në komisione nuk kanë marrë pjesë specialist të fushës për nxjerrje jashtë përdorimit të kompjuterëve et. Për të cilat mban përgjegjësi ish- përgjegjësi i Sektorit të financës z. M. N., veprime këto që janë në papajtueshmëri me dispozitat ligjore që rregullojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e bilanceve në sistemin buxhetor, pasi nuk është zbatuar plotësisht, ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligji nr. 10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", neni 5. Nuk ka gjetur zbatim të plotë Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14, datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar.

- **Në ish Komunën Frakull**.

-Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejt dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Kontabiliteti është azhurnuar me sistemin e ditarëve të plotësuar me shkrim dore(në mënyrë manuale) dhe nuk është vënë në aplikim ndonjë program i veçantë finance.

Nga sektori i Financës së Komunës Frakull është plotësuar dokumentacioni kontabël sipas sistemit të ditarëve e konkretisht: Ditari i arkës, ditari i likuidimeve nëpërmes bankës, ditari i

hyrjeve, ditari daljeve të magazinës, ditari i pagave, ditari i të ardhurave, ditari i shpenzimeve të thesarit.
Në mbajtjen e kontabilitetit u konstatuan mangësi në azhurnimin e artikujve kontabël të mbylljeve të llogarive në mbyllje të periudhave ushtrimore. Gjithashtu nuk është azhurnuar dhe ditari i veprimeve të ndryshme për korrigjimin e gabimeve dhe mbylljen e llogarive në fund të vitit ushtrimorë. Nga sektori i financës nuk është vepruar me llogarinë nr.45"Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit". Për furnizimet e bëra nga DAR Fier në adresë të shkollave që ka administruar Komuna Frakull nuk janë kryqëzuar veprimet dhe kjo llogari nuk ka funksionuar , pasi nuk është vepruar me konfirmitetet përkatëse, veprim i cili bie në kundërshtim me UMF Nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj". Nuk janë kontabilizuar faturat e energjisë elektrike, të Albtelekomit, të postës, të ujit etj.
Në fletë hyrjen nr.7,datë 29.04.2015,sa janë bërë hyrje 4 programe me çmim 2000 lekë / copë në vlerë **8,000 lekë** nuk janë paraqitur në inventarë. Edhe kontabilizimin e hyrjeve të inventarëve që i përkasin llogarisë nr. 218 " Inventarë ekonomik" jenë përfshirë në llogarinë nr. 32 "Objekte Inventari". Sistemimet e këtyre llogarive në fund të viteve ushtrimore janë sistemuar pa artikuj kontabël (ekstra kontabël).
-Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit, sistemimi i diferencave, si dhe respektimi i dispozitave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina.
Pasqyrat financiare të llogarive kryesore (sintetike) si "Të ardhurat" ,"Shpenzimet", Shpenzimet dhe burimet e investimeve" , "Lëvizja në cash", janë plotësuar sipas të dhënave të kontabilitetit. Formulari nr.6 "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (Vlera Bruto).
-Zbatimi i normativave të harxhimit për pjesë këmbimi, të karburanteve të mjetet motorike apo Gjeneratorët që disponon Komuna, miratimi në Këshillin e Komunës për secilin tip, mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, pajisje me leje qarkullimi i tyre, pagesa e taksave dhe figuracioneve vjetore.
U audituar dokumentacioni i shpenzimit të karburantit dhe u konstatua se: Karburanti është shkarkuar nga magazina mbështetur në urdhër dorëzimet rast pas rasti. Në fund të çdo muaj sasia e karburantit të harxhuar është shoqëruar me fletë udhëtimet përkatëse dhe Situacionet të punimeve. Për preventivat e punimeve me makineri është hartuar struktura e kostos duke përcaktuar dhe sasinë e karburantit sipas zërave të punimeve.
*-Administrimi, dokumentimi dhe marrja në dorëzim e ndihmave nga donatorët e ndryshëm***.**
Për periudhën e audituar nuk janë dokumentuar ndihma nga donatorë të ndryshëm(nuk ka pasur).
-Administrimi i letrave me vlerë, sipas përcaktimeve në VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë, i ndryshuar me VKM nr. 277,datë 6.4.2011 dhe VKM nr. 393, datë 18.6.2014.
Nga verifikimi i dokumentacionit të arkës nuk janë dokumentuar letra me vlerë dhe llogaria nr.532 "Vlera të tjera" në bilancet e viteve 2013,2014 e 6/ mujori i vitit 2015 është pa gjendje.
-Auditim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e

<u>të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".</u>

<u>-Auditim mbi ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit kontabël në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe zbatimi i rregullores "Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore".</u>

Dokumentacioni kontabël aktualisht administrohet në ish- Zyrën e Financës të Komunës dhe nuk është inventarizuar. Në arkivat e njësive administrative nuk është arkivuar dokumentacioni me inventarë të rregullt, veprim në kundërshtim me pikat 2 dhe 4 të kreut V "Transferimi i arkivave dhe i dokumentacionit" të KM nr. 510 "Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial ",është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3237, datë 16.07. 2015 të dy ministrive: Ministri për Çështjet Vendore dhe Ministri i Financave "Për procedurat ,afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial" dhe me ligjin mbi arkivat.

Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se u konstatuan mangësi si, në azhurnimin e të gjithë artikujve kontabël në mbyllje të aktivitetit ushtrimorë sipas viteve përkatëse e konkretisht llogaria nr.468, "Debitorë në persona" është paraqitur pa gjendje nga viti 2012 e në vazhdim , duke mos u paraqitur detyrimet e pa shlyera nga taksat dhe tarifat vendore. Në llogarinë 231" Shpenzime në proces " është paraqitur pa gjendje prej vitesh" edhe pse në mbyllje të periudhave ushtrimore, kanë rezultuar objekte ndërtimore brenda garancive dhe të pa marra në dorëzim dhe duhej të pasqyroheshin në bilanc si shpenzime në proces. Në kontabilitet nuk është lënë gjurmë (artikuj kontabël) për përfshirjen në vlerën e objekteve edhe të vlerës së projekteve. Në formatin nr.6 "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme " të bilancit të vitit 2013, nuk janë pasqyruar nxjerrje jashtë përdorimit . Edhe në bilancin e vitit 2014 e 2015, nuk ka pasqyruar nxjerrje jashtë përdorimit.

- **Në ish Komunën Dërmënas.**

<u>-Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejt dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.</u>

Nuk është mbajtur ditari i veprimeve të ndryshme për mbylljen e llogarive në mbyllje të periudhave ushtrimore (viti 2013 ,2014 e 6/ mujori i parë i vitit 2015). Gjithashtu nuk është hartuar libri përmbledhës i llogarive për pasqyrimin e xhirove debitorë e kreditore të llogarive sintetike dhe të llogarive analitike (lëvizjet e llogarive). Mosplotësimi i këtij dokumentacioni bie në kundërshtim me Udhëzimin i Ministrisë Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14,datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar. Për detyrimet ndaj të tretëve të rezultuar nga mbyllja e aktivitetit të Komunës nga auditi i brendshëm i bashkisë është ushtruar auditim për saktësimin e detyrimeve ndaj të tretëve mbështetur në faturat përkatëse dhe janë

bërë sistemimet duke u mbështetur në faturat. Nga ana e bashkisë janë bërë sistemimet mbështetur në shkresën nr. 3083/2, datë 12.10.2015 .

*-Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit, sistemimi i diferencave, si dhe respektimi i dispozitave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina***.**

Për vitin 2013 dhe 2014 është kryer inventarizimi i pasurisë së komunës. Fillimisht janë ngritur komisionet inventarizimit sipas objekteve me urdhër të veçantë të kryetarit të Komunës.

Në kontabilitet nuk janë pasqyruar diferenca. Nga Auditimi i ushtruar nga Auditi i Brendshëm i Prefekturës Fier është ushtruar auditim tematik financiar sipas programit nr. 1134,datë 27.08.2014 për "Verifikimin e gjendjes kontabël dhe fizike të llogarisë nr. 218, inventarë ekonomik për institucionet arsimore të rrethit Fier dhe Mallakastër në varësi të organeve të qeverisjes vendore "është kërkuar kryetarit të Komunës **në Rekomandimin nr. 5,** të dalë urdhri ekzekutiv në ngarkim të Naime Vernozi për vlerën **739,663 lekë** , për sa kanë rezultuar mangët 12 kompjuterë në vlerë 492,761 lekë, 16 karrige në vlerë **64,512 lekë**, 11 UPS në vlerë **59,043 lekë** dhe 1(një) kompjuterë e 1(një) laptop me vlerë **123,347 lekë**. Nga verifikimi i analizës së llogarisë nr. 468 "debitor të ndryshëm", u konstatua se nuk është përfshirë në debitorë dhe nuk është shlyer detyrimi. **Ky veprim ngarkon me përgjegjësi ish – Kryetarin e Komunës z. V. F. në cilësinë e nëpunësit urdhërues, pasi nuk ka urdhëruar marrjen e masave për rakordimin me DAR Fier, për furnizimet e kryera në adresë të shkollave që janë administruar nga Ish- Komuna Fier dhe nxjerrjen përgjegjësisë materiale.**

-Zbatimi i normativave të harxhimit për pjesë këmbimi, të karburanteve të mjetet motorike apo Gjeneratorët që disponon Komuna, miratimi në Këshillin e Komunës për secilin tip, mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, pajisje me leje qarkullimi i tyre, pagesa e taksave dhe figuracioneve vjetore.

Për përdorimin e karburantit janë plotësuar fletë udhëtimet dhe është llogaritur karburanti mbi bazën e distancave të përshkruar nga shoferët. Përdorimi i karburantit është audituar dhe nga auditi i brendshëm i bashkisë deri më datën e shkrirjes së komunës.

-Administrimi, dokumentimi dhe marrja në dorëzim e ndihmave nga donatorët e ndryshëm.

Sipas të dhënave të kontabilitetit dhe të inventarëve fizik nga komuna nuk janë dokumentuar ndihma nga donatorë të huaj.

-Administrimi i letrave me vlerë, sipas përcaktimeve në VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë, i ndryshuar me VKM nr. 277,datë 6.4.2011 dhe VKM nr. 393, datë 18.6.2014.

Sipas të dhënave të kontabilitetit dhe të inventarëve fizik nga komuna nuk janë dokumentuar letra me vlerë.

-Auditim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

Nga ish- Komuna në Bashkinë Fier vetëm është dorëzuar bilanci i 6/mujorit të parë të vitit 2015, i shoqëruar me analizat përkatëse me të dhënat mbi debitorët dhe kreditorët dhe i shoqëruar me inventarin e llogarive për aktivet afat gjata dhe afat shkurtra. Në llogarinë nr. 202, "Studime e kërkime në vlerën 640,000 lekë është e pa analizuar dhe trashëgohet nga viti 2012.

Nuk është zbatuar pika 2,e kreut V-të " Transferimi i arkivave dhe i dokumentacionit të njësive që shkrihen".

-Auditim mbi ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit kontabël në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe zbatimi i rregullores "Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore".

Dokumentacioni i kontabilitetit aktualisht administrohet në arkivin e Njësisë Administrative Dermenas , pasi në Bashkinë Fier nuk ka patuar ambiente për arkivim.

Përfundimisht u arrit në konkluzion se: Pasqyrat financiare përgjithësisht janë plotësuar mbështetur në të dhënat e kontabilitetit , por u konstatuan dhe mungesë e artikujve kontabël në mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, pasi nuk është plotësuar libri përmbledhës i llogarive (centralizatori apo libri i madh). Në llogarinë nr. 202, " Studime e kërkime në vlerën 640,000 lekë është e pa analizuar dhe trashëgohet prej vitesh (nga viti 2012). Në bilance nuk janë pasqyruar shpenzime në proces për investimet e pa përfunduara. Gjithashtu janë kryere dhe veprime ekstra kontabël (pa artikuj), fenomene këto të konstatuara dhe nga auditi i brendshëm e bashkisë. Këto veprime bien në kundërshtim me Udhëzimin i Ministrisë Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14,datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar.

- **Në ish Komunën Cakran.**

-Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 " Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/ zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj". Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejt dhe në përputhje me aktet nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Pasqyrat financiare janë plotësuar pjesërisht mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga ditarët e kontabilitetit. Si mangësi u konstatua se: nga ish – Përgjegjësi i Financës nuk është plotësuar ditari i veprimeve të ndryshme për mbylljen e llogarive në fund të çdo viti ushtrimorë. Gjithashtu nuk është plotësuar centralizatori apo libri i madh i llogarive, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004" për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare "

Në aktivin e bilancit të vitit 2013, nuk janë pasqyruar shpenzimet për investime që ju përkasin objekteve ndërtimore të pa marra në dorëzim në llogarinë nr. 231" Shpenzime në proces" .

Totali i aktiveve respektivisht sipas viteve : Në vitin 2013 në vlerën 538,084,251 lekë në vitin 2014 në vlerën 626,674,096 lekë dhe në 6/mujorin e vitit 2015 në vlerën 447,137,534 lekë.

Situacionet e investimeve nuk janë kontabilizuar. Faturat për shërbimet nuk janë kontabilizuar dhe për pasojë detyrimet në mbyllje të periudhave ushtrimore (fund viteve) nuk janë pasqyruar si detyrime ndaj të tretëve dhe nuk janë përllogaritur në buxhetet fillestare si shpenzime të pa likuiduara . Bilanci i vitit 2013 nuk është shoqëruar me rakordimi me Albtelekomin, Shërbimin Postar, ÇEZ-Shpërndarjen për detyrimet e prapambetura (të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimorë 2013). E njëjta procedurë është ndjekur dhe për vitin 2014 .

-Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit ,sistemimi i diferencave, si dhe respektimi i dispozitave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina .

Për vitin 2013, inventari është kryer mbështetur në urdhrin nr. 70,datë 01.10.2013, me të cilin janë përcaktuar komisionet e inventarit për çdo objekt.

Për vitin 2013 nga inventari fizik nuk kanë rezultuar diferenca. Për vitin 2013 janë asgjësuar inventarët mbështetur në urdhrin e Kryetarit të Komunës nr. 101,datë 26.12.2013. Të dhënat për nxjerrje jashtë përdorimit krahasimisht me të dhënat e formularit të bilancit janë të njëjta me proces verbalet.

Për vitin 2014, inventarizimi i pasurisë është kryer nga komisioni i inventarit i ngritur sipas urdhrit të kryetarit të komunës nr. 128, datë 02.10.2014. Asgjësimi i inventarëve jashtë përdorimit është mbështetur në proces verbalet e mbajtura nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit.

Për vitin 2015, fondet janë pakësuar nga nxjerrjet jashtë përdorimit në shumën 5,440,530 nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe janë pakësuar AQ me 4,737,462 lekë transferim. Transferimi nuk është kryer me artikull kontabël të rregullt por është zbritur nga fondet dhe nga aktivet , ku duhej të bëhej me transfertë .

Sipas bilancit 2014 janë nxjerrë jashtë përdorimit vlera 110,000 lekë nga llogaria nr. 212 "Ndërtime", në llogarinë nr. 213 "rrugë rrjete e vepra ujore" ne vlerën 2,456,651 lekë , në llogarinë 218 " Inventarë Ekonomik në vlerën 1,891,932 lekë. Gjithsejtë nga aktivet afat gjata janë nxjerrë jashtë përdorimit 4,458,583 lekë. Janë zbatuar procedurat.

Bilanci i vitit 2014 dhe 6/ mujori i vitit 2015 është shoqëruar me analizën e llogarive të aktiveve të qëndrueshme afat gjata e afat shkurtër.

Në llogarinë nr. 202" Studime e kërkime prej vitesh pasqyrohet teprica në vlerë 4,304,858 lekë, që ju përket 15 projekteve, por nuk është e saktësuar sa nga projektet janë zbatuar dhe duhej të ishin përfshirë në vlerën e objekteve të marra në dorëzim. Nuk i ka askush në ngarkim në inventar fizik të tyre. Janë të nënshkruar nga Përgjegjësi i Zyrës së Financës A. Xh..

Projektet nuk janë dorëzuar në Urbanistikën e Bashkisë Fier. Nuk ka proces verbal për marrje në dorëzim të projekteve nga bashkia , por janë të arkivuara në arkivin e Njësisë administrative.

Në bilancin e vitit 2014, në pasqyrën e bilancit "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme" janë shtuar shtesa pa pagesë 8,157,650 lekë jashtë sistemit 11,660,437 lekë të pa mbështetura me artikuj kontabël. Në kontabilitet nuk është vepruar me llogarinë nr. 45 " Marrëdhënie me njësitë brenda e jashtë sistemit".

Është likuiduar vlera e plotë e projektit të rrugës "Gorishtë- Autostradë " në vlerë 169,000 lekë sipas, urdhër shpenzimit nr. 174,datë 16.06.2015 pa TVSh në favor të subjektit "N.", pa filluar ndërtimi i objektit, ku duhej të ishte likuiduar 60 % e vlerës. **Është likuiduar më tepër 40% e vlerës e barabartë me 67,600 lekë** *(objekti nuk ka filluar).***Pagesa është kryer në masën 100%, në kundërshtim me VKM nr.444,datë 05.09.94 "Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve.**

Si mangësi u konstatua se:

Pas përfundimit të inventarizimit, komisioni nuk ka hartuar **një raport** lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuat kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me **karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara**, **shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës**, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues, veprim në papajtueshmëri me germën (**c)**pika 85 dhe 89, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ku përcaktohet: "Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin

fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues." Gjithashtu u konstatuan mangësi në rakordimi me DAR Fier , për furnizimet e kryera në adresë të shkollave në administrim të Njësisë Administrative , ku për vitin 2013 e 2014 nuk janë kryer rakordimi dhe në kontabilitet nuk është vepruar me konformitet Llogaria nr. 45," Marrëdhënie me institucionet brenda e jashtë sistemit".

-Zbatimi i normativave për harxhimin e pjesë të këmbimi, të karburanteve për mjetet motorike apo gjeneratorë që ka disponuar komuna , miratimi në këshillin e komunës për secilin tip, mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, pajisje me leje qarkullimi i tyre, pagesa e taksave dhe figuracioneve vjetore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të magazinës, rezultoi se përdorimi i karburantit është mbështetur në kërkesat e bëra sipas nevojave. Mbi bazën e kërkesave janë nxjerrë dhe urdhër dorëzimet që kanë shoqëruar fletë daljet e karburantit. Në çdo fund muaj janë dorëzuar fletë udhëtimet në sektorin e financës dhe janë bërë krahasimet me normat e vendosura për ço mjet.

Nga auditi i brendshëm i Bashkisë Fier, në mbështetje të programit të auditimit nr. 2408/1, datë 27.07.2015, është ushtruar Auditimi për periudhën e aktivitetit financiar 2013 e 214 dhe nga Auditimi ka rezultuar përdorim karburanti tepër dhe është bërë ngarkim sasia prej 2,698 litra karburant në vlerë 484,708 lekë. Mbështetur në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Fier nr. 2408/5, datë 10.11.2012015, për vënie në ngarkim ish- kryetarit të Komunës V. K., ish- Drejtorit të shërbimeve K. Y., ish- Përgjegjësit të Financës A. Xh. gjithë vlerën 484,708 lekë.

Nga Auditi Brendshëm i Bashkisë është saktësuar e gjithë e sasia e karburantit e pajustifikuar me dokumentacion mbështetës.

Është bërë dorëzimi i mjeteve të komunës në Bashkinë Fier , për të cilën nga bashkia është ngritur grup pune me specialistë dhe është mbajtur proces verbal i veçantë midis dy palëve. Nga Njësia Administrative Cakran disponohet një kopje e proces verbalit për dorëzimin e mjeteve .

*-Administrimi, dokumentimi dhe marrja në dorëzim e ndihmave nga donatorët e ndryshëm***.**

Sipas të dhënave të bilanceve dhe dokumenteve të magazinës nuk ka pasur ndihma nga donatorë të ndryshëm.

-Administrimi i letrave me vlerë., sipas përcaktimeve të VKM1497,datë 19.11.2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë ", i ndryshuar me VKM nr. 277,datë 06.04.2011 dhe VKM nr. 393, datë 18.06.2014.

Në bilancet e viteve të audituar (viti2013 ,2014 e 2015) në aktivin e bilancit nuk janë pasqyruar letra me vlerë në llogarinë nr.532" Vlera të tjera" është me gjendje 0 , si dhe nuk ka detyrime për tu paguar për letrat me vlerë në llogarinë nr.464"detyrime për tu paguar për letrat me vlerë' në bilancet 2013,2014 e 2015.

-Auditim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr.510, datë 10.06.2015"Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial".

Është përgatitur raporti financiarë i konsoliduar dhe është dorëzuar në Bashki sipas kërkesave të VKM.

Nuk është zbatuar, pika 2, e kreut V-të "Transferimi i arkivave dhe i dokumentacionit të njësive që shkrira" të VKM sa sipër.

-*Auditim mbi ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit kontabël në zbatim të ligjit nr.9154, datë 06.11.2013 "Për arkivat" si dhe zbatimi i rregullores për punë dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore*".

Dokumentacioni kontabël është ruajtur në ish zyrën e financës të ish- Komunës (Njësia Administrative Cakran). Dokumentacioni është i sistemuar dhe i marrë në dorëzim nga arkivistja e Njësisë Administrative Cakran.

Nga Auditimi i dokumentacionit kontabël u konstatua se :

Kontabiliteti është azhurnuar me sistemin e ditarëve të plotësuar me shkrim dore në mënyrë manuale) dhe nuk është vënë në aplikim ndonjë program i veçantë finance.

Nga Zyra e Financës në ish- Komunën Cakran është plotësuar dokumentacioni kontabël sipas sistemit të ditarëve e konkretisht: Ditari i arkës, ditari i likuidimeve nëpërmes bankës , ditari i hyrjeve, ditari daljeve të magazinës, ditari i pagave, ditari i të ardhurave, ditari i shpenzimeve të thesarit. Për mangësitë e konstatuara mban përgjegjësi ish- Përgjegjësi i Sektorit të Financës z. A. Xh..

Në mënyrë të përmbledhur u konstatuan mangësi :

Llogaria nr. 231 "Shpenzime në proces" është paraqitur pa gjendje edhe pse në mbyllje të periudhave ushtrimore janë pasqyruar detyrime të pa shlyera ndaj sipërmarrëseve për ndërtim objektesh brenda garancive (llogaria nr.466. Në mbyllje të periudhave ushtrimore në raste të veçanta nuk është rakorduar me Drejtorinë Arsimore Rajonale Fier për furnizimet me inventarë në adresë të shkollave që administrohen nga Njësia Admirativë Cakran. Nuk është vepruar me konformitet me llogarinë nr.45 " marrëdhënie me institucionet brenda e jashtë sistemit". Për mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore nuk është plotësuar libri përmbledhës i llogarive".

Këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e bilanceve në sistemin buxhetor, pasi nuk është zbatuar plotësisht, ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligji nr. 10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", neni 5.Nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14,datë, 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre".

(Trajtuar gjerësisht në faqen 68-84, të Projektraport Auditimit)

IX/5. Prokurimi i fondeve publike për mallra ndërtime dhe shërbime.

Nga ana e Autoriteteve Kontraktore (AK), nuk janë respektuar afatet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën.

Bazuar në programin e auditimit, u auditua zbatimi i procedurave të prokurimit të kryera nga ish Komunat Qendër, Topojë, Levan, Frakull, Dërmënas, Cakran dhe Libofshë, sot Njësi Administrative të Bashkisë Fier. Auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit, u ushtrua bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, sipas çështjeve të trajtuara dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve nuk janë botuar, në formë elektronike, në faqen e www.app.gov.al.

Në total për periudhën objekt Auditimi janë zhvilluar dhe audituar 37 procedura prokurimi, me fond limit 109,901 mijë lekë, nga të cilat zhvilluar me procedurë të "*Hapur*" 4 tendera, me procedurë "*Kërkesë me propozim*" 31 tendera dhe 2 procedura me "*Kërkesë me propozim pa shpallje paraprak*e.

Nga 37 procedura prokurimi të zhvilluara <u>në 18 prej tyre ose 48.6 % të tyre ka marrë pjesë vetëm 1 operator ekonomik (OE).</u> Fondi limit i prokuruar është 109,901 mijë lekë nga i cili nga zhvillimi i procedurës së prokurimit ka diferencë të vlerave fituese me fondin limit në shumën 7,851 mijë lekë ose 7.1%.

Në mënyrë të përmbledhur të dhënat mbi procedurat e prokurimit për vitet objekt Auditimi janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	OE		Vlera Fituese (pa TVSh)	Fituesi i procedurës	Kontrata		
				Pjesëmarrës	S'kualifikuar			Data	Vlera me TVSh	Afati
I. ISH KOMUNA DËRMËNAS										
1	Blerje karburanti	750,000	H	1	0	750,000	"G.K. P"	Nr. 143114, ft. 20.6.2013	900,000	210
2	Grumbullim transport mbeturina	780,000	H	1	0	629,555	"H K"	Nr. 127/18, dt. 5.6.2013	755,466	120
3	Riveshje rrugëve paralele	11,574,650	H	3	2	9,000,990	"H K & S"	Nr. 513/13, dt. 3.09.2014	10,801,188	60
4	Blerje karburanti	683,267	KP	1	0	683,267	"G.K. P"	Nr. 359/16, ft. 2.7.2014	819,920	120
5	Rikons rrugëve të brendshme "Driza"; "Shpata", "Fasko", në fshatin Radostinë.	1,777,365	H	5	1	1,524,042	"H K"	Nr. 234/15, dt. 14.5.2015	1,828,850	30
Shuma		**15,565,282**		**11**	**3**	**12,587,854**			**15,054,424**	**540**
II. ISH KOMUNA LIBOFSH										
1	Rikonstruksion fusha sportisti Rreth-Libofsh	744,612	KP	3	0	503,320	"V/F" ShPK	Nr. 321/5, dt. 09.06.2014	603,984	30
2	Ndërtim Pedonale fshati Agim	2,453,216	KP	4	3	2,409,400	"P V"	Nr. 514/6, dt. 19.6.2015	2,409,400	15
3	Blerje karburanti viti 2013	1,958,033	KP	1	0	1,958,033	"B-O"	Nr. 147/5, dt. 25.3.2013	2,349,639	300
4	Blerje karburanti	1,919,525	KP	1	0	1,919,525	"B-O"	Nr. 194/5, dt. 31.3.2014	2,303,430	300
5	Blerje karburanti	755,407	KP	1	0	755,407	"B-O"	Nr. 177/8, dt. 17.3.2015	906,407	120
Shuma		**7,830,793**		**10**	**3**	**7,545,685**			**9,054,822**	**765**
III. ISH KOMUNA QENDËR										
1	Sistemim sh shtrim i rrugës kodrinore të parcelave fshati Radistin Vadhiz segmenti I (1100 ml)	1,826,000	KP	1	0	1,815,200	"Sh"	Nr. 706/16, dt. 3.11.14	2,178,240	30
2	Sistemim sh shtrim i rrugës kodrinore të parcelave fshati Radistin Vadhiz segmenti I (530 ml)	839,000	KP	1	0	827,700	"Sh"	Nr. 707/16, dt. 3.11.14	933,240	20
3	Rikon rrugës dhe sheshit të varrezave fshati Grecalli	1,210,000	KP	4	1	986,620	"Sh & F"	Nr. 505/17, dt. 5.8.14	1,189,944	21
4	Rikon rrugës dhe sheshit të varrezave fshati Grecalli (vazhdim)	634,220	KP	1	0	620,390	"Sh"	Nr. 662/17, dt. 20.10.14	744,468	4
5	Rikon i rrugës dhe sheshit të varrezave në fshatin Daullas	941,000	KP	1	0	940,180	"Sh"	Nr. 696/16, dt. 28.10.14	1,128,216	20
6	Rikonstruksion Lapidareve fshati Grecalli	808,000	KP	2	1	722,650	"V/F"	Nr.481/15, dt. 21.7.14	867,180	60
7	Blerje ushqime për konviktin e shkollës së Mesme "Rakip Kryeziu"	1,413,000	KP	1	0	1,411,750	"M.C.C"	Nr. 128/16, dt. 2.4.2014	1,694,100	270
8	Blerje karburanti viti 2014	2,791,000	KP	2	0	2,791,000	"B-O"	Nr. 129/16, dt. 3.4.2014	3,041,949 (12.6 mzh)	270
9	Blerje karburanti viti 2015	1,250,000	KP	1	0	1,250,000	"B-O"	Nr. 165/17, dt. 31.3.2015	1,500,000 (8 mzh)	270
SHUMA		**11,712,220**		**14**	**2**	**11,365,490**			**13,638,588**	**966**
IV. ISH KOMUNA LEVAN										
1	Riparim e mirëmbajte rruge	1,323,814	KP	10	7	970,566	"F"	Nr. 589/4, dt. 18.9.014	1,164,679	30

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	OE		Vlera Fituese (pa TVSh)	Fituesi i procedurës	Kontrata		
				Pjesëmarrës	S'kualifikuar			Data	Vlera me TVSh	Afati
	parcela Bishan, Bashkim, Qarr									
2	Blerje karburanti për nevojat e komunës, viti 2013	1,704,167	NGP	2	0	1,704,167	"V P"	Nr. 3/5, dt. 12.4.013	2,045,000	260
3	Ndriçim rrugor Levan - Fier	1,742,660	KP	3	1	1,281,447	"N"	Nr. 588, dt. 30.7.014	1,537,736	20
4	Riparim mirëmbajtje murit mbajtës përroi Levan	2,093,452	KP	6	0	1,388,700	"N 1934"	Nr. 379, dt. 01.6.015	1,666,440	15
5	Pastrim dhe heqje dherash	755,972	KP	2	0	539,980	"S"	Nr. 982, dt. 16.12.2014	647,976	5
6	Blerje karburanti 2015	1,575,000	NGP	1	0	1,575,000 (9.5)	"V P"	Nr.--, dt. 4.5.2015	1,575,000	150
SHUMA		**9,195,065**		**24**	**8**	**7,459,860**			**8,951,832**	**480**
V. ISH KOMUNA TOPOJË										
1	Blerje karburanti 2013	1,416,666	KP	1	0	1,350,000 (7.22)	A-1	Nr. 82/8, dt. 11.6.2013	1,692,000	300
2	Blerje karburanti 2014	1,400.00	KP	1	0	1,400,000 (12.6)	A-1	Nr. 157/12, dt. 9.5.2014	1,680,000	300
3	Rikonstruksion rrugës Topojë - Fushë	4,166,626	KP	2	1	4,051,325	"B-B"	Nr. 288/15, dt. 16.7.2014	4,861,590	45
4	Ndërtim kopshti Grykë	3,800,000	KP	3	2	2,884,784	"B-B"	Nr. 364/14, dt. 18.8.2014	3,461,741	30
Shuma		**10,783,292**		**7**	**3**	**9,686,109**			**11,623,308**	**675**
VI. ISH KOMUNA FRAKULL										
1	Rikonstruksion Pallati Kulturës Frakull	1,761,938	KP	3	2	1,738,800	A	Nr. 137, dt. 10.7.2013	1,738,800	30
2	Blerje karburanti	3,300,000	KP	1	0	3,300,000	K	Nr. 43/2, dt. 5.3.2013	3,996,000	300
3	Ndërtim i rrjetit KUZ për fshatin kashitsht	28,841,414	H	7	5	27,990,740	A-I	Nr. 407, dt. 29.12.2014	33,588,888	120
4	Rehabilitim i varrezave Frakull-Karafilaj	2,686,999	KP	4	3	2,637,860	A	Nr. 362, dt. 04.12.2014	3,165,432	30
5	Transport dhe heqje mbeturinash	755,972	KP	2	0	539,980	S	Nr.982, dt. 16.12.014	647,976	5
6	Thellim i kanaleve kullues	4,162,989	KP	2	1	4,128,225	I.C.C G	Nr. 118, dt. 9.4.2015	4,953,870	30
Shuma		**41,509,312**		**17**	**11**	**40,335,605**			**48,402,726**	**510**
VII. ISH KOMUNA CAKRAN										
1	Blerje karburanti 2013	1,600,000	KP	1	0	1,584,475	"V B"	Nr. 560/15, dt. 08.11.2013	1,901,370	53
2	Rikon ujësjellësi Cakran	9,038,755	KP	4	3	8,768,951	"B B"	Nr. 467/16, dt. 24.6.2013	10,522,741	60
3	Rikon rruga Qendër-Cakran (ndërtim kanalizim KUB)	833,000	KP	3	2	666,540	"N 1934"	Nr. 1090/15, dt. 19.11.2014	799,848	15
4	Blerje karburanti 2014	2,590,000	KP	1	0	2,590,000	"R"	Nr. 683/16, dt. 17.7.2014	3,108,000	163
Shuma		**14,061,755**		**9**	**5**	**13,609,966**			**23,531,959**	**291**
37	**TOTALI**	**109,901,747**		**92**	**35**	**102,050,589**			**122,460,707**	**4,227**

Burimi i informacionit: të dhënat sipas procedurave të prokurimit të audituara dhe grupi i auditimit të KLSH.

Nga Auditimi sipas dokumentacionit të paraqitur, si probleme të përbashkëta në të gjitha ish Komunat e audituara nga grupi i auditimit , u konstatua sa vijon:

-Nuk është ngritur dhe funksionuar komisioni i marrjes në dorëzim për tenderat e shërbimit, në kundërshtim me kërkesat e të VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik" kreu VIII, pika 2/b, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 42, pika 54 "Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore.... financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës ....".

-Në 83 % të rasteve është përdorur formë prokurimi "*Kërkesë për propozim*", me argumentimin se janë kontrata nën kufijtë e ulët monetarë, sipas përcaktimit të nenit 8 "Kufijtë monetarë", të VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Bazuar në nenin 29 "Procedurat standarte të prokurimit", të ligjit nr. 6943, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, AK mund të kishte përdorur procedurën e hapur, pasi sipas këtij neni procedura e hapur mund të përdoret për të gjitha kontratat.

Komente dhe sqarime:
-Në shpjegimet që jepen në materialin e dërguar në elektronik, në lidhje me mbajtjen e regjistrave në të cilën pretendohet se ato janë plotësuar nga ana Juaj, sqarojmë se gjatë fazës së auditimit nuk u paraqitën, gjë e cila u bë e mundur në shpjegimet e dhënë në fazën e kundërshtive të akteve të mbajtura. Kështu merret në konsideratë fakti se në këtë ish Komunë Regjistrat janë të plotësuara.
Gjithashtu merret në konsideratë dhe fakti mbi nivelin e kualifikuar të anëtarëve të NJP dhe KVO.

Më poshtë po trajtojmë problematikat e konstatuara në procedurat e audituara:

IX/5-1. Në ish Komunën Frakull.
Nga ana e Autoritetit Kontraktor (AK) Komuna Frakull për periudhën nga 01.01.2013 deri më 31.07.2015 janë kryer **6** procedura prokurimi nga **5** të tilla, me vlerë 40,753,340 lekë, nga të cilat **1** procedurë tender i *hapur* dhe **3** (tre) *kërkesë me propozim*. Janë lidhur kontrata për vlerën 39,795,625 lekë me një diferencë nga fondi limit për vlerën 957,715 lekë. Në këto procedura kanë marrë marr pjesë **17** operatorë ekonomikë (OE) dhe janë s'kualifikuar **11** prej tyre, sipas tabelës sa vijon:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	OE		Vlera Fituese (pa TVSh)	Fituesi i procedurës	Kontrata		
				Pjesëmarrës	S'kualifikuar			Data	Vlera me TVSh	Afati ditë
1.	Rikonstruksion Pallati Kulturës Frakull	1,761,938	KP	3	2	1,738,800	A	Nr. 137, dt. 10.7.2013	1,738,800	30
2.	Blerje karburanti	3,300,000	KP	1	0	3,300,000	K	Nr. 43/2, dt. 5.3.2013	3,996,000	300
3.	Ndërtim i rrjetit KUZ për fshatin kashitsht	28,841,414	H	7	5	27,990,740	A-I	Nr. 407, dt. 29.12.2014	33,588,888	120
4.	Rehabilitim i varrezave Frakull-Karafilaj	2,686,999	KP	4	3	2,637,860	A	Nr. 362, dt. 04.12.2014	3,165,432	30
5.	Transport dhe heqje mbeturinash	755,972	KP	2	0	539,980	S	Nr.982, dt. 16.12.014	647,976	5
6.	Thellim i kanaleve kullues	4,162,989	KP	2	1	4,128,225	I.C.C G	Nr. 118, dt. 9.4.2015	4,953,870	30
	Shuma	**40,753,340**		**17**	**11**	**39,795,625**				**510**

Grupi i auditimit rezultoi se **5** nga **6** procedura prokurimi të periudhës objekt auditivi me vlerë 39,997 mijë lekë ose 98% e prokurimeve të kryera, konkretisht:

1- Tenderin e zhvilluar me objekt:*" Ndërtim i rrjetit KUZ për fshatin Kashitsht*"**,** me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 8, datë 26.11.2014 (shkresa nr. 345, dt. 26.11.2014). Fondi limit 28,841,414 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 8, datë 26.11.2014 Sh. M, ing/ndërtimi E. B, jurist H. K, ekonomist	KVO me shkresën nr. 346, dt. 26.11.2014 Ç. H.. S. C.. B. T.
Procedura e prokurimit – e hapur, Burimi fin. buxheti shtetit.	Fitues "A-I" ShPK	Vlera fituese 27,990,740 pa TVSh,
Datë e hapjes së tenderit 20.12.2014.	Diferenca nga fondi limit 850,674 lekë.	Kontrata nr.407, datë 29.12.2014.
Marrin pjesë **7** OE S`kualifikuar **6** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 27.11.2014 (shkresa nr. 348, dt. 27.11.2014,	Vlera e kontratës 33,588,888 lekë me TVSH.
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 4 muaj ose 120 ditë	Titullar i AK – V. Ç.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Në dokumentacionin e dosjes së procedurës së prokurimit, nuk ka asnjë të dhënë për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu II, pika 2, ***ngarkohet me përgjegjësi ish Titullari i AK z. V. C. dhe NJP***.

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DST janë hartuar me procesverbalin nr. 1, datë 27.11.2014 të cilat nuk janë firmosur nga NJHDT, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Kreu V, "*Zhvillimi i procedurave*", pika 2 "*Hartimi i dokumenteve të tenderit*", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".

Procesverbali nr. 1, datë 27.11.2014 për hartimin e dokumenteve të tenderit dhe miratuar nga titullari i AK. Në DST është kërkuar:

a- *"-Licenca profesionale e shoqërisë sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (ish-MPPT), lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesë licencën profesionale për ekzekutimin e punëve me kategoritë përkatëse:* ***NP1-B; NP4-B;NP7/B; NP12-A;NS1-B dhe NS18-A.***

Kjo kërkesë **nuk është në përputhje me volumet e punës** së përcaktuar në preventiv, pasi nivelet "B" i kategorisë sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", është kur zërat e punimeve sipas kategorive të licencës paraqiten në vlerat 20 – 50 milion lekë, ndërkohë që vlerat sipas preventivit janë:

në lekë

	Zërat e punimeve	**Vlera e përllogaritur e kontratës**
1	Punime për prishje ndërtimi	5,520,000
2	Punime gërmimi	3,093,050
3	punime ujësjellësi	0

b*- Në DT është kërkuar që: "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se* ***40*** *punonjësish të siguru**ar**, nuk përputhet me manualin e punës 2013, duke mos argumentuar numrin e punonjësve me grafikun e punimeve, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të*

ndryshuar, Kreu III "Dokumentet e tenderit" pika 3 "Informacione të veçanta" nënpika (a) "kontratat për punë".

Konkluzion: Vendosja e kërkesave në këtë mënyrë është në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (c, ç dhe d), dhe Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c, Neni 46 pikat (1) dhe (3), dhe me VKM nr.1, datë 10.01.2007, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar, Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2 "Hartimi i Dokumenteve të tenderit", veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: ***NJHDT e përbërë nga zj. Sh. M. me funksion ish-specialiste në INUV, z. E. B. me funksion ish-jurist i komunës dhe z. H. K. me Inspektor i Mbrojtjes Shoqërore dhe Ndihmës Ekonomike + Magazinier.***

C- Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Tenderi është hapur me procesverbalin nr. 3, datë 20.11.2014, nga ku rezulton të kenë marrë pjesë 7 OE sa vijon:

Nr.	Subjekti	Vlera lekë	Kualifikim/skualifik
1	"AI"	0	S'kualifikuar
2	"C.M" & "P-V-K"	17,545,240	S'kualifikuar
3	"S 07" ShPK& "S" & "G K"	26,898,760	S'kualifikuar
4	"A I G C"	27,990,740	**Kualifikuar**
5	"A"	28,210,773	S'kualifikuar
6	"C"	28,659,193	S'kualifikuar
7	"E"	28,833,340	S'kualifikuar
	TOTALI.....	**129,927,273**	

Me procesverbalin datë 20.11.2014, KVO ka **vlerësuar si të rregullt 1 ofertë nga 7 oferta të paraqitura,** me pretendimin se nuk plotësonin të gjitha kriteret e vendosura në DST.
Nga ana e KVO është hartuar Raporti Përmbledhës duke analizuar të gjithë procedurën e ndjekur dhe dërguar për miratim titullarit të AK, i cili me shkresën nr. 405, datë 29.12.2014 është bërë miratimi i tij, duke vlerësuar si operator fitues "A. I. G. C." me vlerë të ofertës 27,990,740 lekë.

D-Vlerësimi i dokumenteve të OE të s'kualifikuar. Në auditimin e dokumenteve në sistemin elektronik të OE të s'kualifikuar ***"A"***, konstatohet se është bërë në përputhje me DST, ***pasi OE nuk ka paraqitur dokumente.***
-BOE **"Sh 07& S & G. K.**", konstatohet **se jo të gjitha** kriteret për të cilat është s'kualifikuar qëndrojnë, pasi disa nga kriteret për të cilat është s'kualifikuar nuk qëndrojnë.

Komente dhe sqarime. *Në shpjegimet që jeni me datë 23.05.2017 (prot KLSH me nr. 276/5, datë 22.05.2017), në lidhje me argumentin se s'kualifikimit i BOE "Sh. 07 & S. & G. Konstruksion", argumentet që paraqisni sqarojnë problematikën e trajtuar nga grupi i auditimit dhe se s'kualifikimi është bërë i saktë nga KVO.*

-Në auditimin e dokumenteve të BOE **"C..M & P.-V.-K.**", konstatohet se kriteret për të cilat është s'kualifikuar nuk qëndrojnë, **por referuar shpjegimeve të dhënë nga subjekti konstatimet e grupit të KLSH nuk qëndrojnë**, konkretisht:

Komente dhe sqarime. *Në shpjegimet që jeni me datë 25.05.2017 (prot KLSH me nr. 276/6, datë 31.05.2017), në lidhje me argumentin se BOE ""C.i.M & P.-V.-K."," nuk i plotëson të*

gjitha kriteret për kualifikim, duke argumentuar dhe konstatimet e grupit të KLSH se i plotëson ato, si vijon:
a-Në lidhje me s'kualifikim e OE "C..M" pasi nuk plotëson kategorinë e licencës NS-1B, qëndron pasi referuar akt-marrëveshjes midis OE për zbatimin projektit ky operator ka 80% të punimeve të cilat korrespondon me zërat për të cilat duhet të ketë këtë kategori licence, ndërsa operatori tjetër "P.-V.-K." ka 20% e punimeve, veprime këto në mbështetje me nenin 45, të LPP, ku huhet se "Kërkesat ekonomike, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e punëve. ***Argumenti i subjektit për pikën "a" qëndron dhe merret në konsideratë nga grupi i KLSH.***
b-Sipas kërkesave të DST, operatorët pjesëmarrës duhet të paraqesë inxhinier gjeolog i përhershëm ose më kontratë, i cili duhet të jetë i pajisur me licenca profesionale, kërkesë të cilën BOE "C. M & P.-V.-K.", nuk e plotëson pasi ky BOE ka paraqitur akt-marrëveshje me subjektin "Gj. & CO", ***por që nuk ka*** *paraqitur llojet e licencave si dhe lista e stafit inxhinieri dhe nuk është akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.* ***Argumenti i paraqitur nga subjekti (ish Komuna Frakull) qëndron në lidhje me pikën "b".***
c-Nuk merret në konsideratë fakti që BEO nuk disponon rul me goma mbi 6 ton, pasi dhe në shpjegimet tuaja jeni kontradiktor ku njëherë thoni e ka një herë nuk e ka. ***Pra nuk argumentoni faktin se subjekti nuk ka paraqitur rul me goma mbi 6 ton;***
d- Në lidhje me pretendimin se stafi teknik është i pasiguruar, ***qëndron argumenti juaj se*** *stafi teknik (dy drejtuesit) nuk janë të siguruar për gjithë periudhën por janë siguruar në muajt Shtator-Tetor 2014, ndërsa periudhën tjetër (Janar 2013 – Gusht 2014) nuk janë t siguruar, gjë e cila është në kundërshtim me DST.* ***Argumenti juaj merret në konsideratë;***
f-Merret në konsideratë fakti se operatori "C." në ekstraktin e QKR nuk ka objekt veprimtarie "Ndërtim ujësjellësi".
Në përfundim merret në konsideratë fakti se BEO "C..M & P.-V.-K.", nuk plotëson kriteret e DST ***dhe s'kualifikimi është i sakta,*** *kjo sipas dhe dokumentacionit bashkëlidhur kundërshtive.*

F-Vlerësimi i dokumenteve të operatorit ekonomik fitues:
Nga vlerësimi i ofertave ekonomike të paraqitura, KVO ka vlerësuar si ofertë të leverdishme operatorin ekonomik ***"A. I. G. C."*** **me vlerë të ofertës 27,990,740 lekë,** u konstatua se dhe ky subjekt nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura nga NJHDST, **por referuar shpjegimeve të dhënë nga subjekti konstatimet e grupit të KLSH nuk qëndrojnë**, konkretisht:

Komente dhe sqarime. *Në shpjegimet që jeni me datë 25.05.2017 (prot KLSH me nr. 276/6, datë 31.05.2017), në lidhje me argumentin se OE "A.– I." plotëson të gjitha kriteret për kualifikim, duke argumentuar dhe konstatimet e grupit të KLSH se disa nga këto kritere nuk i plotësojnë, si vijon:*
a-Merret në konsideratë fakti që subjekti "A.-I.", ka paraqitur vërtetim e energjisë elektrike (bashkëlidhur dokumenti). ***Argumenti qëndron.***
b-Merret në konsideratë fakti se ing. Gjeolog z. P. N. T. nuk është i siguruar për periudhën 2013 dhe 2014, pasi sipas kontratës me datë 07.09.2014 sigurimi fillon nga kjo datë, por referuar pikës 2.3.4 të DST për pikën "e" është i përjashtohet, konkretisht "Ing. Gjeolog". ***Argumenti qëndron.***

c-Merret në konsideratë fakti se OE ka paraqitur makineritë, kjo pasi ka kontratë me subjektin "Shkodra Beton" nr. 4086rep/2628kol, datë 18.12.2010, pasi subjekti i ka në dispozicion këto mjete me kontratë lisingu apo qiraje financiare, i cili sipas kontratës është pronarë i tyre. Kontrata lising pengon shitjen apo vënien si kolaterial, peng të mjeteve, por nuk pengon qiradhënien , huadhënien apo huapërdorjen të të tretëve kundrejt shpërblimit. ***Argumenti qëndron.***

d-Merret në konsideratë fakti që të gjitha mjetet kanë paraqitur certifikatë e kontrolli teknik, leje transporti dhënë në ish Komuna Frakull. Mjetet që janë në pronësi, sqaron se "A.-I." është filial i shoqërisë së huaj dhe në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumente si leje transporti nga Komuna, siç parashikohet në pikën 3 e shtojcës 10 të DST, ku thuhet se: ".....Nëse dokumentet e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjaftohen një deklarata me shkrim...". ***Argumenti qëndron i shoqëruar me dokumentacion.***

e-Merret në konsideratë fakti që OE "A.-I." nuk ka kontrata të ngjashme, pasi sipas dokumentacionit bashkëlidhur subjekti ka kontrata të ngjashme lidhur me datë 14.09.2010 me afat përfundimi 630 ditë dhe vlerë 4870000.54 euro, ku pjesë e kësaj kontrate janë dhe punime kanalizime të ujërave të zeza. Për këtë subjekti ka paraqitur formularin e vlerësimit, situacionet përfundimtar dhe procesverbalin mbi punimet kryesore, si ekuivalent i procesverbalit të marrjes në dorëzim të punimeve, duke mbajtur parasysh dhe faktin se OE është operator i huaj, ku në pikën 3 të DST thuhet se:".....Nëse dokumentet e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjaftohen një deklarata me shkrim...". ***Argumenti qëndron i shoqëruar me dokumentacion***

Në përfundim merret në konsideratë fakti se EO "A. –I.", plotëson kriteret e DST dhe kualifikimi i bërë nga KVO-ja është i sakta, kjo sipas dhe dokumentacionit bashkëlidhur kundërshtive.

2- Tender i zhvilluar me objekt; ***"Thellim i Kanaleve Kullues në Komunën Frakull"*** me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 1, datë 02.03.2015. Fondi limit 4,162,989 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 1, datë 02.03.2015 Sh. M., ing. Ndërtimi E. B., jurist H. K., ekonomist	KVO me shkresën nr. 67, dt. 03.03.2014 Ç. H.. S. C.. B. T.
Procedura e prokurimit – *Kërkesë me propozim*, Burimi financimit të ardhurat e komunës.	Fitues "I.C.C G." ShPK	Vlera fituese 4,128,225 pa TVSh,
Datë e hapjes së tenderit 18.03.2015.	Diferenca nga fondi limit 34,764 lekë.	Kontrata nr.118, datë 09.04.2015.
Marrin pjesë **2** OE S`kualifikuar **1** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 04.03.2015	Vlera e kontratës 4,953,870 lekë ME TVSH.
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 1 muaj ose 30 ditë	Titullar i AK – V. Ç.

A- Llogaritja e fondit limit: Në dosje nuk ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara dhe të miratuar nga ana e Kryetarit të Komunës Frakull për vlerën e fondit limit prej **4,162,898 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbalin nr. 1, datë 04.03.2015. DST nuk janë firmosur nga NJHDT, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 61 *"Hartimi dhe*

publikimi i dokumenteve te tenderit", ku thuhet se: "*Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato*".

C- Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Me procesverbal nr. 1, datë 09.03.2015 në zbatim të procedurës së prokurimit të përcaktuar '*Kërkesë me propozim",* janë ftuar të marrin pjesë 5 OE, konkretisht: "A.", "J.", "F.", "D. J." dhe "K.".
Me shkresën nr. 1/1, datë 17.03.2015 të Titullarit të AK është bërë anulimi i procedurës me faktin se në preventivin e punimeve i cili ndodhen në dosjen e tenderit nuk janë përcaktuar vëllimet e punës, në këto kushte është bërë anulimi i tij për plotësim dokumentacioni dhe zhvillimi pas 5 ditësh i procedurës.
Me procesverbal nr. 3, datë 24.03.2015 nga ana e anëtareve të KOV është bërë hapje e proceduarës dhe zhvillimi i tij. Konstatohet se në këtë procedurë janë paraqitur vetëm 2 OE të tjerë të cilët kanë paraqitur dokumentacionit teknik e ligjore.

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	"A.-I. G. C."	4,160,958	S'kualifikuar
2	"I.C.C G."	4,128,225	**kualifikuar**

Sipas procesverbali të hartuar nga KVO, operatori ekonomik **"A.-I. G. C." është s'kualifikuar** pasi nuk plotëson disa nga kriteret e vendosura, respektivisht: *mungon sigurimi i ofertës, vërtetimi nga Komuna Frakull, çmimet e analizës për punët e vendosura në preventiv, punime të ngjashme, GPS, fatura për blerjen e kostumeve të punës dhe blerjen e tabelave sinjalistike.*
Po sipas këtij procesverbali mbetet për kualifikim operatori ekonomik "I.C.C G." i cili plotëson kriteret teknike e ligjore. Në përfundim është hartuar Raporti Përmbledhës i cili është plotësuar sipas ligjit dhe VKM përkatëse dhe dërguar për miratim tek Titullari i AK, ku ky i fundit me shkresën nr. 103, datë 31.03.2015 ka bërë miratimi e këtij raporti dhe vendos të shpall fitues OE **"I.C.C G." për vlerën 4,128,225 lekë.**

D-Auditimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomike te kualifikuar.
Nga Auditimi i dokumentacionit teknik e ligjorë të paraqitur nga subjekti fitues në format elektronik, pasi në dosjen e procedurës nuk ka dokumente të firmës fituese, konstatohet se ky subjekt nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST, si më poshtë vijon;

a-Nuk është plotësuar deklarata mbi specifikimet teknike, sipas shtojcës 5;

b-Nuk është plotësuar formulari i vlerësimit sipas shtojcës 8;

c-Nuk është paraqitur deklarata për xhiron në tre vitet e fundit, ku sipas deklarimit të subjektit thuhet se është krijuar me datë 08.01.2015, fakt ky që e bën të pamundur plotësimin e kriterit të pikës 1.2-Kapacitete teknikë, pasi nga subjekti nuk mund të plotësohen kërkesat që kërkohen si: Kontrata sipërmarrje, situacionet përfundimtar, akt-kolaudimi, etj. Nuk mund të shpallje fitues një subjekt që nuk ka përvojën e mjaftueshme për kryerjen e ndërtimeve në fushën e pastrimit të kanaleve;

d-Nuk është plotësuar pika 2.3.2 për sigurimin e numrit mesatar të 12 punëtorëve për periudhën janar – mars 2015, pasi në muajin mars nuk ka paraqitur listpagesave dhe muajin janar e ka me 11 punonjës. Gjithashtu në muajin Shkurt 2015 nuk plotësohet kriteri që punonjësit të kenë 22 ditë të plota pune në muaj;

e-Nuk është paraqitur vërtetimi nga Administrata Tatimore për numrin e punonjësve të siguruar (germa "a" e pikës 2.3.3);

f-Nuk është paraqitur për stafin teknik inxhinieri ndërtimit dhe hidroteknik, kjo shoqëruar me CV, diplomë dhe licencat përkatëse;

g-Manovratori i cili pretendohet si i tillë, nuk ka paraqitur licencë Manovratori dhe dokumenti i paraqitur është për traktor me zinxhir dhe autokombajnë dhe kjo e pa rifreskuar;

gj-Nuk plotëson kriterin për instrument topografik "Total Statation", pasi certifikata e paraqitur ka përfunduar afati i kolaudimit me datë 05.02.2015 dhe sipas po kësaj certifikate është e pavlefshme (pika 2.3.6);

l-Nuk ka plotësuar kriterin mbi faturat për blerjen e kostumeve të punës, pasi nuk i ka paraqitur ato (pika 2.3.7)

Konkluzion: KVO **nuk duhej të kualifikonte asnjë nga OE**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit të miratuara në DST nga vetë AK dhe **duhej të anulonte procedurën e prokurimit**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, **të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë i përbërë nga znj. Ç. H. me funksion Drejtoresh Finance, zj. S. C. me funksion P/Zyrës së Taksave dhe z. B. T.me funksion P/Zyrës Urbanistike.**

Komente dhe sqarime: *Për sa sqaroni me shkresën datë 25.05.2017 (prot KLSH me nr. 276/6, datë 31.05.2017), në lidhje me procedurën "Thellim i kanaleve kullues", nuk argumentojnë problemet e trajtuara nga grupi i auditimit, pasi nuk mund të shpallet fitues një operator i cili është krijuar rishtazi dhe të këtë përvojën për kryerjen e punëve. Gjithashtu kriteret për të cilët pretendoni nuk plotësohen dhe në kritere nuk është specifikuar se për subjekte të krijuar rishtazi duhet bërë përjashtime, pasi në procedura e tjera keni s'kualifikuar operatorë vetëm për mos plotësim të sigurimit të punonjësve ose stafit teknik drejtues.*

3- Tender i zhvilluar me objekt; ***"Rehabilitim i varrezave Frakull -Kafaraj"*** me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 6, datë 24.10.2014 (shkresa nr. 313, dt. 24.10.2014). Fondi limit 2,686,999 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 6, datë 24.10.2014 Sh. M., ing. Ndërtimi E. B., jurist H. K., ekonomist	KVO me shkresën nr. 314, dt. 24.10.2014 Ç. H.. S. C.. B. T.
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "A." ShPK	Vlera fituese 2,637,860 pa TVSh,
Datë e hapjes së tenderit 21.11.2014.	Diferenca nga fondi limit 49,139 lekë.	Kontrata nr. 362, datë 04.12.2014.
Marrin pjesë **4** OE S`kualifikuar **4** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 07.11.2014 (shkresa nr. 330/3, dt. 07.11.2014)	Vlera e kontratës 3,165,432 lekë me TVSH.
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 1 muaj ose 30 ditë	Titullar i AK – V. Ç.

A- Llogaritja e fondit limit: Në dosje nuk ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara nga inxhiniere të cilat të jenë miratuar nga ana e Kryetarit të Komunës Frakull për vlerën e fondit limit prej **2,686,999 lekë,** në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu II, pika 2.

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbalin nr. 1, datë 07.11.2014. DST nuk janë firmosur nga NJHDT, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë

20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Kreu V, "*Zhvillimi i procedurave*", pika 2 "*Hartimi i dokumenteve të tenderit*".

C- Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Me procesverbal nr. 1, datë 11.11.2014 në zbatim të procedurës së prokurimit të përcaktuar '*Kërkesë me propozim"* janë ftuar të marrin pjesë 5 OE, konkretisht: "A.", "T.", "F.", "D. J." dhe "K.".
Me procesverbal nr. 3, datë 21.11.2014 nga ana e anëtarëve të KOV është bërë hapje e proceduarës dhe zhvillimi i tij. Sipas këtij procesverbali kanë marrë pjesë këto operatorë ekonomik:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	A.	2,637,860	**Kualifikuar**
2	S.	S'ka ofertë	S'kualifikuar
3	SH.	S'ka ofertë	S'kualifikuar
4	E.	2,660,040	S'kualifikuar

Sipas procesverbali të hartuar nga KVO, janë s'kualifikuar 3 OE për faktin se dy operatorë nuk kanë paraqitur oferta ekonomikë, ndërsa operatori "E." nuk plotëson disa nga kriteret e vendosura nga NJHD, respektivisht: *mungon sigurimi i ofertës, deklaratë mbi specifikimet teknike, deklaratë konflikti interesi, formularë vlerësimi (shtojca 6), deklaratë diponibilitete i mjeteve (shtojca 7), etj.*
Po sipas këtij procesverbali mbetet për kualifikim OE "A.", i cili plotëson kriteret teknike e ligjore. Në përfundim është hartuar raporti përmbledhës i cili është plotësuar sipas ligjit dhe VKM përkatëse dhe dërguar për miratim tek titullari i AK, ku ky i fundit me shkresën nr. 349/1, datë 01.12.2014 ka bërë miratimin e këtij raporti dhe vendos të shpall fitues operatorin ekonomik "A." për vlerën **2,637,860 lekë.**

D-Auditimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomike te kualifikuar.
Nga Auditimi i dokumentacionit teknik e ligjorë të paraqitur nga OE "A." fitues në format elektronik, konstatohet se dhe ky operator nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST, të cilat i paraqesim si vijon;

a-Formulari i vlerësimit sipas shtojcës 6;

b-Nga subjekti është paraqitur vetëm pasqyrat financiare të vitit 2013 dhe jo të tre viteve siç kërkohet në DST (pika 2.2.1 germa "a");

d-Në Listpagesat e paraqitur jo të gjithë punonjësit kanë ditë pune të plota gjatë gjithë periudhës për të cilën është kërkuar informacion (Janar 2014 – tetor 2014);

c-Në stafin drejtues është kërkuar paraqitja e dokumenteve si CV, diplome dhe licenca përkatëse, por sipas verifikimit rezulton se nuk kanë paraqitur dokumente A. F. Gj. me profesion arkitekt (pika 2.3.4);

e-Nuk është paraqitet diploma e drejtuesit teknik dhe CV (pika .3.4 germa "d");

g-Nga subjekti është paraqitur fatura nr. 39 (seri 01286689), datë 06.08.2012 në të cilën janë paraqitur 2 vibrator me vlerë 36,000 lekë, por nga verifikimi i pasqyrave të bilancit (inventari AAM), rezulton se ky aktiv (aset) nuk është në mjetet e tij, pra rezulton se subjekti të mos i disponojë këto mjete (pika 2.3.6 germa "c".

Konkluzion: KVO **nuk duhej të kualifikonte asnjë nga OE**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit të miratuara në DST nga vetë AK dhe duhej të anulonte procedurën e prokurimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e*

përzgjedhjes", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e KVO i përbërë i përbërë nga znj. Ç. H. me funksion Drejtoresh Ekonomike, zj. S. C. me funksion P/Zyrës së Taksave dhe z. B. T.me funksion P/Zyrës Urbanistike.**

Komente dhe sqarime: *Për sa sqaroni me shkresën datë 25.05.2017 (prot KLSH me nr. 276/6, datë 31.05.2017), në lidhje me procedurën "Rehabilitim i varrezave Frakull", nuk argumentojnë problemet e trajtuara nga grupi i auditimit, pasi procedura e zhvilluar nuk është e hapur por kërkesë me propozim dhe sipas DST kërkohet formulari 6. Në lidhje me bilancet është sanksionuar në DST se duhet bilancet financiare të tre viteve të fundit dhe nga operatori është paraqitur vetëm një. Në lidhje me diplomat sipas verifikimit në sistemin app.gov.al ato nuk janë të depozituara. Gjithashtu makineri vibrator nuk është pasqyrën aneks të bilancit si aset i tij.* ***Në këto kushte argumenti juaj nuk qëndron****.*

4- Tender i zhvilluar me objekt; ***"Rikonstruksion i pallati kulturës (kinema), Frakull"*** me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 2, datë 21.05.2013 (shkresa nr. 100, dt. 21.05.2013). Fondi limit 1,761,938 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 2, datë 21.05.2013 Sh. M.; E. B., H. K.	KVO me shkresën nr. 100/1, dt. 21.05.2013 Ç. H., S. C., B. T.
Procedura e prokurimit – *Kërkesë me propozim*, Burimi financimit të ardhurat e komunës.	Fitues "A." ShPK	Vlera fituese 1,738,800 pa TVSh,
Datë e hapjes së tenderit 25.06.2013.	Diferenca nga fondi limit 23,138 lekë.	Kontrata nr.137, datë 10.7.2015
Marrin pjesë 3 OE S`kualifikuar **2** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 2, datë 23.05.2013	Vlera e kontratës 2,086,360 lekë me TVSH.
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 1 muaj ose 30 ditë	Titullar i AK – V. Ç.

Sipas dokumentacionit në dosjen e prokurimit, rezulton se sipas njoftimit të kontratës nr. s'ka, datë 23.05.2013 do zhvillohej tenderi me objekt *"Rikonstruksion i pallatit të kulturës (kinema), Frakull"* me datë 03.06.2013 ora 11.^{00}.
Me procesverbal nr. 11, datë 04.06.2013, NJP në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ka njoftuar 5 OE për pjesëmarrje në tender, respektivisht operatorë: *"K.", "E.", "K.","A." dhe "J.".*
Me vendim nr. 03, datë 03.06.2013 (*shkresa nr. 110, dt. 03.06.2013*), të titullarit të AK z. V. C. është vendosur anulimi i procedurës me arsyetimin se në tenderin e zhvilluar me datë 03.06.2013, asnjë nga operatorët pjesëmarrës nuk ka plotësuar kriteret e vendosura nga AK, për të cilën është njoftuar dhe APP me shkresën nr. 110/2, datë 03.06.2013.
Sipas dokumentacionit në dosje, konstatohet se nga KVO nuk është hartuar asnjë procesverbal për të shpjeguar arsyet e anulimit të kësaj procedure, veprime në kundërshtim me nenet 21 dhe 64, të ligjit nr. 6943, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO **i përbërë i përbërë nga znj. Ç. H. me funksion Drejtoresh Ekonomike, zj. S. C. me funksion P/Zyrës së Taksave dhe z. B. T.me funksion P/Zyrës Urbanistike dhe Titullarin e AK z. V. C..**

Me datës 13.06.2013 nga Titullari i AK është miratuar ndryshim i kritereve të veçanta, duke shtuar pikën 2.5.1 (inxhi. Arkitekt), **por pa shpjeguar shkaqet e kësaj shtese**, pasi referuar vendimit të Titullarit të AK procedura është anuluar për faktin e mos plotësimit të kërkesave

për të cilat nga vetë subjektet nuk është paraqitur asnjë ankimi që këto kërkesa janë të parealizueshme. Në këto kushte autoriteti duhet të shikohet mundësin e lehtësimit të tyre dhe jo shtesë së një kriteri, ku referuar të dhënave të preventivit nuk ka asnjë zë punimesh të cilat ë bëjnë të domosdoshëm shtesën e këtij kriteri, veprime në kundërshtim me Kreun V-*Zhvillimi i procedurave* pika 1 dhe 2, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP i përbërë **nga zj. Sh. M. me funksion ish-Specialiste në INUV, z. E. B. me funksion ish-Jurist i Komunës dhe z. H. K. me Inspektor i Mbrojtjes Shoqërore dhe Ndihmës Ekonomike + Magazinier dhe titullarin e AK z. V. C.**

Me shkresën nr. 110/1, datë 22.05.2013 të Titullarit të AK është bërë njoftim kontratë për tenderin me objekti *"Rikonstruksion i pallatit të kulturës Frakull",* për vlerën e fondit limit 1,761,938 lekë, e cila do zhvillohet me datë 13.06.2013.

A- Llogaritja e fondit limit: Në dosje nuk ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara nga inxhinierë të cilat të jenë miratuar nga ana e Kryetarit të Komunës Frakull për vlerën e fondit limit prej **1,761,938lekë**.

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbalin nr. 1, datë 22.05.2013. Vendosja e kritereve nga NJP është bërë në përputhje me dispozitat e LPP**.**

C- Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Me procesverbal nr. 1/1, datë 24.05.2013 në zbatim të procedurës së prokurimit të përcaktuar '*Kërkesë me propozim"* janë ftuar të marrin pjesë 5 OE, konkretisht: "A", "J", "K", "E" dhe "K".

Me procesverbal nr. 3, datë 25.06.2013 nga ana e anëtarëve të KOV është bërë hapje e proceduarës dhe zhvillimi i tij. Sipas këtij procesverbali kanë marrë pjesë këto operatorë ekonomik:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	"A"	1,738,800	**Kualifikuar**
2	"S. & SH 07"	1,711,500	S'kualifikuar
3	"2Z K."	1,558,200	S'kualifikuar

Sipas procesverbali të hartuar nga KVO, nga **3 OE** janë s'kualifikuar **2 OE** për mos plotësim të kritereve të DST, respektivisht: BOE "S" & "Sh 07" me vlerë oferte 1,711,500 lekë dhe OE "2Z K" për vlerën e ofertës 1,558,200 lekë.

Komente dhe sqarime: *Për sa sqaroni me shkresën nr. 2085/132, datë 13.06.2017 (paraqitur në KLSH nr. 276/12, datë 16.06.2017) dhe në takimin përmbyllës të zhvilluar në ambientet e KLSH me datë 19.06.2017 në orën 10.^{00}, si dhe referuar dokumentacionit që shoqëron këto kundërshtim, grupi i auditivit vlerëson se argumentet e paraqitura tregojnë se KVO ka vepruar drejte në s'kualifimimin e OE "2Z K", pasi nuk plotëson kriteret dhe shpalljen fitues të OE "A", i cili plotëson kriteret sipas DST-ve.* ***Nga sa trajtuam argumentet e paraqitura nga subjekti qëndrojnë dhe nuk gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.***

5- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2013 për nevojat e Komunës Frakull".*

Urdhër prokurimi nr. 1, datë 21.01.2013.	NJHDT sipas urdhrit nr. 1, datë 21.01.2013 Sh. M., E. B., H. K..	KVO me shkresën nr. 16/1, dt. 21.01.2013 Ç. H., S. C.. B. T.
Fondi limit 3,330,000 lekë		

Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "K" ShPK	Vlera fituese 3,300,000 pa TVSh, me marzh fitimi 5.71 ose 10 lek/litri
Dt e hapjes së tenderit 11.2.2013.	Dif nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr.43/2, datë 05.03.2013.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 22.01.2013,	Vlera e kontratës 3,996,000 lekë me TVSH.
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 10 muaj ose 300 ditë	Titullar i AK – V. Ç.

A- Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.

Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna Frakull për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 3,300,000 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1.

Për planifikimin e nevojave për fondin e planifikuar, nuk ka asnjë të dhënë se sa mjete ka në dispozicion, sa është shpenzimi për 100/km për çdo mjet si dhe se sa është planifikimi i km që do të përshkruhen.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Titullari i AK në pozicionin e nëpunësit autorizues z. V. C. dhe znj. Ç. H. me detyrë ish-Drejtoresh Ekonomike në funksion nëpunës zbatues.

B- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në shpalljen e fituesit.

Nga titullari i AK është lëshuar urdhër prokurimi nr. 1, datë 21.01.2013 me vlerë të fondit limit 3,330,000 lekë pa TVSh.

Me procesverbal nr. 1, datë 22.01.2013 NJP ka hartuar dokumentet teknik dhe ligjor mbi procedurën e blerjes së mallrave "*Kërkesë me propozim*" për artikullin "*Blerje karburanti*", ku me vendim nr. 1, datë 22.01.2013 të titullarit të AK është miratuar procedura dhe kërkesat e tenderit.

Me datë 22.01.2013 (procesverbal nr. 1.1), NJP ka bërë njoftimin për pjesëmarrje në tender nda je 5 OE , respektivisht: *"A. K.", "V. B.", "V. P.", "I." dhe "R. P.".*

Në tender janë paraqitur operatorët ekonomik, si më poshtë

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	K	5.71 ose 10 lekë/litri	Kualifikuar
2	I.	6.85 ose 16.88 lekë/litri	S'kualifikuar

DST e hartuara nuk janë nënshkruar nga anëtarët e NJP, veprime në kundërshtim me paragrafit e tretë, germa (a), pika 2 (hartimi i dokumenteve të tenderit), kreu V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C- Auditimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomike te kualifikuar.

Me procesverbal nr. 3, datë 12.02.2013 është bërë hapja e procedurës dhe shqyrtimi i ofertave paraqitura nga operatorët pjesëmarrës, por në këtë procesverbal janë analizuar vetëm dokumentet e operatorit ekonomik "K" dhe jo të operatorit tjetër pjesëmarrës "I", veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Kreu V-*Zhvillimi i procedurës* pika 2 germa (ç) dhe pika 4 germat (a, gj, i).

Me datë 19.02.2013 KVO ka paraqitur Raportin Përmbledhës mbi procesin e zhvillimit të procedurës në të cilën me unanimi është vendosur shpallja fitues e operatorit ekonomik "K" me ofertë ekonomike 5.71 marzhë fitimi ose 10 lekë/litri, raport i cili është miratuar nga titullari i AK me shkresën nr. 26/1, datë 19.02.2013

Me shkresën nr. 27, datë 19.02.2013 titullari i AK ka bërë njoftimin e kontratës fituese, e cila është pallur në APP buletin 04/mars/2013.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjorë mbi shpalljen fitues të operatorit ekonomik "K" në zbatim të kërkesave të DST, rezulton se ky operator nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara.

Komente dhe sqarime: *Për sa sqaroni me shkresën datë 25.05.2017 (prot KLSH me nr. 276/6, datë 31.05.2017),në lidhje me procedurën "Blerje karburanti viti 2013", sqarojmë se sipas dokumentacionit shoqërues është argumentuar fakti se subjekti fitues "K" plotëson të gjitha kriteret e DST dhe shpallja fitues nga KVO është i saktë, pasi janë argumentuar konstatimet e grupit të KLSH se:*

a-Subjekti ka paraqitur vërtetim e gjendjes financiare me nr. 159, datë 08.02.2013, brenda afatit 7 (shtatë) ditor;

b-Ka paraqitur fatura furnizimi, në zbatim të Kreu III, pika 3 germa (b), të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar;

c-Në lidhje me mos plotësimin e pikës 5 të kritereve (licenca e shoqërisë), argumenti i subjektit është se sipas kërkesave të DST, licencat duhet të paraqiten nëse ekzistojnë, si dhe ka paraqitur QKR ku tregohet aktivitet për tregim karburanti

D. Lidhja e kontratës dhe zbatim (shtesë kontrate).

Është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 43/2 prot, datë 05.03.2013 me vlerën e kontratës 3,330,000 lekë pa t.v.sh për Diesel D-1, nga kontraktori "K" sh.p.k përfaqësuar nga administratori z. M. K dhe Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga z. V. Ç.. Afatet e lëvrimit, menjëherë pas lidhjes së kontratës deri me datë 31.12.2013.

IX/5-2. Në ish Komunën Cakran.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) Komuna Cakran, për periudhën nga 01.01.2013 deri më 31.07.2015 janë kryer **4 procedura** prokurimi me fond limit në vlerën 14,061,755 lekë me procedurë "*kërkesë me propozim (KP)*". Diferenca nga fondi limit në total është për vlerën 452 mijë lekë ose 3.2 %, të cilat u audituan të plota. Në këto procedura prokurimi kanë marrë pjesë **9** operatorë ekonomikë (OE) dhe janë s'kualifikuar **5**, sipas pasqyrës si vijon:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	OE		Vlera Fituese (pa TVSh)	Fituesi i procedurës	Kontrata		
				Pjesëmarrës	S'kualifikuar			Data	Vlera me TVSh	Afati
1	Blerje karburanti 2013	1,600,000	KP	1	0	1,584,475	"V. B."	Nr. 560/15, dt.	1,901,370	53

								08.11.2013		
2	Rikon ujësjellësi Cakran	9,038,755	KP	4	3	8,768,951	"B. B"	Nr. 467/16, dt. 24.6.2013	10,522,741	60
3	Rikon rruga Qendër-Cakran (ndërtim kanalizim KUB)	833,000	KP	3	2	666,540	"N. 1934"	Nr. 1090/15, dt. 19.11.2014	799,848	15
4	Blerje karburanti 2014	2,590,000	KP	1	0	2,590,000	"R."	Nr. 683/16, dt. 17.7.2014	3,108,000	163
	Shuma	**14,061,755**		**9**	**5**	**13,609,966**			**23,531,959**	**291**

Nga ana e grupit të u bë i mundur Auditimi i **4 procedurave** me vlerë totale të fondit limit prej 14,061,755 lekë dhe vlerë kontrate 13,609,966 lekë me një diferencë fondi limit prej 457,789 lekë, në të cilën u konstatuan problemet si vijon:

1- Tenderi me objekt "*Rikonstruksion i ujësjellës Rajonal Cakran*", me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 32, datë 09.05.2013. Fondi limit 9,038,755 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 77, datë 11.10.2013 A. A.; L. C.; M. S.	KVO me shkresën nr. 77, datë 19.06.2014 M. Ll; A. Xh.; A. N.
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Nga FZHR.	Fitues "B. B" ShPK	Vlera fituese 8,768,951 pa TVSh.
Dt e hapjes së tenderit 24.05.2013.	Dif nga fondi limit 269,804 lekë.	Kontrata nr. 467/16, datë 24.06.2013.
Marrin pjesë **4** OE S`kualifikuar **1** OE	Miratimi i procedurës me shkresën nr. 467/8, datë 09.05.2013,	Vlera e kontratës 10,522,741 lekë me TVSH.
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 60 ditë	Titullar i AK – V. K.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 09.05.2013 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*Kërkesë për propozim*".
Në dosje **nuk** ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara të objektit "*Rikonstruksion i ujësjellësit rajonale Cakran*". Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1.

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në shkresën nr. 2085/109, datë 22.05.2017 (ardhur në KLSH datë 23.05.2017), se projekti nuk është bërë hyrje për faktin se është hartuar nga FSHZH,* ***nuk qëndron*** *pasi në momentin që ky projekt është vënë në zbatim dhe prokuruar nga ana juaj, duhej të ishte bërë hyrje në ish Komunën Cakran.*

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me procesverbalin nr. 1, datës 09.05.2013.
Për përcaktimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, është vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa (a, b, c), duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V-*Zhvillimi i procedurës*, pika 2- *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*, pasi nuk ka asnjë argumentim dhe

nuk justifikohen me volumet e punës kërkesat teknike ekonomike (kategoritë e licencës, numrin e punëtorisë, numrin dhe llojin e mjeteve, etj.), të përcaktuara nga NJHDT, **pasi**:

a- *Janë të paargumentuara me volume pune kategoritë e licencave të kërkuara e konkretisht* ***NP-1B; NP-7C; NP-12A; NS-19A****, duke kërkuar klasifikim më të lartë të kategorisë së licencës nga sa është në fakt, veprime në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pasi për punime niveli "B" i investimit është 21- 50 milion lekë dhe për punime niveli "C" i investimit është 50- 100 milion lekë,* ***ndërkohë që vlera totale e objektit është 10 milion lekë me TVSh*** *(përfshirë edhe punimet e tjera).*

b- *Është kërkuar që OE pjesëmarrës në tender të ketë një numër mesatar në tre vitet e fundit prej* ***60*** *punonjësish, duke mos argumentuar numrin e punonjësve me grafikun e punimeve, në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, Kreu III "Dokumentet e tenderit" pika 3 "Informacione të veçanta" nënpika (a) "kontratat për punë".*

c- *Në DST për deponimin e makinerive janë kërkuar makineri të cilat referuar zërave të punimeve janë teje të ekzagjeruar, konkretisht të ketë "Kamion minimumi me kapacitet 80 ton (3 copë), etj., Kërkesë e paargumentuar me volume pune sipas preventivit dhe e tejkaluar mbi VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Procesverbali i hartimit të DST nuk jep asnjë të dhënë për argumentimin e kërkesave për kualifikim për të cilën mban përgjegjësi NJHDT, zj. A. A. me funksion sekretare dhe arkiviste; z. L. Ç. me funksion ish-jurist Bashkia Fier dhe M. S..

C- Zhvillimi i procedurës: Me shkresën nr. 467/9, datë 14.05.2013 të Titullarit të AK është miratuar procedura e ftesës së 5 OE pjesëmarrës sipas procesverbalit të hartuar nga NJP nr. 2, datë 13.05.2013, në këtë procedurë prokurimi, respektivisht: "*D. 1", "V.", "G.", "C." dhe "Sh. 07".*

Sipas këtij procesverbali (faqe 3), në pagratin e dytë konstatohet se me datë 23.05.2013 është bërë ndryshimi në dokumentet e tenderit, duke ndryshuar dhe shtyrë afatin e datës së prokurimit me 5 ditë deri me datë 29.05.2013, **por nga verifikimi i dosjes së procedurës nuk u gjet asnjë dokumentacion që të vërtetojë arsyet e ndryshimit** të dokumenteve se cilat qenë mangësitë dhe argumentet për këtë ndryshim, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu V- *Zhvillimi i procedurës*, pika 2- *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*, germa (c), për të cilën ngarkohet me ***përgjegjësi NJHDT, zj. A. A. me funksion sekretare dhe arkiviste; z. L. Ç. me funksion ish-jurist Bashkia Fier dhe M. S..***

Me procesverbal nr. 5, datë 29.06.2013 të hartuar nga anëtarët e KVO është bërë hapja dhe shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, sipas kësaj pasqyre:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	"SH"	S'ka ofertë	S'kualifikohet
2	"D. 1"	S'ka oferte	S'kualifikohet
3	"BO M. S. B"	8,768,951	**kualifikohet**
4	"N & P V"	6,742,927	S'kualifikohet

Në përfundim KVO pas Shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se nga **4 OE** kanë fituar të drejtën e kualifikimit vetëm **një OE**, *konkretisht* **"BOM. S.N B" me vlerë oferte 8,768,951**

lekë pa TVSH., ku sipas KVO plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike të vendosura në DST nga AK.

Nga anëtarët e KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës me shkresën nr. 467/12, datë 14.06.2013 në të cilën është analizuar e gjithë procedura e zhvilluar gjatë fazës së prokurimit, **por konstatohet se data e raportit përmbledhës është 16 ditë më përpara se data e hartimit dhe zhvillimit të procedurës, veprim për të cilën nuk jepet asnjë shpjegim nga anëtarët e KVO.** Gjithashtu ky raport **nuk është miratuar nga ana e Titullarit të AK z. V. K.,** veprime në kundërshtim me pikës 4 germa (gj) e Kreut V, të VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për të cilën ngarkohen me ***përgjegjësi anëtarët e KVO: z. M. Ll., kryetare dhe anëtarë z. A. Xh. me funksion Përgj/Zyrës Financës dhe z. A. N. me funksion Përgj/Zyrës së Taksave.***

D- Auditimi i operatorëve ekonomik të s'kualifikuar.

-S'kualifikimi i OE "**M. SH**" dhe '**D. 1**" është bërë për faktin se nuk kanë paraqitur ofertat ekonomike, **fakt i cili qëndron.**

-Në lidhje me s 'kualifikimi e BOE "*N. & P. V.*", rezulton se nuk qëndrojnë për të gjitha rastet, si vijon:

*a-Shoqëria '**P. V.**" nuk ka dorëzuar vërtetim për mosshlyerjen e taksave vendore për vitin 2013,* ***gjë e cila nuk është e vërtet pasi vërtetimi qëndron (foto)***

*b-Shoqëria "**P. V.**" nuk ka dorëzuar punime të ngjashme,* ***fakt i cili qëndron.***

*c-Shoqëria "**N. & P. V.t**", nuk kanë paraqitur numrin mesatar të punonjësve sipas DST, gjë e cila qëndron* ***por nga verifikimi i dokumentacionit këtë kriter nuk e plotëson dhe operatori fitues.***

d-Nuk plotëson të gjitha mjetet e kërkuar në DST por pa specifikuar se cilat mjete mungojnë, ***pasi sipas dokumenteve të hedhura në sistem të gjithë mjetet që kërkohen në DST janë paraqitur.***

e-Nuk ka të punësuar në staf ing. Topograf, ***fakt i cili qëndron.***

C-Auditimi i dokumentacionit ligjor të OE të shpallur fitues "BO B B" M. S.PK.

Në auditimin e dokumentacionit ligjorë të paraqitur nga subjekti fitues "BOM. B B", konstatohet se dhe ky operator nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST nga AK, konkretisht pikan 2-kriteret e veçanta të kualifikimit:

-Mjetet të cilat janë paraqitur nga subjekti në plotësim të kriterit (pika 2.8.a.b), gjithsej 3 mjete me kapacitet total 80 ton, nuk janë siç kërkohet pasi për disa mjete mungon siguracionit dhe akt-kolaudimi dhe për disa të tjera siguracionit dhe kolaudimi ka përfunduar:

Nr.	*Targa*	*Siguracionit*	*Cer.kulidimi*	*Pronësi/Qira*
1	*AA221BG*	*Jo*		*Pronësi*
2	*AA922GA*	*JO*	*JO*	*Pronësi*
3	*FR9429B*	*JO*	*JO*	*QIRA*
4	*AA072AK*	*JO*	*JO*	*QIRA*
5	*AAP85AR*	*JO*		*QIRA*
6	*FR6240D*	*JaM. S.të afat tender*	*JaM. S.të afat tender*	*QIRA*
7	*Autobot ujë FR5603C*	*JO*	*JaM. S.të afat tender*	*QIRA*

-Nuk disponon aparat saldimi për tubat 2 copë;

-Për mjetet rul verbues, motogjenerator, motosaldatrice, platformë ngjitësi hidraulike ka faturë blerje, por sipas analizës së inventarit të AMM nuk rezulton të jetë në aktivet e bilancit, pra këto mjete nuk i disponon në momentin e zhvillimit të tenderit;
-Nuk disponon kamion vinç;
-Nuk disponon pompë testimi;
-Nuk ka paraqitur dokumente për ing. Hidroteknik dhe ing. Mjedisi
*-Për drejtuesit teknik ing. A. M. dhe ing. D. M. nuk janë paraqitur libreza e punës siç kërkohet në **pikën 2.6.ii, të DST**;*
*-Ing. N. H. me profesion ing. Elektrik, ku sipas kontratës nr. 1990rep/459kol, datë 11.07.2011 është drejtues teknik "Ing. Elektrik" me pagë mujore 49,000 lekë, nuk rezulton të jetë i siguruar dhe regjistruar në Listpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën që janë kërkuar në DST (Janar 2012 – Mars 2013), **gjë e cila klasifikohet si deklarim i rremë dhe sipas DST është element për s'kualifikim**;*
-Nuk ka paraqitur certifikatë ISO 14001:2004 (pika 2.3);
*-Nuk plotëson numër mesatar i punonjësve prej **60** persona për periudhën Janar 2012 – Mars 2013, pasi sipas vërtetimeve të lëshuara nga DRT Fier ky numër rezulton prej **46 persona** (pika 2.7), numri mesatar paraqitet prej 46 persona (691/15);*
Konkluzion: KVO **nuk duhej të kualifikonte OE "B B"** M. S.pk, pasi **nuk plotëson kriteret e kualifikimit të miratuara nga vetë AK,** por nisur nga fakti se BOE "*N & P V*" me vlerë oferte 6,742,927 lekë, ka mangësi të cilat klasifikohen si gabime të vogla, dhe duke qenë se ka paraqitur si ofertë ekonomike një vlerë më të ulët se operatori fitues prej **2,026,024 lekë** (8,768,951 – 6,742,927), në referencë të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4. Veç kësaj, KVO ka vepruar me **dy standarte** pasi ka kualifikuar e M. S.pallur padrejtësisht fitues ofertën e **OE"B B"**, me vlerë më të lartë dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit (DST), **ç'ka ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë M. Ll., kryetare dhe anëtarë A. Xh. me funksion Përgj/Zyrës Financës A. N. me funksion Përgj/Zyrës së Taksave**.

2- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2013 për nevojat e Komunës Cakran".*

Urdhër prokurimi nr. 77, datë 11.10.2013. Fondi limit 1,600,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 77, datë 11.10.2013 A. A.; A. B. M. S.; H. B.	KVO me Shkresën nr. 77, datë 11.10.2013 A. Xh.; A. N. M. S.
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "V. B." M. S.PK	Vlera fituese 1,584,475 pa TVSH., me marzh 8.929 % ose 15 lek/litri
Dt e hapjes së tenderit 24.10.2013.	Dif nga fondi limit 15,525 lekë.	Kontrata nr.560/15, datë 08.11.2013.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 11.10.2013,	Vlera e kontratës 1,901,370 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 53 ditë	Titullar i AK – V. K.

A- Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.
Në dokumentet e tenderit mungojnë kërkesat kualifikuese që operatorët ekonomikë të paraqesin për:

- *Numrin e punonjësve të siguruar të vërtetuar me dokumente nga organet kompetente*, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu V pika 2.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP i përbërë nga zj. A. A. me funksion Përgj/Zyrës sekretarit dhe arkiviste, z. A. B., M. S. me funksion Sekretar i Këshillit të Komunës dhe Hekuran Bregasi me funksion administrator i ndihmës ekonomike.

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në Shkresën nr. 2085/109, datë 22.05.2017 (ardhur në KLM. S. datë 23.05.2017), në lidhje me pikën A, sqarohet problemi i mos vendosjes së kriterit për pikën e deponimit të shpërndarjes së karburantit,* ***ndërsa problemi i mos dokumentimit të punonjësve të siguruar nuk gjen argument sqarues.***

B- Auditimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomike te kualifikuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjorë mbi shpalljen fitues të operatorit ekonomik "*Vëllezërit Brakaj*" në zbatim të kërkesave të DST të cilat janë miratuar dhe nga ana e titullarit të AK, rezulton se ky operator i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara.

C- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në Shpalljen e fituesit.

Nga titullari i AK është lëshuar urdhër prokurimi nr. 77, datë 11.10.2013 me vlerë të fondit limit 1,600,000 lekë pa t.v.M. S..

Me procesverbal nr. 1, datë 10.10.2013, NJP ka hartuar dokumentet teknik dhe ligjor mbi procedurën e blerjes së mallrave "*Kërkesë me propozim*" për artikullin "*Blerje karburanti*", ku me vendim nr. 1, datë 11.10.2013 të titullarit të AK është miratuar procedura dhe kërkesat e tenderit.

Me Shkresën nr. 560/6, datë 11.10.2013 (procesverbal), NJP ka bërë njoftimin për pjesëmarrje në tender ndaje 5 OE , respektivisht: *"R.", "A.-1", "V. P.", "E. P. 2"* dhe *"S.-G".*

Në tender është paraqitur operatori ekonomik, si më poM. S.të

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	V B	8.929 % ose 15 lekë/litri	Kualifikuar

DST e hartuara nuk janë nënshkruar nga anëtarët e NJP, veprime në kundërshtim me paragrafit e tretë, germa (a), pika 2-*Hartimi i dokumenteve të tenderit*, kreu V të VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Me procesverbal nr. 3, datë 29.10.2013 është bërë hapja e procedurës dhe Shqyrtimi i ofertave paraqitura nga operatorët pjesëmarrës, ku rezulton të jetë paraqitur vetëm një operatorë ekonomik**.**

Me datë 06.11.2013 (nr.560/10prot), KVO ka paraqitur Raportin Përmbledhës mbi procesin e zhvillimit të procedurës në të cilën me unanimitet është vendosur shpallja fitues e operatorit ekonomik "*V. B.*" me ofertë ekonomike 8.929 % marzhë fitimi ose 15 lekë/litri, raport i cili është miratuar nga Titullari i AK me vendim nr. 2, datë 06.11.2013 (M. S.kresa nr. 26/1, datë 19.02.2013).

Me Shkresën nr. 560/12, datë 06.11.2013 Titullari i AK ka bërë njoftimin e kontratës fituese.

D. Lidhja e kontratës dhe zbatim.

Është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 560/15 prot, datë 08.11.2013 me vlerën e kontratës 1,584,475 lekë pa t.v.M. S. për Diesel D-1, nga kontraktori "V. B." Sh.p.k përfaqësuar nga

administratori znj. M. B. dhe Autoriteti Kontraktor përfaqësuar nga z. V. K.. Afatet e lëvrimit, menjëherë pas lidhjes së kontratës deri me datë 31.12.2013 **ose 53 ditë**.

3. Tenderi me objekt "*Rikonstruksion rrugës Qendër - Cakran (ndërtim kanalizimi KUZ)*", me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 125, datë 22.09.2014 Fondi limit 833,000 lekë, Procedura e prokurimit – Kërkesë për Propozim	NJHDT nr. 125, datë 22.09.2014 I. M. A. A. H. B.	KVO, me urdhër 125/1, datë 22.09.2014 A. N. O. K K H
Burimi i Financimit nga gandet e komunës	Fitues "N. 1934" SH.PK	Vlera fituese 666,540 lekë pa TVSH.,
Datë e hapjes së tenderit 03.10.2014	Diferenca nga fondi limit 166,460 lekë.	Formulari i kontratës nr. 1090/15 datë 19.11.2014
Marrin pjesë **3** OE S`kualifikuar **2** OE	Miratimi i procedurës 22.09.2014	Vlera e kontratës 799,848 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s`ka Ankimime në KPP - ska	Afati kontratës 15 ditë,	Titullar i AK – V. K.

A- Llogaritja e fondit limit: Në dosje **nuk** ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara dhe miratuar nga ish-Kryetari i Komunës Cakran z. V. K.**.**
Nga NJHDT nuk është mbajtur procesverbali i llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në Shkresën nr. 2085/109, datë 22.05.2017 (ardhur në KLM. S. datë 23.05.2017), ku pretendoni se projekti ndodhet në dosje dhe në DST, sqarojmë se si gjatë fazës së auditimit po ashtu dhe në fazën e kundërshtimeve tuaja nuk është paraqitur asnjë preventiv për të kundërshtuar atë çka konstatuar grupi i auditimit.* ***Argumenti juaj nuk qëndron****.*

B- Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Me procesverbal nr. 3, datë 08.10.2014 është bërë hapja dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, duke vlerësuar OE pjesëmarrës si vijon:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	N. 1934	666,540	Kualifikohet
2	D.-1	829,750	S'kualifikohet
3	A.	692,840	S'kualifikohet

Në përfundim të Shqyrtimit të dokumentacionit teknik e ligjorë, KVO ka kualifikuar vetëm një OE, konkretisht "N. 1934".

C-Auditimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomike..
Nuk ka ankesa të paraqitur nga asnjë operator ekonomik pjesëmarrës në lidhje me zhvillimin e procedurës.
Në përfundim nga KVO me Shkresën nr. 1090/10, është hartuar Raporti Përmbledhës i cili nga ana e tij është shumë i përciptë dhe nuk shpjegon të gjithë procedurën e ndjekur dhe arsyet e s 'kualifikimi të 2 OE, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, raport i cili është miratuar nga Titullarit i AK me vendim nr. 2, datë 20.10.2014 në të cilën SHprehet se miraton vendimin e

KOV për shpallje fitues subjektin "NGRACAN 1934" me vlerë 666,540 lekë, i cili është subjekti me ofertë më të vogël se 2 operatorët e tjerë.

Në Auditimi e dokumenteve të operatorit fitues, konstatohet se ky operator nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST, konkretisht:

a-Nuk ka të punësuar ose me kontratë ing. Ndërtimi (drejtues teknik) siç kërkohet pikën 2.2-Kapaciteti teknik germa (e);

b-Stafi drejtues i shoqërisë sipas listpagesave të paraqitura nuk i kanë ditët e plota të punëve, veprime në kundërshtim me kriteret e vendosura në DST, ku thuhet se: "një punësim mesatar i të paktën 15 punonjësish, duke përfshirë dhe stafin e përhershëm. Konkretisht referuar listpagesave është kjo situatë:

Nr.	Emri punonjësit	Profesioni	Ditë pune	Paga ditë	Muaj
1.	Y.S.	Ing. Shpimi	2	1,616	Janar 2013
2.	G. L.	Ing.Gjeodet	2	1,616	Janar 2013
3.	Y.S.	Ing. Shpimi	3	2,423	Shkurt 2013
4.	G. L.	Ing.Gjeodet	3	2,423	Shkurt 2013
5.	Y.S.	Ing. Shpimi	3	2,423	Mars 2013
6.	G. L.	Ing.Gjeodet	3	2,423	Mars 2013
7.	Y.S.	Ing. Shpimi	19	15,350	Maj 2013
8.	G. L.	Ing.Gjeodet	19	15,350	Maj 2013
9.	Y.S.	Ing. Shpimi	15	12,115	Qershor 2013
10.	G. L.	Ing.Gjeodet	15	12,115	Qershor 2013
11.	Y.S.	Ing. Shpimi	5	4,231	Korrik 2013
12.	G. L.	Ing.Gjeodet	5	4,231	Korrik 2013

E njëjta situatë është dhe për vitin 2014.

Gjithashtu konstatohet se sipas kontratave të paraqitura për dy punonjës, pagesë në Listpagesat e sigurimeve nuk përputhet me pagesën sipas kontratave të lidhura, *respektivisht*:

zj. R. N. Xh., me profesion inxhinier elektrik, kontrata nr. 786rep/355kol, datë 30.06.2013 për pagesë mujore 30,000 lekë, ndërsa në listpagesave është paguar për pagën bazë 22,000 lekë/muaj, **pra 8,000 lekë më pak**.

z. P. A. J., me profesion inxhinier kimist**,** kontrata nr. 882rep/408kol, datë 31.07.2013 për pagesë mujore 30,000 lekë, ndërsa në listpagesave është paguar për pagën bazë 22,000 lekë/muaj, **pra 8,000 lekë më pak**.

Konkluzion: Nga sa trajtuam më sipër KVO është kuSHtet e mos kualifikimit të operatorit fitues dhe anulimin e procedurës së prokurimit, pasi asnjë nga operatorët nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, veprime ne kundërshtim me nenin 46, të LPP, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e VKO**: **z. A. N. me funksion ish-Përgj zyrës së taksave, z. O. K. dhe z. K. H. me funksion ish-përgjegjës i zyrës së administratës.**

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në Shkresën nr. 2085/109, datë 22.05.2017 (ardhur në KLSH datë 23.05.2017), në lidhje me pikën C të shkeljeve të konstatuara, sqarojmë se argumenti që jepni nuk sqaron problemin e trajtuar nga grupi i auditimit, pasi nuk mund të klasifikohet se devijime te vogla mos sigurimi i punonjësve sipas pagës së kontratës, por konsiderohet deklarim i rremë, kjo në zbatim të kritereve të DST.* ***Argumenti juaj nuk qëndron dhe problemi mbete****.*

F- Lidhja e kontratës dhe dokumentacioni për respektimin e afateve kohore. Kontrata nr. 1090/15 datë 19.11.2014, afati 15 ditë, ose deri më 24.11.2014, në SHumën 799,844 lekë.

- Likuidimi i kontratës është bërë me urdhër SHpenzimet sa vijon:

Urdhër SHpenzimi			Fatura tatimore		
Numër	**datë**	**vlerë**	**Numër**	**datë**	**vlerë**
187	25.6.2015	799,844	3	02.03.2015	799,844

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në Shkresën nr. 2085/120, datë 24.05.2047 (prot në KLSH nr. 276/9, datë 31.05.2017), në lidhje problemin e mos aplikimit të kamatëvonesave nga mos përfundimi i punimeve në afat për vlerën 313,539 lekë* ***qëndrojnë,*** *pasi referuar dokumentacionit që paraqisni objekti ka përfunduar brenda afatit të kontratës, kjo vërtetuar nga akt-kolaudimi datë 03.12.2014. Në lidhje me prerjen me vonesë të faturës së TVSH., nga subjekti është tentuar prerja në afat por për mungesë fondesh është prerë në një periudhën të mëvonshme.* ***Argumenti juaj merret në konsideratë dhe vlera prej 313,539 lekë kamatëvonesë), nuk qëndron****.*

4- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2014 për nevojat e Komunës Cakran".*

Urdhër prokurimi nr. 71, datë 19.06.2014. Fondi limit 2,590,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 77, datë 11.10.2013 O. K.; I. M.; H. B.	KVO me Shkresën nr. 77, datë 19.06.2014 A. N.; A. A. K. H.
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "R. "SHPK	Vlera fituese 2,590,000 pa TVSH., me marzh 10 % ose 5.56 lek/litri
Dt e hapjes së tenderit 01.07.2014.	Dif nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr.683/6, datë 17.07.2014.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 19.06.2014,	Vlera e kontratës 3,108,000 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 163 ditë	Titullar i AK – V. K.

Nga Auditimi konstatojmë se:

A- ParaSHikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.

Në dokumentet e tenderit mungojnë kërkesat kualifikuese që operatorët ekonomikë të paraqesin për:

- *Numrin e punonjësve të siguruar të vërtetuar me dokumente nga organet kompetente*, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu V pika 2.

DST e hartuara nuk janë nënshkruar nga anëtarët e NJP, veprime në zbatim me paragrafit e tretë, germa (a), pika 2 (hartimi i dokumenteve të tenderit), kreu V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e NJP i përbërë nga: z. O. K. me funksion Jurist, I. M. me funksion Juriste e Komunës dhe H B me funksion administrator i ndihmës ekonomike.

***B*- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në Shpalljen e fituesit.**

Nga titullari i AK është lëshuar urdhër prokurimi nr. 71, datë 19.06.2014 me vlerë të fondit limit 2,590,000 lekë pa t.v.SH.

Me procesverbal nr. 1, datë 19.06.2014, NJP ka hartuar dokumentet teknik dhe ligjor mbi procedurën e blerjes së mallrave "*Kërkesë me propozim*" për artikullin "*Blerje karburanti*", ku me vendim nr. 1, datë 19.06.2014 të titullarit të AK është miratuar procedura dhe kërkesat e tenderit.
Me Shkresën nr. 683/8 datë 19.06.2014 (procesverbal), NJP ka bërë njoftimin për pjesëmarrje në tender ndaje 5 OE , respektivisht: *"R.", "O.", "V. P.", "A." dhe "V. B.".*
Në tender është paraqitur vetëm një operatorët ekonomik, si më poshtë

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	R.	5.56 % ose 10 lekë/litri	Kualifikuar

Me procesverbal nr. nr. 3, datë 19.06.2014 është bërë hapja e procedurës dhe Shqyrtimi i ofertave paraqitura nga operatorët pjesëmarrës, ku rezulton të jetë paraqitur vetëm një operatorë ekonomik**.**
Me datë 14.07.2014 (nr. 683/11prot), KVO ka paraqitur raportin përmbledhës mbi procesin e zhvillimit të procedurës në të cilën me unanimitet është vendosur Shpallja fitues e operatorit ekonomik të vetëm të paraqitur "RERAL" me ofertë ekonomike 5.56 % marzhë fitimi ose 10 lekë/litri, raport i cili është miratuar nga titullari i AK me vendim nr. 2, datë 14.07.2014 (SHkresa nr. 283/12, datë 14.07.2014).
Me Shkresën nr. 683/13, datë 14.07.2014 titullari i AK ka bërë njoftimin e kontratës fituese.

C- Auditimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomike te kualifikuar.
Nga Shqyrtimi i dokumentacionit ligjorë mbi Shpalljen fitues të operatorit ekonomik "REAL" në zbatim të kërkesave të DST të cilat janë miratuar dhe nga ana e titullarit të AK, rezulton se ky operator **nuk** i përmbuSH të gjitha kriteret e kërkuara, respektivisht:

-Nuk është plotësuar kriteri për përSHkrimin e ofertës sipas SHtojcës 1 (pika 2.1/d);

-Nuk është plotësuar kriteri furnizime të ngjaSHme në një vlerë prej 1,036,000 lekë me TVSH. (pika 2.2/a), pasi nga subjekti është paraqitur një faturës furnizimi nga subjekti "KLODI" SHa me vlerë 2,072,880 lekë dhe një faturë për SHitje me kasë me vlerë 36,937 lekë, por jo furnizime të ngjaSHme siç kërkohet në DST;

-Nuk është plotësuar kriteri për paraqitjen e pasqyrave financiare (të njërit prej viteve), të verifikuar nga autoritetet përkatëse (administrata tatimore (pika 2.2/e), pasi nga subjekti është paraqitur pasqyra financiare e viti 2013 por e pa certifikuar nga administrata tatimore.

Konkluzion: KVO **nuk duhej të kualifikonte OE "REAL"**, pasi nuk plotëson kriteret kualifikimit të miratuara në DST nga vetë AK dhe **duhej të anulonte procedurën e prokurimit**, veprime në kundërshtim me nenin 46, të LPP, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e KVO i përbërë i përbërë nga A. N. me funksion përgjegjës i zyrës së taksave, A. A. me funksion sekretare dhe arkiviste dhe K. H. me funksion Përgj/Zyrës administratës dhe inspektor arsimi.**

(Gjerësisht trajtuar në faqen ---, të Projektraport Auditimit)

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në Shkresën nr. 2085/109, datë 22.05.2017 (ardhur në KLSH datë 23.05.2017), në lidhje me mos plotësimin e disa kritereve nga OE fitues, sqarojmë se nga ana juaj nuk janë paraqitur dokumente që të vërtetojnë të kundërtën e atyre që ka trajtuar grupi i auditimit, pasi sipas dokumentacionit në dosjen e auditimit dhe sistemin e app këto dokumente OE fitues nuk i dispononte.* ***Argumenti juaj nuk merret në konsideratë dhe problemi mbetet****.*

IX/5-3. Në ish Komunën LibofSH.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) Komuna LibofSH, për periudhën nga 01.01.2013 deri më 31.07.2015 janë kryer **5** procedura prokurimi me fond limit në vlerën 7,830,793 lekë me procedurë "*Kërkesë me propozim (KP)*" dhe kontratë të lidhur në vlerën **7,545,685** lekë, më një diferencë nga fondi limit në vlerën 285 mijë lekë ose 3.6 % nga vlera e fondit limit.

Në këto procedura prokurimi kanë marrë pjesë 10 operatorë ekonomikë (OE) dhe janë s'kualifikuar 3, sipas pasqyrës si vijon:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	OE		Vlera Fituese (pa TVSH.)	Fituesi i procedurës	Kontrata		
				Pjesëmarrës	S'kualifikuar			Data	Vlera me TVSH.	Afati
1.	Rikonstruksion fuSHa sportisti Rreth-LibofSH	744,612	KP	3	0	503,320	"V./F" SHPK	Nr. 321/5, dt. 09.06.2014	603,984	30
2.	Ndërtim Pedonale fSHati Agim	2,453,216	KP	4	3	2,409,400	"P. V."	Nr. 514/6, dt. 19.6.2015	2,409,400	15
3.	Blerje karburanti viti 2013	1,958,033	KP	1	0	1,958,033	"B.-O."	Nr. 147/5, dt. 25.3.2013	2,349,639	300
4.	Blerje karburanti	1,919,525	KP	1	0	1,919,525	"B.-O."	Nr. 194/5, dt. 31.3.2014	2,303,430	300
5.	Blerje karburanti	755,407	KP	1	0	755,407	"B.-O."	Nr. 177/8, dt. 17.3.2015	906,407	120
	SHuma	**7,830,793**		**10**	**3**	**7,545,685**			**9,054,822**	**765**

Nga ana e grupit të KLSH, u bë i mundur Auditimi i **5 procedurave** (nga 5 të tilla), me vlerë totale të fondit limit prej 7,830,793 lekë dhe vlerë kontrate 7,545,685 lekë me një diferencë të fondi limit prej 285,108 lekë**,** raste të cilat po i trajtojmë më poshtë:

1- Tenderi me objekt "*Rikonstruksioni fushës së sportit Rrethi-Libofsh, Komuna Libofsh*", me këto të dhëna me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 2, datë 05.05.2014 (SHkresa nr. 321, dt. 05.05.2014) Fondi limit 744,612 lekë, Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim.	NJHDT E. Dh. me detyrë juriste E.P.me detyrë inxhinier A. C. me detyrë inxhinierë	KVO me urdhrin nr. 2/1, datë 05.05.2014 (SHkresa nr. 321/1, dt. 05.05.2014 G.L. *Kryetar* F. M. D. G.
Burimi i Financimit: Buxheti SHtetit.	Fitues "V./F" SHPK.	Vlera fituese 503,320 lekë pa TVSH.,
Datë e hapjes së tenderit 21.05.2014.	Diferenca nga fondi limit 141,292 lekë.	Kontrata nr. 321/5, datë 09.06.2014
Marrin pjesë **3** OE S`kualifikuar **asnjë** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 321/3, datë 08.05.2014	Vlera e kontratës 603,984 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - ska Ankimime në KPP - ska	Afati kontratës 30 ditë.	Titullar i AK – N. D.

A- Llogaritja e fondit limit: Në dosje ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara nga subjekti "E.", me vlerën pa TVSH. **747,385 lekë,** miratuar nga ish-Kryetari i Komunës Libofsh z. N. D., me vlerën pa TVSH. **747,385 lekë.**
Me procesverbal nr. 3, datë 12.05.2014 hartuar nga NJP dhe në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu IV pika 1 SHkronja (a, b), si dhe VKM nr. 45, datë 21.01.2009 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike", janë ftuar të marrin pjesë në prokurim 5 OE, konkretisht: *"B B"; "D"; "F"; "P v" dhe "V/F", me në tekstin që në këtë procedurë mund të marrin pjesë dhe OE të tjerë*.

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbalin nr. 1, datë 08.05.2014.Nga krahasimi i preventivit të hartuar nga subjekti "ERIS" me zërat sipas manualit përcaktuar në VKM nr. 568, datë 27.06.2013, nuk rezultuan diferenca.

C- Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Në datën e hapjes së tenderit kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar sa vijon:

Nr.	**Operatori ekonomik**	**Oferta ekonomike/ lekë**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	"V/F" SHPK	503,320	- Kualifikuar e shpallur fitues.
2	"F" SHPK	620,600	- Kualifikuar
3	"D-G" Sh.p.k	642,000	- Kualifikuar

D-Auditimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomike..
Nuk ka ankesa të paraqitur nga asnjë operator ekonomik pjesëmarrës në lidhje me zhvillimin e procedurës.
Në përfundim është hartuar raporti përmbledhës datë 30.05.2014 në të cilën janë përshkruar të gjitha etapat e zhvilluara për zhvillimin e tenderit dhe në fund është përcaktuar si operator fitues subjekti "V./F" i cili ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se dy të parët në vlerën 503,320 lekë pa TVSH..
Bazuar në raportin përmbledhës titullari i AK me vendim datë 30.05.2014 vendosi të miratoje vijimin e procedurave të vlerësimit të ofertave dhe klasifikimin sipas procesverbalit të KVO.

Me Shkresën nr. 321/4, datë 30.05.2014 (formulari i njoftim fituesit) është bërë njoftimi i OE pjesëmarrës.
Në përfundim të auditimit të dokumentacionit në lidhje me këtë tender, rezulton se ai është zhvilluar sipas procedurave ligjore të ligjit të prokurimeve**.**

E- Lidhja e kontratës: Kontrata nr. 321/5, datë 09.06.2014 afati 30 ditë, ose deri më 09.07.2014, në SHumën 603,984 lekë me TVSH.. Në bazë të ditarit të objektit rezulton se punimet kane përfunduar brenda afatit në kontratë.

2- Tender i zhvilluar me objekt; ***" Ndërtim në fshatin Agim"*** me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 2, datë 06.05.2015 Fondi limit 2,453,216 lekë, Procedura e prokurimit – Kërkesë për Propozim	Me urdhër nr. 2, datë 06.05.2015 është ngritur NJHDT E. Dh. E. P. A. C.	KVO, me urdhër nr. 2/1 datë 06.05.2015 G.L. *Kryetar* F. M. D. G.
Burimi i Financimit Te Ardhurat e Komunës	Fitues "" SHPK	Vlera fituese lekë pa TVSH.,
Datë e hapjes së tenderit 22.05.2015	Diferenca nga fondi limit lekë.	Formulari i kontratës datë
Marrin pjesë **4** OE S`kualifikuar **1** OE	Miratimi i procedurës 18.05.2015	Vlera e kontratës lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s`ka Ankimime në KPP - ska	Afati kontratës xx ditë,	Titullar i AK – N. D.

A- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike janë hartuar nga Ing. A. P., ku si çmime është baruar në çmimet e VKM nr. 568, datë 27.06.2013
Në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.09.2012, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", pika 10 , pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.10, "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", aneksi VI, "Mbi sigurinë në kantier", në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbalin nr. 1, datë 07.05.2015.
C- Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Në datën e hapjes së tenderit sipas procesverbalit nr. 4, datë 18.05.2015, kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar sa vijon:

Nr.	**Operatori ekonomik**	**Oferta ekonomike/ lekë**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	L.	2,441,420	-
2	B. B	1,641,820	-
3	SH.	1,968,796	-
4	P. V.	Nuk hapet	-

Nga sa shihet kanë paraqitur dokumentacion 2 subjekte të tjera të cilat nuk kanë qenë të ftuar ("SH." dhe "P. V.t").
Me procesverbalin nr. 5, datë 22.05.2015 nga ana e KVO është bërë vlerësimi i dokumentacionit ligjore, teknik dhe vlerës së ofertës. Në përfundim KVO ka konkluduar se

nga 4 OE pjesëmarrës, njëri prej tyre dhe konkretisht subjekti "P. V." është **s'kualifikuar** me pretendimin se oferta nuk hapet pasi është dëmtuar gjatë ngarkimit.

Në lidhje me këtë fakt për të cilën është s'kualifikuar subjekti "P. V.", sqarojmë se KVO duhej t'i drejtohej APP, për ndihmë për hapjen e dokumenteve për të cilat KVO ka s`kualifikuar këta OE dhe pas mund të evidentohej si element s 'kualifikues, veprime ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XII, "Manualet dhe trajnimi", neni 83, KVO (AK), ***për të cilën ngarkohet me përgjegjësi komisioni i KVO.***

Me procesverbal nr. 6, datë 22.05.2015 nga KVO është bërë përllogaritja e vlerës anomalisht më të ulët, ku është përcaktuar se njëri nga OE dhe konkretisht subjekti "B. B", ka paraqitur si ofertë një vlerë më të vogël se ajo anomalisht më e ulët, konkretisht:

Nga përllogaritjet vlera anomalisht më e ulët është 1,714,743 lekë ndërsa subjekti pa paraqitur ofertën në vlerën 1,641,820 lekë, duke e s'kualifikuar këto OE.

Në referencë të nenit 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", paragrafët:

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së.

Nga ana e KVO nuk është kryer një veprim i tillë, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: G. L. *Kryetar, z.* F.M. me funksion ish-Përgj zyrës së taksave dhe zj. Dh.Gj me funksion ish-specialiste e MMT.

Me datë 22.05.2015, KVO pas Shqyrtimit të ofertave ekonomike vendosi të SHpall të vlefSHme OE si më poSHtë vijon: në vend të parë OE "B. B" me vlerë 1,641,820 lekë, në vend të dytë "SHendelli" me vlerë 1,968,796 lekë dhe në vend të tretë "L." me vlerë 2,441,420 lekë.

Me Shkresën datë 25.05.2015 subjekti "B. B" është tërhequr nga procedura e prokurimit.

Me vendimin e datës 25.05.2015 titullari i AK ka miratuar raportin përmbledhës mbi tenderin e zhvilluar me objekt *"**Ndërtim pedonale në fshatin Agim",*** ku sipas këtij raporti meqenëse subjekti "B. B" me ofertë me të ulët është tërhequr, në zbatim të pikës 5 e nenit 58, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, KVO ka vendosur anulimin e procedurës dhe kryerjen e një procedure të re.

Me Shkresën nr. 447/6, datë 25.05.2016 titullari i AK ka njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik për anulimin e procedurës.

2/1- Tender i zhvilluar me objekt; *" Ndërtim pedonale në Fshatin Agim"* me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 3, datë 25.05.2015	NJHDT nr. nr. 3, datë 25.05.2015	KVO, me urdhër nr. 3/1, datë 25.05.2015
Fondi limit 2,453,216 lekë,	E.Dh	G. L.
Procedura e prokurimit – Kërkesë për Propozim	E.P. A.P.	F.M. Dh.Gj
Burimi i Financimit nga te Ardhurat e Komunës	Fitues "P. V." dhe "A" SHPK	Vlera fituese 2,409,400 lekë pa TVSH.,
Datë e hapjes së tenderit	Diferenca nga fondi limit	Formulari i kontratës nr. 514/6, datë

04.06.2015	43,816 lekë.	19.06.2015
Marrin pjesë **4** OE S`kualifikuar **3** OE	Miratimi i procedurës 25.05.2016	Vlera e kontratës 2,891,280 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s`ka Ankimime në KPP - ska	Afati kontratës 15 ditë,	Titullar i AK – N.D.

A- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike janë hartuar nga Ing. A.P., ku si çmime është baruar në çmimet e VKM nr. 568, datë 27.06.2013.
Nga NJHDT nuk është mbajtur procesverbali i llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Nga ana e NJHDT është përcaktuar si formë prokurimi procedura "kërkesë për propozim", ku bazuar në nenin 29 "Procedurat standarte të prokurimit", të ligjit nr. 6943, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, AK mund të kishte përdorur procedurën e hapur, pasi sipas këtij neni procedura e hapur mund të përdoret për të gjitha kontratat.
Nuk ka asnjë **argumentim** se si ka dalë vlera e përllogaritur e kontratës, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Në lidhje me këtë projekt nuk ka Detyrë Projektimi si dhe nuk është kryer procedurë prokurimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit", i ndryshuar, neni 1, në të cilin është përcaktuar se: "Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për objektet në Republikën e SHqipërisë kontrollohen dhe disiplinohen në bazë të dispozitave të këtij ligji" dhe ligjin nr. nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, "Për prokurimin publik", ndryshuar, neni 4, "Fusha e zbatimit".
Në hartimin e preventivave, të cilat janë bërë pjesë e DT, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.09.2012, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", pika 10 , pasi nuk është paraSHikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.10, "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", aneksi VI, "Mbi sigurinë në kantier", në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit
B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbalin nr. 1, datë 07.05.2015. Nga ana e NJHDT në procesverbalin e hartimit të DT, nr. 1, datë 07.05.2015, nuk janë argumentuar kërkesat për kualifikim, veprim në kundërshtim me nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2, në të cilin kërkohet që: "Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike **duhet të argumentohen** dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre".

Komente dhe sqarime: *Në lidhje me kundërSHtitë e paraqitura me Shkresën nr. 2085/132, datë 13.06.2017 (paraqitur në KLSH nr. 276/12, datë 16.06.2017), nga ish Kryetari i Komunës LibofSH z. N.D. dhe ish Përgjegjësja e Zyrës së Financës zj. G. L. në lidhje me pretendimin se vendosje e kritereve për kualifikim janë në përputhje me ligjin, sqarojmë se argumenti i paraqitur në lidhje me numrin e fuqisë punëtore dhe kategorinë e licencës NS-18A dhe stafi teknik* ***është sqaruar nga ana juaj me dokumentacion bindës dhe merret në konsideratë nga grupi i auditimit, duke mos gjetur pasqyrim në Raportin Përfundimtar të Auditimit.***

Sipas procesverbalit nr. 3, datë 26.305.2015 nga NJP janë ftuar këto OE për pjesëmarrje në tender, si; "L.", "F.", "C./M", "E./L" dhe "A. AE".

C- Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Në datën e hapjes së tenderit sipas procesverbalit nr. 4, datë 04.06.2015, kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar sa vijon:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	L.	2,343,290	S'kualifikuar
2	B. B	1,839,400	S'kualifikuar
3	S.	2,213,850	S'kualifikuar
4	P. V. & A	2,409,400	**Kualifikuar**

Nga sa SHihet kanë paraqitur dokumentacion 3 subjekte të tjera të cilat nuk kanë qenë të ftuar ("S." dhe "P. V. & A" dhe "B. B").
Me procesverbal nr. 5, datë 05.06.2015 nga KVO është bërë vlerësimi i ofertave të paraqitura nga ku ka rezultuar se **BOE "P. V. " & "A"** plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike për të cilat është bërë kualifikimi i tij.
Me datë 05.06.2015 KVO mori vendim për SHpallje fitues OE **"P. V. " & "A"** me vlerë 2,409,400 lekë me TVSH..
Me datë 15.06.2015 Titullari i AK ka marrë vendim për SHpallje fitues të OE "P. V.".

Komente dhe sqarime: *Për sa sqaroni me Shkresën nr. 2085/132, datë 13.06.2017 (paraqitur në KLSH nr. 276/12, datë 16.06.2017) dhe në takimin përmbyllës të zhvilluar në ambientet e KLSH me datë 19.06.2017 në orën 10.^{oo}, si dhe referuar dokumentacionit që SHoqëron këto kundërshtim, grupi i auditimit vlerëson se argumentet e paraqitura tregojnë se KVO ka vepruar drejte në s'kualifimimin e OE "B. B" dhe Shpalljen fitues të BOE "P. V. dhe A", i cili plotëson kriteret sipas DST-ve.* ***Nga sa trajtuam argumentet e paraqitura nga subjekti qëndrojnë dhe nuk gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.***

E- Lidhja e kontratës dhe dokumentacioni për respektimin e afateve kohore. Kontrata nr. 514/6, datë 19.06.2015, afati 15 ditë, ose deri më 04.07.2015, në shumën 2,409,400 lekë.
Sipas dokumentacionit në dosjen teknike (zbatimit), subjekti me datë 09.07.2015 ka paraqitur kërkesë për përfundimin e punimeve ose 5 ditë jaSHtë afatit të përcaktuar në kontratë.

Komente dhe sqarime. *Në argumentet e paraqitura nga subjekti A/SH." me Shkresën (prot KLSH nr. 276/6, datë 25.06.2015), mbi mos llogaritjen e kamatëvonesës për mos përfundimin në afat të punimeve prej 5 ditë, konstatohet se:*
Shpjegimet e paraqitura dhe dokumentacioni që shoqëron atë është argumentuar problemi i mos përfundimit të afat të punimeve dhe vlera prej ***48,188 lekë****, si kamatëvonesë e llogaritur nga grupi i KLSH nuk qëndron dhe nuk gjen pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.*

3- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2013 për nevojat e Komunës Libofsh".*

Urdhër prokurimi nr. 1, datë 15.02.2013.	NJHDT sipas urdhrit nr. 1, datë 15.02.2013.	KVO me Shkresën nr. 1/1, datë 15.02.2013
Fondi limit 1,958,033 lekë	E.Dh *Kryetar*, T. M. & F. S. *antar*	G. L. *Kryetar*, F.M. & D. Gj.
Procedura e prokurimit – Kërkesë me	Fitues "B.-O"SHpk	Vlera fituese 1,958,033 lekë (10% marzh

propozim, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.		fitimi ose 15 lek/litri),
Dt e hapjes së tenderit 05.03.2013.	Dif nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr. 147/5, datë 25.03.2013.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 147/3, dt. 18.2013,	Vlera e kontratës 2,349,639 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 300 ditë	Titullar i AK – N.D.

Nga Auditimi konstatojmë se:

***A*- Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.**

Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna Libofsh për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 1,958,033 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1.

Për planifikimin e nevojave për fondit e planifikuar, nuk ka asnjë të dhënë se sa mjete ka në dispozicion, sa është shpenzimi i km për çdo mjet si dhe se sa është planifikimi i km që do të përshkruhen.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Titullari i AK në pozicionin e nënpunësi autorizues z. N.D. dhe anëtarët e NJP zj. E.Dh me funksion ish-Zv/Kryetare, F. D. me funksion ish shofer dhe T. M. .

B- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në Shpalljen e fituesit.

Me procesverbal nr. 1, datë 18.02.2013 NJP në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e PP", i ndryshuar ka përcaktuar procedurën e prokurimit *"Kërkesë me propozim KP".*

Me procesverbal nr. 2, datë 18.02.2013 janë miratuar kriteret e vendosura në këtë procedurë prokurimi, të cilat janë miratuar nga ana e Titullarit të AK me Shkresën nr. 147/3, datë 18.02.2013.

Me procesverbal nr. 3, datë 25.02.2013 NJP në zbatim të LPP dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e PP", i ndryshuar, Kreu V, pika 1 germa (a, b), ka bërë ftesën për 5 OE për marrjen pjesë të tender, konkretisht : *"KUID"; "XHEKU-HB"; B.-O."; "GRAMOZ CENE" dhe "VELIU".*

C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit*:* Me procesverbal nr. 4, datë 05.03.2013 KVO është bërë hapja e procedurës dhe marrja në dorëzime dokumentacionit të subjekteve pjesëmarrës në këtë procedurë, nga ku rezulton se ka marrë pjesë vetëm një OE dhe ofertën ekonomike e ka dërguar në mënyrë elektronike.

Sipas këtij procesverbali, konstatohet se asnjë nga kandidatët e ftuar nuk i kanë tërhequr dokumentet e tenderit, por nëpërmjet internetit. Komisioni vijoj punën për verifikimin e dokumenteve të operatorit pjesëmarrës në tender.

Me procesverbal nr. 5, datë 05.03.2013 KVO pas Shqyrtimit të dokumentacionit teknik e ligjore arrin në konkluzionin se operatori pjesëmarrës: "B.-O." i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe se oferta e paraqitur është me marzh fitimi 10% ose 15 lekë/litri pa TVSH..

Me datë 15.03.2013 KVO hartoj Raportin Përmbledhës dhe ia paraqiti për miratim Titullarit të AK, raport në të cilin janë përshkruar të gjithë hapat e ndjekur nga NJP dhe KVO, i cili është miratuar me vendim të Titullarit të AK datë 15.03.2013.
Me Shkresën nr. 147/4, datë 15.03.2013 është bërë njoftimi i fituesit (formulari), për të cilin është lidhur kontrata nr. 147/5, datë 25.03.2013 për vlerën 1,958,033 lekë pa TVSH. në sasinë 1050 litra/MUAJ me marzh fitimi 10% ose 15 lekë/litri pa TVSH. me tolona 10 dhe 20 litra.

Në Shqyrtimin e dokumentacionit të operatorit të Shpallur fitues "B.-O." në dokumentet në dosje dhe në sistemin **www.app.gov.al**, konstatohet se nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

-Nuk është paraqitur sigurimi i ofertës prej 2% në vlerën 39,161 lekë (pika 2.a);

-Nuk është paraqitur vërtetim për SHlyerjen e detyrimeve të taksave vendore për vitet 2010 dhe 2011, si dhe adresat e tjera ky subjekti SHtrin aktivitetin, si: "Katundi i Ri, fshati Rinia, rruga e depozitave, Durrës" dhe "Kashar fshati Mëzës, pikë shitje, Tiranë". Në kërkesa është shprehur qarte se: "Vërtetim të lëshuar nga bashkia/komuna pranë së cilës është regjistruar subjekti, për vitet 2010; 2011 dhe 2012"(pika 2.2.4).

Konkluzioni: Nga sa trajtuam më sipër, **KVO nuk duhej të kualifikonte OE të vetëm pjesëmarrës "B.-O.",** por duhej të anulonte procedurën dhe zhvillohej procedurë e re, pasi OE nuk plotëson kriteret ligjore të DST dhe miratuar nga AK, veprime në kundërshtim me nenin 46, 53 dhe 54, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi komisioni i KVO ***përbërë nga: zj. G. L. me funksion ish-Përgj/Zyrës së Financës, z. F.M. me funksion ish-Përgj/Zyrës së Taksave dhe zj. Dh.Gj me funksion ish-specialiste e MMT***

4- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2014 për nevojat e Komunës Libofsh".*

Urdhër prokurimi nr. 1, datë 28.02.2014 Fondi limit 1,919,525 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 1, datë 28.02.2014 E.Dh *Kryetar*, E.P. & A. C. *antar*	KVO me Shkresën nr. 1/1, datë 28.02.2014 G. L. *Kryetar*, F.M. & D.Gj.
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "B-O"SHpk	Vlera fituese 1,919,525 lekë (9.9% marzh fitimi ose 15 lek/litri),
Dt e hapjes së tenderit 19.03.2014.	Dif nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr. 194/5, datë 31.3.2014.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 194/3, dt. 04.03.2014,	Vlera e kontratës 2,303,430 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 300 ditë	Titullar i AK – N.D.

Nga Auditimi konstatojmë se:

***A*- Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparSHme ose testimin e tregut.**

Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna Libofsh për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 1,958,033 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1.
Për planifikimin e nevojave për fondit e planifikuar, nuk ka asnjë të dhënë se sa mjete ka në dispozicion, sa është SHpenzimi i km për çdo mjet si dhe se sa është planifikimi i km që do të përshkruhen.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Titullari i AK në pozicionin e nënpunësi autorizues z. N.D. dhe anëtarët e NJP zj. E.Dh me funksion ish-Zv/Kryetare, zj. A.P. me funksion specialiste në Zyrën e Planifikim Territorit dhe z. E.P. me specialist në Zyrën e Planifikim Territorit.

B- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në Shpalljen e fituesit.

Me procesverbal nr. 1, datë 04.03.2014 NJP në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e PP", i ndryshuar ka përcaktuar procedurën e prokurimit *"Kërkesë me propozim KP".*

Me procesverbal nr. 2, datë 04.03.2014 janë miratuar kriteret e vendosura në këtë procedurë prokurimi, të cilat janë miratuar nga ana e Titullarit të AK me Shkresën nr. 194/3, datë 04.03.2014.

Me procesverbal nr. 3, datë 25.02.2013 NJP në zbatim të LPP dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e PP", i ndryshuar, Kreu V, pika 1 germa (a, b), ka bërë ftesën për 5 OE për marrjen pjesë të tender, konkretisht : *"K."; "L.-J."; B.-O"; "G. C" dhe "A".*

C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit*:* Me procesverbal nr. 4, datë 19.03.2014 KVO është bërë hapja e procedurës dhe marrja në dorëzime dokumentacionit të subjekteve pjesëmarrës në këtë procedurë, nga ku rezulton se ka marrë pjesë vetëm një OE dhe ofertën ekonomike e ka dërguar në mënyrë elektronike.

Sipas këtij procesverbali, konstatohet se asnjë nga kandidatët e ftuar nuk i kanë tërhequr dokumentet e tenderit, por nëpërmjet internetit. Komisioni vijoj punën për verifikimin e dokumenteve të operatorit pjesëmarrës në tender.

Me procesverbal nr. 5, datë 19.03.2014 KVO pas Shqyrtimit të dokumentacionit teknik e ligjore arrin në konkluzionin se operatori pjesëmarrës: "B-O" i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe se oferta e paraqitur është me marzh fitimi 10% ose 15 lekë/litri pa TVSH..

Me datë 24.03.2014 KVO hartoj Raportin Përmbledhës dhe ia paraqiti për miratim Titullarit të AK, raport në të cilin janë përSHkruar të gjithë hapat e ndjekur nga NJP dhe KVO, i cili është miratuar me vendim të Titullarit të AK datë 24.03.2014.

Me Shkresën nr. 194/4, datë 26.03.2014 është bërë njoftimi i fituesit (formulari), për të cilin është lidhur kontrata nr. 194/5, datë 31.03.2014 për vlerën 1,958,033 lekë pa TVSH. në sasinë 1050 litra/muaj me marzh fitimi 9.9% ose 15 lekë/litri pa TVSH..

Në Shqyrtimin e dokumentacionit të operatorit të SHpallur fitues "B.-O." në dokumentet në dosje dhe në sistemin **www.app.gov.al** , konstatohet se nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

-Nuk është paraqitur vërtetim për SHlyerjen e detyrimeve të taksave vendore për vitet 2010 dhe 2011, si dhe adresat e tjera ky subjekti SHtrin aktivitetin, si: "Katundi i Ri, fSHati Rinia, rruga e depozitave, Durrës" dhe "Kashar Fshati Mëzës, Pikë Shitje, Tiranë". Në kërkesa është shprehur qarte se: "Vërtetim të lëshuar nga bashkia/komuna pranë së cilës është regjistruar subjekti, për vitet 2010; 2011 dhe 2012" (pika2.2.4).

<u>Konkluzioni</u>: Nga sa trajtuam më sipër, **KVO nuk duhej të kualifikonte OE të vetëm pjesëmarrës "B.-O.",** por duhej të anulonte procedurën dhe zhvillohej procedurë e re, pasi OE nuk plotëson kriteret ligjore të DST dhe miratuar nga AK, veprime në kundërshtim me nenin 46, 53 dhe 54, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi komisioni i KVO ***përbërë nga: zj. G. L. me***

funksion ish-Përgj/Zyrës së Financës, z. F.M. me funksion ish-Përgj/Zyrës së Taksave dhe zj. Dh.Gj me funksion ish-specialiste e MMT

5- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2015 për nevojat e Komunës Libofsh".*

Urdhër prokurimi nr. 1, datë 11.02.2015 Fondi limit 755,407 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 1, datë 11.02.2015 E.Dh *Kryetar*, E.P. & A. C. *antar*	KVO me Shkresën nr. 1/1, datë 11.02.2015 G L. *Kryetar*, F.M. & Dh. Gj.
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "B.-O."SHpk	Vlera fituese 755,407 lekë (10% marzh fitimi ose 15 lek/litri),
Dt e hapjes së tenderit 04.03.2015.	Dif nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr. 177/8, datë 17.03.2015.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 177/4, dt. 16.02.2015,	Vlera e kontratës 906,488 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 120 ditë	Titullar i AK – N.D.

Nga Auditimi konstatojmë se:

***A*- Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparSHme ose testimin e tregut.**

Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna Libofsh për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 755,407 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Për planifikimin e nevojave për fondit e planifikuar, nuk ka asnjë të dhënë se sa mjete ka në dispozicion, sa është shpenzimi i km për çdo mjet si dhe se sa është planifikimi i km që do të përshkruhen.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Titullari i AK në pozicionin e nënpunësi autorizues z. N.D. dhe anëtarët e NJP zj. E.Dh me funksion ish-Zv/Kryetare, zj. A.P. me funksion specialiste në Zyrën e Planifikim Territorit dhe z. E.P. me specialist në Zyrën e Planifikim Territorit.

B- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në Shpalljen e fituesit.

Me procesverbal nr. 1, datë 16.02.2015 NJP në zbatim të VKM nr. 914, datë 27.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka përcaktuar procedurën e prokurimit *"Kërkesë me propozim KP".*

Me procesverbal nr. 2, datë 16.02.2015 janë miratuar kriteret e vendosura në këtë procedurë prokurimi, të cilat janë miratuar nga ana e Titullarit të AK me Shkresën nr. 177/4, datë 16.02.2015.

Me procesverbal nr. 3, datë 20.02.2015 NJP në zbatim të LPP dhe VKM nr. 914, datë 27.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ka bërë ftesën për 5 OE për marrjen pjesë të tender, konkretisht : *"K"; "L-J"; "B.-O."; "XH-H" dhe "A".*

C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit*:* Me procesverbal nr. 4, datë 04.03.2015, KVO është bërë hapja e procedurës dhe marrja në dorëzime dokumentacionit të subjekteve pjesëmarrës në këtë procedurë, nga ku rezulton se ka marrë pjesë vetëm një OE dhe ofertën ekonomike e ka dërguar në mënyrë elektronike.

Sipas këtij procesverbali, konstatohet se asnjë nga kandidatët e ftuar nuk i kanë tërhequr dokumentet e tenderit, por nëpërmjet internetit. Komisioni vijoj punën për verifikimin e dokumenteve të operatorit pjesëmarrës në tender.

Me datë 04.03.2015, KVO pas Shqyrtimit të dokumentacionit teknik e ligjore arrin në konkluzionin se operatori pjesëmarrës: "B.-O." i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe se oferta e paraqitur është me marzh fitimi 10% ose 15 lekë/litri pa TVSH..

Me Shkresën nr. 177/5, datë 12.03.2015. KVO hartoj Raportin Përmbledhës dhe ia paraqiti për miratim Titullarit të AK, raport në të cilin janë përSHkruar të gjithë hapat e ndjekur nga NJP dhe KVO, i cili është miratuar me vendim të Titullarit të AK datë nr. 177/6, datë 12.03.2015.

Me Shkresën nr. 177/7, datë 12.03.2015 është bërë njoftimi i fituesit (formulari), për të cilin është lidhur kontrata nr. 177/8, datë 17.03.2015 për vlerën 755,407 lekë pa TVSH. në sasinë 1050 litra/muaj me marzh fitimi 10 % ose 15 lekë/litri pa TVSH..

Në Shqyrtimin e dokumentacionit të operatorit të SHpallur fitues "B.-O." në dokumentet në dosje dhe në sistemin **www.app.gov.al** , konstatohet se nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

-Nuk është paraqitur vërtetim për SHlyerjen e detyrimeve të taksave vendore për vitet 2013 dhe 2014 për adresat e tjera ky subjekti SHtrin aktivitetin, si: "Katundi i Ri, fshati Rinia, rruga e depozitave, Durrës", Lagjja "Unaza Lindore e Qytetit, rruga Kole Prela nr. 7.9 SHkodër (pikë karburanti) dhe "Kashar fshati Mëzës, pikë shitje, Tiranë". Në kërkesa është SHprehur qarte se: "Vërtetim të lëshuar nga bashkia/komuna pranë së cilës është regjistruar subjekti, për vitet 2010; 2011 dhe 2012" (pika2.2.4);

-Nuk është paraqitur certifikata nga Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Naftës (pika 2.3.3);

-Nuk është paraqitur një dokument që vërteton origjinën e mallit (pika 2.3.4) .

Konkluzioni: Nga sa trajtuam më sipër, **KVO nuk duhej të kualifikonte OE të vetëm pjesëmarrës "B.-O.",** por duhej të anulonte procedurën dhe zhvillohej procedurë e re, pasi OE nuk plotëson kriteret ligjore të DST dhe miratuar nga AK, veprime në kundërshtim me nenin 46, 53 dhe 54, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi komisioni i KVO ***përbërë nga: zj. G. L. me funksion ish-Përgj/Zyrës së Financës, z. F.M. me funksion ish-Përgj/Zyrës së Taksave dhe zj. Dh.Gj me funksion ish-specialiste e MMT***

Për sa trajtuar mësipërm është mbajtur procesverbali nr. 27, datë 11.05.2017 me punonjësit z. N.D. me funksion ish-Kryetar Komune (në cilësinë e Titullarit të AK), zj. E.Dh me funksion ish-Zv/Kryetare dhe juriste, zj. A.P. me funksion specialiste në Zyrën e Planifikim Territorit, z. E.P. me funksion specialist në Zyrën e Planifikim Territorit, F. D. me funksion ish SHofer dhe T. M. (në cilësinë e anëtarit të NJP sipas periudhave), zj. G. L. me funksion ish P/Zyrës së Financës, z. F.M. me funksion ish-Përgj/Zyrës së Taksave, zj. Dh.Gj me funksion ish-specialiste e MMT (në cilësinë e anëtarëve të KVO), z. A. SH. mbikëqyrësin e punimeve subjektin "A.SH".

IX/5-4. Në ish Komunën Dërmënas.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) Komuna Dërmënas, për periudhën nga 01.01.2013 deri më 31.07.2015 janë kryer **5** procedura prokurimi me fond limit në vlerën 15,565,282 lekë, nga e cila me procedurë të "*Hapur*" **4**praktika dhe me procedurë "*Kërkesë me propozim (KP)*" **1**praktikë. Diferenca nga fondi limit në total është për vlerën 2,977,428 lekë ose 19.1 % nga vlera e fondit limit.

Në këto procedura prokurimi kanë marrë pjesë **11** operatorë ekonomikë (OE) dhe janë s'kualifikuar **3**, sipas pasqyrës si vijon:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	OE		Vlera Fituese (pa TVSH.)	Fituesi i procedurës	Kontrata		
				Pjesëmarrës	S'kualifikuar			Data	Vlera me TVSH.	Afati
1	Blerje karburanti	750,000	H	1	0	750,000	"G. K. P."	Nr. 143114, ft. 20.6.2013	900,000	210
2	Grumbullim transport mbeturina	780,000	H	1	0	629,555	"H. K."	Nr. 127/18, dt. 5.6.2013	755,466	120
3	RiveSHje rrugëve paralele	11,574,650	H	3	2	9,000,990	"H. K. & S."	Nr. 513/13, dt. 3.09.2014	10,801,188	60
4	Blerje karburanti	683,267	KP	1	0	683,267	"G.K. P."	Nr. 359/16, ft. 2.7.2014	819,920	120
5.	Rikons rrugëve të brendshme "Driza"; "Shpata", "Fasko", në fshatin Radostinë.	1,777,365	H	5	1	1,524,042	H. K."	Nr. 234/15, dt. 14.5.2015	1,828,850	30
	SHuma	**15,565,282**		**11**	**3**	**12,587,854**			**15,054,424**	**540**

Nga ana e grupit të KLSH, u bë i mundur auditimi i **5 procedurave** (nga 5 të tilla), me vlerë totale të fondit limit prej 15,565,282 lekë dhe vlerë kontrate 12,587,854 lekë me një diferencë të fondi limit prej 2,977,428 lekë ose 19.5%. Në procedura konstatohet se:

1- Tenderi me objekt *"Grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane në fshatrat: Darëzez e Re, Poveleçë, Hoxharë, Baltëz, Hamil, Radostinë dhe Pojan*", me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 1, datë 23.04.2013. Fondi limit 780,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 1, datë 24.07.2014 I. H. *Kryetar*, M. Z. & L. M. *anëtar*	KVO me Shkresën nr. 1, datë 25.04.2013 A. G. *Kryetar*, D. B. & H. G. *anëtar*.
Procedura e prokurimit – Hapur. Burimi fin. Nga të ardhurat e komunës.	Fitues OE "H.K."	Vlera fituese 629,555 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 10.05.2013.	Dif nga fondi limit 150,445 lekë.	Kontrata nr. 127/18, datë 05.06.2013.
Marrin pjesë **2** OE S`kualifikuar **1** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 127/1, dt. 23.04.2013	Vlera e kontratës 755,466 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 120 ditë	Titullar i AK – V. F.

A- Llogaritja e fondit limit: Nga ana e AK u paraqit preventivi dhe analiza e kostos për SHërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në ish-Komunën Dërmënas, për të cilin nuk ka urdhër titullari për ngritje komisioni për hartimin e preventivave dhe specifike teknike, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK z. V. F..**

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me procesverbalin nr. 1, datës 23.04.2013. Në Shqyrtimin e kritereve të vendosura për zhvillimin e procedurës, konstatohet

se ato janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe argumentuara me procesin e SHërbimit që do kryhet**.**

C- Zhvillimi i procedurës: Nga KVO nuk është mbajtur procesverbal për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit teknik të pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi, por është kaluar direkt në hartimin e raportit përmbledhës në të cilën janë përcaktuar hapat e ndjekur nga ky komision, veprime në kundërshtim me zbatim të nenit 52, të LPP dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu V- "*Zhvillimi i procedurave*", pika 4 germa (i), për të cilën ngarkohet me ***përgjegjësi KVO e përbërë nga: A. G. me funksion ish specialiste arkivist; D. B. me funksion ish Përgj/Zyrës së AMT dhe H. G. me ish funksion arkëtare.***

Komente dhe sqarime*: Për sa shpjegoni në shkresën nr. 2085/118, datë 26.05.2017 (prot KLSH nr. 276/9, datë 31.05.2017 në të cilën shpreheni se procesverbali është konvertuar në "Raport Përfundimtar", kjo si rezultat i ndryshimeve q ka pësuar VKM nr. 1, datë 10.01.2007 me VKM nr. 32, datë 23.01.2013, i ndryshuar,* ***sqarojmë se:*** *në asnjë paragraf të VKM nr. 32, datë 23.01.2013, i ndryshuar nuk thuhet se është hequr hartimi i procesverbalit për vlerësimin e dokumenteve të tenderit dhe kalimi në raport përfundimtar.* ***Argumenti nuk merret në konsideratë.***

Sipas raport përmbledhës nr. 127/5, datë 30.05.2013 të hartuar nga KVO dhe miratuar nga Titullari i AK z. V. F., konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 OE, sipas pasqyrës:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	"H.K."	629,555	**Kualifikohet**
2	"V/F"	612,540	S'kualifikohet

Subjekti pjesëmarrës "V./F" me Shkresën nr. 127/4, datë 22.05.2013 *(shkresë me shkrim dore dhe nr. shkresës dhe data janë me shkrim dhe bojë tjetër)*, është tërhequr nga konkurrimi për arsye objektive (***pa shpjegim tjetër***) dhe në këto kuSHte procedura ka vijuar vetëm më një OE , ku sipas KVO i plotëson të gjitha kriteret teknik dhe ligjore për Shpalljen fitues të tij.
Për sa mësipërm Titullari i AK me vendim nr. 1, datë 30.05.2013 ka miratuar raportin dhe SHpallje fitues të OE "H.K." me vlerë oferte 629,555 lekë.

D- Auditimi i dokumentacionit ligjor administrativ të OE të SHpallur fitues "H.K." SHPK, rezulton se:
Në auditimin e dokumentacionit ligjorë të paraqitur nga subjekti fitues OE "H.K." , në dosjen dhe sistemin **www.app.gov.al**, konstatohet se ky OE nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe miratuara nga AK, veprime në kundërshtim me pikën 3/b të Kreut III, të VKM nr. 01, datë 10.01.2007, i ndryshuar dhe rubrikën në seksionin III, seksionin IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, konkretisht:
-Vërtetimi mbi gjendjen financiarë nga një bankë e nivelit të dytë nuk është brenda afatit 10 ditor, siç kërkohet në DST (pika 2.3.a), pasi vërtetimi mban datën 21.03.2013 dhe tenderi është zhvilluar me datë 10.05.2013;
-Nuk është paraqitur bilanci financiar i vitit 2011, siç kërkohet në DST (pika 2.3.2);
-Nuk është paraqitur përvoja të suksesshme në kryerjen e këtij shërbimi, pasi sipas situacioneve të paraqitura vlera e punëve të kryera sipas zërave të preventivit të objektit të

tenderuar është prej 228 mijë lekë, ndërsa në DST pika 2.3.a kërkohet 325 mijë lekë ose 50 % e fondit limit);
-Situacionet i punimeve nuk është paraqitur me vërtetim nga punëdhënësi mbi cilësinë e punimeve, siç kërkohet në DST (pika 2.3.b);
-Punësimi mesatar për vitet 2011 dhe 2012 nuk është 7 punëtorë por është 6.08 punonjës, në kundërshtim me pikën kapacitet teknik (pika 3). Gjithashtu drejtuesi teknik z. A. P. Q. ku sipas kontratës nr. 1084rep/563kol, datë 21.06.2013 nuk është me profesion ing. Ndërtimi por me profesion ing. Gjeolog, si dhe nuk është bashkëlidhur CV e tij. Drejtuesi teknik sipas listpagesave të shoqërisë nuk është i siguruar, veprime në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", Kreu IV "Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueSHmëria me këtë detyrë" (pika 2.3 Kapacitet teknik). Konstatohet se kontrata me drejtuesin teknik është nënshkruar pas datës së zhvillimit të tenderit (data kontrata 21.06.2013 ndërsa tenderi zhvilluar datë 15.05.2013);
Konkluzion: KVO **nuk duhej të kualifikonte OE "H.K." Shpk**, pasi ky OE nuk plotëson të gjitha kriteret e kualifikimit të miratuara nga vetë AK, veprime në kundërshtim me nenin 46, 53 dhe 54, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, duke krijuar efekt negativ në buxhetin e komunës për **vlerën 629,555 lekë**, ***të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë nga: A. G. me funksion specialiste arkive; D. B. me funksion Përgj/Zyrës së AMT dhe H. G. me funksion arkëtarë.***

Komente dhe sqarime**: Për sa shpjegoni në shkresën nr. 2085/118, datë 26.05.2017 (prot KLSH nr. 276/9, datë 31.05.2017 nuk jepni asnjë kundërshti në lidhje me gjetjet për kualifikimin e padrejtë të OE "H.K." i cili nuk përmbush të gjithë kërkesat e DST.* ***Argumenti nuk merret në konsideratë.

Në analizën e dosjen së prokurimit, konstatohet se OE pjesëmarrës "V./F" me Shkresën nr. 127/4, datë 22.05.2013 *(SHkresë me SHkrim dore dhe nr. SHkresës dhe data janë me SHkrim dhe bojë tjetër*), është tërhequr nga konkurrimi për arsye objektive (pa SHpjegim tjetër), dhe nga ana e KVO nuk është bërë konfiskimi i ofertës në vlerën **14,000 lekë** ndajë OE "V./F", veprime në kundërshtim me pikën 2 e nenit 49, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe kreu V zhvillimi procedurës", pika 4 germa (ç), të VKM nr. 01, datë 10.1.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë nga: ***A.G. me funksion specialiste arkive; D.B. me funksion Përgj/Zyrës së AMT dhe H. G. me funksion arkëtarë.***

2- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2013 për nevojat e Komunës Dërmënas".*

Urdhër prokurimi nr. 2, datë 09.05.2013. Fondi limit 750,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 2, datë 09.05.2013 I.H. *Kryetar*, M.Z. & L.M. *anëtar*	KVO me Shkresën nr. 2, dt. 13.05.2013 D.B. *Kryetar*, A.G. & H. G. *anëtar*
Procedura e prokurimit –HAPUR, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "G K P" SHPK	Vlera fituese 750,000 pa TVSH.,
Dt e hapjes së tenderit 23.05.2013.	Dif nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr. 143114, datë 20.6.2013.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 113/1, dt. 09.05.2013,	Vlera e kontratës 750,000 lekë me TVSH..

A- ParaSHikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.
Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna Dërmënas për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 750,000 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: ***NJP e përbërë nga I.H. me funksion Jurist, M.Z. me funksion P/Ndihmës Ekonomike dhe L.M. me funksion specialiste në zyrën e urbanistikës*.**

Komente dhe sqarime. *Në SHpjegimet e dhënë me Shkresën datës 2085/119, datë 26.07.2017 (prot KLSH nr. 276/9, datë 31.05.2017 të ish punonjësve Durim Beqiraj, Jolanda Silo, K.B., Melida Zlacaj dhe L.M., sqarojmë se nuk argumentojmë problemin e trajtuar nga grupi i auditimit, pasi në mungesë të stafit përgjegjës dhe në zbatim të VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, është NJP organi i cili duhet të argumentojë fondin limit të hedhur në procedurë prokurimi.* ***Argumenti juaj nuk merret në konsideratë.***

B- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në Shpalljen e fituesit.
Me urdhër prokurimin nr. 2, datë 09.05.2013 është miratuar fondi limit për blerje karburanti me vlerë 750,000 lekë pa TVSH., me procedurë "Hapur".
Me procesverbal nr. 1, datë 09.05.2013 NJHD ka hartuar kërkesat ligjore dhe teknike për zhvillimin e procedurës "*Blerje karburanti për vitin 2013 për Komunën Dërmënas*" .

C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit*:* Nga KVO nuk është mbajtur procesverbal për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit teknik të pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi, por është kaluar direkt në hartimin e raportit përmbledhës në të cilën janë përcaktuar hapat e ndjekur nga ky komision, veprime në kundërshtim me zbatim të nenit 52, të LPP dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu **V-**"Zhvillimi i procedurave", pika 4 germa (i), për të cilën ngarkohet me ***përgjegjësi KVO e përbërë nga: D.B. me funksion Përgj/Zyrës së AMT, A.G. me funksion specialiste arkivist dhe H. G. me funksion arkëtarë.***
Raportit Përmbledhës është miratuar nga ana e Titullarit të AK me Shkresën nr. 143/10, datë 06.06.2013. Në këtë raport është bërë përmbledhja e gjithë procedurës së zhvilluar në tender, ku konstatohet se ka marrë pjesë vetëm një OE , konkretisht OE "G K P" me ofertë 180 lekë/litri pa TVSH. ose me vlerë të plotë 750,000 lekë.

D- Auditimi i dokumentacionit ligjor administrativ të OE të SHpallur fitues "G K P" SHPK.
Në auditimin e dokumentacionit në sistemin **www.app.gov.al**, të paraqitur nga subjekti fitues OE "*G K P*", konstatohet se ky OE nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST nga AK, veprime në kundërshtim me pikën 3/b të Kreut III, të VKM nr. 01, datë 10.01.2007, i

ndryshuar dhe rubrikën në seksionin III, seksionin IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, konkretisht:

-Nuk është paraqitur sigurimi i ofertës (sipas SHtojcës 2);

-Nuk është paraqitur vërtetimi për gjendjen në llogarinë rrjedhëse nga një nga bankat e nivelit të dytë, siç kërkohet në DST pika 2.2.a;

-Nuk është paraqitur vërtetimi për SHlyerjen e detyrimeve fiskale vendore, pika 2.2.c;

-Nuk është paraqitur kopje e certifikatës së bilancit të shoqërisë në vitin e fundit, pika 2.2.ç;

-Nuk paraqet furnizime të së njëjtës natyre, pika 2.3.a;

-Nuk është paraqitur certifikata dhe/ose leje e tregtimit për "Shit-bjerrje karburante", të lëshuar nga organet kompetente, pika 2.3.b;

-Nuk është paraqitur kopje e kontratës për furnizim të ngjaSHme, si dhe dokumenti i faturave tatimore të TVSH., për furnizime të ngjashme, pika 2.3.1&2;

-Nuk janë specifikimet teknike, dëSHmitë e rezultatit të testimeve dhe vërtetimi laboratorik, pikat 3 dhe 4 të DST;

Konkluzioni: Nga sa trajtuam më sipër, **KVO nuk duhej të kualifikonte OE të vetëm pjesëmarrës "G K P",** por duhej të anulonte procedurën dhe zhvillohej procedurë e re, pasi OE nuk plotëson kriteret ligjore të DST dhe miratuar nga AK, veprime në kundërshtim me nenin 46, 53 dhe 54, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi komisioni i KVO ***përbërë nga: D.B. me funksion Përgj/Zyrës së AMT, A.G. me funksion specialiste arkivist dhe H. G. me funksion arkëtarë.***

Në lidhje me fondin limit të përcaktuar nga NJP me vlerë 750,000 lekë dhe ofertën e fituese nga OE "**G K P" SHPK prej 180 lek/litri** pa TVSH., konstatohet se ky fond është llogaritu me SHumë, bazuar në buletinin e APP të datës 23 Maj 2013 me çmimet referuar bursës REUTERS për "*gazoil (10 ppm ULSD)*" është në vlerën 162.11 lekë/litër pa t.v.SH dhe jo 180 lekë/litër.

Argumentimi i detajuar jepet sipas tabelës nr. 1.

Nr.	Elementet e çmimit	Njësia	Çmimi në ton	Den. 15 gradë	Kursi zyrtar kem	Lek/litër
1	Çmimi në Bursë	USD	817			
2	Premio	″	30			
	SHuma	″	847	0.8316	109.5	77.13
3	Akciza	Lekë/litër				37.00
4	Taksa e karbonit	″				3.00
5	Taksa e qarkullimit	″				27.00
6	SHpenzime markimi	″				0.61
7	SHuma para marzhit					**144.74**
8	Marzhi i fitimit					17.37
9	**Çmimi pa TVSH.**					**162.11**

Sipas tabelës nr.1, rezulton se diferenca më SHumë e çmimit të aplikuar në llogaritjen fondit limit dhe me ofertë e paraqitur nga subjekti është në vlerën 17.89 lekë/litri (180 – 162.11). Nisur nga sasia e karburantit të planifikuar për komunën në sasinë prej 5000 litra, diferencë e planifikuar më Shumë në llogaritjen e fondit limit paraqitët në shumën **89,450 lekë** (5000 litra x 17.89 lekë/litra), veprim me efekt negativ në buxhetin e komunës për të cilën ngarkohet me përgjegjësi: ***NJP e përbërë nga I.H. me funksion Jurist, M.Z. me funksion P/Ndihmës Ekonomike dhe L.M. me funksion specialiste në zyrën e urbanistikës.***

3- Tenderi me objekt *"Riveshje e dy rrugëve paralele Hidrovor-Bregdet dhe hapja e traSHjeje për rrugë paralele me bregdet"*, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 1, datë 24.07.2014. Fondi limit 11,574,650 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 1, datë 24.07.2014 S.R. *Kryetar*, S.S. dhe L.M.	KVO me Shkresën nr. 1, datë 27.07.2014 D.B. *Kryetar*, J.S. dhe K.B. *anëtar*.
Procedura e prokurimit – Hapur. Burimi fin. Nga të ardhurat e komunës.	Fitues BOE "H.K." dhe "S"	Vlera fituese 9,000,990 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 15.08.2014.	Dif nga fondi limit 2,573,660 lekë.	Kontrata nr513/13, datë 03.09.2014.
Marrin pjesë **3** OE S`kualifikuar **2** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 18.08.2014	Vlera e kontratës 10,801,188 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 30 ditë	Titullar i AK – V. F.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Në dosje ndodhet preventivi dhe detyra e projektimit (*pa nënshkruar nga zyra e urbanistikës)*, hartuar nga ing. Taqo Nicka dhe miratuar nga ana e Kryetarit të Komunës z. V. F., me vlerën pa TVSH. prej **11,574,650 lekë.**

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me procesverbalin nr. 1, datës 24.07.2014. Në përcaktimet e kritereve të veçanta të kualifikimit nga Njësia e Prokurimit, u konstatuan mangësi, pasi kriteret e përdorura nuk janë në përputhje nenin 46, pika 1 dhe 3, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V-*Zhvillimi i procedurës*, pika 2- *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*, duke SHkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë, pasi nuk ka asnjë argumentim dhe nuk justifikohen me volumet e punës kërkesat teknike ekonomike (kategoritë e licencës, numrin e punëtorisë, numrin dhe llojin e mjeteve, etj.), të përcaktuara nga NJHDT, pasi:
a- *Janë të paargumentuara me volume pune kategoritë e licencave të kërkuara e konkretisht* ***NP-1F; NP-2B; NP-3A; NP-5 & NP-9****, duke kërkuar klasifikim më të lartë të kategorisë së licencës nga sa është në fakt punimet, veprime në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që uSHtrojnë veprimtari ndërtimi", pasi për punime (B) niveli i investimit është 21- 50 milion lekë dhe për punime (F) niveli i investimit është 400-800 milion lekë, ndërkohë që vlera totale e objektit është 11 milion lekë me TVSH. (përfshirë edhe punimet e tjera).*
Për sa më sipër mban përgjegjësi: ish Titullari i AK V. F. për miratimin e këtyre kërkesave dhe NJHDT, S.R. me funksion Juriste; S.S. me funksion P/Zyrës Urbanistikës; L.M. me funksion specialiste urbanistike .

Komente dhe sqarime: *Në SHpjegimet e paraqitura me Shkresën nr. 2085/83, datë 17.05.2015 (ardhur në KLSH me datë 23.05.2017) nga ish ing. S.S. me datë 17.05.2017 (në format elektronik), është sqaruar problemi i numrit të punonjësve, ndërsa kategoritë e licencave nuk argumentohet. Shpjegimi që keni bërë nuk argumenton kategorinë e licencës por tregon zbatimin e punimeve të terren.*
Në SHpjegimet e dhënë me Shkresën nr. 2085/102, datës 22.05.2017 (ardhur në KLSH me datë 23.05.2017) të ish punonjësve M. Z.j dhe L.M. dhe S.R., sqarojmë se nuk argumentojmë problemin e trajtuar nga grupi i auditimit, pasi është detyrë e NJHD vendosje e kritereve në

zbatim të dispozitave të LPP dhe akteve ligjore e nënligjore në zbatim të tij, duke mos vendosur kritere të cilat janë përjashtues për shumë operatore ekonomik, duke u bazuar në fondin limit të vënë në dispozicion, zërat të preventivit dhe objektin që do prokurohet, dhe nuk janë kushtet gjeologjike- dhe periudhën në të cilën bëhet prokurimi. ***Argumenti juaj nuk merret në konsideratë.***

C- Zhvillimi i procedurës: Nga KVO nuk është mbajtur procesverbal për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit teknik të pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi, por është kaluar direkt në hartimin e raportit përmbledhës në të cilën janë përcaktuar hapat e ndjekur nga ky komision, veprime në kundërshtim me zbatim të nenit 52, të LPP dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu **V-** "Zhvillimi i procedurave", pika 4 germa (i)**.**
Sipas raport përmbledhës nr. 513/10, datë 18.08.2014, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kamë marrë pjesë 3 OE, sipas pasqyrës:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	"H.K. "&"S"	9,000,990	**Kualifikohet**
2	"B. B"	5,914,750	S'kualifikohet
3	"SH & F"	7,495,550	S'kualifikohet

Në përfundim anëtarët e KVO nga 3 OE kanë fituar të drejtën e kualifikimit vetëm **një** OE, konkretisht BOE "H.K. "&"Spartaku" me vlerë oferte **9,000,990 lekë pa TVSH.**, i cili plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike të vendosura në DST nga AK, por **me vlerë oferte më të lartë se operatorët e tjerë pjesëmarrës,** kjo sipas KVO.

D- Auditimi i dokumentacionit ligjor administrativ të BOE të shpallur fitues "H.K. & S" SHPK.
Në auditimin e dokumentacionit ligjorë të paraqitur nga fituesi BOE "H.K. & S" në dosjen dhe sistemin **www.app.gov.al,** konstatohet se ky BOE **nuk i plotëson të gjitha** kriteret e vendosura në DST nga AK, konkretisht:
*-Subjekti "**H.K.**" nuk plotëson pikën **12 të DST**, kryesisht licencat e punimeve për kategoritë (NP-1F; NP-2B; NP-5 & NP-9), ku sipas kontratës së baSHkëpunimit nr. 1863rep/492kol, datë 12.08.2014, ky subjekt do mbulojë 60% të punimeve të cilat lidhen me SHtresë çakulli, mbeturina, gërmim dheu, shtresë me rërë bituminoze;*
-Subjekti "S" nuk ka deklaruar inxhinier ndërtimi me licencë, sipas pikës 9, të pikës 2.3- Kapacitet teknik;
-Subjekti "S" nuk ka depozituar sigurimin e ofertës me afat 150 ditë;
-Subjekti "H.K." nuk disponon asnjë nga certifikatat ISO (99001:2008; 14001-2004;18001:2007), duke qenë në faktet që subjekti kryesore sipas kontratës së baSHkëpunimit nr. 1863rep/492kol, datë 12.08.2014, i cili do mbulojë 60%.
-Për dy subjektet "H.K. & Spartak" SHPK, nuk është marrë vërtetimi për taksat vendore për vitin 2013 dhe sipas kushteve të përcaktuar në DST, ***brenda 10 ditëve,*** *konkretisht;*

E-Auditimi i dokumentacionit të subjekteve të s'kualifikuar: Nga KVO janë s'kualifikuar dy subjektet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, me të vetmen mungesë në

dokumentacion, mos paraqitjen e vërtetimit të energjisë elektrike, kjo sipas shtojcës shtesë (kujtesë) të DST, paraqitur me Shkresën nr. 513/6, datë 24.07.2014**,** *konkretisht subjektet*:
a-OE "B-B" me vlerë oferte 5,914,750 lekë
b-BOE "SH & F" me vlerë oferte 7,495,550 lekë.
Nga sa SHihet të dy këto OE kanë oferta ekonomike më të ulët se operatori fitues.
Konkluzion: KVO **nuk duhej të kualifikonte BOE "H.K. & S"** SHPK, pasi **nuk plotëson kriteret e kualifikimit të miratuara nga vetë AK,** por nisur nga fakti se të dy operatorët ekonomik kanë mangësi në plotësimin e kritereve të DST, KVO duhet të vlerësonte kriterin kryesorë që është çmimi i leverdishëm të subjektit "B-B" me vlerë oferte 5,914,750 lekë", të cilat nuk ndikojnë në zbatimin e projektit, veprim me efekt negativ me dëm në buxhet për vlerën **3,085,240 lekë** (9,000,990 – 5,914,750), dhe në referencë të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4, **çka ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga D.B. me funksion ish-Përgjegjës i Zyrës së AMT (kryetar), dhe anëtarë J.S. me funksion Specialist Finance arkëtar dhe K.B. *anëtar.***

Komente dhe sqarime**: Për sa SHpjegoni në Shkresën nr. 2085/118, datë 26.05.2017 (prot KLSH nr. 276/9, datë 31.05.2017), problemet e trajtuara nuk argumentojnë problematikën e trajtuar nga grupi i KLSH, pasi nga ana juaj është sqaruar vetëm fakti i s'kualifikimit të OE "B", gjë për të cilën grupi nuk e ka kontestuar, por nisur nga fakti se dhe operatori fitues ka mangësi të cilat nuk përputhet me disa nga kriteret e DST, për të cilën KVO duhet të vlerësonte kriterin kryesore që është çmimi i ofertës duke SHpallur fitues operatorin me çmim më të leverdishëm, që në rastin konkret është OE 'B". **Argumenti nuk merret në konsideratë.

4- Tenderi me objekt "*Rikonstruksion i rrugëve të brendSHme "Driza", "SHpata", "Fasko" në fshatin Radostinë, Komuna Dërmënas*", me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 234, datë 01.04.2015. Fondi limit 1,777,365 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 234, datë 01.04.2015 S.R. *kryetar*, Melida Zjaci & L.M. *antar*	KVO me urdhrin nr. 1, dt. 7.04.2015 D.B. *kryetar*, K.B. & J. S..
Procedura e prokurimit – Me buxhetin e SHtetit Burimi fin. Nga buxheti SHtetit.	Fitues "H.K. "SHPK	Vlera fituese 1,524,042 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 22.04.2015.	Dif nga fondi limit 253,323 lekë.	Kontrata nr.234/15, datë 14.05.2015.
Marrin pjesë **5** OE S`kualifikuar **1** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 234/12, datë 7.05.2015,	Vlera e kontratës 1,828,850 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 30 ditë	Titullar i AK – V. F.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Në dosje ndodhet preventivi hartuar nga ing. L.M. me vlerën 1,777,365 lekë (pa TVSH.),projekt i cili nuk është nënshkruar nga ana e ish-Kryetarit si dhe verifikuar nga ish-Zyra PZHT.

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me procesverbalin nr. 1, datës 01.04.2015. Kriteret e vendosura nga NJP janë të pranueSHme për vetë vlerën e investimit që po kryhet, këSHtu që nuk ka mangësi në përcaktimin e kritereve**.**

C- Zhvillimi i procedurës: Nga KVO nuk është mbajtur procesverbal për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit teknik të pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi, por është kaluar direkt në hartimin e raportit përmbledhës në të cilën janë përcaktuar hapat e ndjekur nga ky komision, veprime në kundërshtim me zbatim të nenit 52, të LPP dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu **V-** "*Zhvillimi i procedurave*", pika 4 germa (i)**.**
Sipas raport përmbledhës nr. 234/11, datë 07.5.2015, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi kamë marrë pjesë 5 OE, sipas pasqyrës:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1.	"S"	1,316,510	S'kualifikuar
2.	"H.K. "&"S"	1,524,042	**Kualifikohet**
3.	"SH"	1,685,042	kualifikohet
4.	"I"	1,540,400	kualifikohet
5.	"2Z K"	1,647,800	kualifikohet

Në përfundim anëtarët e KVO nga 5 OE kanë fituar të drejtën e kualifikimit vetëm **një** OE, konkretisht BOE "H.K." me vlerë oferte **1,524,042 lekë pa TVSH.**, i cili plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike të vendosura në DST nga AK, por **me vlerë oferte më të lartë se operatorët e tjerë pjesëmarrës,** kjo sipas KVO.

D-Auditimi i dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës.
- Auditimi i dokumentacionit të OE fitues **"H.K." me vlerë oferte 1,524,042 lekë pa TVSH.,** konstatohet se ky operator nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe miratuara nga AK, konkretisht ky operator nuk plotëson këto kërkesa*:*
a-Bilanci financiar i vitit të fundit (2014), nuk është i certifikuar nga organet tatimore, siç kërkohet në pikën 2.2.5, të DST;
b-Nuk ka paraqitur Listpagesat e periudhës 2014-2015 të punonjësve, siç kërkohet në pikën 2.2.1, të DST;
c-Nuk paraqet vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore, sigurimet shoqërore e shëndetësore nga administrata tatimore për vitin 2014, siç kërkohet në pikën 2.2.2, të DST;
d-Nuk ka paraqitur kopjen e deklaratave të xhiros jo më të vogël se vlera e fondit limit objekt prokurimi, siç përcaktohet në pikën 2.2.6 të DST.
Në këto kushte ky operator nuk duhej kualifikuar.
- Auditimi i operatorit të s'kualifikuar **"S"** me vlerë oferte **1,316,510 lekë,** konstatohet se:
a-KVO e ka s'kualifikuar këtë operator pasi 3 kontrata qiraje në lidhje me shtojcën 9, nuk janë të noterizuar, ***fakt i cili qëndron.***
b-*KVO e ka s'kualifikuar pasi ka mospërputhje midis asaj çka deklarohet në shtojcën 9 (mbi dispononi e makinerive) dhe dokumenteve të paraqitur nga operatori**. Nga verifikimi rezulton se ky* ***pretendim nuk qëndron,*** *pasi nga verifikimi i dokumenteve të paraqitur dhe depozituar në sistemin app.gov.al, operatori i disponon të gjitha dokumentet që ka deklaruar në SHtojcën nr. 9.*
Konkluzion: KVO **nuk duhej të kualifikonte OE "H.K."** SHPK, pasi **nuk plotëson kriteret e kualifikimit të miratuara nga vetë AK,** por nisur nga fakti se OE "S" me vlerë oferte 1,316,510 lekë, dhe mangësi të cilat klasifikohen si gabime të vogla nuk ndikojnë në procesin e zbatimit të projektit, duke qenë se ka paraqitur si ofertë ekonomike një vlerë më të

ulët se operatori fitues prej **207,532 lekë** (1,316,532 – 1,524,042), dhe në referencë të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 1, "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4. Veç kësaj, KVO ka vepruar me **dy standarte** pasi ka kualifikuar e SHpallur padrejtësisht fitues ofertën e **OE "H.K."**, me vlerë më të lartë dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit (DST), **c'ka ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga D.B. me funksion ish-Përgjegjës i Zyrës së AMT (kryetar), dhe anëtarë J.S. me funksion Specialist Finance arkëtar dhe K.B. *anëtar.***

5- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2014 për nevojat e Komunës Dërmënas".*

Urdhër prokurimi nr. 2, datë 28.05.2014. Fondi limit 683,267 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 2, datë 28.05.2014 S.R. *Kryetar*, S.S. & L.M. *anëtar*	KVO me urdhrin nr. 1, datë 30.05.2014 D.B. *Kryetar*, J. S. & K.B. *anëtar*
Procedura e prokurimit –HAPUR, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "G K P" SHPK	Vlera fituese 683,267 lekë pa TVSH.,
Dt e hapjes së tenderit 16.06.2014.	Dif nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr. 359/16, datë 02.07.2014.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 26.6.2014,	Vlera e kontratës 819,920 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 210 ditë	Titullar i AK – V. F.

A- ParaSHikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparSHme ose testimin e tregut.

Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna Dërmënas për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 683,267 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi **Titullari i AK z. V. F. dhe NJP e përbërë nga S.R. me funksion Juriste, S.S. me funksion Përgj i Zyrës së Urbanistikës dhe L.M. me funksion specialiste në zyrën e urbanistikës.**

Komente dhe sqarime. *Në SHpjegimet e dhënë me Shkresën nr.2085/102, datës 22.05.2017 (ardhur në KLSH me datë 23.05.2017) të ish punonjësve S.R., M. Z. dhe L.M., sqarojmë se nuk argumentojmë problemin e trajtuar nga grupi i auditimit, pasi në referencë të VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, është NJP organi i cili duhet të argumentojë fondin limit të hedhur në procedurë prokurimi.* ***Argumenti juaj nuk merret në konsideratë.***

B- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në Shpalljen e fituesit.

Me urdhër prokurimin nr. 2, datë 28.05.2014 është miratuar fondi limit për blerje karburanti me vlerë 683,267 lekë pa TVSH., me procedurë "Hapur".

Me procesverbal nr. 1, datë 28.05.2014 NJHD ka hartuar kërkesat ligjore dhe teknike për zhvillimin e procedurës "*Blerje karburanti për vitin 2014 për Komunën Dërmënas*" .

C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit*:* Nga KVO nuk është mbajtur procesverbal për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit teknik të pjesëmarrësve në këtë procedurë prokurimi, por është kaluar direkt në hartimin e raportit përmbledhës në të cilën janë përcaktuar hapat e ndjekur nga ky komision, veprime në kundërshtim me zbatim të nenit 52, të LPP dhe VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu V-"Zhvillimi i procedurave", pika 4 germa (i).
Raportit Përmbledhës është miratuar nga ana e Titullarit të AK me Shkresën nr. 359/13, datë 26.06.2014, ku konstatohet se ka marrë pjesë vetëm një OE , konkretisht OE "G K P" me ofertë 150.3 lekë/litri pa TVSH. ose me vlerë të plotë 683,267 lekë.

D- Auditimi i dokumentacionit ligjor administrativ të OE të SHpallur fitues "G K P" SHPK.
Në auditimin e dokumentacionit në sistemin **www.app.gov.al**, të paraqitur nga subjekti fitues OE "*G K P*", konstatohet se ky OE nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST nga AK, veprime në kundërshtim me pikën 3/b të Kreut III, të VKM nr. 01, datë 10.01.2007, i ndryshuar dhe rubrikën në seksionin III, seksionin IV.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, konkretisht:
-Nuk është paraqitur licenca profesionale miratuar nga Pushteti Vendor (BaSHkia/Komuna), në zbatim të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, te gazit dhe nënprodukteve te tyre. Në sistem nuk është i pasqyruar (pika 2.1.a);
-Nuk është vërtetim për SHlyerjen e taksave vendore për vitet 2013-2014 (pika 2.2.b);
Nuk është paraqitur kontrata të ngjaSHme në vlerën 40% e fondit dhe fatura e paraqitur në sistem është e vitit 2016 (pika 2.1.3).
Konkluzioni: Nga sa trajtuam më sipër, **KVO nuk duhej të kualifikonte OE të vetëm pjesëmarrës "G K P",** por duhej të anulonte procedurën dhe zhvillohej procedurë e re, pasi OE nuk plotëson kriteret ligjore të DST dhe miratuar nga AK, veprime në kundërshtim me nenin 46, 53 dhe 54, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi komisioni i KVO ***përbërë nga: D.B. me funksion Përgj/Zyrës së AMT, J.S. me funksion Specialist Finance arkëtar dhe K.B..***
(Gjerësisht trajtuar në faqen ---, të Projektraport Auditimit)

IX/5-5. Në ish Komunën Topojë.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) Komuna Topojë, për periudhën objekt auditimi janë kryer **4 procedura** prokurimi me fond limit në vlerën 10,783,292 lekë, me procedurë "*Kërkesë me propozim*". Diferenca nga fondi limit në total është për vlerën 1,097 mijë lekë ose 10.1 % nga vlera e fondit limit. Në këto procedura prokurimi kanë marrë pjesë **7** operatorë ekonomikë (OE) dhe janë s'kualifikuar **3**, sipas pasqyrës si vijon:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	OE		Vlera Fituese (pa TVSH.)	Fituesi i procedurës	Kontrata		
				Pjesëmarrës	S'kualifikuar			Data	Vlera me TVSH.	Afati
1.	Blerje karburanti 2013	1,416,666	KP	1	0	1,350,000	A-1	Nr. 82/8,	1,692,000	300

						(7.22)		dt. 11.6.2013		
2.	Blerje karburanti 2014	1,400.000	KP	1	0	1,400,000 (12.6)	A-1	Nr. 157/12, dt. 9.5.2014	1,680,000	300
3.	Rikonstruksion rrugës Topojë - Fushë	4,166,626	KP	2	1	4,051,325	"B-B"	Nr. 288/15, dt. 16.7.2014	4,861,590	45
4.	Ndërtim kopshti Grykë	3,800,000	KP	3	2	2,884,784	"B-B"	Nr. 364/14, dt. 18.8.2014	3,461,741	30
	SHuma	**10,783,292**		**7**	**3**	**9,686,109**			**11,623,308**	**675**

Nga grupi i auditimit u audituan **4 procedura** prokurimi me vlerë të fondit limit prej **10,783,292** lekë ose 100 % e fondit limit, nga ku rezultojë se:

1- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2013 për nevojat e Komunës Topojë".*

Urdhër prokurimi nr. 2, datë 15.03.2013. Fondi limit 1,416,666 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 2, datë 15.03.2013 A.M. *Kryetar*, J.Xh & L.Xh. *antar*	KVO me Shkresën nr. 82/1, datë 15.03.2013 E.M. *Kryetar*, A.M. & P. C. *antar*
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "A-1"SHpk	Vlera fituese 1,350,000 pa TVSH. (me marxhë 7.22 %),
Dt e hapjes së tenderit 03.04.2013.	Dif nga fondi limit 66,666 lekë.	Kontrata nr. 82/8, datë 11.06.2013.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 82/4, dt. 3.5.2013,	Vlera e kontratës 1,620,000 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 270 ditë	Titullar i AK – A.V.

Nga auditimi konstatojmë se:

A-ParaSHikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.

Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 1,416,666 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, ***për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP i përbërë nga A.M. me funksion specialist në Zyrën e PZHT J. M. me funksion ish P/Zyrës së Taksave & z. L.Xh. me funksion inspektor i taksave (mesëm).***

B- **Zbatimi i procedurave të prokurimit.** Nga titullari i AK është lëshuar urdhër prokurimi nr. 2, datë 15.03.2013 me vlerë të fondit limit 1,416,666 lekë pa t.v.SH.

Me *procesverbal nr. 1, datë 15.03.2013*, NJP ka hartuar dokumentet teknik dhe ligjorë mbi procedurën e blerjes së mallrave "*Kërkesë me propozim*" për artikullin "Blerje karburanti".

Me procesverbal nr. 2, datë 15.03.2013, NJP ka bërë njoftimin për pjesëmarrje në tender nda je 5 OE , respektivisht: *"SH.", "R.", "V. P.", "K. I." dhe "B. B".*

Me procesverbal nr. 3, datë 03.04.2013 dhe nr. 5, datë 02.05.2013 është bërë hapja e procedurës dhe Shqyrtimi i ofertave të paraqitura nga operatorët pjesëmarrës, ku konstatohet se ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht "A.-1".

Pas Shqyrtimit të dokumentacionit ligjorë e teknik, nga KVO është konstatuar se ky OE i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe miratuara nga AK. Në këto kuSHte ky OE është

SHpallur fitues me vlerë oferte marzh fitimi 7.22 % ose 10.84 lekë/litri dhe vlerë 1,350,000 lekë.

Me procesverbal nr. 6, datë s'ka është bërë marrja në dorëzim e dokumenteve të operatorit të vetëm të paraqitur në tender "A.-1". Nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës në të cilën është pasqyruar e gjithë procedura e ndjekur deri në Shpalljen e fituesit, raport i cili është **nuk miratuar nga ana e Titullarit të AK me vendim.**

Me Shkresën nr. 113, datë 11.04.2013 të Kryetarit të AK z. A.V. adresuar APP, është kërkuar ndihme për hapje dokumenti, pasi oferta ekonomike e subjektit nuk hapej. Me Shkresën nr. 4337/1, datë 18.04.2013 të APP është konfirmuar se një nga anëtarët e KVO duhej të paraqitej në zyrat e APP për të asistuar në hapjen e dokumentit dhe procedurën se si veprohej.

C- Auditimi i dokumenteve të operatorit fitues. Në Shqyrtimin e dokumenteve të operatorit fitues nga sistemi www.app.gov.al, konstatohet se ky OE nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST dhe miratuara nga AK, pasi:

-Nuk plotëson pikën 2.2.a "OE duhet të paraqes kontrata të ngjaSHme të së njëjtës natyrë (karburante të ndrySHme e nënprodukte të naftës), të SHoqëruar me fatura. ***Nga OE janë paraqitur vetëm faturat të pashoqëruar me kontrata;***

-Nuk është plotësuar pika 2.2.b, për xhiron e vitit 2012 e cila duhet të jetë jo më e ulët se 1,400,000 lekë;

-Nuk është plotësuar pika 2.2 "Pika e SHitjes së karburantit të ndodhet brenda juridiksionit territorial të Komunës Topojë Fier ose nuk duhet të jetë më larg se 13 km nga vendodhja e Komunës Topojë Seman". **Nuk ka asnjë dokument që tregon se pika e karburantit është brenda ose në distancë prej 13 km nga Komuna Topojë.**

-Nuk është plotësuar pika 2.1.3.a, pasi nuk është paraqitur autorizim (licencë) stacioni i SHitjes së karburanteve, në referencë të neneve 15, 17 dhe 18 të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999;

Konkluzioni: Në këto kuSHte KVO**, nuk duhej të kualifikonte OE "AGA-1"**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit në DST të miratuara nga vetë AK, por duhej të anulonte procedurën e prokurimit dhe të vijonte me procedurë të tjetër prokurimi, nenin 2"Parimet e përzgjedhjes", nenin 24"Anulimi i një procedure prokurimi" dhe neni 46,të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ***veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët e KVO i përbërë nga: E.M. me funksion P/Zyrës Urbanistike, A. M. me funksion ish Inspektor në Sektorin e Urbanistikës dhe P. C. me funksion ish P/Sektorit të Financës***

2-Tenderi i zhvilluar me objekt: ***" Rikonstruksion i Rrugës Topojë-Shen Pjeter, Komuna Topojë, Seman, Fier"***, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 14, datë 06.06.2014 Fondi limit 4,166,626 lekë, Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim	NJHDT me urdhrin nr. 14, datë 06.06.2014, i përbërë nga: A.M. *Kryetar;* T. L. & G. P. *Antar*	KVO, me urdhër nr. 14, datë 06.06.2014, i përbërë nga: J.M. *Kryetar;* A.M. & P.C
Burimi i Financimit: buxheti i SHtetit & të ardhurat e komunës	Fitues "B. B" SHPK	Vlera fituese 4,051,325 lekë pa TVSH.,
Datë e hapjes së tenderit 20.06.2014	Diferenca nga fondi limit prej 115,301 lekë	Kontrata nr. 288/15, datë 16.07.2014
Marrin pjesë 2 OE S`kualifikuar 1 OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 06.06.2014.	Vlera e kontratës 4,861,590lekë me TVSH..
Ankimime në AK - 1 Ankimime në KPP - ska	Afati kontratës 45 ditë	Titullar i AK – A.V.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Në dosje ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara nga "E." SHPK, me vlerën pa TVSH. **4,166,626 lekë,** të miratuar nga ana e Titullarit të AK z. A. V.**.** Nuk ka akt-marrëveshje me subjektin për hartimin e këtij preventivi ku të përcaktohen modalitet në lidhje me koston e tij dhe kryerjen e pagesave.
Projekti nuk është bërë hyrje në magazinë si dhe nuk është bërë dalje për Drejtorinë e Urbanistikës (sot PZHT), veprim në papajtueshmëri me UMF nr. 30, datë 27.12.11, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Nga ana e studio "E" SHPK, nuk janë përcaktuar dhe argumentuar kategoritë e licencës, llojet e makinerive si dhe numri i fuqisë punëtore që duhet për realizimin e objektit. Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk ka asnjë dokumentim nga ana e AK, veprim në papajtueSHmëri me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1.
Për sa më sipër mban përgjegjësi: NJHDT e përbërë nga: z. A.M. me funksion specialist në Zyrën e PZHT, T.L. me funksion ish-P/Zyrës së Financës dhe G.P. me funksion ing/PyjeSH.

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Me procesverbal nr. 1, datë 06.06.2014 janë hartuar dokumentet e tenderit në të cilën janë përcaktuar kriteret e përgjithSHme dhe të veçanta të kualifikimit të OE, ku nga verifikimi konstatohet se këto kërkesa nuk janë të analizuara dhe në përputhje me zërat e preventiv.
Për përcaktimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, është vepruar në papajtueSHmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (c, ç & d), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa (a, b & c), në të cilën thuhet "*AK duhet të SHmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e OE, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontratktorëve ose ndaj kategorive të tyre*, VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V-*Zhvillimi i procedurës*, pika 2- *Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*, si dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që uSHtrojnë veprimtari ndërtimi", pasi nuk ka asnjë argumentim dhe nuk justifikohen me volumet e punës kërkesat teknike ekonomike (kategoritë e licencës, numrin e punëtorisë, numrin dhe llojin e mjeteve, etj.), të përcaktuara nga NJHDT, pasi:

- ***a-*** *Punësimi mesatar prej 35 punonjësish duke përfshirë dhe stafin e përhershëm, sipas preventivit dhe manualit të çmimeve dhe afatit kohorë është shumë I lartë dhe me qëllim mos lejimin pjesëmarrje e OE të tjerë*;
- ***b-*** *Vërtetimi i lëshuar nga Komuna Topojë është kriter i paargumentuar, pasi ky dokument mund të merret tek njësia vendore që subjekti ka selinë dhe jo në njësinë ku zhvillohet aktiviteti, në kundërshtim të hapu me ligjin e prokurimit dhe nuk ka bazë ligjore me qëllim për të SHmangur konkurrencën.*

Sa me sipër mban përgjegjësi, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: NJHDT e përbërë nga: A.M. me funksion specialist në Zyrën e PZHT, T.L. me funksion ish-P/Zyrës së Financës dhe G.P. me funksion ing/PyjeSH.

C- Zhvillimi i procedurave: Me procesverbal nr. 2, datë 06.06.2014 të hartuar nga anëtarët e NJP dhe KVO janë ftuar të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi 5 OE, konkretisht: *"P.*

V."; "S. & L."; "N."; "N./L" dhe "B. B", kjo në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 Për Rregullat e Prokurimit Publik", pika 1, germa (ç) e kreut V.
Sipas procesverbalit nr. 3, datë 20.06.2014 kanë marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi 2 OE, konkretisht: "S." dhe "B. B", ku nga Shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se është s'kualifikuar OE "S." pasi nuk ka paraqitur ofertë dhe është kualifikuar OE i mbetur i vetëm "B. B" me ofertë **4,051,325 lekë.**
Me Shkresën datë 16.06.2014 nga subjekti "SH." është bërë ankesë në lidhje me kërkesat **diskriminuese që ka vendosur AK**, ku kjo e fundit me Shkresën nr. 310/1, datë 19.06.2014 ka kthyer përgjigje subjektit se ankesë e bërë është jaSHtë afateve kohore, të përcaktuara në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit privat", i ndryshuar, Kreu IX "Shqyrtimi ankesave".

D- Auditimi i dokumentacionit të OE të s'kualifikuar.
1. Operatori ekonomik "SH." SHPK është s'kualifikuar nga KVO për faktin se nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, **fakt i cili qëndron dhe s 'kualifikimi është i drejtë**.
E- Auditimi i dokumentacionit të OE të kualifikuar.
1. Në auditimin e dokumentacionit të OE të kualifikuar "B. B" SHPK, rezulton se ky OE nuk përmbuSH kapacitetin teknik (Pika 2.2.2). *Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik uSHtron aktivitet për vitet 2012, 2013 dhe 2014, shoqëruar me faturat e pagesës. Në rastet e baSHkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia.*
Ne baze te QKR kjo shoqëri ka ushtruar aktivitet ne Fier lagjja Bishanake, Rruga Skënderbeu nr. 8, për të cilën n**uk ka paraqitur vërtetim nga BaSHkia Fier.**
-Nuk përmbuSH pikën2.3.4. *Disponimi ose mundësia e sigurt e deponimit në pajisje / kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: Autobot uji copë 1 (një).*OE ka paraqitur një kontrate qiraje me nr.905Rep dhe nr.494 Kol e lidhur me datë 21.03.2014 për autobot uji me targa AA 365 IB **, por nga auditimi rezulton se për këtë mjete mungon policia e mjetit dhe certifikata e kontrollit teknik, siç kërkohet në DST.**
<u>Konkluzioni</u>: Në këto kuSHte KVO**, nuk duhej të kualifikonte asnjë nga OE**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit në DST të miratuara nga vetë AK, por duhej të anulonte procedurën e prokurimit dhe të vijonte me procedurë të tjetër prokurimi, nenin 2"Parimet e përzgjedhjes", nenin 24"Anulimi i një procedure prokurimi", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ***veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët e KVO i përbërë nga: J.M. me funksion ish P/Zyrës së Taksave, A.M. me funksion ish Inspektor në Sektorin e Urbanistikës dhe P.C me funksion ish P/Sektorit të Financës.***

3-Tenderi i zhvilluar me objekt: **"*1-Kat kopshti Gryke-Topojë*"**, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 18, datë 15.7.2014 Fondi limit 3,053,764 lekë, Procedura e prokurimit – tender kërkesë për propozim	NJHDT me urdhrin nr. 18, datë 15.7.2014 A.M. *Kryetar*, T.L. & G.P. *antar*	KVO, me urdhër nr. 18, datë 15.7.2014 J.M. *Kryetar*, A.M. & P.C *antar*
Burimi i Financimit: Nga te ardhurat + grandi	Fitues "B. B" SHPK	Vlera fituese 2,884,784lekë pa TVSH.,
Datë e hapjes së tenderit 28.07.2014	Diferenca nga fondi limit 168,979 lekë	Kontrata nr. 364/14, datë 18.8.2014
Marrin pjesë 3 OE S`kualifikuar 2 OE	Miratimi i procedurës me vendim nr.1, dt. 16.07.2014	Vlera e kontratës 3,461,741 lekë me TVSH..

Ankimime në AK - s`ka Ankimime në KPP - ska	Afati kontratës 45 dite	Titullar i AK – A.V.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Në dosje nuk ndodhet preventivi dhe projekti i hartuar i objektit "*1-Kat kopshti Gryke-Topojë*". Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1.

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbalin nr. 1, datë 16.07.2014, në të cilën janë përcaktuar kriteret e përgjithSHme dhe të veçanta për kualifikim.
C- Zhvillimi i procedurave: Tenderi është hapur me procesverbalin nr.2, datë 16.07.2014 në të cilën është vendosur dërgimi i ftesës për ofertë të 5 operatorëve ekonomik, si më poSHtë: *"P. V.", "S. & L.", "A. A. C.", "E./L" dhe "B. B".*
Me procesverbal nr. 3, datë 28.07.2014 është bërë hapja dhe vlerësimi i ofertave, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 3 OE , si vijon:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1.	"SH."	S'ka	S'kualifikuar
2.	"P. V.	2,337,330	S'kualifikuar
3.	"B. B"	2,644,803	**Kualifikuar**

D- Auditimi i dokumentacionit të OE të s'kualifikuar :
Me procesverbal nr. 4, datë 29.07.2014, KVO bëri hapjen dhe vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit teknik, nga ku rezulton se nga 3 OE janë s'kualifikuar 2 prej tyre, konkretisht: operatori "SH." i cili nuk ka ofertë ekonomike dhe operatori **"P. V.",** për arsye se:

-Nuk përmbuSH kriterin e DST (pika 2.1.1). Një vërtetim nga "CEZ SHpërndarje" SHa, ***fakt i cili qëndron****.*

-Nuk përmbush kriterin DST (pika 2.3.2) License profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pikat: ***NS14 dhe NS 19, fakt i cili qëndron****.*

-Nuk ka te punësuar inxhinier elektrik, teknik ndërtimi, teknik për sigurimin teknik dhe SHofer, ***fakt i cili qëndron.***

Në këto kushte vendimi për SHkualifikimin e këtyre 2 OE marrë nga KVO është i drejtë.

E- Auditimi i dokumentacionit të OE të kualifikuar:
Ne lidhje me OE të kualifikuar "B. B" SHPK, nga auditimi rezulton se OE përmbuSH të gjitha kërkesat e DST.

4- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2014 për nevojat e Komunës Topojë".*

Urdhër prokurimi nr. 4, datë 01.04.2014.	NJHDT sipas urdhrit nr. 4, datë 01.04.2014	KVO me Shkresën nr. 4, datë 01.04.2014
Fondi limit 1,400,000 lekë	A.M. *Kryetar*, T.L. & G.P. *antar*	J.M. *Kryetar*, P.C dhe A.M. *antar*

Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "A-1"SHpk	Vlera fituese 1,400,000 pa TVSH. (me marxhë 12.6 %,
Dt e hapjes së tenderit 14.04.2014.	Dif nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr. 157/12, datë 09.05.2014.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. 1, datë 01.04.2014,	Vlera e kontratës 1,680,000 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 230 ditë	Titullar i AK – A.V.

A- Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparSHme ose testimin e tregut.
Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna Topojë për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 1,400,000 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1.

B- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në Shpalljen e fituesit.
Nga titullari i AK është lëshuar urdhër prokurimi nr. 1, datë 01.04.2014 me vlerë të fondit limit 1,400,000 lekë pa t.v.SH.
Me Shkresën nr. 157/1, datë 01.04.2014 (*procesverbal nr. 1, datë 14.04.2014*) NJP ka hartuar dokumentet teknik dhe ligjorë mbi procedurën e blerjes së mallrave "*Kërkesë me propozim*" për artikullin "Blerje karburanti", ku me vendim nr. 1, datë 01.04.2014 të titullarit të AK është miratuar procedura dhe kërkesat e tenderit.
Me procesverbal nr. 157/6, datë 05.04.2014, NJP ka bërë njoftimin për pjesëmarrje në tender ndaj 5 OE , respektivisht: *"R", "A-1", "V. P", "O" dhe "R. P."*.
Me procesverbal nr. 3, datë 12.05.2014 është bërë hapja e procedurës dhe Shqyrtimi i ofertave të paraqitura nga operatorët pjesëmarrës, ku konstatohet se ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht "A.-1".
Pas Shqyrtimit të dokumentacionit ligjorë e teknik, nga KVO është konstatuar se ky OE i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe miratuara nga AK. në këto kuSHte ky PE është SHpallur fitues me vlerë oferte marzh fitimi 14 lekë/litri dhe vlerë 1,400,000 lekë.
Nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës në të cilën është pasqyruar e gjithë procedura e ndjekur deri në Shpalljen e fituesit, raport i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK me vendim nr. 2, datë 29,08,2014.

C- Auditimi i dokumenteve të operatorit fitues. Në Shqyrtimin e dokumenteve të operatorit fitues nga sistemi www.app.gov.al, konstatohet se nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST dhe miratuara nga AK, pasi:
-Nuk është plotësuar pika 2.2 "*Pika e SHitjes së karburantit të ndodhet brenda juridiksionit territorial të Komunës Topojë Fier ose nuk duhet të jetë më larg se 13 km nga vendodhja e Komunës Topojë Seman".* **Nuk ka asnjë dokument që tregon se pika e karburantit është brenda ose në distancë prej 13 km nga Komuna Topojë.**
Konkluzioni: Në këto kushte KVO**, nuk duhej të kualifikonte OE "A.-1"**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit në DST të miratuara nga vetë AK, por duhej të anulonte procedurën e prokurimit dhe të vijonte me procedurë të tjetër prokurimi, nenin 2"Parimet e përzgjedhjes", nenin 24"Anulimi i një procedure prokurimi" dhe neni 46,të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për

prokurimin publik", i ndryshuar, ***veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët e KVO i përbërë nga: J.M. me funksion ish P/Zyrës së Taksave, A.M. me funksion ish Inspektor në Sektorin e Urbanistikës dhe P.C me funksion ish P/Sektorit të Financës***

(Gjerësisht trajtuar në faqen ---, të Projektraport Auditimit)

IX/5-6. Në ish Komunën Qendër.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) Komuna Qendër, për periudhën nga 01.01.2014 deri më 31.07.2015 janë kryer **9** procedura prokurimi me fond limit në vlerën **11,712,220** lekë me procedurë "*Kërkesë me propozim* (KP)". Diferenca nga fondi limit në total është për vlerën 346 mijë lekë ose 2.9 % nga vlera e fondit limit.

Në këto procedura prokurimi kanë marrë pjesë **14** operatorë ekonomikë (OE) dhe janë s'kualifikuar 2, sipas pasqyrës si vijon:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	OE		Vlera Fituese (pa TVSH.)	Fituesi i procedurës	Kontrata		
				Pjesëmarrës	S'kualifikuar			Data	Vlera me TVSH.	Afati ditë
1.	Sistemim SH SHtrim i rrugës kodrinore të parcelave fSHati Radistin Vadhiz segmenti I (1100 ml)	1,826,000	KP	1	0	1,815,200	"S."	Nr. 706/16, dt. 3.11.14	2,178,240	30
2.	Sistemim SH SHtrim i rrugës kodrinore të parcelave fSHati Radistin Vadhiz segmenti I (530 ml)	839,000	KP	1	0	827,700	"S."	Nr. 707/16, dt. 3.11.14	933,240	20
3.	Rikon rrugës dhe SHeSHit të varrezave fSHati Grecalli	1,210,000	KP	4	1	986,620	"SH & F"	Nr. 505/17, dt. 5.8.14	1,189,944	21
4.	Rikon rrugës dhe SHeSHit të varrezave fSHati Grecalli (vazhdim)	634,220	KP	1	0	620,390	"S."	Nr. 662/17, dt. 20.10.14	744,468	4
5.	Rikon i rrugës dhe SHeSHit të varrezave në fSHatin Daullas	941,000	KP	1	0	940,180	"S."	Nr. 696/16, dt. 28.10.14	1,128,216	20
6.	Rikonstruksion Lapidareve fSHati Grecalli	808,000	KP	2	1	722,650	"V/F"	Nr.481/15, dt. 21.7.14	867,180	60
7.	Blerje uSHqime për konviktin e SHkollës së Mesme "Rakip Kryeziu"	1,413,000	KP	1	0	1,411,750	"M.C.C"	Nr. 128/16, dt. 2.4.2014	1,694,100	270
8.	Blerje karburanti viti 2014	2,791,000	KP	2	0	2,791,000	"B.-O."	Nr. 129/16, dt. 3.4.2014	3,041,949 (12.6 mzh)	270
9.	Blerje karburanti viti 2014	1,250,000	KP	1	0	1,250,000	"B.-O."	Nr. 165/17, dt. 31.3.2015	1,500,000 (8 mzh)	270
SHUMA		**11,712,220**		**14**	**2**	**11,365,490**			**13,638,588**	**966**

Nga ana e grupit të KLSH, u bë i mundur auditimi i **9 procedurave** (nga 9 të tilla), me vlerë totale të fondit limit prej 11,712,220 lekë dhe vlerë kontrate 11,365,490 lekë me një diferencë të fondi limit prej 346 mijë lekë ose 2.9%. Në procedura konstatohet se:
Dy procedurat e blerjes së karburantit nuk kanë probleme në zbatim të ligjit si në fazën e planifikimit të fondit limit, të vendosjes së kritereve po ashtu dhe të zhvillimit të procedurës. Ndërsa procedurat e tjera po i trajtojmë si vijon:

1- Tenderi me objekt "*Sistemim dhe shtrim me zhavorr mali i rrugës kodrinore të parcelave në fshatin Radostin dhe radistin – Vadhizë, Segmenti 1 (1100 ml)"*, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 9, datë 26.09.2014. Fondi limit 1,826,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 9, datë 26.09.2014 A.M. *Kryetar,* J.G. & M.S. *antar*	KVO me Shkresën 9/1, datë 06.10.2014 E.Q. *Kryetar,* O.Gj. & E.Gj.*antar.*
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Nga të ardhurat e komunës.	Fitues "SHENDELLIA" SHPK	Vlera fituese 1,815,200 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 14.10.2014.	Dif nga fondi limit 10,800 lekë.	Kontrata nr. 706/16, datë 03.11.2014.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 706/5, dt. 26.09.2014 (vendim nr. 1, dt. 26.09.2014)	Vlera e kontratës 2,178,240 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 30 ditë	Titullar i AK – H.M.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 09.05.2013 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*kërkesë për propozim*".
Në dosje ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara nga ing. E.Gj..

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me procesverbalin nr. 1, datës 26.09.2014. Nga krahasimi i preventivit të hartuar me zërat e preventivit të DT nuk rezultuan diferenca në volume për më pak AK**.**

C- Zhvillimi i procedurës: Me Shkresën nr. 706/7, datë 27.09.2014 të titullarit të AK është miratuar procedura e ftesës së 5 OE pjesëmarrës sipas procesverbalit të hartuar nga NJP, duke ftuar në këtë procedurë prokurimi, respektivisht: "*V./F", "A", "SH", "F" dhe "2Z K".*
Me procesverbal nr. 3, datë 14.10.2014 të hartuar nga anëtarët e KVO është bërë hapja dhe Shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht subjekti "SH" me vlerë oferte **1,815,200 lekë.**
Në përfundim KVO dhe Shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se OE ka fituar të drejtën e kualifikimit, pasi plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike të vendosura në DST nga AK, kjo sipas KVO.
Nga Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, konstatohet se nuk ka mangësi në kërkesat e paraqitura dhe Shpallja e fituesit është në përputhje me LPP.

2- Tenderi me objekt *"Sistemim dhe shtrim me zhavorr mali i rrugës kodrinore të parcelave në fshatin Radostin dhe radistin – Vadhizë, Segmenti II (530 ml)"*, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 10, datë 26.9.2014. Fondi limit 839,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 10, datë 26.9.2014 A.M. *Kryetar,* J.G. & M.S. *antar*	KVO me Shkresën nr. 10/1, datë 06.10.2014 E.Q. *Kryetar,* O.Gj. & E.Gj.*antar.*
Procedura e prokurimit – Kërkesë me	Fitues "SH" SHPK	Vlera fituese 827,700 pa TVSH..

propozim, Burimi fin. Nga të ardhurat e komunës.		
Dt e hapjes së tenderit 14.10.2014.	Dif nga fondi limit 11,300 lekë.	Kontrata nr. 707/16, datë 03.11.2014.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 707/5, dt. 26.09.2014 (vendim nr. 1, dt. 26.09.2014)	Vlera e kontratës 993,240 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 20 ditë	Titullar i AK – H.M.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 26.9.2014 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*Kërkesë për propozim*".
Në dosje ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara nga ing. E.Gj..
B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me procesverbalin nr. 1, datës 26.09.2014. Nga krahasimi i preventivit të hartuar me zërat e preventivit të DT nuk rezultuan diferenca në volume për më pak AK**.**

C- Zhvillimi i procedurës: Me Shkresën nr. 707/7, datë 27.09.2014, Titullari AK ka miratuar procedura e ftesës së 5 OE pjesëmarrës sipas procesverbalit të hartuar nga NJP, duke ftuar në këtë procedurë prokurimi, respektivisht: "*V./F", "A", "SH", "F" dhe "A C".*
Me procesverbal nr. 3, datë 14.10.2014 të hartuar nga anëtarët e KVO është bërë hapja dhe Shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht subjekti "SH" me vlerë oferte **827,700 lekë.**
Në përfundim KVO dhe Shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se OE ka fituar të drejtën e kualifikimit, pasi plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike të vendosura në DST nga AK, kjo sipas KVO.
Nga Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, konstatohet se nuk ka mangësi në kërkesat paraqitura dhe Shpallja e fituesit është në përputhje me LPP.

3- Tenderi me objekt "*Rikonstruksion i rrugës së varrezave në fSHatin Grecalli*", me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 6, datë 30.6.2014. Fondi limit 1,210,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 10, datë 26.9.2014 A.M. *Kryetar*, J.G. & M.S. *antar*	KVO me Shkresën nr. 6/1, datë 7.7.2014 E.Q. *Kryetar*, O.Gj. & E.Gj.*antar.*
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Nga të ardhurat e komunës.	Fitues "SH & F" SHPK	Vlera fituese 986,620 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 14.7.2014.	Dif nga fondi limit 223,380 lekë.	Kontrata nr. 505/17, datë 5.8.2014.
Marrin pjesë 4 OE S`kualifikuar 1 OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 505/5, dt. 30.6.2014 (vendim nr. 1, dt. 30.6.2014)	Vlera e kontratës 1,183,944 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 21 ditë	Titullar i AK – H.M.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 30.6.2014 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*Kërkesë për propozim*".
Në dosje ndodhet preventivi i hartuara nga ing. E.Gj..

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me procesverbalin nr. 1, datës 26.09.2014. Nga krahasimi i preventivit të hartuar me zërat e preventivit të DT nuk rezultuan diferenca në volume për më pak AK**.**

C- Zhvillimi i procedurës: Me Shkresën nr. 505/7, datë 01.7.2014, Titullari AK ka miratuar procedura e ftesës së 5 OE pjesëmarrës sipas procesverbalit të hartuar nga NJP, duke ftuar në këtë procedurë prokurimi, respektivisht: *"V./F", "A", "S", "F" dhe "A C".*
Me procesverbal nr. 3, datë 18.7.2014 të hartuar nga anëtarët e KVO është bërë hapja dhe Shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë 4 OE, konkretisht:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	"SH" & "F"	986,620	Kualifikohet
2	"V./F"	1,000,750	Kualifikohet
3	"N 1934"	1,000,040	Kualifikohet
4	"S"	839,200	**S'kualifikohet**

Në vlerësimin e dokumentacionit ligjor është s'kualifikuar OE "SARK' për faktin se sipas KVO nuk ka paraqitur vërtetimin e energji elektrike, kërkesë e DST, ndërsa 3 OE të tjera janë kualifikuar në fazën e vlerësimit të dokumentacionit ligjorë.
Me Shkresën nr. 505/11, datë 18.07.2014 është mbajtur Raporti Përmbledhës sipas LPP, në të cilën janë pasqyruar e gjithë procedura e zhvilluar, i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK me vendim nr. 2, datë 18.07.2014.
Në procesverbalin e hapjes së ofertave **nuk ka të dhëna nëse KVO ka kryer korrigjime matematikore për ofertat pa gabime,** në kundërshtim me Kreun V-*Zhvillimi Procedurës",* pika 4, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Sipas këtij raporti dhe vendimit të Titullarit të AK, fitues është SHpallur BOE "SH & F", me vlere oferte më të ulët se operatorët e tjerë prej 986,620 lekë, i cili është SHpallur në vend të parë. Ndërsa në vend të dytë është SHpallur OE "N 1934" me vlerë 1,000,040 lekë dhe në vend të tretë OE "V./F" me vlerë 1,000,750 lekë.

D- Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës.

1. Në Shqyrtimin e dokumentacionit të operatorit të s'kualifikuar "S" me ofertë ekonomike 839,200 lekë, konstatohet se ky operator është s'kualifikuar nga KVO për faktin se nuk ka paraqitur vërtetimin e energjisë elektrike, ndërkohë që vetë subjekti ka deklaruar se nuk ka kontrata ne OSHE, pasi objekti ku janë zyrat është me qira.

2. Në Shqyrtimin e dokumentacionit të subjektit të shpallur fitues nga KVO, BOE "SH& F" me ofertë 986,620 lekë, konstatohet se:
-Sipas dokumentacionit në sistemin **www.app.gov.al**, ky BOE nuk i plotëson të gjitha kriteret e miratuar në DST nga NJP, pasi sipas DST pika 2.2 "*Kapacitet teknik*", operatorët ekonomik duhet të paraqesin licenca profesionale të SHoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve në kontratë, si vijon:

a- Ing. Konstruktor
b-Teknik ndërtimi
c-Topograf

Në auditimin e dokumenteve, konstatohet se asnjë nga BOE nuk ka paraqitur dokumentacion për ing. Konstruktor, pasi licencat dhe diplomat që SHoqërojnë këto licenca nuk ka të specifikuar ing. Konstruktor por thjesht ing. Ndërtimi, ndërsa subjekti "F" nuk ka paraqitur "*Teknik ndërtimi".*

Konkluzion: Nisur nga sa mësipërm, KVO duhet të vlerësonte ofertën ekonomike me çmim më të leverdishëm, pasi si BEO i SHpallur fitues "SH & F" dhe OE "S" kanë mangësi të dokumenteve ligjorë të paraqitura sipas kërkesave të DST, veprime **efekt ekonomik negativ me dëm147,420 lekë** (986,620 – 839,200), **ç'ka ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga E.Q. me funksion ish Zv/Kryetar Komune, O.Gj. me funksion ish P/Zyrës Urbanistikës (sot PZHT) dhe E.Gj.me funksion ish inspektor i Zyrës së Urbanistikës,** veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa (a, b, c), duke shkaktuar pabarazi në vlerësimin e ofertave.

F- Lidhja e kontratës dhe dokumentacioni për respektimin e afateve kohore. Kontrata nr. 505/17, datë 05.08.2014, afati 21 ditë, ose deri më 26.08.2014, në SHumën 1,183,944 lekë me TVSH..

Komente dhe sqarime: *Në shpjegimet e paraqitura nga subjekti (ish Komuna Qendër)Shkresën nr. 2085/132, datë 13.06.2017 (paraqitur në KLSH nr. 276/12, datë 16.06.2017), në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt Rikonstruksion i rrugës së varrezave në fshatin Grecalli", merret në konsideratë fakti që subjekti "SH" nuk duhej të kualifikohej, pasi ka paraqitur vërtetimin nga OSSHE, datë 08.07.2014, citohet se ky operator është në proces ankimim që në datë 16.02.2012 me numër serie 136283. Në datën 08.07.2014 Gjykata e SHkallës së Parë Fier për këtë operator ka pranuar kërkesë padinë ndaj OSSHE dhe me vendimin nr. 1300 datë 11.11.2014 ky operator ka fituar të drejtën ndaj faturave të OSSHE dhe ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë.*

Nga ana juaj si ne kundërSHtitë tuaja po ashtu dhe në takimin përmbyllës të datës 19.06.2017 të zhvilluara në ambientet e KLSH në orën 10.oo, nuk argumentoni mos plotësimin e kriterit *sipas DST pika 2.2 "Kapacitet teknik", OE duhet të paraqesin licenca profesionale të SHoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve në kontratë, si vijon:*

a- Ing. Konstruktor
b-Teknik ndërtimi
c-Topograf

Në auditimin e dokumenteve, konstatohet se asnjë nga BOE nuk ka paraqitur dokumentacion për ing. Konstruktor, pasi licencat dhe diplomat që shoqërojnë këto licenca nuk ka të specifikuar ing. Konstruktor por thjesht ing. Ndërtimi, ndërsa subjekti "F" nuk ka paraqitur "Teknik ndërtimi".

Në këto kuSHte kur të dy subjektet pjesëmarrës kanë të mangësi në plotësimin e kritereve të DST, KVO duhet të vlerësonte kriterin kryesorë është çmimi i ofertës më të ulët, që në rastin konkret e ka OE "S"

Gjithashtu është argumentuar dhe fakti i mos llogaritjes së penalitetit, pasi në fazën e auditimit në dosjen nuk ndodhej amendament shtesë, por në shpjegimet e mëvonshme është paraqitur amendamenti i mataruar nga AK për SHtyrje të punimeve. ***Kështu që kamatëvonesa për 269,939 lekë nuk qëndron.***

4- Tenderi me objekt "*Rikonstruksion i rrugës së varrezave në fshatin Grecalli (vazhdim)*", me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 7, datë 12.09.2014.	NJHDT sipas urdhrit nr. 7, datë 12.09.2014	KVO me Shkresën nr. 7/1, datë 22 .09.2014
Fondi limit 634,220 lekë	A.M. *Kryetar*, J.G. & M.S. *antar*	E.Q. *Kryetar*, O.Gj. & E.Gj.*antar*.

Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Nga të ardhurat e komunës.	Fitues "SH" SHPK	Vlera fituese 620,390 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 26.09.2014.	Dif nga fondi limit 13,830 lekë.	Kontrata nr. 662/17, datë 20.10.2014.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 662/5, dt. 12.09.2014 (vendim nr. 1, dt. 12.09.2014)	Vlera e kontratës 744,468 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 4 ditë	Titullar i AK – H.M.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 12.09.2014 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*Kërkesë për propozim*".
Në dosje ndodhet preventivi i hartuara nga ing. E.Gj.. Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK z. H.M. dhe NJP.**

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me Shkresën nr. 662/4, datë 12.09.2014 i është drejtuar Titullarit të AK për miratimin e dokumenteve të procedurës, kërkesë me propozim, ku ky i fundit me vendim nr. 1, datë 12.09.2014 ka bërë miratimin e tyre. Nga krahasimi i preventivit të hartuar me zërat e preventivit të DT nuk rezultuan diferenca në volume për më pak AK**.**

C- Zhvillimi i procedurës: Me Shkresën nr. 662/7, datë 12.09.2014, Titullarit AK ka miratuar procedura e ftesës së 5 OE pjesëmarrës sipas procesverbalit të hartuar nga NJP, duke ftuar në këtë procedurë prokurimi, respektivisht: "*V./F", "A", "SH", "F" dhe "2Z K".*
Me procesverbal nr. 3, datë 26.09.2014 të hartuar nga anëtarët e KVO është bërë hapja dhe Shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë një OE, konkretisht "SH" me vlerë oferte 620,390 lekë pa TVSH..
Me Shkresën nr. 662/11, datë 04.10.2014 është mbajtur Raporti Përmbledhës sipas LPP, në të cilën janë pasqyruar e gjithë procedura e zhvilluar, i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK me vendim nr. 2, datë 04.10.2014.
Në përfundim KVO dhe Shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se OE ka fituar të drejtën e kualifikimit, pasi plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike të vendosura në DST nga AK, kjo sipas KVO.
Nga Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, konstatohet se nuk ka mangësi në kërkesat paraqitura dhe Shpallja e fituesit është në përputhje me LPP**.**

5- Tenderi me objekt "*Rikonstruksion i rrugës dhe SHeSHit të varrezave në fshatin Daullas, Komuna Qendër Fier)"*, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 8, datë 25.9.2014. Fondi limit 941,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 8, datë 25.9.2014 A.M. *Kryetar*, J.G. & M.S. *antar*	KVO me Shkresën 8/1, datë 6.10.2014 E.Q. *Kryetar*, O.Gj. & E.Gj.*antar.*
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Nga të ardhurat e komunës.	Fitues "SH" SHPK	Vlera fituese 940,180 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 13.10.2014.	Dif nga fondi limit 820 lekë.	Kontrata nr. 706/16, datë 03.11.2014.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 696/4, dt. 25.09.2014 (vendim nr. 1, dt. 25.09.2014)	Vlera e kontratës 1,128,216 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 20 ditë	Titullar i AK – H.M.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 25.09.2014 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*Kërkesë për propozim*".
Në dosje ndodhet preventivi dhe projektet të hartuara nga ing. E.Gj.. Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK z. H.M. dhe NJP.**

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me Shkresën nr. 696/4, datë 25.09.2014 është kërkuar miratimi i kërkesave të DST nga ana e Titullarit të AK, ku ky i fundit me vendim nr. 1, datë 25.09.2014 ka bërë miratimin e sajë. Nga krahasimi i preventivit të hartuar me zërat e preventivit të DT nuk rezultuan diferenca në volume për më pak AK**.**

C- Zhvillimi i procedurës: Me Shkresën nr. 969/7, datë 27.09.2014, Titullari AK ka miratuar procedura e ftesës së 5 OE pjesëmarrës sipas procesverbalit të hartuar nga NJP, duke ftuar në këtë procedurë prokurimi, respektivisht: "*V./F", "A", "SH", "F" dhe "A CO".*
Me procesverbal nr. 3, datë 13.10.2014 është bëra hapja dhe vlerësimi i ofertave të operatorëve pjesëmarrës, ku sipas këtij procesverbali ka marrë pjesë vetëm një operator, konkretisht ***"SH"* me vlerë oferte 940,180 lekë**
Me Shkresën nr. 969/11, datë 21.10.2014 është hartuar Raporti Përmbledhës në të cilën është reflektuar e gjithë procedura e ndjekur, raport i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK me vendim nr. 2, datë 21.10.2014.
Nga Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, konstatohet se nuk ka mangësi në kërkesat e paraqitura dhe Shpallja e fituesit është në përputhje me LPP.

6- Tenderi me objekt "*Rikonstruksion i Lapidarëve në fshatin Grecalli"*, me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 5, datë 13.6.2014. Fondi limit 808,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 5, datë 13.6.2014 A.M. *Kryetar*, J.G. & M.S. *antar*	KVO me Shkresën 5/1, datë 16.06.2014 E.Q. *Kryetar*, O.Gj. & E.Gj.*antar.*
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Nga të ardhurat e komunës.	Fitues "V./F" SHPK	Vlera fituese 722,650 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 27.06.2014.	Dif nga fondi limit 85,350 lekë.	Kontrata nr. 481/15, datë 21.7.2014.
Marrin pjesë **2** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 481/5, dt. 13.6.2014 (vendim nr. 1, dt. 13.6.2014)	Vlera e kontratës 21.7.2014 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 60 ditë	Titullar i AK – H.M.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 13.6.2014 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*Kërkesë për propozim*".
Në dosje ndodhet preventivi i hartuara nga ing. E.Gj..

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me Shkresën nr. 418/4, datë 13.06.2014 është kërkuar miratimi i kërkesave të DST nga ana e Titullarit të AK, ku ky i fundit me vendim nr. 1, datë 13.06.2014 ka bërë miratimin e sajë. Nga krahasimi i preventivit të hartuar me zërat e preventivit të DT nuk rezultuan diferenca në volume për më pak AK**.**

C- Zhvillimi i procedurës: Me Shkresën nr. 481/7, datë 16.6.2014, Titullari i AK ka miratuar procedura e ftesës së 5 OE pjesëmarrës sipas procesverbalit të hartuar nga NJP, duke ftuar në këtë procedurë prokurimi, respektivisht: "*V./F", "A", "E", "F" dhe "A C".*

Me procesverbal nr. 3, datë 13.10.2014 është bëra hapja dhe vlerësimi i ofertave të operatorëve pjesëmarrës, ku sipas këtij procesverbali ka marrë pjesë 2 operator, konkretisht: ***"V./F"*** me vlerë oferte 722,650 lekë dhe "**F**", i cili është s'kualifikuar OE "F", pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga administrata tatimore**.**

Me Shkresën nr. 969/11, datë 21.10.2014 është hartuar Raporti Përmbledhës në të cilën është reflektuar e gjithë procedura e ndjekur, raport i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK me vendim nr. 2, datë 21.10.2014.

Nga Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, konstatohet se nuk ka mangësi në kërkesat e paraqitura dhe Shpallja e fituesit është në përputhje me LPP.

7- Tender i zhvilluar me objekt: ***"Blerje ushqime për Konviktin e shkollës së Mesme "Rakip Kryeziu, viti 2014",*** me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 3, datë 17.02.2014. Fondi limit 1,413,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 3, datë 17.02.2014 O. K. *Kryetar*, J.G. & E.Gj.*antar*	KVO me Shkresën 3/ datë 27.02.2014 E.Q. *Kryetar*, O.Gj. & L.K.*antar*.
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Grand i Min. Arsimit.	Fitues "M.C C" SHPK	Vlera fituese 1,411,750 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 13.03.2014.	Dif nga fondi limit 1,250 lekë.	Kontrata nr. 128/16, datë 02.04.2014.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 128/5, dt. 24.02.2014 (vendim nr. 1, dt. 24.02.2014	Vlera e kontratës 1,694,100 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 270 ditë	Titullar i AK – H.M.

A- Llogaritje e fondit limit: nuk ka asnjë të dhënë se ku është bazuar NJHDT, në lidhje me:

A/1- Çmimet e 19 artikujve uSHqimorë që do të prokurohen, veprim në papajtueSHmëri me nenin 28 "*Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike*", pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu II "*Rregullat e përgjithSHme të prokurimit*", pika 2 "*Llogaritja e vlerës së kontratës*", pika (c).

A/2 – Analizimin e kostove të mallrave, për të cilën ka rezultuar vlera e fondit limit prej 1,413,000 lekë pa TVSH., në kundërshtim me pikën (ç) e nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

A/3- Përcaktimin e numrit të nxënësve, frekuentimit dhe mbi çfarë periudhe kohore është bazuar komisioni i cili ka hartuar preventivin të hartuar nga Përgjegjësja e Zyrës së Financës zj. L.Dh. dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë H.M..

B-Mos ndarje me lote e procedurës: Në auditimin e dokumentacionit, konstatohet se kjo procedurë prokurimi nuk është ndarë me lote sipas llojit të artikujve më vete, në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu II, pika 2 germa (dh).

B/1- Hartimi i DT është bërë me procesverbalin nr. 1, datë 24.02.2014. Në DT specifikimet teknike të artikujve uSHqimorë, që do të prokurohen.

Për 19 artikuj e prokuruar, *në asnjë rast nuk janë përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, SHqisorë, markerimi, etiketimi, standardet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit dhe cilësia e artikujve të kërkuar*, objekt prokurimi, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 23 "*Specifikimet teknike*", pika 3 e tij.

Sa më sipër mban përgjegjësi: Titullari i AK z. H.M., P/Zyrës së Financës zj. L.Dh. (hartues preventivit) dhe NJHDT i përbërë O. K. me funksion Jurist, J.G. me funksion specialist të Zyrën e Taksave dhe E.Gj.me funksion specialist në zyrën e Urbanistikës.

C- Zhvillimi i procedurës: Me Shkresën nr. 128/8, datë 27.02.2014 të titullarit të AK është miratuar procedura e ftesës së 5 OE pjesëmarrës sipas procesverbalit të hartuar nga NJP, duke ftuar në këtë procedurë prokurimi, respektivisht: *"E", "M.C C", "L. M.", "R. C." dhe "O. C.".*

Me procesverbal nr. 3, datë 17.03.2014 të hartuar nga anëtarët e KVO është bërë hapja dhe Shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht subjekti "M.C.C." SHPK me vlerë oferte **1,411,750 lekë.**

Në përfundim KVO dhe Shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se OE ka fituar të drejtën e kualifikimit, pasi plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike të vendosura në DST nga AK, kjo sipas KVO.

Me Shkresën nr. 128/11, datë 25.03.2014 nga anëtarët e KVO është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës në të cilin janë përSHkruar e gjithë procedura e ndjekur nga KVO, raport i cili është miratuar me vendim nr. 2, datë 25.03.2014 nga ana e Titullarit të AK.

Në auditimin e dokumentacionit të operatorit fitues "M.C.C.", konstatohet se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST dhe kualifikimi është në zbatim të tyre.

Theksojmë se sipas dokumentacionit në dosjen e auditimit, me përjaSHtim të Oltion Kaçani i cili ka bërë deklarimin për kuSHtet e konfliktit të interesit, asnjë nga anëtarët e tjerë të NJP dhe KVO nuk kanë bërë deklaratën e konfliktit të interesit, veprime në kundërshtim me Kreun V, pika 1 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik**",** ***për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtar:*** **J.G. i jashtëm dhe E.Gj.me funksion specialist në zyrën e Urbanistikës dhe anëtarët e KVO i përbërë** ***nga E.Q. me funksion Zv/Kryetar Komune, O.Gj. me funksion ish Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës dhe L.K.me funksion Zv/Kryetar Komune.***

8- Tender i zhvilluar me objekt: ***"Blerje ushqime për Konviktin e Shkollës së Mesme "Rakip Kryeziu, viti 2015",***me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 3, datë 04.02.2015. Fondi limit 1,993,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 3, datë 04.02.2015 A.M. *Kryetar,* M.S.& F.P.*antar*	KVO me Shkresën 3/1, datë 05.02.2015 E.Q. *Kryetar,* O.Gj. & E.Gj.*antar.*
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Grand i Ministria e Arsimit.	Fitues "M.C C & E" SHPK	Vlera fituese 1,990,100 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 16.02.2015.	Dif nga fondi limit 2,900 lekë.	Kontrata nr. 69/15, datë 05.03.2015.
Marrin pjesë **1** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 69/5, dt. 04.02.2015 (vendim nr. 1, dt. 04.02.2015	Vlera e kontratës 2,388,120 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 270 ditë	Titullar i AK – H.M.

A-Llogaritje e fondit limit: nuk ka asnjë të dhënë se ku është bazuar NJHDT, në lidhje me:

A/1- Çmimet e 21 artikujve ushqimorë që do të prokurohen, veprim në papajtueSHmëri me nenin 28 "*Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike*", pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" dhe nenin 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik".

A/2 – Analizimin e kostove të mallrave, për të cilën ka rezultuar vlera e fondit limit prej 1,993,000 lekë pa TVSH., në kundërshtim me pikën (ç) e nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

A/3- Në hartimin e preventivit dhe përcaktimin e fondit limit të hartuar nga P/Konviktit z. A. N. dhe Magazinieri zj. L. M., nuk ka asnjë dokumentacion ku të jetë përcaktuar numri i nxënësve që përfitojnë bursën (uSHqim e fjetje), frekuentimi dhe mbi çfarë periudhe kohore është bazuar ky komision. Nuk ka asnjë analizë e kostos të mallrave, që do të prokurohen duke krahasuar elementët e më sipërm dhe specifikimet teknike të mallrave, punëve dhe SHërbimeve përkatëse për të cilën ka rezultuar vlera prej 1,993,000 lekë pa TVSH.. Nuk ka asnjë të dhënë të paraqitur nga ky grup mbi numrin e nxënësve me burse dhe gjysmë burse. Specifikimet teknike të paraqitura **në asnjë rast nuk kanë të përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standarte, mënyra e ruajtjes dhe transportimit si dhe cilësia e artikujve të kërkuar**.

B-Mos ndarje me lote e procedurës: Në auditimin e dokumentacionit, konstatohet se kjo procedurë prokurimi nuk është ndarë me lote sipas llojit të artikujve më vete, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 27.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik" neni 9 pika 5,kjo ka çuar në vendosjen e kritereve përjashtues për subjekte të tjera , si vijon:

b/1- Hartimi i DT është bërë me procesverbalin nr. 1, datë 04.02.2015. Në DT specifikimet teknike të artikujve ushqimorë, që do të prokurohen.

- Në këto dokumente në pikën 2.1, "Kapaciteti teknik", është kërkuar që: *"Ofertuesi duhet të tregojë se është teknikisht në gjendje ta kryejë prokurimin. Për të provuar mundësinë e tij teknike për këtë prokurim, ofertuesi duhet të paraqesë eksperienca te ngjashme, të mëparshme, te realizuara gjate aktivitetit te SHoqërisë ne tre vitet e fundit. Për këtë kërkesë ofertuesi te paraqesë: Kontratat e furnizimit te mallrave te ngjashme, me vlere deri 40% te fondit limit qe prokurohet, vlera e kontratave te furnizimit te ngjashme nuk duhet te jete me vogël se 797,200 leke ne tre vitet e fundit. Në rastin e përvojës me sektorin privat si dëSHmi pranohen vetëm fatura tatimore te SHitjes, ku shënohen datat shumat dhe sasitë e furnizimit".*

Sa më sipër nga ana e NJHDT, në papajtueSHmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 27, "*Kontratat e mallrave*", nga NJHDT, nuk është kërkuar që: "*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparSHme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara".*

-Është vendosur si kriter (pika 2.2), kompleks stallor, dyqan mishi dhe thertore, kriter ky përjashtues, pasi nuk është i nevojshëm vendosja e kompleksit stallor;

-Është vendosur dhe dyqan bulmeti dhe njësi prodhimi bulmeti, kur mund të ishte vendosur vetëm dyqan bulmeti

Vendosje e këtyre kritereve (*kompleks stallor dhe njësi prodhimi*) janë dy kritere përjashtues për operatorët e tjerë, kryesisht subjekteve të mesëm, si dhe mos e bërja me lote e procedura ka çuar në mos pjesëmarrje të operatorëve të tjerë dhe marrjen pjesë të një operatori të vetëm me çmim pothuajse fiks me fondin limit, kjo për mungesë konkurrence, veprime në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 27, "*Kontratat e mallrave*", pika 3,.

Sa më sipër mban përgjegjësi: Titullari i AK H.M., P/Zyrës së Financës zj. L.Dh. (hartues preventivit) dhe NJHDT i përbërë O. K. me funksion Jurist, J.G. me funksion specialist të Zyrën e Taksave dhe E.Gj.me funksion specialist në zyrën e Urbanistikës.

C- Zhvillimi i procedurës: Me Shkresën nr. 69/7, datë 04.02.105 të titullarit të AK është miratuar procedura e ftesës së 5 OE pjesëmarrës sipas procesverbalit të hartuar nga NJP, duke ftuar në këtë procedurë prokurimi, respektivisht: *"E", "M.C CG", "DUKA&R.J.M.I", "E 2013" dhe "G 1987".*

Me procesverbal nr. 3, datë 16.02.2015 të hartuar nga anëtarët e KVO është bërë hapja dhe Shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, ku në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht subjekti "M.C.C & E" SHPK me vlerë oferte **1,990,100 lekë.**

Në përfundim KVO dhe shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se OE ka fituar të drejtën e kualifikimit, pasi plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike të vendosura në DST nga AK, kjo sipas KVO.

Me Shkresën nr. 69/11, datë 16.02.2015 nga anëtarët e KVO është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës në të cilin janë përshkruar e gjithë procedura e ndjekur nga KVO, raport i cili është miratuar me vendim nr. 2, datë 25.02.2015 nga ana e Titullarit të AK.

D-Auditimi i dokumentacionit të operatorit të vetëm të SHpallur fitues.

Në auditimin e dokumentacionit të vetëm të shpallur fitues BOE "M.C.C. & E.", konstatohet se ky BOE nuk i plotëson të gjitha kriteret për kualifikim sipas DST të miratuar nga AK, konkretisht:

-Nuk plotësohet pika 2.1 "*vërtetim për pagesën e taksave vendore për vitet 2012;2013 dhe 2014",* ky kriter nuk plotësohet nga subjekti "E", pasi sipas dokumenteve në sistem ka paraqitur vërtetimet si vijon:

-Për adresën në Komuna Kalis ka paraqitur vërtetim për vitet 2013 dhe 2014, ***por nuk ka paraqitur për vitin 2012;***

-Për adresën BaSHkia Kamzë (dyqan mishi), ka paraqitur vërtetim vetëm për vitin 2014, ***por nuk ka paraqitur për vitin 2012 dhe 2013,*** *konkretisht foto:*

-Nuk plotëson pikën 2.2 "O duhet të ketë veteriner me kontratë pune". Nga subjekti "M.C.C" është paraqitur diploma e veterinerit z. I. M., ***por nuk është paraqitur kontrata e punës.***

Konkluzion: Nga sa trajtuam KVO nuk duhej të kualifikonte BOE "M.C.C. & E.", pasi sipas dokumenteve të audituar dhe relatuar më sipër nuk plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, në këto kuSHte duhej të ish anuluar procedura dhe ribëhej procedurë e re, **çka ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga E.Q. me funksion ish Zv/Kryetar Komune**, **O.Gj. me funksion ish P/Zyrës Urbanistikës dhe E.Gj.me funksion ish inspektor i Zyrës së Urbanistikës,** pasi nuk kanë zbatuar ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa (a, b, c) dhe neni 46, duke SHkaktuar pabarazi në vlerësimin e ofertave.

Komente dhe sqarime: *Në SHpjegimet e paraqitura nga subjekti ish Komuna Qendër me Shkresën nr. 2085/132, datë 13.06.2017 (ardhur në KLSH nr. 276/12, datë 16.06.2017), në lidhje me kualifikimin e padrejtë të BOE "M.C.C. & E." se vërtetimi për taksat vendore i lëshuar për periudhën 2014 përfSHin dhe vitet e mëparshme, nuk qëndron, kjo për faktin se në DST thuhet prerazi se duhet vërtetim për çdo vit të kërkuar (2012; 2013 & 2014). Gjithashtu nga ana juaj nuk janë argumentuar dy mangësitë e tjera. Në këto kushte argumenti juaj nuk qëndron dhe shpallja fitues e BOE "M.C. & E", nuk është ligjore dhe tenderi duhej anuluar.*

(Gjerësisht trajtuar në faqen 80-166, të Projektraport Auditimit)

IX/5-7. Në ish Komunën Levan.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (*këtu e në vijim AK*) Komuna Levan, për periudhën nga 01.01.2013 deri më 31.07.2015 janë kryer **6** procedura prokurimi me fond limit në vlerën 9,195,065 lekë, nga e cila "*Kërkesë me propozim* (KP)" **4** procedura dhe "*Negocim pa shpallje* (NGP)" **2** procedura. Diferenca nga fondi limit në total është për vlerën 1,735 mijë lekë ose 18 % nga vlera e fondit limit.

Në këto procedura prokurimi kanë marrë pjesë **24** operatorë ekonomikë (OE) dhe janë s'kualifikuar **8** operatorë, sipas pasqyrës si vijon:

Nr.	Objekti prokurimit	Fondi limit	Lloji i procedurës	OE		Vlera Fituese (pa TVSH.)	Fituesi i procedurës	Kontrata		
				Pjesëmarrës	S'kualifikuar			Data	Vlera me TVSH.	Afati ditë
1.	Riparim e mirëmbajte rruge parcela Bishan, BaSHkim, Qarr	1,323,814	KP	10	7	970,566	"F"	Nr. 589/4, dt. 18.9.014	1,164,679	30
2.	Blerje karburanti për nevojat e komunës, viti 2013	1,704,167	NGP	2	0	1,704,167	"V P"	Nr. 3/5, dt. 12.4.013	2,045,000	260
3.	Ndriçim rrugor Levan - Fier	1,742,660	KP	3	1	1,281,447	"N"	Nr. 588, dt. 30.7.014	1,537,736	20
4.	Riparim mirëmbajtje murit mbajtës përroi Levan	2,093,452	KP	6	0	1,388,700	"N 1934"	Nr. 379, dt. 01.6.015	1,666,440	15
5.	Pastrim dhe heqje dheraSH	755,972	KP	2	0	539,980	"S"	Nr. 982, dt. 16.12.2014	647,976	5
6.	Blerje karburanti 2015	1,575,000	NGP	1	0	1,575,000 (9.5)	"V P"	Nr.--, dt. 4.5.2015	1,575,000	150
	SHUMA	**9,195,065**		**24**	**8**	**7,459,860**			**8,951,832**	**480**

Nga grupi i auditimit të KLSH, u audituar **6** procedura prokurimi me vlerë 9,195,065 lekë ose 100 % e vlerës së fondit limit.

Tenderi me objekti *"Pastrim dhe hedhje dheraSH"* me vlerë të fondit limit 755,972 lekë, u auditua dhe nuk u konstatuan probleme, pasi në këtë procedurë ka fituar operatori me ofertë më të ulët dhe që i plotëson të gjitha kriteret (të dhënat sipas pasqyrës sipër).

1- Tenderi me objekt "*Riparim e mirëmbajtje të rrugëve të parcelave të fshatrat Bishan, BaSHkim, Qarri*", me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 589, datë 30.7.2014.	NJHDT sipas Shkresa nr. 589, datë 30.7.2014	KVO me Shkresën nr. 589/1, datë 30.7.2014

Fondi limit 1,323,814 lekë	B.M. juriste, Sh.Gj. ekonomiste, Z.T. spe/urbanistik	M.N.*kryetar*, Sh.H. & P.K. *anëtar*
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim, Burimi fin. Nga të ardhurat e komunës.	Fitues "f." SHPK	Vlera fituese 970,566 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 11.08.2014.	Dif nga fondi limit 353,248 lekë.	Kontrata nr.589/4, datë 18.9.2014.
Marrin pjesë **10** OE S`kualifikuar **7** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 467/8, datë 09.05.2013,	Vlera e kontratës 1,164,679 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 30 ditë	Titullar i AK – Xh.M.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 31.07.2014 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*Kërkesë për propozim*".
Në dosje ndodhet preventivi i punimeve të objektit *"Riparim e mirëmbajtje të rrugëve të parcelave të fSHatrat Bishan, Bashkim, Qarr"*, i hartuar nga tekniku i komunës z. Z.T. dhe miratuar nga ana e titullarit të AK z. Xh.M..

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë miratuar me procesverbalin nr. 1, datës 31.07.2014. Nuk disponohet dokumentacion ligjorë që tregon se NJP të ketë bërë ftesën për 5 OE pjesëmarrës në tender siç përcaktohet në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, kreu VI, pika 1, germa (b), **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: Titullarin e AK z. Xh.M. dhe komisioni e NJP zj. B.M. me funksion juriste, Sh.Gj. me funksion ekonomiste dhe Z.T. me funksion spec/urbanistik.**

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në Shkresën nr. 2085/108, datë 22.05.2017 (ardhur në KLSH datë 23.05.2017), nga ish punonjësit e Komunës Levan në lidhje me mos paraqitjen e ftesës së ofertës për 5 OE, nga subjekti si në fazën e auditimit (dosjen e subjektit dhe sistem app), po ashtu dhe në kundërSHtitë tuaja nuk është paraqitur asnjë dokument që tregon të kundërtën e atyre që grupi i auditimit ka kundërshtuar.*

C- Zhvillimi i procedurës: Me procesverbal nr. 2, datë 11.08.2014 anëtarët e KVO ka bërë hapjen dhe Shqyrtimin e ofertave ekonomike dhe dokumentacionit ligjorë të paraqitur nga 10 operator ekonomik, *respektivisht*:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	"D"	840,820	S'kualifikuar
2	"SH"	S'ka	S'kualifikuar
3	"2Z K	918,660	S'kualifikuar
4	"S"	999,660	S'kualifikuar
5.	"B"	1,093,200	S'kualifikuar
6.	"B. B"	1,011,180	**Kualifikuar**
7.	"B"	1,227,240	**Kualifikuar**
8.	N 1934"	850,890	S'kualifikuar
9.	"N"	826,190	S'kualifikuar
10.	"F."	970,566	**Kualifikuar**

Në përfundim nga **10** OE kanë fituar të drejtën e kualifikimit vetëm **1 (një)** OE, konkretisht "F." me vlerë oferte **970,566 lekë** pa TVSH., ku sipas KVO plotëson të gjitha kriteret ligjore e teknike të vendosura në DST nga AK.

D- Auditimi i dokumentacionit ligjor administrativ të OE të SHpallur fitues "F." SHPK.

Në auditimin e dokumentacionit ligjorë të paraqitur nga subjekti fitues "F.", konstatohet se dhe ky operator nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST nga AK, konkretisht:

-Vërtetimi për energjinë elektrike nuk është sipas DST, pasi është lëshuar për individin Vilson F., kjo se sipas librezës së pagesave është për abonent familjarë dhe jo për shoqërinë "F.". Gjithashtu ky vërtetim nuk përcakton kohën dhe periudhën nëse subjekti është ose jo debitor.

Gjithashtu libreza është vetëm për njërën kontratë dhe jo për tjetrën (pika 2.2 e DST).

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ENERGJITIKES
ND.ELEKTRIKE
Zona ____ Kontrata 11410
Leshuar VILSON FILIPI
Rruga ____
Pallati 34 Shkalla I
Ap. 2

VËRTETIM DEBIE

Komente dhe sqarime: *Për sa kundërSHtoni në Shkresën nr. 2085/132, datë13.06.2017 (ardhur në KLSH me nr. 276/12, datë16.06.2016), në lidhje me konstatimet e grupit të auditimit se subjekti i shpallur fitues nuk plotëson tre nga kërkesat e DST, sqarojmë se:* *Në argumentet që paraqisni keni shpjeguar faktin se subjekti ka paraqitur vërtetimin për deklarimin e xhiros për vitet 2011-2012-2013 dhe vërtetimi nga Administrata tatimorë për numrin e punonjësve për secilën periudhë që është kërkuar Janar-Dhjetor 2013 dhe Janar – QerSHor 2014,* ***por nuk argumenton faktin se subjekti nuk ka paraqitur vërtetimin e pagesës së energjisë elektrike, pasi subjekti disponon dy kontrata dhe ka paraqitur vetëm një librezë pagesë dhe se në vërtetim nuk përcaktohet periudha. Element ky për s'kualifikim.***	

Nga sa trajtuam ky subjekt nuk plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST.

E-Auditimi i dokumentacionit të subjekteve që janë s'kualifikuar.

Sipas procesverbalit nr. 3, datë 20.08.2014 KVO për vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët pjesëmarrës, janë s'kualifikuar **7 OE**, respektivisht:

1.Subjekti ***"D. G" me ofertë840,80 lekë****, ku vlerësimi për s'kualifikim* ***është bërë saktë;***

2.Subjekti ***"B." me ofertë 1,093,200 lekë,*** *vlerësimi për s'kualifikim i bërë nga KVO është i saktë;*

*3.Subjekti **"2Z K." me ofertë 918,660 lekë***, është s'kualifikuar pasi vërtetimi i energjisë elektrike nuk ka të specifikuar muajin QerSHor 2014, **gjë e cila nuk është e vërtetë,** pasi sipas dokumentacionit në faqen e APP, ky vërtetim ekziston në të cilën tregon se nuk ka detyrime deri më 31.07.2014, gjë për të cilën është kualifikuar operatori fitues ku në vërtetimin e tij nuk përcaktohet periudha e detyrimit.
*4.Subjekti **"N." me ofertë 826,190 lekë***, për të cilën komisioni i KVO e ka vlerësuar drejt për s'kualifikim;
*5.Subjekti**"S." me ofertë 999,660 lekë,*** s 'kualifikimi i bërë nga KVO është i saktë, pasi nuk është paraqitur certifikata ISO;
*6.Subjekti **"SH."*** pa ofertë ekonomike, s 'kualifikimi i bërë nga KVO është i saktë.
*7.Subjekti **"N. 1934" me ofertë 850,890 lekë,*** ku sipas KVO **nuk kualifikohet** për faktin se nuk është kontrata me sipërmarrësin, fakt i cili nuk është i saktë pasi sipas dokumenteve në elektronik subjekti ka hedhur pjesë të kontratës.

Komente dhe sqarime: *Për sa kundërshtoni në shkresën nr. 2085/108, datë 22.05.2017 (ardhur në KLSH me datë 23.05.2017), se subjekti "N 1043" nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST, me pretendimin se nuk ka paraqitur kontrata të ngjaSHme por pjesë të sajë, nuk qëndrojnë, pasi:*
Subjekti sipas verifikimit në sistem ka paraqitur kontratën për punimet e ngjashme dhe konkretisht ato pjesë të saj ku flitet për punimet e ngjashme, akt-kualifikim, faturat, stacionet, akt-marrje dorëzimet.,. ***Argumenti juaj nuk merret në konsideratë.***

Janë kualifikuar me dokumentacion të rregullt teknik e ligjore subjektet:
*8.Subjekti **'F."** me vlerë **970,566 lekë***, nga KVO është **kualifikuar** si operator i rregullt;
*9.Subjekti **"B"** me vlerën **1,227,240 lekë,*** është **kualifikuar** nga KVO si operator me dokumente të rregullt teknik e ligjor;
*10.Subjekti **"B. B"** me vlerë oferte **1,011,180 lekë***, është **kualifikuar** nga KVO me dokumentacion të rregullt teknik e ligjor;
Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se kuSHtet e kualifikimit e plotësojnë **3 OE** nga të cilët **2 OE** janë me ofertë më të lartë se operatori fitues dhe fitues është SHpallur subjekti "F." me ofertë më të ulët.
Konkluzion: KVO në referencë të nenit 53 dhe 54, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe duke u nisur nga kriteri kryesorë *"**çmimi ekonomik më i leverdishëm"*** të vlerësonte ofertën me vlerë më të leverdishme për buxhetin e ish-komunës Levan për vlerën **850,890 lekë**, duke vlerësuar se operatori **"N. 1934"** nuk ka mangësi të dokumenteve e paraqitura, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa (a, b, c), duke SHkaktuar pabarazi në vlerësimin e ofertave me dëm në buxhetin e komunës për **vlerën 19,676 lekë, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë nga z. M.N. me funksion Zv/Kryetar dhe P/Zyrës së Financës, z. Sh.H. me funksion agronom dhe z. P.K. me funksion Ins/Ndihmës Ekonomike**.

F- Lidhja e kontratës dhe dokumentacioni për respektimin e afateve kohore. Kontrata nr. 589/4, datë 18.9.2014, afati 30 ditë, ose deri më 19.10.2014, në SHumën 1,164,679 lekë me TVSH..

G- Likuidimi i kontratës është bërë me urdhër SHpenzimet sa vijon:

Urdhër SHpenzimi			Fatura tatimore		
Numër	**datë**	**vlerë**	**Numër**	**datë**	**vlerë**
364	19.11.2014	1,163,120	27	17.11.2014	1,163,120

Bazuar në ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995, **"**Për tatimin mbi vlerën e SHtuar", i ndryshuar, neni 13, "Momenti i furnizimit" i ndryshuar me nenin 99, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, faturat tatimore nr. 27, datë 17.11.2014, në SHumën 1,163,120 lekë, tej afatit kohor të dorëzimit të punës së kryer në një kohë që furnizimi quhet i kryer në momentin kur është e detyrueSHme të lëshohet fatura.
Sa më sipër duhet të ishin mbajtur sanksione sipas kuSHteve të përgjithSHme të kontratës për punime civile, pjesë e DST, në shumën:

*Për vlerën **1,163,120 lekë** e likuiduar me datë 17.11.2014, vonesat janë për **28 ditë** dhe penalitetit duhej të ish llogaritur në vlerën (1,163,120 lekë x 4/1000/ditë x 28 ditë)* **=130,269 lekë, sanksione të pa mbajtura me dëm ekonomik dhe ngarkohet me përgjegjësi: Mbikëqyrësin e punimeve z. Z.T. dhe P/Zyrës së Financës M.N..**

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në Shkresën nr. 2085/132, datë 13.06.2017 (ardhur në KLSH nr. 276/12, datë 16.06.2017), nga ish punonjësit e Komunës Levan në lidhje me mos llogaritjen e penaliteteve për mos përfundimin në afat të punimeve, nuk sqaron problemin e trajtuar nga grupi i auditimit, pasi situacioni përfundimtar dhe fatura që e shoqëron atë mban datën 17.11.2014 ose 28 ditë vonesë. Në këto kushte argumenti juaj nuk qëndron dhe detyrimi mbete.*

2- Tenderi me objekt "*Ndriçimi rrugor Levan Fier*", me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 422, datë 29.05.2014. Fondi limit 1,742,660 lekë	NJHDT sipas SHkresës nr. 422, datë 29.05.2014 E.Gj. *Kryetar*, B.M. & Z.T. *anëtar*	KVO me Shkresën nr. 422/1, datë 29.05.2014 M.N. *Kryetar*, Sh.H. & U.M. *anëtar*
Procedura e prokurimit – *Kërkesë me propozim*, Burimi financimi. Nga të ardhurat Komunës.	Fitues "N" SHPK	Vlera fituese 1,281,447 pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 09.06.2014.	Dif nga fondi limit 461,213 lekë.	Kontrata nr.588, datë 30.07.2014.
Marrin pjesë **3** OE S`kualifikuar **1** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. 29/5, dt. 29.05.2014	Vlera e kontratës 1,537,736 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - ka	Afati kontratës 20 ditë	Titullar i AK – Xh.M.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës: Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 23.04.2014 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*Kërkesë për propozim*".
Në dosje ndodhet preventivi për objektit "*Ndriçim Rrugor Qendër-Levan*" i hartuara nga ing. Petrit Gishti, por i panënshkruar nga ana e ish-Kryetarit të Komunës z. Xh.M., si dhe nuk ka asnjë dokumentacion për kontrollimin e këtij projekti e preventivi, si dhe nëse preventivi përmban apo jo punimet e projektit, nga Sektori i PZHT.
Me Shkresën nr. 412, datë 27.05.2014 të ish-Kryetarit të Komunës z. Xh.M. në adresë të Agjencisë së Prokurimit Publik (*këtu e në vijim APP*), bëri anulimin e kësaj procedure pasi asnjë nga subjektet pjesëmarrës nuk plotëson kriteret teknike e ligjore për kualifikim. Për këtë procedura është ripërsëritur por pa bërë asnjë ndryshim në kërkesat për kualifikim.

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Nuk disponohet dokumentacion ligjorë që tregon se NJP të ketë bërë ftesën për 5 OE pjesëmarrës në tender siç përcaktohet në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, kreu VI, pika 1, germa (b),***veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi komisioni e NJP zj. B.M. me funksion ish juriste, Sh.Gj. me funksion ish ekonomiste dhe Z.T. me funksion ish spec/Urbanistik.***

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në shkresën nr. 2085/108, datë 22.05.2017 (ardhur në KLSH datë 23.05.2017), nga ish punonjësit e Komunës Levan në lidhje me mos paraqitjen e ftesës së ofertës për 5 OE, nga subjekti si në fazën e auditimit (dosjen e subjektit dhe sistem app), po ashtu dhe në kundërshtitë tuaja nuk është paraqitur asnjë dokument që tregon të kundërtën e atyre që grupi i auditimit ka kundërshtuar.*

C- Zhvillimi i procedurës: Me procesverbal nr. 2, datë 09.06.2014 është bërë regjistrimi dhe inventarizimi i dokumenteve të paraqitur nga operatorët ekonomik (*këtu e në vijim OE*). Sipas procesverbalit nr. 3, datë 09.06.2014 të KVO në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 OE, *respektivisht*:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1	"B-93"	1,499,600	Kualifikohet
2	"N"	1,281,446	**kualifikohet**
3	"S"	1,236,790	S'kualifikohet

Në përfundim sipas procesverbalit nr. 4, datë 16.06.2014 është bërë vlerësimi i dokumentacion ligjorë të OE pjesëmarrës në të cilën është konstatuar se nga 3 OE nuk kualifikohet OE "S", pasi certifikata ISO nuk është regjistruar në sistemin e kompanisë certifikues, ndërsa dy OE janë kualifikuar.
Më pas është vijuar puna për verifikimin e ofertave teknike, ku është konstatuar se OE **"B-93"** ka gabime aritmetike dhe iu është dërguar mesazh elektronik për rregullim e saj, duke i lënë afat 24 orë.
Sipas procesverbalit nr. 5, datë 17.06.2014, nga KVO është bërë rivlerësimi i dokumenteve teknik pas korrigjimeve dhe arrin në konkluzionin se kualifikohen dy OE sipas kësaj renditje:

Në vendin e parë OE "N" me vlerë oferte 1,281,446 lekë
Në vend të dy OE "B-93" me vlerë ofertë 1,499,600 lekë

Me Shkresën nr. 422/7, datë 07.07.2014 është hartuar dhe dërguar për miratim tek titullari Raporti Përmbledhës, duke bërë të gjitha shpjegimet e duhura dhe fazat e procedurës, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (këtu e ne vijim AK) me shkresën nr. 422/8, datë 07.07.2014, duke SHpallur fitues *OE* **"N" me vlerë oferte 1,281,446 lekë**.
Me shkresën nr. 184, datë 19.06.2014 subjekti "S", ka bërë ankimim mbi s 'kualifikimi e tij si të padrejtë, pasi dokumentacioni ligjorë është i rregullt, kryesisht për deklarim të rremë të certifikatës ISO, gjë e cila nuk është e vërtetë sipas subjektit.
Me urdhër nr. 483/1, datë 20.06.2014 të Titullarit të AK është kërkuar anulimi i procedurës deri në Shqyrtimin e ankesës nga komisioni i ngritur i përbërë prej Sh.Gj., A. B. dhe P.K..
Nga ana e këtij komisioni sipas procesverbalit nr. 483/2, datë 20.06.2014 është bërë verifikimi i ankesës dhe arritur në konkluzionin se pretendimi i subjektit nuk qëndron, pasi nga verifikimi që u bë në sistemin e certifikimit të kompanisë për këtë shoqëri nuk del me certifikate, *por që konfirmim nga kompania certifikues nuk ka ardhur megjithëse nga ana komisionit është kërkuar një gjë e tillë***.**

Sipas këtij procesverbali nga ana e Titullarit të AK, u mor vendimi nr. 483/3, datë 23..06.2014 për mos pranim të ankesës së bërë nga SHoqëria "S" dhe vijimin e procedurës.
Me Shkresën nr. 483/4, datë 23.06.2014 është njoftuar shoqëria "S" në lidhje me ankesën, në të cilën njoftuar mos marrjen në konsideratë të ankesës së bërë nga kjo shoqëri.
Me shkresën nr. 188, datë 05.07.2014 shoqëria "S" i është drejtuar për ankimin Komisionit të Prokurimit Publik (këtu e në vijim KPP), ku ky i fundit pas Shqyrtimit të ankesës dhe dëgjesës së KVO arriti në konkluzionin se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë pasi certifikata nuk është e rregullt.
Në përfundim ankesa e bërë nga shoqëria 'S" nuk qëndron.

D- Auditimi i dokumentacionit ligjor administrativ të OE të shpallur fitues "N" SHPK.
Në auditimin e dokumentacionit ligjorë të paraqitur nga subjekti fitues "N", konstatohet se dhe ky operator nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST nga AK, konkretisht:

-Mjeti tip kamion i marrë me qira nga subjekti "D"(sipas kontratës nr. 753rep/395/2kol, datë 20.05.2014, ***nuk ka të depozituar certifikatë kontrolli teknik*** *(pika 5 germa (a);*

-Vërtetimi i lëshuar për numrin e punonjësve për periudhën Mars –Dhjetor 2012, ***nuk është lëshuar nga Administrata tatimore siç kërkohet në DST, por nga Dega e Sigurimeve Vlorë*** *(pika 4 germa (i).*
-Paga e drejtuesit teknik ing. A. D. me profesion inxhinier ndërtimi në Listpagesat e sigurimeve shoqërore (48,611 lekë) nuk është e barabartë me pagën e nënshkruar në kontratën e punës e cila figuron në vlerën 50,000 lekë ose ma pak për shumën 1,389 lekë, deklarim i rremë dhe sipas DST duhej s'kualifikuar. Gjithashtu drejtuesi teknik nuk ka qenë i angazhuar gjatë gjithë periudhës pasi në muaj të ndryshim ka prezencë të ndryshme, konkretisht: në muajt Prill – shtator 2013 ka punuar mesatarisht 4 ditë në jave me pagë 9,000 lekë, në muajin Tetor 2013 me pagë 22,000 lekë, në muajin Nëntor-Dhjetor 2013 për 7 ditë me pagë 10,500 lekë. Ndërsa në periudhën Janar-Mars 2014 ka punuar mesatarisht 6 ditë në muaj me pagë 9,000 lekë. ***Deklarim i rrem. Në këto kuSHte ky OE duhej s'kualifikuar.***
Konkluzion: KVO **duhet të anulonte këtë** procedurë prokurimi, pasi dhe OE i SHpallur fitues nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të cilat janë vendosur nga AK dhe duhej të procedonte me procedurë të re tenderimi, veprime në kundërshtim me nenin 46, të LPP**, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë nga z. M.N.me funksion Zv/Kryetar dhe P/Zyrës së Financës, z. Sh.H. me funksion agronom dhe z. P.K. me funksion Ins/Ndihmës Ekonomike**.

F- Lidhja e kontratës dhe dokumentacioni për respektimin e afateve kohore. Kontrata nr. 588, datë 30.07.2014, afati 20 ditë, ose deri më 19.08.2014, në SHumën 1,281,447 lekë me TVSH..
G- Likuidimi i kontratës është bërë me urdhër shpenzimet sa vijon:

Urdhër SHpenzimi			Fatura tatimore		
Numër	**datë**	**vlerë**	**Numër**	**datë**	**vlerë**
395	05.12.2014	1,323,495	233	02.10.2014	1,323,495

Bazuar në ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995, **"**Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, neni 13, "Momenti i furnizimit" i ndryshuar me nenin 99, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, faturat tatimore nr. 27, datë 17.11.2014, në SHumën 1,163,120 lekë, tej afatit kohor të dorëzimit të punës së kryer në një kohë që furnizimi quhet i kryer në momentin kur është e detyrueshme të lëshohet fatura.

Sa më sipër duhet të ishin mbajtur sanksione sipas kuSHteve të përgjithSHme të kontratës për punime civile, pjesë e DST, në SHumën:

*Për vlerën **1,323,495 lekë** e likuiduar me datë 02.10.2014, vonesat janë për **42 ditë** dhe penalitetit duhej të ish llogaritur në vlerën (1,281,447 lekë x 4/1000/ditë x 42 ditë) = **215,283 lekë,*** **sanksione të pa mbajtura me dëm ekonomik dhe ngarkohet me përgjegjësi: Mbikëqyrësin e punimeve zj. L.V. dhe P/Zyrës së Financës M.N..**

Komente dhe sqarime. *Për sa sqaroni në Shkresën nr. nr. 2085/132, datë 13.06.2017 (ardhur në KLSH nr. 276/12, datë 16.06.2017), nga ish punonjësit e Komunës Levan në lidhje me mos llogaritjen e penaliteteve për mos përfundimin në afat të punimeve, nuk sqaron problemin e trajtuar nga grupi i auditimit, pasi situacioni përfundimtar dhe fatura që e SHoqëron atë mban datën 17.11.2014 ose 42 ditë vonesë. Në këto kushte argumenti juaj nuk qëndron dhe detyrimi mbete.*

3- Tenderi me objekt "*Riparim mirëmbajtje e murit mbajtës tek përroi Levan*", me këto të dhëna:

Urdhër prokurimi nr. 2, datë 29.04.2015. Fondi limit 2,093,452 lekë	NJHDT sipas SHkresës nr. 422, datë 29.05.2014 P.K. *Kryetar*, Z.T. & SH.Gj.*anëtar*	KVO me Shkresën nr. 2/1, datë 29.04.2015 M.N. *Kryetar*, Sh.H. & E.Gj. *anëtar*
Procedura e prokurimit – *Kërkesë me propozim,* Burimi financimi. Nga të ardhurat Komunës.	Fitues "N. 1934"SHpk	Vlera fituese 1,388,700 lekë pa TVSH..
Dt e hapjes së tenderit 12.05.2015.	Dif nga fondi limit 704,752 lekë.	Kontrata nr.379, datë 01.06.2015.
Marrin pjesë **6** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. s'ka, dt.27.5.2015	Vlera e kontratës 1,666,440 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 15 ditë	Titullar i AK – Xh.M.

A- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës (fondi limit): Nga ana e NJHDT me procesverbalin nr. 1, datë 29.04.2014 është përcaktuar si formë prokurimi procedura "*Kërkesë për propozim*". Në dosje ndodhet preventivi për objektin "*Riparim mirëmbajtje e murit mbajtës tek përroi Levan*" i hartuara nga ing. Z.T. me funksion spec/urbanistike (teknik ndërtimi) dhe i nënshkruar nga ana e ish-Kryetarit të Komunës z. Xh.M..

Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, dhe dokument për kontrollin e këtij preventivi nëse është i saktë ose jo.

Nga auditimi rezulton se fondi limit i përcaktuar sipas këtij preventivi në vlerën 2,093,452 lekë pa TVSH. është rënduar padrejtësisht, pasi sipas këtij preventivi është futur një zë punimeSH në **vlerën 170,000 lekë** (*riparim i pasarel dhe lyrje me bojë*), ku megjithëse njësia paraqitet zero, sasia është zero dhe vlera është 170,000 lekë, në fund vlera 170,000 lekë, fakt i cili nuk qëndron, foto.

Në këto kushte nga AK është rënduar padrejtësisht fondi limit, duke e rënduar atë për vlerën **170,000 lekë, vlerë e cila konsiderohet si dëm në buxhetin e komunës**, pasi kjo vlerë është hedhur për prokurim pavarësisht nga ofertat e paraqitura nga OE pjesëmarrës, veprime në kundërshtim me nenet 57 dhe 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi hartuesi preventivit z. Z.T..**

B- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Nuk disponohet dokumentacion ligjorë që tregon se NJP të ketë bërë ftesën për 5 OE pjesëmarrës në tender siç përcaktohet në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 39 pika 4.

C- Zhvillimi i procedurës: Me procesverbal nr. 2, datë 12.05.2015 është bërë hapje e procedurës konkurse, në të cilën u konstatuan se në këtë prokurimi kanë marrë pjesë 6 (*këtu e në vijim OE*) dhe fillojë Shqyrtimi i ofertave dhe dokumentacionit të hedhur në sistem.
Sipas procesverbalit nr. 3, datë 19.05.2015 të KVO në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 6 OE, *respektivisht*:

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta ekonomike/ lekë	Vlerësimi i KVO-së
1.	"N. 1934"	1,388,700	Kualifikohet
2.	"2Z K."	1,440,222	Kualifikohet
3.	"S."	1,467,300	Kualifikohet
4.	"D. J."	1,499,461	Kualifikohet
5.	"I."	1,633,700	kualifikohet
6.	"SH. C."	1,671,420	kualifikohet

Në përfundim sipas procesverbalit ne. 3, datë 19.05.2015 është bërë vlerësimi i dokumentacion ligjorë të OE pjesëmarrës në të cilën është konstatuar se të 6 OE janë kualifikuar nga KVO.
Është bërë vlerësimi i ofertave ekonomike, ku në përfundim është vendosur të SHpallet fitues OE "N. 1934" me vlerë ofertë 1,388,700 lekë, si oferta më e ulët.
Me Shkresën nr. s'ka, datë 27.03.2015 është hartuar dhe dërguar për miratim tek Titullari AK Raporti Përmbledhës, duke bërë të gjitha SHpjegimet e duhura dhe fazat e procedurës, raport i cili **nuk është miratuar** nga titullari i Autoritetit Kontraktor (këtu e ne vijim AK), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 68-*Raporti përmbledhës,* **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë nga z. M.N.me funksion Zv/Kryetar dhe titullari i AK z. Xh.M.**.

4- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2013 për nevojat e Komunës Levan".*

Urdhër prokurimi nr. 3, datë 01.04.2013. Fondi limit 1,704,167 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 3, datë 01.04.2013 B. M. *kryetar,* M.N.& Z.T. *anëtar*	KVO me Shkresën nr. 3/1, dt. 01.04.2013 E.B. *Kryetar,* U.M. & Sh.H. *anëtar*
Procedura e prokurimit –Negocim pa SHpallje, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "V. P." SHPK	Vlera fituese 1,704,167 pa TVSH. (ose 22 lekë/litri,
Dt e hapjes së tenderit 01.04.2013.	Dif nga fondi limit 0 lekë.	Kontrata nr.3/5, datë 12.04.2013.
Marrin pjesë **2** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me vendim nr. x, datë x,	Vlera e kontratës 2,045,000 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 260 ditë	Titullar i AK – Xh.M.

A- ParaSHikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.
Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna Levan për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 1,704,167 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I

pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP.**

B- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në Shpalljen e fituesit.

Me urdhër prokurimin nr. 2, datë 07.03.2013 është miratuar fondi limit për blerje karburanti me vlerë 1,704,167 lekë pa TVSH., me procedurë "*KP*", si dhe NJP si në pasqyre.
Formulari i njoftimit të kontratës përcaktohet fondi limit prej 1,704,167 lekë pa TVSH., procedura "*Kërkesë me propozim",* data e zhvillimit të tenderit datë 19.03.2013.
Me procesverbal nr. 1, datë 07.03.2013 NJHD ka hartuar kërkesat ligjore dhe teknike për zhvillimin e procedurës "*Blerje karburanti për vitin 2013 për Komunën Levan*" .
Me Shkresën nr. s'ka, datë 07.03.2013 të ish-Kryetarit të Komunës z. Xh.M. është njoftuar APP për anulim procedure si rezultat i ndryshimit të dokumenteve standarte (*këtu e në vijim DST*) në referencë të VKM nr. 1, datë 01.02.2013 "Për miratimin e disa SHtesave dhe ndrySHimeve në DST për furnizimin e mallrave, SHërbimeve dhe kryerjen e punimeve" SHpallur në buletinin e prokurimeve të APP periudhën Mars 2013, **por që në dosje nuk ka asnjë gjurmë (dokumentacion) që tregon arsyen e këtij ndryshimi dhe hartimi i dokumenteve shtesë siç pretendohet në shkresë,** në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu VII-*KuSHtet të përgjithSHme për zbatim*, pika 1 germat (a, b), ***veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJHD i përbërë z. Blerta MemaSHaj dhe z. M.N. me funksion Zv/Kryetar dhe përgjegjës finance dhe Z. T. me funksion specialist urbanistike.***

- Me Shkresën nr. s'ka, datë 19.03.2013 të ish-Kryetarit të Komunës z. Xh.

M. është njoftuar APP për anulim procedure si rezultat i ndrySHimit të dokumenteve standarte (*këtu e në vijim DST*) në referencë të VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, me pretendimin se nuk u paraqit asnjë ofertë.
Me Shkresën nr. s'ka, datë 01.04.2013 të ish-Kryetarit të Komunës z. Xh.M. është njoftuar APP për anulim procedure si rezultat i ndrySHimit të dokumenteve standarde, në referencë të VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, me pretendimin se nuk u paraqit asnjë ofertë.
Në dy rastet e mësipërme nga KVO nuk është mbajtur procesverbal për argumentimin e anulimit të procedurë, duke mos zbatuar asnjë procedurë të ndjekur, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu V-*Zhvillmi procedurës*, pika 4, germat (a, b) dhe pika 1, ***veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë nga: E. B. me funksion Zv/Kryetar dhe P/Zyrës së Shërbimeve, U.M. dhe Sh.H. me funksion inspektor i taksës së tokës.***

Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nuk ka ftesën e operatorëve pjesëmarrës në këtë procedura, e cila është zhvilluar në formë "*Negocim pa shpallje paraprake",* veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu VI-*Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogël, Shërbimet e konsulentë, konkursi i projektimit*, pika 1-*Kërkesë me propozim*, pikat (a, b, c)**.** Gjithashtu nuk është zbatuar Kreu IV-*Llojet dhe përzgjedhja e procedurës*, e VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pika 5.

C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit. Me procesverbal nr. 2, datë 12.04.2013 KVO ka vijuar me procedurën e zhvillimit të tenderit me objekt '*Blerje karburanti viti 2013",* në të cilën SHprehen se në datën dhe orën e caktuar janë paraqitur 2 ofertues, konkretisht:

a-Subjekti "V. P." me Nipt K63...K dhe ofertë 22 lekë/litri pa TVSH.,

b-Subjekti "A.- 1" me Nipt K62...B dhe ofertë 24 lekë/litri pa TVSH..

Komisioni ka bërë vlerësimin e këtyre dy ofertave, duke kualifikuar si të vlefSHme ofertën ekonomike të subjektit "**V. P." me marzh fitimi 22 lekë/litri.**

Më Shkresën nr. 5/4, datë 12.04.2013, KVO përgatiti raportin përmbledhës duke përSHkruar procedurën e ndjekur dhe dërgon për miratim tek titullari AK Z. Xh.M., **raport i cili nuk është miratuar nga ana e tij, pasi nuk ka vendim miratimi në dosje,** veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, germa "gj" e pikës 4 të Kreut V, ***për të cilën ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e KVO: E. B. me funksion Zv/Kryetar dhe P/Zyrës së Shërbimeve, U.M. dhe Sh.H. me funksion inspektor i taksës së tokës***.

5- Tenderin e zhvilluar me objekt *"Blerje karburant 2015 për nevojat e Komunës Levan".*

Urdhër prokurimi nr. 1, datë 24.04.2015 Fondi limit 1,575,000 lekë	NJHDT sipas urdhrit nr. 1, datë 24.04.2015 P.K. *Kryetar*, Z.T. & Sh.Gj. *anëtarë*	KVO me urdhrit nr. 1/1, datë 24.04.2015 M.N.*Kryetar*, Sh.H. & E.Gj. *anëtarë*
Procedura e prokurimit – Kërkesë me propozim pa SHpallje paraprake, Burimi fin. Të ardhurat e komunës.	Fitues "V.P." SHPK	Vlera fituese 1,497,000 lekë (9.5% marzh fitimi ose 15.96 lek/litri),
Dt e hapjes së tenderit 04.05.2015.	Dif nga fondi limit 78,0100 lekë.	Kontrata nr. s'ka, datë 04.05.2015.
Marrin pjesë **2** OE S`kualifikuar **0** OE	Miratimi i procedurës me Shkresën nr. s'ka, dt. 25.03.2015,	Vlera e kontratës 1,796,400 lekë me TVSH..
Ankimime në AK - s'ka Ankimime në KPP - s'ka	Afati kontratës 150 ditë	Titullar i AK – Xh.M.

***A*- ParaSHikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.**

Nuk ka dokumentacion mbi procedurën e ndjekur për llogaritjen e fondit limit, si dhe kërkesë për nevojat që ka ish-Komuna Libofsh për të argumentuar vlerën e fondit limit të përcaktuar prej 1,575,000 lekë me destinacion blerje karburanti, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 27.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Për planifikimin e nevojave për fondit e planifikuar, nuk ka asnjë të dhënë se sa mjete ka në dispozicion, sa është shpenzimi i km për çdo mjet si dhe se sa është planifikimi i km që do të përshkruhen.

B- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në shpalljen e fituesit.

Sipas të dhënave në faqen e internetit www.app.gov.al dhe dokumentacionit në dosje, konstatohet se kjo procedurë prokurimi është hedhur tre herë në tender elektronik dhe për mungesë pjesëmarrje nuk është bërë i mundur kryerja e tij.

Për këtë Titullari i AK ka bërë njoftimet në APP për anulim, konkretisht me Shkresën nr. s'ka datë 10.04.2015 dhe Shkresën nr. s'ka datë 30.03.2015.

Në buletinin e datave 07.04.2015 dhe 20.04.2015 të faqes së APP është bërë shpallja e anulimit të tenderit për mungesë pjesëmarrje dhe gabimit të elektronik në faqen e internetit.

Sipas të dhëna në dosje, nuk disponohet asnjë procesverbal për të argumentuar arsyen e anulimit të tenderit si dhe nuk është mbajtur Raport Përfundimtar në të tre fazat e procesit të anulimit, për të argumentuar arsyet e anulimeve, veprime në kundërshtim me nenin 6, të VKM nr. 914, datë 27.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë nga: **z. M.N.me funksion Zv/Kryetar dhe P/Zyrës së Financës, z. Sh.H. me funksion specialist agronom në MMT dhe zj. E.Gj. me funksion ish Inspektore e ZTT.**

Konstatohet se dosja nuk është e inventarizuara dhe të numëruara, veprim në papajtueSHmëri me ligjin nr.9154, datë 06.11.03 "Për Arkivat" dhe aktet ligjore në zbatim të tij dhe me përcaktimin në nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08.07.10, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.11, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 36.

Pas dëSHtimit në sistemin elektronik të kësaj procedure (tre herë), ky tender është zhvilluar me procedurë "*Kërkesë me propozim pa shpallje paraprake".*

Sipas procesverbalit datë 04.05.2015 dhe në mbëSHtetje të urdhër prokurimit nr. 1/1, datë 24.04.2015 dhe nr. 1, datë 24.04.2015 janë ftuar të marrin pjesë 5 OE, konkretisht: *"LAMCE", "K OIL", "V.P.", "R. P." dhe "A. 1".*

Sipas këtij procesverbali janë paraqitur në tender 2 subjekte "V.P." dhe "A.-1". Pas Shqyrtimit të dokumentacionit ligjorë e teknik të dy këto operatorë janë kualifikuar të cilat kanë këto oferta:

a-Operatori "V.P." për marzh fitimi 14.5 % ose 23.33 lekë/litri, në vend të parë.

b- Operatori "A.-1" për marzh fitimi 15.3846 % ose 25 lekë/litri, në vend të dytë.

KVO ka vlerësuar në vend të parë operatorin "V.P." pasi ka çmimi më të leverdishëm.

Në përfundim nga KVO është mbajtur raporti përmbledhës në të cilin janë përSHkruar të gjitha fazat e procesit deri ne Shpalljen e fituesit, raport ky i miratuar nga Titullari i AK me Shkresën nr. s'ka, datë 04.05.2015.

Me Shkresën nr. s'ka, datë 04.05.2015 të Titullarit të AK është bërë njoftimi për operatorët e kualifikuar sipas dokumenteve.

Me Shkresën nr. --, datë 04.05.2015 të Titullarit të AK është bërë njoftimi i fituesit "V.P." *për marzh fitimi 14.5 % ose 23.33 lekë/litri, në vend të parë.*

Me Shkresën nr. 353/1, datë 08.05.2015 të Titullarit të AK është bërë njoftimi APP për lidhje kontrate.

Nga Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit fitues "V.P." (dokumentacion i cili ndodhej në dosje), konstatohet se ky operator nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, konkretisht:

-Nuk është paraqitur vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve për taksat e tarifat vendore për vitet 2014 dhe 2015 (pika 2.2);

-Vërtetimi i paraqitur nga Administrata Tatimore nr. 5179/1, datë 05.05.2015 në të cilën thuhej se subjekti është debitor për TVSH. në SHumën 37,575 lekë, tatim fitimi në SHumën 392 lekë dhe dënime të tjera në shumën 500,000 lekë (pika 1.2);

-Nuk ka paraqitur deklaratë për xhiron e viti 2014, siç kërkohet në pikën 2.2 të DST;

-Nuk ka paraqitur kontratë për shërbime të ngjashme në masën 405 të vlerës (pika 2.3).

-Nuk është bërë sigurimi i ofertës prej 2%.

Konkluzioni: Nga sa trajtuam më sipër, **KVO nuk duhej të kualifikonte** OE "V.P.", por duhej të anulonte procedurën dhe zhvillohej procedurë e re, pasi OE nuk plotëson kriteret ligjore të DST dhe miratuar nga AK, veprime në kundërshtim me nenin 46, 53 dhe 54, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi komisioni i KVO **përbërë nga*: z. M.N.me funksion Zv/Kryetar dhe P/Zyrës së Financës, z. Sh.H. me funksion specialist agronom në MMT dhe zj. E.Gj. me funksion ish Inspektore e ZTT.**

(Gjerësisht trajtuar në faqen84-160, të Projektraport Auditimit)

Komente dhe sqarime: *Për sa kundërshtoni në shkresën nr. 2085/108, datë 22.05.2017 (ardhur në KLSH me datë 23.05.2017), mos paraqitjen e dokumentacionit argumentues për rastet e anulimit të procedurave dhe në fazën e kundërshtive nuk paraqisni asnjë procesverbal të KVO për të argumentuar arsyet e anulimit, por keni paraqitur vetëm shkresat adresuar APP për anulimin e procedurave.* ***Argumenti juaj nuk qëndron.***

IX/5.1. Zbatimi i kontratave.

Lidhja dhe zbatimi i kontratave, zbatimi i kërkesave ligjore e nënligjore për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit.

Në Bashkinë Fier, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, u audituan 1 kontratë zbatimi punimesh e cila ishte përfunduar, ishte kolauduar dhe ishte marrë në dorëzim nga ish-Komunat, Ndërsa një prej kontratave u auditua për hartimin e fondit limit, pasi ishte objekt ende i papërfunduar.

Nga ky auditim rezultuan:

- Janë përfituar më tepër në vlerë, duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të SHtetit**9,590,880 lekë pa TVSH., nga të cilat:**

- Janë preventivuar më tepër fond limit në vlerën **8,096,380 lekë pa TVSH.,** duke SHkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të SHtetit dhe njësisë vendore
- Diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **500,000 lekë pa TVSH.;**
- Zëra punimeSH qe nuk janë kryer sipas kërkesave të projektit por janë ndryshuar pa u SHoqëruar me çmimin përkatës duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën**994,500 lekë pa TVSH..**
-

- Mangësi në dokumentacion;

1."**Riveshje e Dy Rrugëve Paralele "Hidrovor - Bregdet" dhe Hapje Traseje për Rrugën Paralel me Bregun"**, ish-Komuna Dermenas, Fier.

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike nr. - prot., datë 03.09.2014 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Dermenas përfaqësuar nga ish-kryetari z. V. F. dhe operatorit ekonomik "H. K." SHPK përfaqësuar nga administratori i SHoqërisë z. A. A.. Vlera e kontratës bazë është 9,000,990 lekë pa TVSH. ose 10,801,188 lekë me TVSH.. Afati zbatimit të kontratës bazë është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes.

Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve mungon në dosjen teknike të punimeve.

Kontrata me kolaudatori e punimeve mungon në dosjen teknike të punimeve.

Objekti i kontratës është zbatimi i punimeve në objektin: **"Riveshje e Dy Rrugëve Paralele "Hidrovor - Bregdet" dhe Hapje Traseje për Rrugën Paralel me Bregun"**, ish-Komuna Dermenas, Fier.

Punimet kanë filluar më datë 05.09.2014 dhe kanë përfunduar me datë 02.11.2014. Akti i kolaudimit të punimeve ka datën 06.11.2014. Objekti është marrë përkohësisht në dorëzim më datë 10.11.2014, pa komision të marrjes në dorëzim të punimeve, por akti i marrjes në dorëzim është firmosur vetëm nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve dhe ish-Kryetari i Komunës Dermenas z. V. F..

b. Mbi realizimin e pagesave.

Gjatë zbatimit të kontratës së punimeve civile dhe pas përfundimit të punimeve janë likuiduar situacionet 100 % të vlerës së kontratës, duke përfshirë 5 % të vlerës së kontratës që i përket vlerës së garancisë së punimeve.

c. Mbi mbajtjen e dokumentacionit teknik.

Konstatohet se në dokumentacionin teknik mungojnë:

1. Raportet e testimit të për çakullin dhe rërën bituminoze të përdorur në objekt;
2. Certifikatat e cilësisë për materialet e përdorura në objekt;
3. Mungon pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip;
4. Mungon dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse;
5. Mungon plan-organizimi i punimeve të ndërtimit;
6. Mungon libri i kantierit;
7. Grafiku i punimeve;
8. Mungojnë aktet e inspektimeve të kryera gjatë zbatimit të punimeve;
9. Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve;
10. Kontrata me kolaudatori e punimeve;
11. Projekti i zbatimit;
12. Fotot gjatë zbatimit të punimeve;

d. Mbi realizimin e punimeve të kontratës dhe mbajtjen e dokumentacionit teknik.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca *më tepër në vlerë, në vlerën* **1,494,500 lekë pa TVSH. duke shkaktuar dëm ekonomik,** *nga të cilat vlera***500,000 lekë pa TVSH.** *për punime të pakryera në fakt dhe vlera* **994,500 lekë pa TVSH.** *si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u SHoqëruar me çmimin përkatës.*

- **Diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 500,000 lekë pa TVSH.**

Kjo diference del si rrjedhojë e situacionimin dhe likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Konkretisht tabela:

Tabela 1

Nr.	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca ne +	
							Vol.	Vlera
Riveshje e Dy Rrugëve Paralele "Hidrovor - Bregdet" dhe Hapje Traseje për Rrugën Paralel me Bregun								
1	Shtresë çakulli mbeturinë kave t=20cm, përhapur dhe ngjeSHur me makineri	m^2	400	2,500	2,500	1,250	1,250	500,000

	në rrugën paralel me bregun ml 500, B=5m							
							Total	**500,000**

Të argumentuara këto si më poSHtë:

- Zëri 1: Shtresë çakulli mbeturinë kave t=20cm, përhapur dhe ngjeSHur me makineri në rrugën paralel me bregun ml 500, B=5m

Situacioni përfundimtar pasqyron 2,500 m^2 Shtresë çakulli mbeturinë kave t=20cm, përhapur dhe ngjeSHur me makineri në rrugën paralel me bregun ml 500, B=5m gjithsej. Libri i masave pasqyron 2,500 m^2 Shtresë çakulli mbeturinë kave t=20cm, përhapur dhe ngjeSHur me makineri në rrugën paralel me bregun ml 500, B=5m. Në fakt, nga krahasimi i volumeve të pasqyruara në projekt si dhe nga matjet e kryera në terren rezultoi volumi prej 1,250 m^2 SHtresë çakulli mbeturinë kave t=20cm, përhapur dhe ngjeshur me makineri në rrugën paralel me bregun ml 500, B=5m dhe jo 2,500 m^2 sa pasqyrohet në situacionet përfundimtar. Kjo diferencë vjen si rezultat pasi nga verifikimi në terren rezulton se ky volum pune nuk është kryer. Por duke qenë se në disa vende rruga ka një gjerësi 0.5 më të madhe se sa projekti te SHtruar me rërë bituminoze, atëherë ky zë është llogaritur vetëm për këtë gjerësi 0.5m nga një krah i rrugës, ndërkohë që nga libreza e masave është pasqyruar si i realizuar nga të dy krahët e rrugës. Për rrjedhojë sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin 1,250 m^2 SHtresë çakulli mbeturinë kave t=20cm, përhapur dhe ngjeshur me makineri në rrugën paralel me bregun ml 500, B=5m. (2,500-1,250)

Tabela 2

Nr.	Zëri i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi i ofertës	Çmimi faktik	Diferenca ne +	
						Çmim	Vlera
	Riveshje e Dy Rrugëve Paralele "Hidrovor - Bregdet" dhe Hapje Traseje për Rrugën Paralel me Bregun						
2	SHtresë rëre bituminoze t=10cm për RiveSHje të rrugëve ekzistuese	m^2	11,050	300	210	90	994,500
						SHuma	**994,500**

- Zëri 2: Shtresë rëre bituminoze t=10cm për RiveSHje të rrugëve ekzistuese.

Situacioni përfundimtar pasqyron 11,050 m^2 shtresë rëre bituminoze t=10cm për riveshje të rrugëve ekzistuese gjithsej. Libri i masave pasqyron në mënyre analitike volumin prej 11,050 m^2 shtresë rëre bituminoze t=10cm për riveshje të rrugëve ekzistuese. Në fakt, nga verifikimi në terren rezultoi se trashësia e rërës bituminoze ishte jo më shumë se 7 cm. Duke marrë në konsideratë çmimin e ofertuar nga vetë sipërmarrësi i punimeve 300 lekë/m^2 shtresë rëre bituminoze t=10cm për riveshje të rrugëve ekzistuese, rezulton se çmimi faktik i këtij zëri është 210 lekë/m^2 për trashësi t=7 cm. Për rrjedhojë sipërmarrësi ka përfituar më tepër si rrjedhojë e diferencës në çmim vlerën 90 lekë/m^2.

Si përfundim, **janë përfituar nga "H K" SHPK** *më tepër në vlerë, në vlerën* **1,494,500 lekë pa TVSH. duke shkaktuar dëm ekonomik,** *nga të cilat vlera* **500,000 lekë pa TVSH.** *për punime të pakryera në fakt dhe vlera* **994,500 lekë pa TVSH.** *si pasojë ndrySHimit të zërave të punimeve pa u SHoqëruar me çmimin përkatës.*

-**Nga mbikëqyrësi i punimeve**, *Ing. N. M.*, nuk është zbatuar ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, dhe konkretisht neni 7.

- **Nga mbikëqyrësi i punimeve**, *Ing. N.M.* dhe **nga kolaudatori i punimeve**, *Ing. F.G.*, nuk janë marrë masa për zbatimin e Udhëzimit nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.
- **Nga mbikëqyrësi i punimeve**, *Ing. N.M.* dhe **nga kolaudatori i punimeve**, *Ing. F.G.*, nuk është zbatuar udhëzimi nr.3, datë 15.02.2001 "*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave* "***Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit***", pika 3.2 dhe 3.3.
- **Nga mbikëqyrësi i punimeve**, *Ing. N.M.* dhe **nga kolaudatori i punimeve**, *Ing. F.G.*, nuk është zbatuar udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 "*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave* "***Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit***"", *pika 4, paragrafi 4 ku përcaktohet dokumentacioni i nevojSHëm në dosjen teknike.*
- **Nga mbikëqyrësi i punimeve**, *Ing. N.M.* dhe **nga kolaudatori i punimeve**, *Ing. F.G.*, nuk është zbatuar Udhëzimi nr. 1 datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë.
- **Nga mbikëqyrësi i punimeve**, *Ing. N.M.* dhe **nga kolaudatori i punimeve**, *Ing. F.G.*, nuk është zbatuar Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, pika 8.3 .
- **Nga mbikëqyrësi i punimeve**, Ing. N.M. dhe **nga kolaudatori i punimeve**, Ing. F.G., nuk është zbatuar Vendimi Nr.514, datë 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.9.2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave" për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", Pika 9, paragrafi i dytë.
-**Nga kolaudatori i punimeve**, Ing. F.G., nuk është zbatuar ligji nr., 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", dhe konkretisht neni 12 dhe udhëzimi nr. 3 datë 15.02.200 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" e konkretisht Kreu II, Pika 3.

2. "**Rikonstruksioni i Rrugës Topojë – SHeqMarinëz - Seman"**, ish-Komuna Topojë Seman, Fier.
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 216/7 prot., datë 15.10.2012 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Topojë Seman, Fier përfaqësuar nga ish-kryetari z. A.V. dhe operatorit ekonomik "B.B" SHPK, përfaqësuar nga administratori z. B D. Vlera e kontratës bazë është 70,449,244 lekë pa TVSH. ose 84,539,093 lekë me TVSH.. Afati zbatimit të kontratës bazë është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data e fillimit të punimeve.
Mbi hartimin e fondit limit:
Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës të lidhur midis palëve, për këtë objekt është 8,234,366 lekë pa TVSH. ose 10.5 % më pak se fondi limit.
Nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projekt – preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se:

- Janë preventivuar më tepër fond limit në vlerën 8,096,380 lekë pa TVSH., duke SHkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të SHtetit dhe njësisë vendore si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve gjatë hartimit të projekt-preventivit të objektit: "Rikonstruksioni i Rrugës Topojë – Sheqmarinëz - Seman", ish-Komuna Topojë Seman, Fier.

